



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



Muhamed Xhevàd Mugnijeh

**FIKHU I IMAM**  
**XHA'FERR SADIKUT**

*(Paqja goftë mbi të!)*

**XI**

**Titulli: Fikhu i Imam Xha`ferr Sadikut** (*Paqja qoftë mbi të!*) **XI**

**Autori: Muhamed Xhevàd Mugnijeh**

**Përktheu: H. Selim Stafa** (*Allahu e mëshiroftë!*)

**Recensent: H. Vullnet Merja**

**Redaktoi: Jerida Kulla**

**Perkujdesja garfike: Sabrie Feza**

**Kapaku: Sabrie Feza**

**Botoi: Shoqata FLLADI**

## بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

### DIVORCI

Në hadithin e transmetuar prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) thuhet: “Hallalli më i urryer te Allahu, është divorci. Allahu urren çdo burrë që lë një grua, për të marrë një grua tjetër, si dhe çdo grua që, sapo ndahet me një burrë, martohet me një burrë tjetër. S’ka gjë më të dashur te Allahu se një shtëpi që popullohet me martesë dhe s’ka shtëpi më të urryer te Allahu, që priset me ndarjen.”

Divorci ka katër kolona: divorcuesi, e divorcuara, formula e divorcit dhe dëshmitarët që dëshmojnë divorcin.

## **Divorcuesi**

Për divorcuesin kërkohen kushtet vijuese:

### **1- Arritja e pjekurisë seksuale**

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe me dëshminë e autorit të librit “El Hadaik” se divorci i fëmijës është i pavlefshëm, qoftë kur fëmija dallon, qoftë kur nuk dallon, qoftë kur ka mbushur dhjetë vjeç, qoftë kur nuk ka mbushur dhjetë vjeç, për shkak se arritja e pjekurisë seksuale të divorcuesi është prej kushteve të përgjithshme.

Për këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nuk lejohet divorci i djalit, derisa ai të arrijë pjekurinë seksuale.”

Ka transmetime të tjera që e lejojnë divorcin e fëmijës, kur ai mbush dhjetë vjeç, por fukahatë më të dëgjuar nuk i kanë pranuar këto transmetime, të cilat autori i librit “Esh’sheràiu” i ka cilësuar të shkallës “Daij” -“Dobët”.

Autori i librit “El Xheuahir” i ka mbartur në rastin kur fëmija dhjetë vjeç ka arritur pjekurinë seksuale dhe gëzon shëndet të plotë mendor, ashtu siç ndodh në disa vende të nxehta.

## **2- Mendja**

Nuk është i vlefshëm divorci i të çmendurit, qoftë kur gjendja e çmendurisë te ai është e përhershme, qoftë kur është me periudha. Gjithashtu, nuk është i vlefshëm divorci i atij që ka humbur ndërgjegjen, as i atij që ka humbur mendjen për shkak të etheve, as i atij që është në gjumë. Nuk është i vlefshëm as divorci i të dehurit. Kjo është e barabartë, qoftë kur është dehur me dashjen e tij, qoftë kur është i detyruar të dehet.

## **3- Përzgjedhja**

Nuk ndodh divorci i të detyruarit. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Për këtë çështje fukahatë kanë një fjalë të përbashkët, duke shtuar edhe tekstet përgjithësuese, siç është hadithi: *“Prej umetit tim është hequr dënimi për punët e detyruara”*, si dhe transmetimi i ardhur prej Zerares, prej Imam Xhafer Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): *“Divorci i të detyruarit nuk është divorc dhe as lirimi i robit prej tij, nuk është dhënie lirie.”*

## **4- Qëllimi**

Ai e shqipton divorcin me fjalë, duke pasur qëllim kuptimin e vërtetë të divorcit. Sikur ai të ketë qëllim divorcin, por nuk e shqipton fjalën “divorc”, ose e shqipton fjalën “divorc”, por nuk kishte qëllim divorcin për shkak harrese, ose gabimi, ose për shkak gjumi, ose dehje, ose për shkak të rraskapitjes, divorci në këto gjendje nuk ndodh.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Me fjalën e përbashkët të fukahave, sipas transmetimit të ardhur në “Sahijhun” e Hish’shàmit, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “S’ka divorc, përveç atij që ka qëllim divorcin.”, si dhe fjala e Imam Bakirit, babait të Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “S’ka divorc pa nijet. Sikur një burrë të divorcojë dhe nuk ka pasur nijet divorcin, divorci i tij nuk është divorc.”

Burri e shqipton formulën e divorcit dhe pastaj thotë: “Nuk kisha qëllim divorcin.” A pranohet fjala e tij?

*Përgjigje:* Kur gruaja e vërteton fjalën e tij, pretendimi i burrit pranohet. Kjo është e barabartë, qoftë kur gruaja është duke kaluar kohën e pritjes ligjore, qoftë kur është jashtë kësaj kohe.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Nuk gjej asnjë kundërshtim në pranimin e pretendimit të tij, kur atë e vërteton gruaja, sepse kjo e drejtë është e kufizuar ngushtësisht vetëm te ata të dy. Madje fjalët e qarta të fukahave dëshmojnë pranimin e pretendimit të burrit, edhe nëse koha e pritjes ligjore ka mbaruar.”

Në qoftë se gruaja nuk e vërteton thënien e burrit, pranohet pretendimi prej tij, derisa gruaja vazhdon të jetë duke kaluar kohën e pritjes ligjore, për shkak se lidhja martesore vazhdon të ekzistojë gjatë kësaj kohe. Nuk dëgjohet fjala e burrit, kur burri e pretendon divorcin pas përfundimit të kohës së pritjes ligjore, për shkak se ky vonim është i ngjashëm me gënjeshtren e tij, ashtu siç ka ardhur në librin “El Xheuahir”, i cituar prej librit “Keshfu Lithàm”.



## **Divorci i kujdestarit**

Babai s'ka të drejtë të divorcojë për djalin e tij të vogël. Vetëkuptohet akoma më shumë s'ka të drejtë të divorcojë për të tjerët, ashtu siç thuhet në hadithin: "Divorci është në dorën e atij që ka të dejtë të vërë dorën në kërcirin e këmbës."

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka martuar djalin e tij në moshë të vogël. A është problem kjo gjë? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Për martesën s'ka problem."

Pyetësi i tha: "A është i vlefshëm divorci i babait (të divorcojë gruan e djalit të tij të vogël)?" Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: "Jo."

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Hadaik", i cili ka thënë se, kur fëmija arrin pjekurinë seksuale në gjendje çmendurie, në atë mënyrë që çmenduria është vijim i çmendurisë së tij që nga mosha e vogël, në këtë gjendje, divorcin për këtë fëmijë e bën babai i fëmijës, ose gjyshi i tij nga ana e babait, patjetër kur divorcin e kërkon interesi.

Në qoftë se ky fëmijë i çmendur nuk ka as baba e as gjysh nga ana e babait, divorcin për këtë fëmijë e bën gjykatësi.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për divorcin e idiotit. Kush e bën divorcin e idiotit? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Divorcin për këtë e bën kujdestari i tij, të cilin unë e shikoj në pozitën e Imamit."

Autori i librit "El Xhevahir", këtë transmetim dhe të transmetime të tjera që kanë ardhur në lidhje me këtë çështje, i ka

komentuar me këto fjalë: “S’ka asnjë komplikim në atë që tregojnë tekstet për vlefshmërinë e divorcit prej kujdestarit për idiotin.”

### ***Prokurimi për të divorcuar***

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe me dëshminë e autorit të librit “El-Hadaik”, të cilët kanë thënë: “Kur burri nuk është pranë gruas, burri ka të drejtë të prokurojë cilin të dëshirojë për të divorcuar gruan e tij, për shkak se argumentet për këtë çështje janë të pakushtëzuara.

Shejkhu Et Tùsij, Ibn Hamza, Ibi El Berr’rràxh dhe fukaha të tjerë të dëgjuar kanë thënë se prokurimi për divorcin është i vlefshëm, kur burri është larg gruas dhe nuk është i vlefshëm, kur burri është pranë gruas.

*Pyetje:* A lejohet që vetë gruaja të jetë e prokuruar prej burrit të saj për të divorcuar vetveten?

Autori i librit “El Hadaik”, tekstualisht, ka thënë: “Shejkhu i madh, i njohur me epitetin shejkhu Et Tùsij, në librin “El Mepsat” ka thënë: “Në qoftë se burri dëshiron ta lërë punën (divorcin) në dorën e gruas, te ne (te shi’at), bazuar në thënie të shkallës “Sahijh” të medh’hebit, nuk lejohet.”

Autori i librit “El Hadaik” ka qëndruar në këtë fjalë dhe nuk ka dhënë asnjë gjykim, kurse autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në të gjitha gjendjet, për rezervë nuk duhet të lihet divorci në dorën e gruas.”

Është e kuptueshme që këtu patjetër duhet të jemi të rezervuar, për shkak se puna e nderit të gruas është plotësisht si puna e gjakut. Për rrjedhojë, prokurimi i gruas nga ana burrit të saj për të bërë divorcin e vetvetes, është prej punëve të dyshimta, prej të cilave është detyrë të hiqet dorë. Veç kësaj, duhet të shikohet se kur është prokurimi i gruas për të bërë divorcin, pasi është bërë kontrata e martesës dhe kur në tekstin e kontratës është vënë kusht në atë mënyrë që gruas i lejohet të divorcojë veten, kur të dëshirojë, kushti prishet me vendosmëri të plotë, sepse ky kusht është mashtrim me ligjin e Allahut, sepse e le divorcin në dorën e gruas, sepse divorci, sipas këtij kushti, ndodh pavarësisht nga burri.

Fukahatë janë bashkuar në një fjalë të vetme dhe janë shprehur për prishjen e këtij kushti, sepse vënia e këtij kushti është në kundërshtim me Librin e Allahut dhe me Sunetin e Profetit të Tij.

Imam Bakiri, babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një burrë që ka bërë martesë me një grua dhe ka vënë kusht kundër vetes së tij, që në dorën e gruas të jetë kryerja e marrëdhënieve intime dhe divorci. A ka vepruar drejt ky burrë? Imam Bakiri është përgjigjur: *“Ka kundërshtuar Sunetin dhe i ka lënë në dorë një të drejtë atij që nuk i takon, sepse në martesë, burri ka detyrim të paguajë shumën e kurorës, kurse kryerja e marrëdhënieve intime dhe divorci janë në dorën e burrit.”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“S’ka divorc, përveçse për atë që ka qëllim të divorcojë.”*

Sikur prokurimi i gruas, nga ana e burrit të saj për të kryer divorcin të ishte i vlefshëm, do të ishte e vlefshme që gruaja të

prokurohej t'i shiste një burri një zgjua blete me një kontratë të detyrueshme, ky burrë do të kishte të drejtë ta martonte këtë grua me cilën të dojë ai, madje edhe atëherë kur gruaja nuk e miraton martesën me atë burrë. Nuk mendoj se dikush do të guxojë ta hapë këtë portë, duke i ditur pasojat shkatërruese.

### ***E divorcuara***

Kolona e dytë prej kolonave të divorcit është e divorcuara. Që gruaja të quhet e divorcuar, kërkohen kushtet vijuese:

1- Gruaja realisht të jetë bashkëshorte e përhershme. Kur burri thotë: "U martova me filanen dhe ajo është e divorcuar.", ose burri thotë: "Me çdo grua që unë do të martohem, ajo është e divorcuar.", me fjalën e përbashkët të fukahave, ky divorc është fjalë boshe. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Madje kjo është prej domosdoshmërive të medh'hebit."

2- Emërtimi, kur burri thotë: "Filanja është e divorcuar.", ose të bëjë me shenjë me gisht në drejtim të gruas që divorcin, duke thënë: "Ajo është e divorcuar."

Kur burri divorcon gruan me të cilën ai ka kryer marrëdhënie intime dhe nuk është grua që nuk i kanë ardhur menstruacionet, ose është grua shtatzënë, është detyrim që divorci të ndodhë, kur gruaja të jetë në kohë pastrimi dhe gjatë kësaj kohe burri nuk ka kryer marrëdhënie intime me atë grua.

Sikur burri ta divorcojë gruan, kur ajo është me menstruacione (*hajd*), ose është në periudhën e lehonisë (*nifâs*), ose ai kryen marrëdhënie intime me të duke qenë ajo në kohën e

pastrimit, me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, divorci është prishur.

Prej teksteve, në lidhje me këtë çështje, kemi fjalën e Imam Bakirit, babait të Imam Xhaferr Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: *“Kur gruaja pastrohet pas menstruacioneve, thirren të dëshmojnë dy burra të drejtë, para se burri të kryejë marrëdhënie intime me këtë grua, të cilës i kishte thënë një herë të vetme: “Je e divorcuar.”*

Err Rràzij, në komentimin e ajetit 1 të sures “Et Talàk”:

“يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِذَا طَلَّقْتُمُ النِّسَاءَ فَطَلِّقُوهُنَّ لِعَدَّتِهِنَّ”

**“O Profet, kur të divorconi gratë, divorcoini ato, kur ato janë në kohën e pastrimit...”**, fjalë për fjalë, ai ka thënë: Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të të gjithë umetit islam, divorci duhet të ndodhë, kur gruaja nuk është me menstruacione dhe gjatë kohës që ajo është pa menstruacione, burri nuk kryen marrëdhënie intime me të. Në tërësi, është detyrim që divorci të ndodhë, kur gruaja nuk është me menstruacione, ndryshe divorci nuk është divorc sipas Sunetit, duke ditur që e divorcuara, sipas Sunetit, është grua e rritur, me të cilën burri ka kryer marrëdhënie intime dhe nuk është grua që nuk i kanë ardhur menstruacionet, ose grua shtatzënë.”

Kjo është edhe esenca e asaj që kanë thënë fukahatë e shí'ave. Kur burri kryen marrëdhënie intime me gruan gjatë kohës kur ajo është me menstruacione, pas ndërprerjes së menstruacioneve, divorci që ai i bëri kësaj gruaje nuk është i vlefshëm, por duhet të pritet që gruas t'i vijnë menstruacionet e radhës, të pastrohet prej menstruacioneve dhe pastaj ai ta divorcojë gruan në këtë pastrim të ri, sepse kushti është që, pas

kryerjes së marrëdhënieve intimeve, menstruacionet vërtetojnë që gruaja nuk është shtatzënë. Divorci të ndodhë në kohën jashtë menstruacioneve. Burri, gjatë kësaj kohe nuk kryen marrëdhënie intime me gruan, domethënë që gruaja patjetër duhet të kalojë menstruacionet, që të vërtetohet se ajo nuk është shtatzënë dhe burri, në kohën e saj të pastrimit, nuk kryen marrëdhënie intime me të.

### ***Gruaja e dyshimtë***

Gruaja e dyshimtë është femra, në moshën kur gruas i vijnë menstruacionet, por asaj nuk i vijnë menstruacionet, për shkak të natyrës së saj të krijimit, ose për shkak të ndonjë sëmundjeje, ose për shkak lehonie. Divorci i kësaj gruaje, me tekst e me fjalën e përbashkët të fukahave, është i vlefshëm vetëm pasi burri të ndalojë veten prej asaj gruaje, më e pakta tre muaj. Prej teksteve kemi transmetimin që na njofton se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur rreth gruas së dyshimtë dhe ka thënë: “Burri ndalon veten prej gruas tre muaj dhe pastaj e divorcon atë.”

### ***Vlefshmëria e divorcit në kohën e menstruacioneve***

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se divorci është i vlefshëm për pesë kategori grash, në kohën e menstruacioneve dhe në gjendje të tjera:

- 1- Gruaja e vogël që s’ka mbushur nëntë vjeç.

2- Gruaja me të cilën burri nuk ka kryer marrëdhënie intime, qoftë ajo beqare ose jo, qoftë kur kanë qëndruar në vetmi të plotë, ose nuk kanë qëndruar në vetmi.

3- Gruaja s'ka menstruacione, ka mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç dhe që nuk është prej kurejshëve, ose është prej kurejshëve, por ka mbushur gjashtëdhjetë vjeç.

4- Gruaja, burri i së cilës nuk ka qenë pranë saj për aq kohë sa ajo kalon periudhën e menstruacioneve dhe kalon në kohën e pastrimit. Shumica e fukahave e kanë vlerësuar kohën e mungesës së burrit pranë gruas një muaj. Për këtë çështje ka më shumë se një transmetim të ardhur prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*). Prej këtyre transmetimeve përmendim transmetimin e përcjellë prej Is'hakut, i cili tregon se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Burri që nuk është larg gruas, kur dëshiron ta divorcojë gruan, e lë atë një muaj."* Edhe i burgosuri është në dispozitën e atij që është larg gruas.

5- Gruaja shtatzënë. Argumenti për këtë grua është nxjerrë prej transmetimeve të shumta të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*): *"Pesë gra i divorcon burri në të gjitha gjendjet: shtatzënë, barra e së cilës duket qartë, gruan me të cilën burri s'ka kryer marrëdhënie intime, kur burri është larg gruas, gruan që nuk i kanë ardhur menstruacionet, domethënë nuk ka mbushur nëntë vjeç dhe gruan që i kanë shteruar menstruacionet."*

## **Formula**

Kolona e tretë e divorcit është formula. Ligjvënësi ka thënë qartë se martesë nuk ndodh, nëse fjala martesë nuk shqiptohet qartë me fjalën “U martova me ty”, ose “Të vura kurorë”. Po kështu, Ligjvënësi e ka thënë qartë se edhe divorci nuk ndodh, nëse nuk shqiptohet fjala “Je e divorcuar.”

Në tekstin arabisht “tàlik”, domethënë të pashquar. Nëse burri fjalën “tàlik” e thotë të shquar, sipas rregullit të gramatikës së gjuhës arabe “et’tàlik” (e divorcuara), “elmutal’lekeh” (grua e divorcuar), ose në formën e foljes së kohës së shkuar “tal’laktëki” (të kam divorcuar), ose “et’talàk” (divorc), apo burri e divorcon gruan me fjalë të tjera të kësaj kategorie, divorci është i gabuar.

Në Sahihun e El Halebij’jut transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që i ka thënë gruas së tij: “Ti je e lirë!”, “Nuk ke asnjë përgjegjësi.”, ose “Të kam divorcuar përfundimisht.”, ose “Ti për mua je grua e ndaluar.” A e ka divorcuar burri me këto fjalë gruan e tij? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Këto fjalë s’janë asgjë.”

Në transmetimin e përcjellë prej Bekir bin Ajunit, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet se burri i thotë gruas, në prani të dy dëshmitarëve burra të drejtë, kur ajo nuk është me menstruacione dhe s’ka kryer marrëdhënie



intime me të: “Ti je e divorcuar.”, divorci ka ndodhur. Me fjalë të tjera, përveç kësaj fjale, divorci nuk ndodh.

Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “kurse me fjalë të tjera, përveç kësaj fjale, divorci nuk ndodh.”, është e qartë, prandaj për këtë fjalë të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk mund të bëhet asnjë komentim e asnjë shpjegim, kurse hulumtimi për këtë fjalë të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) mund të bëhet vetëm në lidhje me burimin nga është marrë teksti. Prandaj është me përparësi që divorci nuk ndodh. Madje divorci nuk ndodh as kur burrin e pyet dikush: “A e divorcove gruan tënde?” dhe burri thotë: “Po.”, qoftë edhe nëse burri, me fjalën e tij “Po”, ka qëllim të tregojë që bëri divorcin e gruas së tij.

Për atë që ka mundësi të shqiptojë fjalën arabe “tâlik”, divorci nuk ndodh, nëse ai i thotë gruas, me fjalë jo arabe “Të kam divorcuar.”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në përputhje me fjalët e fukahave më të dëgjuar dhe sipas fjalëve të teksteve.”

Divorci nuk ndodh as me shkrim, e as me shenjë, me përjashtim të memecit që s’ka mundësi të shqiptojë fjalët, për të cilin autori i librit “El-Xhevahir” ka thënë: “Një fjalë e vetme, bazuar në origjinën, edhe në fjalët e teksteve.”

Gjithashtu, divorci nuk ndodh me betim, as me të taksur, as me dhënie bese, as me komentin rreth një sendi,

cilido send qoftë. Siç shihet, divorci nuk ndodh me asnjërin prej veprimeve të lartpërmendura, përveçse me fjalën “tâlik”-“e divorcuar”, pa asnjë kusht. Shihet qartë urtësia e Ligjvënësit për të ngushtuar ndodhjen e divorcit, duke e reduktuar ndodhjen e divorcit vetëm me këtë fjalë.

Kur burri i thotë gruas: “Ti je tri herë e divorcuar.”, ose i thotë: “Ti je e divorcuar, ti je e divorcuar, ti je e divorcuar”, duke pasur qëllim tri herë, divorci ka ndodhur vetëm në njërin prej fjalëve të tij.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, madje kjo thënie është si të jetë prej domosdoshmërive të medh’hebit të shi’ave.”

Në Sahijhun e Zurares transmetohet se ai ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që e ka divorcuar gruan e tij tri herë në një kuvend dhe gruaja nuk ishte me menstruacione. Ka vepruar drejt?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “Një.”

### ***Dëshmia për divorcin***

Kolona e katërt e divorcit është që divorci nuk ndodh, nëse atë nuk e dëshmojnë dy burra të drejtë, sepse për divorcin nuk pranohet dëshmia e grave, qoftë kur gratë dëshmojnë tek e tek, qoftë kur dëshmojnë në grup. Me fjalën e përbashkët të fukahave, të bazuar në Librin e Allahut dhe në transmetimet e ardhura me

varg të pashkëputur përcjellësish, divorci është i pavlefshëm, kur burri shpall divorcin dhe pastaj sjell dëshmitarët.

Prej teksteve kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të babait të tij, Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse ai e divorcon gruan në kohën e pastrimit të saj të ardhshëm, gjatë kësaj kohe nuk kryen marrëdhënie intime me gruan, por për divorcin që bëri, nuk ka dëshmitarë dy burra të drejtë, divorci që burri i bëri gruas së tij, nuk është divorc.”

Në një transmetim të dytë, thuhet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi ta!*), për martesën nuk lejonte dëshminë e dy grave dhe për divorcin lejonte vetëm dëshminë e dy burrave të drejtë.”

Shejkhu Ebu Zuhreh, prej dijetarëve të dëgjuar të fesë prej Ehli Sunetit, në librin “Gjendjet personale”, në kapitullin “Vërtetimi i divorcit dhe dëshmitarët për divorcin”, ka thënë: “Fukahatë e shí’ave kanë thënë: “Divorci nuk ndodh pa dëshminë e dy burrave të drejtë, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar:

“وَأَشْهَدُوا ذَوِي عَدْلٍ مِّنكُمْ وَأَقِيمُوا الشَّهَادَةَ لِلَّهِ ۚ ذَلِكُمْ يُوعَظُ بِهِ مَن كَانَ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ”

**“...duke e dëshmuar (divorcin) dy burra të drejtë nga mesi juaj dhe dëshminë ta bëni për hir të Allahut. Kështu këshillohet ai që i beson Allahut dhe Ditës së Gjykimit...”** (*Sure “Et Talak”, ajeti 2*)

Urdhri për të dëshmuar ka ardhur, pasi ka ndodhur divorci dhe lejimi për rikthim (të burrit te gruaja) dhe ishte e përshtatshme që burri të rikthehej për divorcin.

Komentimi që dëshminë ta bëjë ai që i beson Allahut dhe Ditës së Gjykimit, ky urdhër e kandidon këtë person si dëshmitar dhe e përforcon atë, sepse prania e dëshmitarëve të drejtë për divorcin, në të njëjtën kohë i drejtohet me këshillë të mirë edhe dy bashkëshortëve, pasi kështu atyre u hapet një portë për dalë prej divorcit, si veprimi më i urryer te Allahu.

Sikur ne në Egjipt do të na duhej të bënim një zgjedhje në lidhje me komentin për këtë çështje, patjetër që do të zgjidhnim këtë mendim, sepse ky mendim e kushtëzon ndodhjen e divorcit me praninë e dëshmisë së dy burrave të drejtë.”

### ***Burri suni dhe gruaja shi'a***

Kur burri suni divorcon gruan e tij shi'a me divorc të varur, ose duke thënë tri herë formulën e divorcit, ose e divorcon në kohën e pastrimit, por gjatë kësaj kohe ai ka kryer marrëdhënie intime me gruan, ose e divorcin, kur gruaja është me menstruacione, ose është në kohën e lehonisë, ose e divorcon pa praninë e dy dëshmitarëve, ose është betuar që do ta divorcojë gruan, ose e divorcon gruan me veprime të tjera të lejuara për atë, si ndjekës i Ehli Sunetit, por që janë të pavlefshme te shi'at, a është i vlefshëm ky divorc, domethënë a renditen mbi atë divorc ndikimet e vlefshmërisë dhe e divorcuara të jetë e lirë, në atë mënyrë që lejohet martesë me këtë grua, pasi ajo të kalojë kohën e pritjes ligjore?

Fukahatë janë bashkuar në një fjalë të vetme, me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir”, që çdo grup të përmbahet në doktrinën që ndjek dhe mbi atë të rendisin ndikimet e

vlefshmërisë së martesës së tyre, të trashëgimisë, të divorcit që bëjnë dhe të gjitha marrëdhëniet e tyre, kur ato bëhen në përputhje me doktrinën e tyre, ashtu siç ka thënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Prej këtyre punëve bëni detyrim për ata gjithçka që ata kanë bërë detyrim mbi veten e tyre.”

Në një transmetim të dytë, tregohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një grua që e ka divorcuar burri i saj suni, jo sipas kushteve të divorcit që praktikohen te shi’at. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Gruaja martohet dhe nuk lihet pa burrë.”

Në një transmetim të tretë, ai ka thënë: “Për ndjekësin e çdo doktrine, lejohet ajo që te ata është e lejuar.”

Në një transmetim të katërt, ka thënë: “Ai që beson në një doktrinë, dispozitat e asaj doktrine bëhen të detyrueshme për të.”

Bazuar mbi këto që u thanë, themi: Kur burri suni divorcon gruan e tij shi’a, sipas rregullave të doktrinës që ai ndjek, divorci është i vlefshëm. Nëse burri shi’a divorcon gruan e tij ndjekëse të Ehli Sunetit, sipas doktrinës në të cilën ajo beson, por burri nuk e beson doktrinën që beson gruaja e tij sunite, ky divorc nuk është i vlefshëm, sepse divorci është veprim që e bën burri, prandaj si kriter merret doktrina në të cilën beson burri dhe jo doktrina në të cilën beson gruaja.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Ne i rendisim ndikimet sipas rregullit: Ato që janë të vlefshme te ata, janë të pavlefshme te ne, madje sipas kërkesës së transmetimit të ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), për ne lejohet të marrim gjithçka që ata besojnë në doktrinën e tyre.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që vdes dhe ka lënë të bijën dhe motrën e tij prej babe e prej nëne. Si do të bëhet ndarja e trashëgimisë? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“E gjithë pasuria i takon vajzës së të vdekurit dhe motrës së tij nuk i takon asnjë send.”*

Pyetësi tha: *“Në të vërtetë, ne kemi sjellë argumente për rastin kur i vdekuri është suni dhe motra e tij është prej shí’ave.”* Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Merr për atë (motrën) gjysmën, merrni prej atyre ashtu siç marrin ata prej jush, sipas rrugës së tyre, sipas gjykimit të tyre dhe sipas dispozitave të tyre. Merre të drejtën tënde me dispozitat e tyre e me rrugën e praktikës së tyre, ashtu siç e marrin ata prej jush.”*

### ***Divorci është Sunet dhe sajësë (bid'atu)***

Duke vënë në konsideratë ligjërimin e mosligjërimin e divorcit, fukahatë e kanë ndarë divorcin në dy kategori: divorc Sunet dhe divorc sajësë. Divorci Sunet është divorci që ka ligjëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij. Ky divorc është i vlefshëm dhe me të zgjidhet lidhja mes dy bashkëshortëve. Divorci sajësë, është divorci i paligjëruar, për rrjedhojë me divorcin sajësë lidhja martesore mbetet ashtu siç ishte.

Në divorcin sajësë hyjnë katër raste të këtij divorci:

1- Burri divorcon gruan, kur ajo është me menstruacione, ose kur gruaja është lehonë, burri ka kryer marrëdhënie intime me gruan, është pranë gruas dhe gruaja nuk është shtatzënë.

2- Burri e divorcon gruan në kohën e saj të pastrimit dhe ka kryer marrëdhënie intime me të, gruaja nuk është shtatzënë dhe burri ka qëndruar pranë saj.

3- Burri e ka divorcuar gruan tri herë me një formulë të vetme, ose edhe me më shumë dhe pas divorcit të parë ai nuk është kthyer te gruaja, kështu që divorci është i vlefshëm edhe me shqiptimin vetëm një herë të formulës “Je e divorcuar.” dhe priset për herët e tjera, ashtu siç e pamë më sipër.

4- Burri e divorcon gruan pa dëshmitarë.

Divorci Sunet ndodh, kur burri e divorcon gruan e tij sipas të gjitha kushteve dhe sipas të gjitha hollësive të pamë më sipër.

### ***Divorci i kthyeshëm dhe divorci i pakthyeshëm***

Divorci Sunet ndahet në divorc të kthyeshëm dhe në divorc të pakthyeshëm. Divorci i kthyeshëm është kur divorcuesi e ka në dorë të kthehet te e divorcuara, derisa ajo është në kohën e pritjes ligjore. Kjo është e barabartë, qoftë kur gruaja e miraton, qoftë kur nuk e miraton kthimin e burrit te ajo. Prej kushteve që të ndodhë divorci i kthyeshëm është që burri duhet të këtë kryer marrëdhënie intime me gruan, sepse e divorcuara, më të cilën burri s’ka kryer marrëdhënie intime, nuk ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar në ajetin 49 të sures “El Ahzab”:

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نَكَحْتُمُ الْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ طَلَقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَمْسُوهُنَّ فَمَا لَكُمْ عَلَيْهِنَّ مِنْ عِدَّةٍ تَعْتَدُونَهَا...”

**“O ju që keni besuar, kur lidhni kurorë me besimtare dhe më pas i divorconi ato para se të kryeni marrëdhënie intime me to, ju s’keni të drejtë t’u kërkoni atyre që ato të kalojnë kohën e pritjes ligjore...”**

Gjithashtu, prej kushteve të divorcit të kthyeshëm është që divorci të mos jetë marrje kompensimi pasuror që gruaja i paguan burrit, me qëllim që me këtë shumë ajo të çlirohet prej detyrimeve martesore, por as të mos jetë plotësues i të treve, ashtu siç do tregohet më poshtë.

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se e divorcuara me divorc të kthyeshëm është në dispozitën e gruas, për rrjedhojë divorcuesi gëzon të gjitha të drejtat që ka burri mbi gruan, domethënë se burri e gruaja trashëgojnë njëri-tjetrin, kur njëri prej atyre të dyve vdes para tjetrit dhe patjetër para përfundimit të kohës së pritjes ligjore.

Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) ka thënë: *“E divorcuara, me divorc të kthyeshëm, lyen sytë me kohël (lloj rimeli), bën tualet dhe vesh rrobat që ajo dëshiron (patjetër brenda normave të veshjes islame për gratë), sepse Allahu, i Gjithëpushtetshëm thotë:*

“لَعَلَّ اللَّهَ يُحْدِثُ بَعْدَ ذَلِكَ أَمْرًا”

**“...pas asaj Allahu mund të bëjë një punë tjetër.”** (Sure *“Et Talak”*, ajeti 1). Në tërësi, divorci i kthyeshëm nuk sjell ndonjë të re përveç kalimit të kohës së pritjes ligjore, kur burri e ka shqiptuar tri herë formulën e divorcit.



Në rastin e divorcit të pakthyeshëm, divorcuesi nuk e ka më në dorë të kthehet te e divorcuara. Divorci i pakthyeshëm përfshin disa kategori të divorcesh:

1- Gruan me të cilën burri s'ka kryer marrëdhënie intime.

2- E divorcuara, së cilës burri i ka shqiptuar tri herë formulën e divorcit.

3- E divorcuara kundrejt pagesës, domethënë gruaja paguan burrin që ai të divorcojë atë. Për këtë lloj divorci do të flitet në vendin përkatës.

4- Gruaja që i janë ndërprerë menstruacionet, është plotësisht si gruaja me të cilën burri s'ka kryer marrëdhënie intime, ashtu siç mësojmë prej ajetit 4, të sure "Et Talak":

“وَاللَّائِي يَكْسَنَ مِنَ الْمَحِيضِ مَنْ نَسَائِكُمْ إِنْ ارْتَبْتُمْ فَعِدَّتُهُنَّ ثَلَاثَةُ أَشْهُرٍ وَاللَّائِي لَمْ يَحْضَنْ -

**“Grave tuaja që u janë ndërprerë menstruacionet dhe ju nuk e dini, koha e pritjes ligjore për to është tre muaj, gjithashtu edhe për ato gra që nuk u kanë ardhur akoma menstruacionet...”**  
(Sure “Et Talak”, ajeti 4)

Qëllimi i përdorimit të fjalisë: **“Grave tuaja që u janë ndërprerë menstruacionet.”**, është të tregojë ato gra që dihet se u janë ndërprerë menstruacionet dhe ju nuk e dini, nëse u janë ndërprerë për shkak të ndonjë sëmundjeje, apo për shkak të moshës.

Gjithsesi, koha e pritjes ligjore për këto gra është tre muaj, duke pasur si argument fjalën e Allahut të Lartësuar: **“dhe ju nuk e dini.”**

Prej kësaj fjale të ajetit të nderuar, kuptohet se, kur ju dyshoni te gruaja, nëse ajo e ka arritur ose jo moshën e ndërprerjes së menstruacioneve (menopauzës), dispozita për këtë grua është që koha e pritjes ligjore të jetë tre muaj.

Fjalja tjetër e ajetit të nderuar: **“ato gra që nuk u kanë ardhur akoma menstruacionet.”**, ka për qëllim të tregojë të rejat që janë në moshën kur gratë shikojnë menstruacionet, megjithëkëtë atyre u është ndërprerë hemorragjia e zakonshme e menstruacioneve. Me lejen e Allahut, për këtë çështje do të rikthem edhe një herë në kapitullin “Koha e pritjes ligjore”.

5- Gruaja s’ka mbushur nëntë vjeç, edhe nëse burri ka kryer marrëdhënie intime me të.

### ***E divorcuara tri herë dhe bërësi hallall***

Burri që i thotë tri herë gruas së tij: “Je e divorcuar.”, ajo grua nuk është më hallall për të, derisa ajo të martohet me një burrë tjetër me martesë të vlefshme dhe burri i dytë të kryejë realisht marrëdhënie intime me të, ashtu siç është edhe fjala e Allahut të Lartësuar në ajetin 230 të sures “El Bekare:

“فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا تَحِلُّ لَهُ مِنْ بَعْدُ حَتَّى تَنْكِحَ زَوْجًا غَيْرَهُ فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا حُنَاحَ عَلَيْهِمَا أَنْ يَتَرَاجَعَا”

**“Në qoftë se burri e divorcon gruan (për herë të tretë), ajo grua nuk është më hallall për të, derisa gruaja të martohet me një tjetër burrë dhe, nëse ky e divorcon, s’ka ndonjë problem që ata të dy të rikthehen te njëri-tjetri...”**

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “E divorcura tri herë, nuk është më hallall për atë (divorcuesin), derisa gruaja të martohet me tjetër burë, i cili të përjetojë me të kënaqësinë e gruas...”

Është kusht që burri i dytë që do të martohet me gruan e divorcuar, të ketë arritur moshën e pjekurisë seksuale dhe martesë e lidhur të jetë martesë e përhershme. Gjithashtu, është kusht që burri i dytë të kryejë marrëdhënie intime me këtë grua.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që e divorcon gruan me divorc të pakthyeshem, domethënë gruaja bëhet e ndaluar për të, derisa ajo të martohet me një tjetër burrë. Burri që u martua me këtë grua është djalë i vogël që akoma nuk ka parë dalje të spermës. A është e drejtë martesë e saj? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Jo, derisa djali të arrijë moshën e pjekurisë seksuale.”

Gjithashtu, ai është pyetur për një grua të divorcuar tri herë dhe më pas ajo bën një martesë të ndërprerë. A është hallall kjo grua për burrin e parë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Jo, sepse Allahu i Lartësuar thotë: ‘Nëse ai e divorcon’, domethënë, nëse atë e divorcon burri i dytë, atëherë s’ka problem për të dy që të kthehen te njëri-tjetri. Kurse për gruan me martesë të ndërprerë, s’ka divorc.”

Në lidhje me kushtin e kryerjes së marrëdhënieve intime me burrin e dytë, tregon fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) në transmetimin e mësipërm: “Të përjetojë me të kënaqësinë e gruas.”

Kur burri i dytë e ka hallall këtë grua sipas tri kushteve që u thanë dhe më pas ai ndahet prej saj, për shkak se vdes, ose për shkak se e divorcon dhe, pasi gruaja kalon kohën e pritjes ligjore,

vetëm atëherë kjo grua është e lejuar përsëri për burrin e parë, me kusht që ai të bëjë kontratë të dytë martese me të.

Nëse burri i parë e divorcon tri herë këtë grua, pasi e mori për herë të dytë, gruaja nuk është më hallall për të, edhe sikur gruaja të marrë tjetër burrë, ashtu siç u shpjegua.

Pra, gruaja bëhet haram për burrin, pasi ai e divorcon tri herë me radhë dhe bëhet hallall me martesën e saj me atë që e ka hallall, edhe nëse e divorcon njëqind herë, me përjashtim të një forme të vetme, që është: Kur ai e divorcon nëntë herë brenda kohës së pritjes ligjore dhe bën kurorëzim me të dy herë, në këtë gjendje, ajo është e ndaluar përgjithmonë për burrin.

Divorc në kohën e pritjes ligjore do të thotë: Ai e divorcon, pastaj kthehet te ajo, kryen marrëdhënie intime me atë dhe pastaj e divorcon përsëri në një pastrim tjetër. Pastaj rikthehet te ajo dhe kryen edhe marrëdhënie intime me të. Pastaj e divorcon. Më pas gruan e bën hallall ai që e ka hallall të martohet me të. Më pas burri i parë martohet me këtë grua me një kontratë të re martese dhe e divorcon atë tri herë në kohën e pritjes ligjore, ashtu siç veproji edhe herën e parë. Më pas gruaja martohet me burrin e parë. Nëse ai e divorcon tri herë dhe divorci në kohën e pritjes ligjore plotësohet nëntë herë, kjo grua bëhet e ndaluar përgjithmonë për burrin e parë.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Për këtë fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët.”

Pastaj ai përmend transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut goftë mbi ta!*) dhe prej këtyre transmetimeve kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja goftë mbi të!*): “Ai që e shqipton fjalën e

*divorcit që e bën gruan haram për të, derisa gruaja të martohet tri herë me tjetër burrë, ajo grua nuk është përgjithmonë hallall për të.”*

Kur divorci nuk ndodh në kohën e pritjes ligjore, si për shembull, kur burri e divorcon gruan dhe pastaj kthehet te ajo gjatë kohës së pritjes ligjore dhe më pas e divorcon para se të kryejë marrëdhënie intime me të, ose burri e divorcon dhe gruaja kalon kohën e pritjes ligjore dhe pas kalimit të kohës së pritjes ligjore gruaja martohet me atë dhe pastaj ai e divorcon, gruaja nuk bëhet përgjithmonë e ndaluar për atë, por bëhet hallall, përsëri me anë të martesës me një burrë tjetër, edhe nëse divorcet janë aq shumë, sa nuk numërohen dot.

### ***Dyshimi dhe kthimi herë pas here***

Burri dyshon, nëse doli ose jo prej tij fjala divorc. Origjina është mosndodhja e divorcit dhe, kur ai e di mirë se me të vërtetë e ka shqiptuar fjalën divorc, por nuk di sa herë i ka thënë gruas: “Je e divorcuar.”, i ka thënë një herë apo më shumë. Edhe në këtë rast, origjina është mosshkrimi mbi atë që je i bindur.

### ***Vërtetimi i të divorcuarës me bërjen e saj hallall***

Burri e divorcon gruan tri herë dhe burri largohet prej saj, ose gruaja largohet prej tij aq kohë sa është e mjaftueshme që gruaja të kalojë kohën e pritje ligjore për shkak të ndarjes prej burrit dhe gruaja pretendon se ajo është martuar, është divorcuar dhe ka kaluar edhe kohën e pritjes ligjore. Pastaj përsëri ajo është martuar, pastaj është divorcuar dhe ka kaluar edhe kohën e pritjes

ligjore. Nëse është kështu siç u shtrua, fjala e gruas pranohet pa betim dhe burri i parë ka të drejtë të martohet me të kur ai është i sigurt se ajo thotë të vërtetën. Nuk është detyrim të bëhet ndonjë vëzhgim apo studim.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në këtë çështje nuk kam gjetur kundërshtimin e asnjë studiuesi, sipas transmetimit të shkallës “Sahijh” të Ham`màdit prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili është pyetur në lidhje me një burrë që e ka divorcuar tri herë gruan e tij dhe ajo u largua prej tij. Mirëpo ai dëshironte të rikthehej te ajo dhe për këtë i thotë gruas: “Unë dua të rikthehem te ti, prandaj martohu me një burrë tjetër.” Gruaja i thotë: “Unë u martove me një burrë tjetër dhe kështu unë e kam bërë veten hallall për ty.” A duhet të besohet fjala e kësaj gruaje që ai të rikthehet te ajo? Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse gruaje është e besueshme, fjala e saj vërtetohet.”

Autori i librit “El Xheuahir”, në komentimin e këtij transmetimi, ka thënë: “Besueshmëria e gruas dhe besnikëria e saj në njoftimet e saj, nuk janë kusht, për shkak se askush nuk ka thënë që ky kusht duhet marrë në konsideratë, sepse në besueshmërinë e pretenduesit s’ka ndërhyrje nga ana qenies së tij. Gjithashtu, e njëjta gjë është me vërtetimin e pretenduesit. Në të vërtetë, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka përmendur këtë kusht si veprim i preferuar dhe jo si veprim detyrim.”

Ne themi se kjo punë tregon se është veprim i detyrueshëm, ose kur themi se është veprim i pëlqyer, në të dyja rastet, del nevoja e krahasimit me një shembull të ngjashëm, por këtu s’ka shembull të ngjashëm, s’ka as kundërshtar që të

përgënjeshtrojë fjalën e gruas, prandaj është thënë: “S’ka ndërhyrje në besueshmërinë e pretenduesit dhe s’ka asnjë fjalë që të na frikësojë.”

### ***Burri kryen marrëdhënie intime me gruan dhe pretendon divorcin***

Në librin “Esh Sheràiu” dhe në librin “El Xheuahir” thuhet se, kur divorcon burri që është larg gruas dhe gruaja kalon kohën e pritjes ligjore, por me pas burri vjen dhe kryen marrëdhënie intime me gruan, por pas kësaj pretendon divorcin, pretendimi i tij nuk pranohet dhe prej tij nuk dëgjohet asnjë argument që përforcon veprimin e tij të kundërligjshëm, sepse ai, me veprimin e tij, përgënjeshton vetveten. Nëse gruaja lind, fëmija i atashohet babait.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që e ka divorcuar gruan e tij, duke mos qenë pranë gruas, madje divorcin e ka bërë në prani të dëshmitarëve. Më pas ai vjen dhe rri me gruan një muaj, por nuk i thotë asgjë gruas për divorcin, ndërkaq gruaja i thotë se është shtatzënë, ndërsa burri i thotë: “Unë të kam divorcuar dhe për këtë kam edhe dëshmitarë që të kam divorcuar.” Si duhet të veprohet në këtë rast?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai duhet të pranojë shtatzëninë e gruas. Fjala e burrit nuk pranohet.”

## EL KHUL'U DHE EL MUBARE'TU

### *El Khul'u*

*El Khul'u* do të thotë kur gruaja paguan burrin që ai ta divorcojë atë. Baza për këtë lloj ndarje është fjala e Allahut të Lartësuar:

“فَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا يُقِيمَا حُدُودَ اللَّهِ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا فِيمَا افْتَدَتْ بِهِ تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ فَلَا تَعْتَدُوهَا”

**“... dhe nëse keni frikë që ata të dy nuk do të zbatojnë dispozitat e Allahut, atëherë për ata të dy s’ka problem nëse ajo bën kompensim. Këto janë dispozitat e Allahut, prandaj mos i kundërshtoni ato...”** (Sure “El Bekare”, ajeti 229)

Si dhe fjala tjetër e Allahut të Lartësuar në ajetin 4 të sures “En Nisa”:

“فَإِنْ طِبَّرَ لَكُمْ عَنْ شَيْءٍ مِّنْهُ نَفْسًا فَكُلُوهُ هَنِيئًا مَّرِيئًا”

**“...nëse ato me vullnetin e vet ju falin diçka prej asaj (shumës së kurorës), hajeni atë hallall dhe të mirë.”**



Në hadith tregohet se Thabit bin Kajsî ishte martuar me të bijën e Abdullah bin Ubejit. Thabiti e donte atë, kurse ajo e urrente Thabitin. Ajo erdhi te i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe i tha: “O i Dërguar i Allahut, as mua e as Thabiti, asgjë nuk e bashkon mendjen time me mendjen e Thabitit.” Thabiti i kishte dhënë asaj për shumë kurore një kopsht, prandaj Thabiti tha: “Po kopshti?”

I Dërguari i Allahut i tha asaj: “Ç’thua?”

Ajo tha: “Po, madje edhe më shumë.”

I Dërguari i Allahut tha: “Jo, vetëm kopshtin.”

Ajo u nda prej tij. Thuhet se në këtë ngjarje e ka zanafillën shkaku për zbritjen e ajetit të cituar në fillim të kapitullit.

Në vijim do të flitet për formulën e daljes së gruas prej martesës (*el khul'u*), për shumën e dhënë, kushtet dhe dispozitat. Do të bëhet e qartë për ne të gjithë se *el khul'u* kundrejt pagesës nga ana e gruas, është njëra prej kategorive të divorcit dhe në këtë kategori divorci merret në konsideratë gjithçka që merret në konsideratë në divorcin e drejtpërdrejtë, por duke shtuar pagesën e shumës nga ana e gruas dhe urrejtjen që ka gruaja ndaj burrit.

## **Formula**

*El khul'u* nuk ndodh e shqiptuar me fjalë metaforë, as me ndonjë fjalë tjetër jo metaforë, përveçse me dy fjalë: “*El khul'u*” dhe “*Talak*” - dalje prej martesë dhe divorc, krahas pagesës. Me çdo njëren prej këtyre dy fjalëve ndodh dalja e gruas prej

martesës. Kjo është plotësisht e mjaftueshme, edhe nëse thuhet vetëm njëra prej këtyre dy fjalëve. Kur gruaja i thotë burrit: “Shpenzoi kaq që ti të më divorcesh.” dhe burri i thotë: “Për këtë shumë unë të liroj prej detyrimeve martesore.”, ose i thotë: “Për këtë shumë ti je e divorcuar.”, dalja e gruas prej martesës (*el khul'u*) është e vlefshme me të dyja shprehjet. Por është më e pëlqyeshme që të dyja shprehjet të thuhen së bashku, pasi kështu arrihet edhe veprimi në përputhje me fjalën e përbashkët të fukahave në lidhje me këtë çështje.

Që është e mjaftueshme vetëm fjala “Je e liruar prej detyrimeve martesore.”, pa e përmendur fjalën “divorc” për daljen e gruas prej martesës, tregon fjala e Imam Sadikut (*Paqja goftë mbi të!*) në lidhje me kohën e pritjes së gruas së dalë prej martesës dhe të gruas së divorcuar, sepse gruaja e dalë prej martesës për shkak të pagesës që bën, nuk quhet e divorcuar.

Në lidhje me faktin që është e mjaftueshme të shqiptohet vetëm fjala “divorc”, krahas pagesës, autori i librit “El Hadaik” ka thënë: “Fjalët e fukahave, në lidhje me këtë çështje, janë të qarta dhe ndër fjalët e tyre s’ka asnjë kundërshtim të njohur.”

Në librin “Esh Sheràiu uel Xheuàhir”, thuhet: “Dalja e gruas prej martesës ndodh me fjalën divorc, krahas shpenzimit nga ana e gruas, edhe pse fjala divorc (talàk) nuk është e njëjtë me fjalën dalje e gruas prej martesës (*el khul'u*), sepse ashtu siç u tha më sipër, dalja e gruas prej martesës është një lloj divorci i veçantë.

Edhe pse në teorikisht mjaftohemi vetëm me fjalën “*el khul'u*” ose me fjalën “talàk”- dalja e gruas prej martesës dhe

divorc, krahas shpenzimit nga ana e gruas, praktikisht ne i bashkojmë të dyja shprehjet dhe për këtë e urdhërojmë burrin, ose të ngarkuarin (të prokuruarin) prej tij që të thotë: “Kështu unë e liroj atë prej detyrimeve të martesës dhe për atë që ajo ka shpenzuar, ajo është e divorcuar.”

Kjo formë e shprehjes është më korrekte në ligjin e fesë, veçanërisht kur marrim në konsideratë se këtë mënyrë të shprehuri e kanë bërë detyrim Shejkhu ibn Zuhreh, ibn Idrijsi, Xhaferri, Hasani, dy bijtë e Sema, Ali bin Ribati dhe ibn Hudhejfehî prej fukahave të mëparshëm, si dhe Ali bin Hasan prej fukahave të mëvonshëm, ashtu siç thuhet në librin “El Xheuahir”, madje në këtë libër gjendet edhe një transmetim i ardhur prej Imam Kadhîm, djalit të Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Kur burri i bie shkurt dhe përmend vetëm fjalën “*el khul'u*” - “të liroj prej detyrimeve martesore” dhe nuk e përmend fare fjalën “*talàk*” - “divorc”, a ndodh divorci i llogaritur sikur të jetë thënë tri herë formula, apo divorci është i prishur dhe nuk numërohet tri herët e shqiptimit të fjalës “divorc”?

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe autorit të librit “El Hadaik” se në këtë rast kemi divorc dhe jo prishje, ashtu siç është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Dalja e saj prej martesës, është divorci i saj.”, si dhe fjalën tjetër të tij, e ardhur në një transmetim të dytë: “Kur burri e liron gruan e tij prej detyrimeve martesore, ajo është një fjalë e vetme dhe kjo grua bëhet e divorcuar përgjithmonë prej atij burri.”, domethënë, pasi burri e liroi atë prej detyrimeve të martesës, kemi vetëm një divorc dhe me kaq mjafton.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se formula e daljes së gruas prej martesës është detyrim që gruaja të divorcohet e pambaruar prej asnjë sendi, si për shembull, kur burri i thotë gruas së tij: “Unë të liroj prej detyrimeve martesore, nëse do të jetë kjo apo ajo gjë.”, ky lirim prej detyrimeve martesore nuk është i vlefshëm.

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se dalja e gruas prej martesës e bën të detyrueshme menjëherë pagesën nga ana e gruas, pa asnjë ndarje në kohë. Nëse kemi vonesë në pagesën nga ana e gruas, burri nuk ka të drejtë të marrë kompensimin, për rrjedhojë ka ndodhur vetëm divorc i kthyeshëm, në qoftë se burri ka kryer marrëdhënie intime me gruan dhe gruaja vazhdon të jetë në moshën e menstruacioneve.

Autori i librit “El Xheuahir” e ka justifikuar detyrimin që pagesa, nga ana e gruas, të jetë e menjëhershme, si një rëndësi prej kërkesave të shkëmbimit të ndërsjellë.

Theksojmë se në ligjin e fesë nuk ka argument që e bën detyrim pagesën menjëherë, madje për këtë nuk ka as argument logjik, për rrjedhojë kriter mbetet vullneti i gruas për të paguar në kohën kur ajo del prej martesës. Nëse gruaja kthen mendje para se të ndodhë lrimi i saj prej detyrimeve martesore, divorci i kërkuar prej saj është pa vlerë, por ndryshe do të ishte i vlefshëm.

Më sipër është trajtuar problemi i pagesës së menjëhershme, në pjesën e tretë, në kapitullin “Kushtet e kontratës”, në paragrafin “Vijueshmëria”.

## **Pagesa**

Pagesa, në tekstin arabisht “*el fidjeh*”, është shuma që gruaja i paguan burrit që ai ta divorcojë atë. Çdo send që lejohet të jetë shumë kurore, lejohet të jetë edhe pagesë për divorcin dhe çdo send që nuk lejohet të jetë shumë kurore, nuk lejohet të jetë as pagesë për divorcin. Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, pagesa për divorcin lejohet të jetë në sasinë e shumës së kurorës, ose më pak, ose edhe më shumë. Prej teksteve kemi fjalën e Imam Bakirit, babait së Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Burri e liron gruan prej detyrimeve martesore me atë që ata të dy janë marrë vesh mes tyre, pak ose shumë.*”

Nuk është kusht që pagesa të dihet në detaje, por mjafton që të dihet si tërësi, ashtu siç është edhe për shumën e kurorës, madje këtu mosnjohja e shumës në detaje, ka më përparësi. Lejohet që burri ta lirojë gruan e tij prej detyrimeve martesore, edhe duke hequr dorë gruaja prej asaj pjese të shumës së kurorës që ai akoma nuk ia ka dhënë asaj dhe prej shpenzimeve që ai ka detyrim të bëjë për gruan, edhe nëse shuma nuk njihet, për shembull, kur për shumën thuhet me aq sa janë në arkë, ose aq sa janë në shtëpi, ose sa është çmimi i kopshtit, në atë mënyrë që shuma e përmendur mund të mësohet.

Autori i librit “*El Xheuahir*” ka thënë: “Të gjitha këto dhe të tjera, janë të vlefshme, për shkak se argumentet janë të përgjithshme dhe të pakushtëzuara.”

Pagesa është e vlefshme të bëhet prej vetë gruas, ose prej të prokuruarit prej gruas dhe që vepron në emër të saj, gjithashtu pagesa është e vlefshme edhe kur bëhet prej një të huaji, me

kërkesën e vetë gruas që ai ta bëjë këtë pagesë. Nëse ky i huaj e bën pagesën si bamirësi nga vetja e tij, kjo pagesë nuk është e vlefshme për daljen e gruas prej martesës, për rrjedhojë, nuk është e vlefshme as dalja e gruas prej martesës, e bazuar mbi këtë pagesë.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Prej librit e prej Sunetit mësojmë ligjshmërinë e pagesës nga ana e gruas, qoftë edhe nëpërmjet të prokuruarit prej saj, kurse dhurimi i kësaj shume për bamirësi, në origjinë, mbetet ndalim, sepse për këtë s’ka as argument të përgjithshëm, as argument të pakushtëzuar që të flasë për ligjshmërinë e kësaj pagese.”

Sikur gruaja të shpenzojë pasuri që burri ta divorcojë atë dhe ai e bën divorcin në atë mënyrë që shpenzimi të sjellë divorcin, por divorci praktikisht nuk është ndërtuar mbi atë shpenzim, shpenzimi është i vlefshëm, por, në këtë gjendje, ka ndodhur vetëm divorc i kthyeshëm dhe nuk ka ndodhur dalje e gruas prej martesës.

Kur gruaja del prej martesës me një pasuri të veçantë dhe burri beson se ajo është pronë e saj dhe rezulton që është pronë e një tjetri, nëse pronari e lejon, atëherë burri do ta marrë pronën në fjalë, në të kundërt, do të marrë një të ngjashme, ose çmimin.

Kur gruaja del prej martesës së burrit të saj me kushtin që ajo të ushqejë me gji fëmijën e tij dhe pa shpenzuar burri për një kohë të caktuar, kjo lloj pagese është e vlefshme dhe gruaja ka detyrim të qëndrojë në fjalën e dhënë.

Gjithashtu, dalja prej martesës e gruas, me kusht që të ushqejë fëmijën me gji, por shpenzimi të jetë mbi burrin, nëse

gruaja e lind fëmijën të gjallë, sepse kërkesa është ekzistenca e fëmijës, që në rastin konkret, është shtatzënia, si dhe marrja përsipër nga ana e gruas që t'i përmbahet kushtit që ajo i vuri vetes. Pra, veprohet sipas rregullit: "Besimtarët janë në kushtet e tyre", me kushtin që hallalli nuk bëhet haram dhe harami nuk bëhet hallall. Vetëkuptohet që ky kusht është mjaft i përhapur dhe i mbështetur ligjërisht, për rrjedhojë, është detyrim që kushti të respektohet dhe të mbahet besa për plotësimin e tij, për shkak se kushti është marrë prej një formule që e bën detyrim mbajtjen e besës.

Kur burri e liron gruan prej detyrimeve martesore me kushtin që gruaja të paguajë shpenzimet për fëmijën, por më vonë ajo e ka të pamundur të mbulojë shpenzimet për fëmijën, në këtë gjendje, gruaja ka të drejtë të kërkojë prej babait të fëmijës shpenzimet për fëmijën e tij, madje babai detyrohet për këto shpenzime, por babai i kërkon nënës shpenzimet kur ajo të jetë në gjendje të mirë ekonomike.

## ***Kushtet***

Për burrin e për gruan është kusht që të dy të jenë të mençur, të kenë arritur pjekurinë seksuale, të bëjnë zgjedhjen vetë dhe të kenë qëllim për ndarjen që do të bëjnë. PAGESA është e vlefshme, edhe kur pagesën e bën kujdestari i gruas. Gjithashtu, dalja e gruas prej martesës prej kujdestarit të burrit është e vlefshme, vetëm atëherë kur këtë gjë e kërkon interesi.

Lirimi i gruas prej detyrimeve martesore, nga ana e burrit, është i vlefshëm, edhe atëherë kur burri është i sëmurë nga një

sëmundje vdekjeprurëse, ose kur pasuria e burrit është e ngurtësuar për shkak se ai është mendjeshkurtër, ose për shkak falimentimi. Kjo është e barabartë, qoftë kur pagesa është në sasinë e shumës së kurorës, qoftë kur është më pak, sepse dalja e gruas prej martesës kundrejt pagesës nuk kërkon të bëhet shpenzim, por bën detyrim fitimin e pasurisë. Nëse burri e liron gruan falas prej detyrimeve martesore, lirimi i gruas prej detyrimeve martesore është i vlefshëm, por divorci i kësaj kategorie, krahas pagesës, është me përparësi.

Vetëkuptohet që në rastin kur burri është mendjeshkurtër, pagesa i dorëzohet kujdestarit të këtij mendjeshkurtri. Gjithashtu, shpenzimi i gruas është i vlefshëm, kur ajo është e falimentuar, me kusht që shpenzimi që ajo po bën për të dalë prej martesës, s'ka lidhje me të drejtën e kreditorëve.

Gruaja e sëmurë nga një sëmundje vdekjeprurëse, nëse ndahet prej burrit, kundrejt shumës së kurorës së ngjashme më shoqet e saj, pa shtuar gjë më shumë se shuma e kurorës, ndarja është e lejuar dhe marrja e shumës bëhet prej origjinës, plotësisht sikur i sëmuri të shesë e të blejë me çmimin e tregut. Nëse gruaja shpenzon më shumë se shuma e zakonshme e kurorës që kanë edhe shoqet e saj, atëherë sasia e shumës së ngjashme të kurorës nxirret prej origjinës, kurse shtesa nxirret prej një të tretës.

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Kjo është thënia më e përhapur në mesin e fukahave dhe me këtë ata e shpjegojnë."

Autori i librit "Esh Sheràiu" ka thënë: "Kjo është e ngjashme me bazat e me rregullat e medh'hebit."



Përveç kushteve të lartpërmendura për gruan që del prej martesës, është kusht që dalja e saj prej martesës të ndodhë në kohën e saj të pastrimit (kur nuk është me menstruacione) dhe burri nuk ka kryer marrëdhënie intime me të, por burri më parë ka hyrë te ajo dhe gruaja nuk është e vogël në moshë, nuk është në moshën kur gruas i janë ndërprerë menstruacionet dhe nuk është shtatzënë, plotësisht ashtu siç kërkohet për të divorcuarën.

Gjithashtu, për vlefshmërinë e daljes së gruas prej martesës kundrejt pagesës, është kusht prania e dy dëshmitarëve të drejtë, ndryshe kjo dalje prej martesës është fjalë pa vlerë, ashtu siç ishte edhe për divorcin, kur ndodh pa praninë e dy dëshmitarëve të drejtë.

Është kusht që fjalët, në lidhje me pagesën dhe formulën e daljes prej martesës, të thuhën me fjalë të shkurtra dhe pa asnjë interpretim.

## **Urrejtja**

Për urrejtjen vumë këtë paragraf të veçantë, jo për shkak se është me rëndësi, por e vumë në kuadrin e tërësisë së kushteve, si dhe për shkak se janë të shumtë ata që nuk i kushtojnë vëmendje këtij kushti. Pavarësisht nga fjalët e njerëzve, fukahatë kanë një fjalë të vetme se, për daljen e gruas prej martesës, burrit i lejohet të marrë pagesën për lirimin e gruas prej detyrimeve martesore, vetëm nëse gruaja e urren burrin, por kur nuk ka urrejtje as prej burrit e as prej gruas, ose burri e urren gruan, kurse gruaja nuk e urren burrin, në këtë gjendje, pagesa nga ana e gruas për të dalë prej martesës, është e pavlefshme dhe burri e ka haram të marrë

pagesë prej gruas që ai ta divorcojë atë. Nëse burri e merr pagesën, në të vërtetë ka ndodhur vetëm divorc i kthyeshem, me kusht kur plotësohen të gjitha kushtet e divorcit. Kur urrejtja është e dyanshme, atëherë kemi ndarje me pajtim, për të cilën do të flitet në një paragraf të veçantë në fundin e këtij kapitulli.

Argumenti për kushtin e urrejtjes, pas fjalës së përbashkët të fukahave, është nxjerrë prej transmetimeve të shumta të ardhura me varg të pashkëputur përcjellësish dhe, sipas shprehjes së autorit të librit “El Xhevahir”, prej këtyre transmetimeve kemi hadithin që përmendëm më sipër në lidhje me gruan e Thabit bin Kajsit në fillim të kapitullit.

Gjithashtu, prej teksteve kemi transmetimin e ardhur prej Imam Bakirit, babait të Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nuk ndodh dalja e gruas prej martesës (el khul'u), derisa gruaja t'i thotë burrit: ‘Nuk të bindem në asnjë punë. Nuk të pranoj asnjë betim.’”

Kur gruaja i thotë burrit këto fjalë, burri e ka të lejuar të lirojë gruan e tij prej detyrimeve martesore kundrejt shumës për të cilën ata bien në marrëveshje mes tyre, pak ose shumë dhe s'ka dallim, nëse gruaja ia thotë burrit këto fjalë me shprehjet e lartpërmendura, ose me fjalë të tjera që çojnë në të njëjtin kuptim, ose me veprim, ose i flet atij me gjuhën që përdoret ndër njerëzit.

### ***Dispozitat për daljen e gruas prej martesës***

1- Kur burri e kërcënon ose e keqtrajton gruan, me qëllim që ajo të paguajë për të dalë prej martesës dhe për këtë shkak nga frika ajo shpenzon, ose ajo shpenzon që të shpëtojë prej

keqtrajtimit të burrit, në këtë gjendje, burri është mëkatar dhe nuk e ka hallall asgjë prej shpenzimit të gruas, për shkak se për njeriun nuk është hallall pasuria e tjetrit që nuk jepet me dashje. Kur dalja e gruas prej martesës bëhet kundrejt këtij shpenzimi, te fukahatë nuk ka ndodhur dalja e gruas prej martesës, por ka ndodhur divorc i kthyeshëm.

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “S’ka asnjë kundërshtim që mund të atakohet bërja e daljes së gruas prej martesës divorc i kthyeshëm, kur burimi i këtij divorci është i këtillë, por pavlefshmëria e shpenzimit, nuk kërkon të jetë i pavlefshëm edhe divorci.”

Konstatohet se formula ka ndodhur dhe dalja e gruas prej martesës (*el khul'u*) është ndërtuar mbi shpenzimin, por dihet se ajo që është ndërtuar mbi një send të prishur, është vetë e prishur, prandaj, bazuar mbi këtë rregull, arrijmë në përfundimin se, me këtë formulë, s’ka ndodhur dalja e gruas prej martesës, edhe nëse burri, me atë formulë, ka pasur qëllim lirim e gruas prej detyrimeve martesore, sepse qëllimi i tij nuk është i vlefshëm. Gjithashtu, nuk ndodh as divorc i kthyeshëm, sepse burri nuk kishte qëllim divorcin e kthyeshëm. Veç kësaj, nuk ka tekst për këtë çështje që të bëjë detyrim veprimin sipas tekstit, atëherë duhet të gjykojmë që nga baza pavlefshmërinë e shpenzimit dhe të divorcit.

Kur burri e keqtrajton gruan dhe nuk ka qëllim që ajo të shpenzojë në favor të tij, por gruaja shpenzon që të dalë prej martesës për shkak të ndonjë të mete në karakterin e tij, ose për shkak se burri ka dobësi në fenë e vet dhe kundrejt shpenzimit gruaja del prej martesës, shpenzimi dhe dalja e saj prej martesës

janë të vlefshme, për shkak se me të vërtetë nuk kemi të bëjmë me imponim.

2- Shumica e fukahave kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Hadaik”, i cili thotë se, kur gruaja bën hapur ndonjë imoralitet, burrit i lejohet ta shtrëngojë e ta keqtrajtojë gruan që ajo të shpenzojë për të dalë prej martesës, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar:

“وَلَا تَعْضُلُوهُنَّ لِتَذَهَبُوا بِبَعْضِ مَا آتَيْنَهُنَّ إِلَّا أَنْ يَأْتِيَنَّ بِعَاقِبَةٍ مُّبِينَةٍ”

**“...dhe mos i shtrëngoni gratë për t’u marrë diçka prej asaj që i kini dhënë atyre, veçse kur ato bëjnë hapur ndonjë imoralitet...”**  
(Sure “En Nisa”, ajeti 19)

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Thuhet se ky ajet është abroguar me ajetin “الرَّائِبَةُ وَالرَّائِي فَاجْلِدُوا” **“kurvën e kurvarin i rrihni me kamxhik...”** (Sure “En Nur”, ajeti 2)

Por nuk është vërtetuar abrogimi dhe te ne s’ka asnjë që e thotë këtë fjalë.”

3- Gruaja e dalë prej martesës, kur nuk ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore, është si gruaja me të cilën burri nuk ka kryer fare marrëdhënie imitime, ose ajo do të kalojë kohën e pritjes ligjore, nëse divorci i saj është plotësuar tri herë, por gruaja s’ka të drejtë të kërkojë atë që shpenzoi.

Kur gruaja është në kohën e pritjes ligjore, përveç divorcit të shqiptuar tri herë, burri s’ka të drejtë të kthehet te gruaja, kurse gruaja, gjatë kohës së pritjes ligjore, ka të drejtë të kërkojë atë çka

ajo shpenzoi, me kusht që burri ka dijëni që gruaja po e kërkon para se të përfundojë kohën e pritjes ligjore.

Nëse burri ka dijëni, burri ka të drejtë të kthehet te gruaja sikur ta kishte divorcuar gruan me divorc të kthyeshëm, pasi, edhe në këtë rast, gruaja bëhet e divorcuar me divorc të kthyeshëm dhe për këtë grua vërtetohen të gjitha të drejtat që gëzon gruaja e divorcuar me divorc të kthyeshëm, siç është detyrimi i burrit që të shpenzojë për të siguruar jetesën e gruas dhe trashëgimia e ndërsjellë, ashtu siç është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Prej atij bëhet e qartë, nëse gruaja do, ai i kthen asaj atë çka mori prej saj dhe gruaja praktikisht është gruaja e tij.”

Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Qëllimi me fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “është gruaja e tij”, është që divorci i saj, në këtë kohë, është divorc i kthyeshëm, pasi e divorcuara me divorc të kthyeshëm, me fjalën e përbashkët të fukahave, është në pozitën e gruas, sepse ajo tanimë bëhet grua thjeshtë nga fakti i kthimit të burrit te ajo.”

4- Kur gruaja nuk kërkon kthimin e shpenzimit, burri ka të drejtë të vërë kurorë me atë me kontratë kurore të re dhe me shumë kurore të re, sepse tani ajo, për këtë burrë, është si grua e huaj (grua me të cilën ai e ka të drejtë të martohet), por kjo nuk është e lejueshme për gruan që është në kohën e pritjes ligjore, për shkak të divorcit të kthyeshëm, sepse ajo në të vërtetë vazhdon të mbete gruaja e atij burri.

5- S’ka trashëgimi të ndërsjellë mes gruas së dalë prej martesës kundrejt pagesës dhe divorcuesit, kur njëri prej atyre të dyve vdes para se gruaja të përfundojë kohën e pritjes ligjore, por vërtetohet trashëgimia për gruan në kohën e pritjes ligjore, kur ajo

e kalon këtë kohë pritje për shkak se është divorcuar me divorc të kthyeshëm.

Gruaja e dalë prej martesës kundrejt pagesës e kalon kohën e pritjes ku të dëshirojë dhe burri s'ka detyrim të shpenzojë për të, me përjashtim të rastit kur ajo është shtatzënë, ashtu siç u shpjegua në pjesën e pestë të këtij libri, në kapitullin "Martesa".

### ***Ndarja me pajtim***

Nga ana gjuhësore, fjala arabe e tekstit "*mubàre'eh*" do të thotë "ndarje". Le ta ilustruam me një shembull: Ti thua: "U ndava me ortakun tim." Nga pikëpamja e dispozitave dhe kushteve kjo ndarje është plotësisht si dalja e gruas prej martesës.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "*Ndarja në kohën e pajtimit, është divorc i përhershëm dhe në këtë ndarje s'ka kthim.*"

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "*S'ka ndarje me pajtim, përveçse në kohën e pastrimit të gruas dhe pa kryer marrëdhënie intime me të, të vërtetuar me dëshmitarë.*"

Në një transmetim tjetër, ai ka thënë: "*Mes atyre të dyve s'ka trashëgimi, sepse qenia e gruas, nën mbrojtjen e burrit, ka mbaruar.*"

Ndarja me pajtim dallohet prej daljes së gruas prej martesës nga disa anë:

1- Urrejtja të jetë te të dy bashkëshortët. Nëse s'ka urrejtje, ose urrejtja është vetëm prej njërit prej dy bashkëshortëve, fjala "ndarje me pajtim" nuk është e vlefshme.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët për këtë çështje, duke shtuar fjalën e besueshme të Sem'mà'ah, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Sema tregon: "E pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për ndarjen me pajtim. Si është ajo?"

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: "Kur gruaja ka për të marrë diçka prej burrit të saj, prej shumës së kurorës, ose ndonjë pasuri tjetër që ajo ka te burri dhe burri i ka dhënë gruas vetëm një pjesë të asaj që ka detyrim t'i japë, ndërkaq ata fillojnë të urrejnë njëri-tjetrin. Në këtë gjendje, gruaja i thotë burrit të saj: "Ajo çka unë kam marrë prej teje, më takon mua dhe ajo që ka mbetur pa e marrë akoma prej teje, le të jetë për ty. Unë ndahem prej teje me pajtim."

Burri i thotë gruas: "Nëse ti do të kërkosh diçka prej asaj që po heq dorë, unë kam të drejtë më shumë se kushdo tjetër mbi ty.""

2- Është detyrim që shpenzimi të jetë në sasinë e shumës së kurorës, ose edhe më pak, por nuk lejohet të jetë më shumë, ashtu siç është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Për burrin është hallall të marrë prej gruas vetëm shumën e kurorës, ose më pak."

3- Dalja e gruas prej martesës është e vlefshme, edhe kur burri i thotë gruas: "Të lirova prej detyrimeve martesore, edhe nëse nuk shton fjalën "Je e divorcuar.", ashtu siç u shpjegua më sipër.

Në ndarjen me pajtim, krahas fjalës “U ndava me ty.”, është kusht që, pas kësaj fjale, “u ndava”, të thuhet edhe fjalia: “Je e divorcuar.”

Gjithashtu, ndarja me pajtim është e vlefshme, edhe nëse burri thotë vetëm fjalën “divorc” dhe i thotë gruas: “Je e divorcuar me kaq ose për kaq.”

Gjithsesi, fjala “divorc” duhet të thuhet prej burrit në të gjitha gjendjet. Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Për këtë fukahatë kanë një fjalë të përbashkët.”

Dëshmori i dytë, në komentin e librit “El Lum’ah”, ka thënë: “Bazuar në fjalën e fukahave më të dëgjuar, ndarja me pajtim, patjetër duhet të pasohet me fjalën “divorc” dhe për këtë nuk dimë të ketë ndonjë kundërshtues, madje një grup fukahash pretendon se kjo thënie ka edhe fjalën e përbashkët të fukahave.”

Kur fjala “divorc” në ndarjen me pajtim është domosdoshmëri, atëherë lejohet që me fjalën “divorc” të jetë e bashkuar çdo fjalë e ngjashme. Kjo është e barabartë, qoftë kur fjala është e qartë, qoftë kur është metaforë, me kusht që të bëjë insinuatë për divorcin. Kjo është edhe arsyeja që vetëm ky autor është mjaftuar të shprehet se kjo është e lejueshme.

\* \* \*



## KOHA E PRITJES LIGJORE

Në tërësi, detyra për kalimin e kohës së pritjes ligjore, nga ana e gruas, është prej domosdoshmërive të fesë dhe nuk mund të thuhet se është dispozitë e veçantë për njërin medh'heb dhe nuk flitet rreth saj në një medh'heb tjetër. Origjina për kalimin e kohës së pritjes ligjore është fjala e Allahut të Lartësuar:

“وَالْمُطَلَّقَاتُ يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ ثَلَاثَةَ قُرُوءٍ”

**“Gratë e divorcuara janë të detyruara të presin tri menstruacione...”** (Sure “El Bekare”, ajeti 228)

Si dhe fjala tjetër e Allahut të Lartësuar:

“وَالَّذِينَ يُتَوَفَّوْنَ مِنْكُمْ وَيَذَرُونَ أَزْوَاجًا يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ وَعَشْرًا”

**“Të vdekurit prej jush që lënë pas vetes gra, ato do të presin katër muaj e dhjetë ditë...”** (Sure “El Bekare”, ajeti 234)

Hadithet janë të shumta dhe e kanë tejkaluar kufirin e vijueshmërisë së përcjellësve. Prej këtyre haditheve përmendim hadithin e nderuar: “Ai që i ka besuar Allahut e Ditës së Gjykimit,

dy burra nuk e mbulojnë (nuk kryejnë marrëdhënie intime) një grua në të njëjtin pastrim.”

Në vijim do të flasim për gruan që s’ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore, për gruan që e ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore, kur atë e ka divorcuar burri, ose gruan që dhuron kohën, siç është gruaja me martesë të ndërprerë. Do të flasim për gruan që kalon kohën e pritjes ligjore për shkak të vdekjes së burrit, për kalimin e kohës gjatë pritjes ligjore prej gruas me të cilën është kryer marrëdhënie intime e dyshimtë, do të flitet për pastrimin e lavires, për kohën e pritjes ligjore që kalon gruaja së cilës i ka humbur burri, si dhe për dispozitat që renditen mbi këto raste.

### ***S’kalon kohën e pritjes ligjore***

1- Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, s’ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore gruaja e divorcuar, para se burri të kryejë marrëdhënie intime me të, qoftë gruaja e virgjër ose jo e virgjër. Prej teksteve, kemi fjalën e Allahut të Lartësuar:

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نَكَحْتُمُ الْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ طَلَقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَمْسُوهُنَّ فَمَا لَكُمْ عَلَيْهِنَّ مِنْ عِدَّةٍ تَعْتَدُونَهَا”

**“O besimtarë, kur bëni kurorëzim me besimtares dhe më pas i divorconi, para se të kryeni marrëdhënie intime me ato, nuk keni te drejtë të kërkoni që ato të kalojnë kohën e pritjes ligjore...” (Sure “El Ahzab”, ajeti 49)**

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur burri e divorcon gruan e tij dhe nuk ka kryer marrëdhënie intime me të, ajo është përgjithmonë e divorcuar prej tij. Nëse ajo dëshiron, mund të martohet që nga çasti i divorcimit.”

Përfundimi i kohës së martesës së ndërprerë, ose dhurimi i kohës së kësaj martese, me dispozitën e divorcit, gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, kështu është edhe puna për rastin e martesës së prishur.

S’ka asnjë ndikim qëndrimi i burrit me gruan në vetmi, kur ai nuk kryen marrëdhënie intime me të, pavarësisht nga lloji i qëndrimit të atyre të dyve në vetmi. Nëse burri luan mbi kofshët e gruas dhe uji i tij shkon në vaginën e gruas, a ka detyrim kjo grua të kalojë kohën e pritjes ligjore?

*Përgjigje:* Koha e pritjes ligjore është detyrim, sepse teksti tregon qartë që pritja ligjore bëhet detyrim me njëren prej dy veprimeve: ose me hyrjen e burrit te gruaja, pavarësisht nëse pati ose jo derdhje të spermës, ose me rrëshqitjen e ujit të burrit në vaginën e gruas, pa kryer marrëdhënie të mirëfillta intime.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që është martuar me një grua dhe gruaja ka hyrë te burri, por burri as nuk e ka prekur e as nuk ka arritur te ajo. Më pas burri e divorcoi atë. A ka detyrim kjo grua të kalojë pritjen ligjore? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Koha e pritjes ligjore është prej ujit.”

Pyetësi vazhdoi: “Nëse burri kryen marrëdhënie intime me gruan, por nuk ka derdhje të spermës. Si duhet të veprohet?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kur burri hyn te

gruaja, bëhet detyrim shuma e kurorës, gusuli dhe kalimi i pritjes ligjore.”

2- E divorcuara nuk kalon pritjen ligjore, nëse nuk ka mbushur nëntë vjeç, edhe nëse burri ka kryer marrëdhënie intime me të dhe pastaj e divorcon.

3- Gruas që i janë ndërprerë menstruacionet, që ka mbushur pesëdhjetë vjeç dhe nuk është prej fisit të kurejshëve, nëse është prej fisit të kurejshëve, duhet të ketë mbushur gjashtëdhjetë vjeç. Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse ajo ka detyrim të kalojë pritjen ligjore, kur burri e divorcin, pasi ka kryer marrëdhënie intime me të.

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë dy fjalë: Sej'jid El Murtezà, ibn Sema dhe Ibn Shejkrashubi, kanë shkuar me thënien e librit “El Xhevahir”, kurse Ibn Zuhreh ka shkuar me thënien e librit “El Hadaik” dhe të librit “El Mesalik”, që janë shprehur për detyrimin e gruas për të kaluar kohën e pritjes ligjore, plotësisht si ka detyrim të kalojë pritjen ligjore, kur e divorcuara është vajzë e re, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar, në ajetin 4 të sures “Et Talak”:

“ وَاللَّائِي يَكْسَنُ مِنَ الْمَحِيضِ مِنْ نَسَائِكُمْ إِنْ أَنْتَبْتُمْ فَعِدَّتُهُنَّ ثَلَاثَةَ أَشْهُرٍ وَاللَّائِي أَمْ يَحْضُنَّ ”

**“Grave tuaja që u janë ndërprerë menstruacionet dhe ju nuk e dini, koha e pritjes ligjore për këto gra është tre muaj, gjithashtu edhe gratë që s’kanë menstruacione...”**

Prej Imam Sadikut (Paqja goftë mbi të!) transmetohet se ai ka thënë: “Koha e pritjes ligjore për gruan që i janë ndërprerë menstruacionet është tre muaj.”

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorëve të librave “El Xheuahir”, “El Hadaik”, “El Mesalik” dhe me të tjerë fukahatë të dëgjuar dhe janë shprehur se kjo grua s’ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore, pasi, në lidhje me këtë çështje, kanë ardhur transmetime të shumta prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*). Për këto transmetime, në kuadrin e shprehjes së autorit të librit “El Xhevahir”, mund të pretendohet se janë me varg përcjellësish të pashkëputur, sepse janë shumë transmetime dhe për shkak se janë transmetuar me përcjellës të gradës “Sahijh”, të pakundërshtueshëm në besueshmërinë si përcjellës të transmetimeve. Përveç kësaj, me këto transmetime kanë punuar fukahatë më të dëgjuar, të cilët, bazuar mbi këto transmetime, e kanë bërë detyrim për gruan që ajo të plotësojë kohën e pritjes ligjore.

Për ajetin e nderuar që u përmend më sipër, është folur në kapitullin “Divorci”, në paragrafin “Divorci i kthyeshëm dhe divorci i pakthyeshëm”. Sqarojmë se fjala e ajetit “**që i janë ndërprerë menstruacionet**”, ka qëllim gratë që nuk shikojnë më hemorragjinë e përmuajshme, por që ne nuk e dimë shkakun e ndërprerjes së menstruacioneve të asaj gruaje, nëse shkakun është mosha në të cilën grave u ndërpritet cikli mujor i menstruacioneve, apo është për ndonjë shkak tjetër. Gjithashtu, ajeti e thotë qartë se koha e pritjes ligjore për këtë grua është tre muaj dhe argumenti për këtë shpjegohet në vetë ajetin e nderuar me fjalën “**dhe ju nuk e dini**”.

## 1- Koha e pritjes ligjore për të divorcuarën shtatzënë

Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, koha e pritjes ligjore për të divorcuarën shtatzënë është lindja e fëmijës. Prej këtyre teksteve kemi fjalën e Allahut të Lartësuar:

“وَأُولَاتُ الْأَحْمَالِ أَجَلُهُنَّ أَنْ يَضَعْنَ حَمْلَهُنَّ”

**“...dhe për gratë shtatzëna, afati i pritjes ligjore është derisa të lindin...”** (*Sure “Et Talak”, ajeti 4*)

Imam Bakiri, babai Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Divorci i shtatzënës është vetëm një, kur ajo e nxjerr atë që ka në barkun e saj, ajo është e ndarë përfundimisht prej tij.”

Shtatzëna del prej kohës së pritjes ligjore, sapo të lindë fëmijën, madje edhe nëse i linduri nuk është plotësisht i krijuar. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një grua që dështon dhe të cilën e kishte divorcuar burri i saj. Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Çdo gjë e bën të qartë që dështimi ishte shtatzëni, qoftë i dështuari i plotë ose jo. Me dështimin, gruaja ka përfunduar pritjen ligjore, madje dhe, nëse i dështuari është në fazën e formimit, si bukë e mbllaçitur (*mud'gah*).”

Kriteri është: Me dështimin, gruaja shtatzënë del prej kohës së pritjes ligjore, duke ditur që kjo fazë është fillimi i formimit të njeriut dhe patjetër, në asnjë rast, nuk mund të quhet shtatzëni, kur gruaja nxjerr spermën.

Kur gruaja është shtatzënë me më shumë se një fëmijë, ajo nuk del prej pritjes ligjore pa i lindur të gjithë, pasi ky është edhe kuptimi i fjalës së ajetit të nderuar: **“derisa të lindin”**, do të thotë:

derisa gruaja të lindë fëmijët që ka në bark dhe jo lindë vetëm disa dhe të mos lindë të tjerët që ka në bark.

Më sipër është shpjeguar se koha e pritjes ligjore për gruan me martesë të ndërprerë dhe për gruan me martesë të prishur, është në dispozitën e pritjes ligjore për gruan e divorcuar. Bazuar mbi këtë rregull, koha e pritjes ligjore për shtatzënë me martesë të prishur, si dhe për gruan me martesë të ndërprerë, është lindja e fëmijës, plotësisht si për të divorcuarën shtatzënë.

## **2- Pas divorcit, gruaja pretendon shtatzëninë**

Kur burri e divorcon gruan, sipas rregullit të ligjit të fesë dhe në kohën e divorcit gruaja nuk pretendon që është shtatzënë, por pas një kohe ajo thotë: “Jam shtatzënë.”, a besohet fjala e kësaj gruaje?

*Përgjigje:* Kur gruaja pretendon shtatzëninë, pasi që nga kryerja e marrëdhënieve intime me burrin e saj ka kaluar aq kohë sa është koha më e largët e shtatzënisë, fjala e gruas refuzohet dhe nuk vërtetohet, sepse shtatzënia, në këtë gjendje, është e pamundur.

Nëse nuk ka kaluar kjo periudhë kohe, gruaja duhet të bëjë durim një vit. Nëse gruaja lind para përfundimit të kësaj kohe, fëmija i atashohet divorcuesit, ndryshe nuk i atashohet atij.

Në lidhje me këtë çështje, s’ka dallim mes gruas që e kalon pritjen ligjore të llogaritur në muaj, ose të llogaritur të bazuar në ciklin menstrual.

Autori i librit “El Hadaik”, në vëllimin 7, botim i vitit 1317H, ka thënë: “Nëse asaj i vonohet cikli i dytë ose i tretë menstrual, ajo pastrohet vetëm me lindjen e fëmijës. Origjina për këtë dispozitë është nxjerrë prej transmetimit që ka përmendur Shejkhu në librin “Et Tehdhijb”, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili është pyetur për një burrë që ka divorcuar gruan e tij vetëm një herë në kohën e pastrimit të saj dhe ai s’ka kryer marrëdhënie intime me të, domethënë ai ka vepruar në përputhje me kushtet e divorcit sipas Sunetit. Veç kësaj, gruaja është grua që ka menstruacione dhe kanë kaluar tre muaj, gjatë të cilave ajo ka pasur menstruacione vetëm një herë dhe pastaj menstruacionet i kanë ndaluar, derisa kalojnë tre muaj të tjerë, duke shtuar se gruaja nuk e di shkakun që i ndaloi asaj menstruacionet.

*Ai tha: “Nëse ajo është e vajzë e re dhe menstruacionet i ka të rregullta, por më pas, gjatë tre muajve, asaj i vijnë menstruacionet vetëm një herë dhe pastaj përsëri menstruacionet i ndalojnë, ajo do të presë nëntë muaj që nga dita e divorcit, pastaj do të kalojë edhe tre muaj të tjerë për të plotësuar pritjen ligjore. Pas kësaj kohe, nëse dëshiron, ajo mund të martohet.”*

### **3- Koha e pritjes ligjore për gruan me menstruacione të rregullta**

Burri e divorcon gruan e tij, pasi ka kryer marrëdhënie intime me të, gruaja nuk është shtatzënë dhe vazhdon të ketë menstruacione, por asaj menstruacionet zakonisht i vijnë një herë në çdo tre muaj ose edhe në më pak, ose edhe në më shumë se tre muaj. Në këtë gjendje, gruaja e llogarit kohën e pritjes ligjore tre menstruacione, ashtu siç thuhet në ajetin 228 të sures “El Bekare”:



“وَالْمُطَلَّقَاتُ يَتَرَقَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ ثَلَاثَةَ قُرُوءٍ”

**“Gratë e divorcuara janë të detyruara të presin tre menstruacione...”,** domethënë të kalojnë tri pastrime. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Sipas praktikës dhe transmetimit, për këtë çështje nuk kam hasur asnjë kundërshtar.”

Imami Bakiri, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Kur gruaja hyn në menstruacionin e saj të tretë, ajo e ka kryer kohën e pritjes ligjore dhe e ka hallall të martohet.”

Gjithashtu, ai ka thënë: “Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi ta!*), ka thënë: “Në të vërtetë, pastrimi është mes dy menstruacioneve.”

Bazuar mbi këtë transmetim, kur burri e divorcon gruan në fundin e pastrimit të saj, këtë kohë ai e llogarit si kohën e pritjes ligjore dhe pas këtij pastrimi, koha e pritjes ligjore për këtë grua llogaritet pas dy pastrimeve të tjera; kurse gruaja që kalon kohën e pritjes ligjore për shkak të martesës së prishur, është plotësisht si gruaja që kalon kohën e pritjes ligjore për shkak të divorcit. Për sa i përket gruas me martesë të ndërprerë, koha e pritjes ligjore është që ajo të kalojë dy menstruacione, por për këtë grua do të flitet më poshtë.

#### **4- Koha e pritjes ligjore e vajzës që s’ka menstruacione**

Kur vajza është në moshën e vajzave që kanë menstruacione, por ajo nuk ka menstruacione për shkak të formimit të saj fizik, ose për shkak të ndonjë sëmundjeje, koha e

pritjes ligjore për këtë grua është tre muaj, me kusht që burri të ketë kryer marrëdhënie intime me të dhe ajo nuk është shtatzënë. Kjo është e barabartë, qoftë kur burri është ndarë prej saj për shkak të divorcit, qoftë kur është ndarë për shkak të martesës së prishur.

Për sa i përket gruas me martesë të ndërprerë, siç do të vijë më poshtë, koha e pritjes ligjore është dyzet e pesë ditë. Argumenti që tregon se koha e pritjes ligjore për gruan që nuk ka menstruacione është tre muaj, është nxjerrë prej transmetimeve të shumta të ardhura prej Ehli Bejtit (Paqja e Allahut qoftë mbi ata!), prej të cilave përmendin fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Koha e pritjes ligjore për gruan e divorcuar është tri pastrime, ose tre muaj, nëse nuk ka menstruacione.”*

Gjithashtu, ai është pyetur për një burrë që divorcon gruan e tij, pasi gruaja lind fëmijën dhe është pastruar, por gruas nuk i vijnë menstruacionet gjatë kohës që ajo ushqen foshnjën me gji. Sa është koha e pritjes ligjore për këtë grua? Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Tre muaj.”*

## ***5- Koha më e shkurtër e pritjes ligjore***

Kur gruaja njofton se plotësoi kohën e pritjes ligjore, sipas llogaritjes me pastrimet, fjala e kësaj gruaje vërtetohet, kur koha që ajo pretendon, është e mjaftueshme që ajo të kalojë kohën e pritjes ligjore. Koha më e paktë, në të cilën mund të vërtetohet fjala e gruas që kalon pritjen ligjore, të llogaritur me pastrimet, është njëzet e gjashtë ditë dhe dy momente, domethënë burri e divorcon gruan në fundin e kohës së pastrimit. Pastaj asaj i vijnë

menstruacionet tri ditë, që siç dihet është koha me paktë e periudhës së menstruacioneve. Më pas gruaja kalon kohën më të paktë të pastrimit, e cila, ashtu siç dihet, është dhjetë ditë. Pastaj asaj i vijnë menstruacionet për tri ditë. Pastaj për gruan fillon koha e pastrimit të dytë që i zgjat dhjetë ditë, derisa asaj i vijnë menstruacionet. Sapo kjo grua të shohë gjakun e fundit, ajo del prej kohës së pritjes ligjore, patjetër kërkohet që, prej çastit të parë të ardhjes së menstruacioneve për herë të tretë, duhet të dihet mirë dhe plotësisht edhe pastrimi i fundit.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo është për vetë menstruacionet, ndryshe mund të përfytyrohet kalimi i kohës së pritjes ligjore në më pak kohë se kjo që u tha në lidhje me periudhën e lehonisë. Sikur burri të divorcojë gruan, pasi ajo të lindë fëmijën, para se ajo të shikojë gjak vetëm në një çast dhe pastaj ajo sheh vetëm për një çast hemorragjinë e lehonisë, sepse te ne s’ka kufi për kohën më të vogël të hemorragjisë së lehonisë dhe pastaj gruaja sheh pastrimin e saj për dhjetë ditë, pastaj ajo sheh gjak për tri ditë, pastaj sheh pastrimin për dhjetë ditë, duke llogaritur këto ditë, shuma rezulton 23 ditë dhe tre çaste: çasti pas divorcit, çasti i lehonisë dhe çasti i gjakut të tretë. Duhet të theksojmë se qëllimi i përdorimit të togfjalëshit “kohën më të shkurtër”, është të tregojë kohën më të shkurtër të pritjes ligjore për gruan që e kalon kohën e pritjes ligjore të llogaritur me pastrimet, ndryshe ka mundësi që koha e pritjes ligjore të jetë edhe më pak se një orë, si për shembull, në rastin kur burri e divorcon gruan, kur ajo është shtatzënë dhe lind fëmijën, menjëherë pasi ai e divorci. Në këtë gjendje, kjo grua del prej kohës së pritjes ligjore menjëherë pas lindjes.

## 6- Koha më e gjatë e pritjes ligjore

Më sipër folëm për gruan që i ka menstruacionet e rregullta. Koha e pritjes ligjore për këtë grua është që ajo të kalojë tri pastrime. Gruaja që s'ka menstruacione dhe është në moshën e menstruacioneve, koha e pritjes ligjore për këtë grua është tre muaj, pikërisht këtu lind një pyetje: Kur kjo grua e llogarit kohën e pritjes me muaj, por para se ajo të kalojë tre muaj të bardhë, kjo grua sheh gjak, si duhet të veprojë?

*Përgjigje:* Kjo grua, kohën e pritjes ligjore e llogarit me një rënë prej dy mënyrave që u thanë më sipër, domethënë, ose me tre muaj të bardhë, ose tri pastrime, në kuptimin që ajo kalon tre muaj të bardhë, para se të plotësohet pastrimi në të cilin përfundon koha e pritjes ligjore për të. Nëse kalojnë tri pastrimet para tre muajve, koha e pritjes ligjore ka përfunduar.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Çdo një rënë prej dy mënyrave të llogaritjes që ajo të marrë në konsideratë, për atë ka përfunduar koha e pritjes ligjore. Nëse kalojnë tre muaj dhe ajo nuk sheh gjak gjatë këtyre tre muajve, koha e pritjes ligjore për këtë grua ka përfunduar. Gjithashtu, kur ajo kalon tri pastrime, koha e pritjes ligjore për atë ka përfunduar.”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Me këtë bëhet i qartë rregulli përgjithësues: Për çdo grua që kalon kohën e pritjes ligjore për shkak divorci, si dhe për shkak të martesës së prishur, domethënë llogaritjen e kohës ajo e bën sipas mënyrës që u tha më sipër, pa asnjë dallim mes individëve.”

Kur gruaja shikon menstruacionet para se të përfundojnë tre muaj, qoftë edhe vetëm për një çast, ajo do të bëjë durim dhe të

presë nëntë muaj, qoftë edhe kur pas kësaj ajo nuk sheh më gjak. Ajo ka detyrim të presë edhe tre muaj të tjerë. Pas përfundimit të nëntë muajve, nëse ajo lind para përfundimit të vitit, atëherë ajo del prej pritjes ligjore.

Gjithashtu, gruaja del prej pritjes ligjore, kur plotësohen pastrimet. Kur gruaja nuk lind dhe nuk plotësohen tri pastrimet para vitit, ajo qëndron në pritjen ligjore tre muaj plus nëntë muaj dhe kështu shuma e muajve bën një vit i plotë.

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Originë për këtë është njoftimi i ardhur prej Sudeh bin Keljbit që tregon se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka divorcuar gruan e tij në praninë e dy dëshmitarëve të drejtë, duke i thënë vetëm një herë: “Je e divorcuar.”, në kohën e pastrimit të saj dhe nuk ka kryer marrëdhënie intime me të. Pra, e ka divorcuar në përputhje me divorcin Sunet. Duhet të theksojmë se gruaja është grua që ka menstruacione. Kalojnë tre muaj dhe gjatë këtyre tre muajve ajo ka pasur menstruacione vetëm një herë. Më pas asaj i janë ndërprerë menstruacionet. Kalojnë edhe tre muaj të tjerë dhe ajo nuk e di shkakun që iu ndërprejnë menstruacionet.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Në qoftë se gruaja është në moshë të re dhe menstruacionet i ka të rregullta, megjithëkëtë gjatë tre muajve sheh menstruacione vetëm një herë, pastaj asaj i ndërpriten menstruacionet dhe ajo nuk e di shkakun që iu ndërprejnë menstruacionet, kjo grua pret nëntë muaj që nga dita e divorcimit. Pastaj ajo do të kalojë edhe tre muaj të tjerë që të plotësojë pritjen ligjore dhe vetëm pas kësaj kohe, nëse dëshiron, ajo mund të martohet.”

## **7- Koha e pritjes ligjore për gruan me martesë të përkohshme**

Kur përfundon koha e martesës së ndërprerë, burri i dhuron asaj përfundimin e martesës, para se të kryejë marrëdhënie intime me të. Kjo grua s'ka detyrim të kalojë pritjen ligjore, sepse bën pjesë te gratë që përmenden në ajetin: **“dhe më pas i divorconi ato para se të kryeni marrëdhënie intime me to, nuk keni te drejtë të kërkoni që ato të kalojnë kohën e pritjes ligjore...”** (Sure “*El Ahzab*”, ajeti 49), domethënë se përfundimi i kohës, ose dhurimi i kësaj kohe, është në varësi të divorcit.

Nëse kjo e divorcuar është shtatzënë, koha e pritjes ligjore për atë është lindja e fëmijës, ashtu siç thuhet në fjalën e Allahut të Lartësuar: **“...dhe për gratë shtatzëna, afati i pritjes ligjore është derisa të lindin...”** (Sure “*Et Talak*”, ajeti 4)

Shumica e fukahave më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “*Mulhakatul Urveh*” se koha e pritjes ligjore për të divorcuarën me martesë të përkohshme, me të cilën burri ka kryer marrëdhënie intime dhe ajo nuk është shtatzënë, është dy menstruacione, ashtu siç thotë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): **“Kur përfundon afati (i martesës së përkohshme), ajo ndahet prej tij pa divorc, burri i jep asaj diçka dhe koha e pritjes ligjore për këtë grua është që ajo të kalojë dy menstruacione.”**

Kur gruaja me martesë të përkohshme është në moshën kur gratë kanë menstruacione, por ajo nuk ka menstruacione, koha e pritjes për këtë grua është dyzet e pesë ditë. Autori i librit “*El Xheuahir*” ka thënë: “Me fjalën e përbashkët dhe me tekst, madje në njoftimin e El Bizentij’jit, tregohet se Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi*

të!) ka thënë: “Imam Ebu Xhaferi (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Koha e pritjes për gruan me martesë të ndërprerë është dyzet e pesë ditë dhe për rezervë thuhet edhe dyzet e pesë net, në kuptimin dyzet e pesë ditë e net, por është më e pëlqyeshme që mos të merret në konsideratë bashkimi ditë-natë.”

Në qoftë se e divorcuara me martesë të përkohshme, s’ka menstruacione, kjo grua s’ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore.

Nëse gruas me martesë të përkohshme i vdes burri, koha e pritjes ligjore për atë është katër muaj e dhjetë ditë. Kjo është e barabartë, qoftë kur burri ka kryer marrëdhënie intime me të, qoftë kur nuk ka kryer, madje edhe sikur gruaja të jetë në moshë të vogël.

Nëse gruaja me martesë të përkohshme është shtatzënë, koha e pritjes ligjore për këtë grua është njëri prej dy afateve më të gjata.

Imam Bakiri, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Çdo grua me burrë, kur asaj i vdes burri, qoftë grua e lirë, ose robëreshë dhe e çdo lloji qoftë martesa e saj, e përkohshme ose e përhershme, qoftë grua e martuar me kurorë, qoftë grua prej robëreshave të luftës, koha e pritjes është katër muaj e dhjetë ditë.”

Në vendin përkatës, do të flitet për kohën e pritjes së gruas, kur asaj i vdes burri.

## **8- Koha e pritjes ligjore për gruan, burri i së cilës braktis Islamin**

Kur burrë e grua janë me origjinë myslimane dhe burri braktis Islamin, në këtë rast shikohet: Nëse burri ka lindur prej prindërve me origjinë myslimane, ose është mysliman vetëm babai i tij, gruaja e këtij renegati ndahet prej tij menjëherë, sepse me braktisjen e Islamit bëhet detyrim që ai të ekzekutohet, të pjesëtohet trashëgimia e tij dhe në raport me dispozitat e kësaj bote, atij nuk i pranohet as pendimi (*teubeh*), edhe sikur pendimi i tij të jetë i pranuar prej Allahut të Lartësuar.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Çdo mysliman që braktis Islamin, mohon dhe e përgënjeshtrohet Muhamedin (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), gjaku i këtij njeriu është i lejuar për këdo që e dëgjon atë. Gruaja ndahet prej tij përgjithmonë ditën që ai braktis Islamin dhe nuk i afrohet atij. Gjithashtu, pasuria e tij pjesëtohet ndërmjet trashëgimtarëve të tij, por gruaja e tij do të kalojë kohën e pritjes ligjore si grua së cilës i vdes burri, duke ditur se Imami e ka detyrim ta ekzekutojë këtë renegat dhe të mos i kërkojë atij që të pendohet.”

Kur ky renegat nuk është me origjinë myslimane, por është i konvertuar në Islam dhe më pas ai e braktis Islamin, këtij renegati i pranohet pendimi, por gruaja e tij myslimane është e ndaluar për atë, për shkak të pozitës së Islamit dhe kjo grua e kalon kohën e pritjes ligjore siç e kalon gruaja e divorcuar. Në qoftë se ky renegat pendohet gjatë kohës së pritjes ligjore të gruas, patjetër që ai ka të drejtë më shumë së kushdo tjetër mbi gruan e tij, ndryshe ajo ndahet prej tij përgjithmonë.



## 9- Koha e pritjes ligjore për gruan që i vdes burri

Kur gruas i vdes burri dhe gruaja nuk është shtatzënë, koha e pritjes ligjore për këtë grua është katër muaj e dhjetë ditë, e madhe apo e vogël qoftë gruaja, qoftë grua së cilës i janë ndërprerë menstruacionet, qoftë grua e re në moshë, ka kryer ose jo burri marrëdhënie intime me atë, është me martesë të përhershme apo me martesë të ndërprerë, koha e pritjes për këto gra është ashtu siç urdhëron Allahu i Lartësuar në fjalën e Tij:

“وَالَّذِينَ يُتَوَفَّوْنَ مِنْكُمْ وَيَذَرُونَ أَزْوَاجًا يَتَرْتَبِصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ وَعَشْرًا”

**“Të vdekurit prej jush që lënë pas vetes gra, ato do të presin katër muaj e dhjetë ditë...”** (Sure “El Bekare”, ajeti 234)

Ky ajet i nderuar i Kur'anit Famëlartë, nuk përmban kushte, prandaj përfshin të gjitha kategoritë e grave, me përjashtim të gruas shtatzënë, argumentin për të cilën do ta shikojmë në vijim.

Në paragrafin e mësipërm përmendëm fjalën e Imam Bakirit, babait të Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), që pavarësisht se çfarë lloji është martesë, koha e pritjes ligjore për gruan së cilës i vdes burri, është katër muaj e dhjetë ditë.

Për sa i përket gruas shtatzënë, koha e pritjes për atë është njëri prej dy afateve më të gjata, lindja e fëmijës dhe katër muaj e dhjetë ditë. Në qoftë se ajo kalon katër muaj e dhjetë ditë para lindjes, ajo e plotëson kohën e pritjes ligjore me lindjen e fëmijës dhe, nëse ajo lind fëmijën para se të kalojnë katër muaj e dhjetë ditë, ajo e plotëson kohën e pritjes ligjore me katër muaj e dhjetë ditë.

Argumenti për këtë rregull është nxjerrë nga procesi i bashkimit të ajetit: **“ato do të presin katër muaj e dhjetë ditë.”** dhe ajetit: **“...derisa të lindin...”**

Ajeti i parë për gruan që i vdes burri, e ka bërë pritjen ligjore katër muaj e dhjetë ditë dhe përfshin shtatzënë e jo shtatzënë, kurse ajeti i dytë e ka bërë pritjen ligjore katër muaj e dhjetë ditë dhe përfshin të divorcuarën dhe gruan së cilës i vdes burri. Duke parë të dy ajetet nga ana e jashtme, arrihet kontradikta kur shtatzëna që lind para katër muajve e dhjetë ditëve, sipas kërkesës së ajetit të dytë, ajo e ka përfunduar kohën e pritjes ligjore, sepse ajo e lindi fëmijën, kurse sipas kërkesës së ajetit të parë, ajo akoma nuk e ka përfunduar kohën e pritjes ligjore, sepse akoma nuk kanë kaluar katër muaj e dhjetë ditë.

Gjithashtu, kontradikta arrihet edhe kur kalojnë katër muaj e dhjetë ditë dhe gruaja akoma nuk ka lindur fëmijën, atëherë sipas kërkesës së ajetit të parë, koha e pritjes ligjore përfundon, sepse pritja ligjore është katër muaj e dhjetë ditë dhe kjo kohë ka kaluar, kurse sipas kërkesës së ajetit të dytë, koha e pritjes ligjore nuk ka përfunduar, sepse gruaja akoma nuk ka lindur fëmijën.

Mirëpo fjalët e Kur'anit patjetër janë në harmoni e në përshtatje me njëra-tjetrën, veçanërisht kur të dy ajetet janë të të njëjtit nivel nga ana e jashtme, ashtu siç kemi dy ajetet që kemi marrë në trajtim. Bazuar mbi këtë rregull ne i bashkuan dy ajetet sipas kësaj forme:

“وَالَّذِينَ يُتَوَفَّوْنَ مِنْكُمْ وَيَذَرُونَ أَزْوَاجًا يَتَرْتَبِعْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ وَعَشْرًا”

**“Të vdekurit prej jush që lënë pas vetes gra, ato do të presin katër muaj e dhjetë ditë...”** (Sure “El Bekare”, ajeti 234)

Si dhe ajeti:

“وَأُولَاتُ الْأَحْمَالِ أَجَلُهُنَّ أَنْ يَضَعْنَ حَمْلَهُنَّ”

**“...dhe për gratë shtatzëna, afati i pritjes ligjore është derisa të lindin...”** (Sure “Et Talak”, ajeti 4)

Kuptimi rezulton se koha e pritjes ligjore, në rastin e vdekjes së burrit, është katër muaj e dhjetë ditë, për gruan që nuk është shtatzënë, si dhe për gruan shtatzënë që lind para se të kalojnë katër muaj e dhjetë ditë, kurse gruaja që lind, pasi kalojnë katër muaj e dhjetë ditë, koha e pritjes ligjore për atë është lindja e fëmijës.

Me këtë bashkim, fjala e ajeteve të Kur'anit vihet në balancë, domethënë që nuk mbetet më kontradiktë mes ajeteve, duke theksuar se fukahatë shi'a e kanë marrë kuptimin e këtij bashkimi të ajeteve prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), të cilët janë njerëzit më të ditur në kuptimin e ajeteve të Kur'anit.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët në lidhje me detyrën që ka gruaja që të mbajë zi për vdekjen e burrit të saj gjatë kohës së pritjes ligjore. Zija e gruas për vdekjen e burrit do të thotë që ajo të qëndrojë larg veprimeve që sjellin zbukurimin dhe çojnë në synime erotike drejt asaj.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Gruaja që i vdes burri, nuk lyen sytë me kohl për t'u zbukuruar, nuk parfumohet, nuk vesh rroba të ngjyrosura, nuk del prej shtëpisë së saj dhe kryen të gjitha detyrimet.”

Kriter për heqjen dorë prej zbukurimit është tradita.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur vdes burri i të divorcuarës me divorc të kthyeshëm, para se ajo të përfundojë kohën e pritjes ligjore, gruaja ka detyrim të rifillojë kohën e pritjes ligjore për vdekjen e burrit që nga çasti i vdekjes së burrit. Kjo është e barabartë, qoftë kur divorci ka ndodhur në sëmundjen nga e cila ai vdiq, qoftë kur divorci ka ndodhur kur ai ishte në gjendje të mirë shëndetësore, sepse lidhja martesore mes të divorcuarës e divorcuesit nuk është shkëputur dhe pikërisht për këtë shkak ata trashëgojnë njëri-tjetrin.

Gjithashtu, janë këto gjendje që bëjnë detyrim për ne të hulumtojmë në çështjet e ligjit të fesë. Në qoftë se gruaja është duke kaluar pritjen ligjore për shkak të një divorci të pakthyeshëm, gruaja kalon kohën e pritjes ligjore dhe, në rast se i vdes burri gjatë pritjes së saj ligjore, ajo nuk bën pritje ligjore të dytë për shkak të vdekjes së burrit, sepse lidhja martesore mes atyre të dyve, me divorcin e pakthyeshëm, është ndërprerë përfundimisht.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka divorcuar gruan e vet dhe ka në dorë kthimin, domethënë ka bërë divorc të kthyeshëm, por më pas ai vdes. Çfarë duhet të bëjë gruaja?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "*Gruaja kalon pritjen ligjore me njërin prej dy afateve më të gjata, katër muaj e dhjetë ditë.*"

Fillimi i pritjes ligjore për shkak divorci, llogaritet që nga çasti i ndodhjes së divorcit, qoftë kur burri është pranë gruas, qoftë kur është larg saj. Kur burri e ka divorcuar gruan dhe ajo nuk di gjë se ai e ka divorcuar, derisa plotësohet koha e pritjes

ligjore, kjo grua s'ka më detyrim të kalojë një pritje ligjore të dytë, kurse pritja ligjore, me rastin e vdekjes së burrit, fillon që nga çasti kur ajo merr njoftim për vdekjen e burrit, në rastin kur burri nuk është pranë gruas. Nëse burri është pranë gruas dhe supozohet se ajo mëson për vdekjen e tij pas një farë kohe, në këtë gjendje, pritja ligjore për këtë grua fillon që prej çastit të vdekjes së burrit.

Në lidhje me këtë çështje, autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kur burri është pranë gruas, ajo e fillon pritjen ligjore që nga çasti i ndodhjes së divorcit, ose që prej çastit të vdekjes së burrit. Për këtë unë s'kam gjetur asnjë kundërshtim, në të kundërt, kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, sipas rregullit të puqjes pasojë-shkak. Gruaja e divorcuar prej burrit, që është larg gruas, sipas fjalës së fukahave më të dëgjuar, e fillon kohën e pritjes që nga koha e ndodhjes së divorcit.

Ky rregull është nxjerrë prej teksteve të shumta të ardhura me varg të pandërprerë përcjellësish, si njoftimi i shkallës "Sahijh", i transmetuar prej ibn Muslimit, i cili tregon: Imam Bakiri, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), më tha mua: "Kur burri divorcon gruan dhe nuk është pranë saj, ai ka detyrim të ketë dëshmitarë për divorcin që bën dhe, kur gruaja kalon tri menstruacione që prej kësaj dite, ajo e ka plotësuar kohën e saj të pritjes ligjore."

Kur vdes burri që është larg gruas, gruaja e tij e fillon llogaritjen e pritjes ligjore që prej çastin kur ajo merr njoftim për vdekjen e tij dhe jo që prej kohës së vdekjes së tij. Kështu janë shprehur fukahatë më të dëgjuar, të bazuar në tekstet e shumta të ardhura me varg përcjellësish të pandërprerë, siç është njoftimi i shkallës "Sahijh", i përcjellë prej Ibn Muslimit, i cili tregon se

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur në lidhje me një burrë të martuar që vdes larg gruas së tij. Çfarë duhet të bëjë gruaja në këtë rast? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Gruaja fillon pritjen ligjore që prej çastit që merr njoftim për vdekjen e tij.*”

### **10- Pritja ligjore për shkak të kryerjes së marrëdhënieve intime të dyshimta**

Marrëdhënie intime e dyshimtë, është rasti kur burri është i justifikuar dhe për këtë lloj marrëdhënie nuk bëhet detyrim dënimi sipas ligjit të fesë, sepse objekti për zbatimin e dënimit është kurvërimi. Në këtë rast supozohet se nuk kemi kurvërim. Gruaja me të cilën është kryer marrëdhënie intime e dyshimtë, ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore, plotësisht ashtu siç është pritja ligjore e gruas së divorcuar. Nëse ajo mbetet shtatzënë, koha e pritjes ligjore për atë është lindja e fëmijës. Nëse gruaja është në moshën e menstruacioneve, e llogarit kohën e pritjes ligjore me kalimin e tri pastrimeve.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që martohet me një grua e cila është duke plotësuar kohën e pritjes ligjore. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Nëse burri kryen marrëdhënie intime me të, bëhet ndarja mes atyre të dyve, gruaja plotëson pritjen e parë ligjore dhe pastaj kalon pritjen ligjore për herë të dytë, të llogaritur me tri pastrime të ardhshme.*”

Bazuar mbi këtë rregull, kur vdes burri që kryen marrëdhënie intime të dyshimta, gruaja kalon pritjen ligjore që kalon gruaja së cilës i vdes burri, pra, veprohet në përputhje me

fjalën e Allahut të Lartësuar që u tha që në fillim të kapitullit **“Të vdekurit prej jush që lënë pas vetes gra...”**

*Pyetje:* Burri që kryen marrëdhënie intime të dyshimta, a ka detyrim të shpenzojë për këtë grua gjatë kohës që ajo plotëson pritjen ligjore?

*Përgjigje:* Jo. Kjo është e barabartë, qoftë kur gruaja është shtatzënë ose jo, sepse shpenzimi është detyrim për gruan me divorc të kthyeshëm, domethënë që burri e ka në dorën e tij të kthehet te gruaja. Gjithashtu, burri e ka detyrim të shpenzojë për gruan e divorcuar me divorc të pakthyeshëm gjatë kohës kur ajo është duke plotësuar kohën e pritjes ligjore, vetëm nëse gruaja është shtatzënë, kurse gruaja në studimin tonë, nuk është grua e divorcuar, prandaj, nisur nga ky fakt, autori i librit “El Xheuhir” ka thënë: “Fjala më e saktë, bazuar në origjinë, është se për këtë grua, në mënyrë të prerë, s’ka shpenzim.”

*Pyetje tjetër:* Sikur të supozohet që gruaja me të cilën u krye marrëdhënie intime e dyshimtë është grua e martuar, a ka detyrim burri ligjor të shpenzojë për këtë grua gjatë kohës që ajo kalon pritjen ligjore, ose detyrimi për të shpenzuar për atë bie, sepse burri e kishte të ndaluar të afrohej te ajo?

*Përgjigje:* Burri ligjor ka detyrim të shpenzojë për këtë grua, sepse penguesi për afrimin te ajo nuk erdhi prej gruas, por erdhi prej ligjit. Është e vetëkuptueshme që ndaluesi ligjor është si ndaluesi logjik, prandaj, bazuar mbi këtë rregull, kjo grua nuk është në dispozitën e gruas që urren burrin, që të rrezohet detyrimi i burrit për të shpenzuar për gruan e tij.

Nëse dyshimi është prej burrit dhe gruas, fëmija i atashohet të dyve, kur supozojmë se ajo mbetet shtatzënë, për rrjedhojë, për këtë grua bëhet detyrim të marrë shumën e kurorës. Në rastin kur i dyshimtë është njëri prej atyre të dyve, pra, jo të dy së bashku, fëmija i atashohet të dyshimitit.

Në qoftë se gruaja ka dijani për ndalimin, për këtë grua s'ka shumë kurore, sepse, në këtë rast, ajo ka kurvëruar dhe për laviren s'ka shumë kurore.

Në lidhje me këtë çështje kemi folur me hollësi në kapitullin "Martesa".

### ***11- Mbledhja e dy pritjeve ligjore***

Gruaja e martuar kryen marrëdhënie intime të dyshimta dhe më pas burri e divorcon, ose është duke kaluar kohën e pritjes ligjore për shkak divorci, ose për shkak të vdekjes së burrit dhe me këtë grua kryhen marrëdhënie intime të dyshimta para se ajo të përfundojë pritjen e saj ligjore. Për këtë grua janë bërë detyrim të kalojë dy kohë pritje ligjore. Nëse është kështu siç u përshkrua, a mund të mblidhen dy kohët e pritjes ligjore dhe të mjaftohet vetëm me një kohë pritje ligjore, apo ajo patjetër duhet të plotësojë të dyja kohët e pritjeve ligjore, domethënë ajo plotëson kohën e pritjes ligjore për shkak të divorcit, kur me atë është kryer marrëdhënie intime gjatë kohës së pritjes ligjore dhe pas kësaj kohe ajo kryen edhe pritjen e dytë ligjore për shkak të marrëdhënieve intime të dyshimta.



Kur gruaja është e martuar dhe me të kryhen marrëdhënie intime të dyshimta dhe pastaj ajo divorcohet, së pari, ajo kryen kohën e pritjes ligjore për shkak të marrëdhënieve intime të dyshimta dhe pastaj fillon kohën e pritjes për shkak të divorcit.

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe të autorit të librit “El Hadaik” për detyrimin e gruas që të kryejë të dyja kohët e pritjes ligjore dhe të mos futet njëra kohë pritje në kohën tjetër të pritjes, sepse origjina është: numri i pasojës me numrin e shkakut.

Në disa transmetime tregohet se, kur gruaja martohet pa e ditur që është në kohën e pritjes ligjore, kjo martesë është e pavlefshme, por pritja ligjore nuk ndërpritet. Nëse burri, gjatë kohës që gruaja kalon pritjen ligjore, nuk kryen marrëdhënie intime me të, ajo plotëson kohën e saj të pritjes ligjore dhe me kaq mjafton. Nëse gjatë kohës së pritjes ligjore kryen marrëdhënie intime me të, gruaja plotëson kohën e pritjes së parë, për shkak se ajo është më përpara dhe pastaj fillon pritjen tjetër ligjore.

Një grup prej fukahave të mëdhenj, ndër të cilët autori i librit “El Mesalik”, autori i librit “El Hadaik” dhe autori i librit “Mulshakàtul-Urveh” janë shprehur për bashkimin e dy kohëve të pritjes ligjore dhe mjaftohen vetëm me një kohë pritje ligjore. Kjo fjalë e këtyre fukahave patjetër që është bazuar në transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) dhe janë transmetime të shumta të shkallës “Sahijh”. Prej këtyre transmetimeve kemi transmetimin që tregon se Imam Bakiri, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një grua që martohet para se ajo të plotësojë kohën e pritjes ligjore. Si duhet të veprohet në këtë rast? Ai është përgjigjur: “Bëhet ndarja

*mes atyre të dyve dhe ajo kalon vetëm një kohë pritje ligjore në vend të dy kohëve."*

## **12- Koha e pritjes ligjore për laviren**

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët me autorin e librit "El Hadaik" se nuk ka kohë pritje ligjore për gruan që ka mbetur shtatzënë prej kurvërimit dhe ajo ka të drejtë të martohet para se të lindë fëmijën. Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me gruan që kurvëron dhe nuk mbetet shtatzënë, nëse ajo ka detyrim të presë që të pastrohet me një menstruacion.

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se ajo nuk e ka këtë detyrim dhe asaj i lejohej të martohet me cilin të dojë. Gjithashtu, lejohej që me këtë grua të martohet ai që dëshiron që nga çasti që ai kurvëroi me të.

Dijetari poliedrik, El Hil'lij dhe autori i librit "El Hadaik" janë shprehur se ajo duhet të presë që të pastrohet me ardhjen e menstruacioneve, kurse autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Për këtë s'ka problem, për shkak të kujdesit që të mos përzihen ujërat dhe përkatësia familjare (atësia).

Gjithashtu, edhe ne themi: S'ka problem që ajo të presë t'i vij në menstruacionet. Kështu ka ardhur në librin "El Kâfij", ku tregohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që kurvëron me një grua dhe më pas rezulton se ai do të martohet me të. A është hallall kjo grua për këtë burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Po, me kusht që ajo të largohet prej tij, derisa të plotësojë kohën e saj të pritjes ligjore, me qëllim

*që të pastrojë mitrën e saj prej ujit të kuroërimit dhe vetëm pas këtij pastrimi ai ka të drejtë të martohet me atë grua."*

Kur është detyrim që ajo të pastrohet prej ujit të atij me të cilin ajo kurvëroi para se të martohet me atë me qëllim që të dallohet fëmija ligjor prej fëmijës jo ligjor, padyshim që ka më shumë përparësi që ajo të pastrohet prej ujit të ndonjë tjetri.

### ***13- Koha e pritjes ligjore për ithtaren e librave të mëparshëm*** (çifute e kristiane)

Koha e pritjes ligjore për ithtaren e librave të mëparshëm është plotësisht si koha e pritjes ligjore për myslimanen, si numër, si dispozitë si koha e zisë për vdekjen e burrit. Kjo është e barabartë, qoftë kur ithtarja e librave të mëparshëm është grua e një myslimani, qoftë kur është grua e një ithtari të librave të mëparshëm si ajo vetë, qoftë kur asaj i vdes burri, qoftë kur atë e divorcon burri, martesë me këtë grua është e vlefshme vetëm pasi ajo të përfundojë kohën e pritjes ligjore.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim, për shkak se argumentet nuk janë të kushtëzuara dhe në njoftimin e shkallës "Sahijh", të përcjella prej Es Seraxhit. Tregohet se ai e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një grua kristiane, së cilës i ka vdekur burri, edhe ai kristian. Sa është koha e pritjes ligjore për këtë grua? Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Aq sa është koha e pritjes për myslimanen e lirë (jo robëreshë), katër muaj e dhjetë ditë."

#### 14- Gruaja e burrit të humbur

Burri që nuk është pranë gruas, mund të jetë në dy gjendje:

*Gjendja e parë:* Dihet vendi ku ai ndodhet, gruaja e këtij burri, me fjalën e përbashkët të fukahave, e ka të ndaluar rreptësisht të martohet.

*Gjendja e dytë:* Lajmet për atë burrë janë ndërprerë dhe nuk dihet vendi ku ai ndodhet. Në këtë gjendje, shikohet: Nëse burri ka pasuri, gruaja shpenzon për veten e saj prej pasurisë së burrit, ose kur burri ka të afërm, i afërmi i burrit do të shpenzojë për gruan, ose gjendet ndonjë bamirës që të shpenzojë për gruan. Gruaja e këtij burri ka detyrim të bëjë durim e të presë, pasi asaj, në asnjë gjendje, nuk i lejohet të martohet, derisa të mësojë për vdekjen e burrit, ose që ai e ka divorcuar.

Në qoftë se burri s'ka pasuri dhe nuk gjendet asnjë njeri që e merr përsipër të shpenzojë për këtë grua, nëse ajo bën durim, atëherë le të presë dhe, nëse dëshiron të martohet e ngre çështjen e saj të gjykatësi, i cili e shtyn kohën e saj të martesës për katër vjet, duke filluar që nga dita e ngritjes së çështjes pranë tij. Pastaj gjykatësi verifikon në këtë kohë. Nëse asgjë nuk është bërë e qartë, atëherë shikohet: Në qoftë se i munguari ka të afërm ose kujdestar që merret me punët e të munguarit, ose i munguari ka lënë të prokuruar prej tij, gjykatësi urdhëron të afërmin, ose kujdestarin, ose të prokuruarin që ai ta divorcojë këtë grua në emër të burrit.

Nëse i munguari s'ka as të afërm, as kujdestar e as të prokuruar prej tij, ose edhe ka, por i afërmi, ose kujdestari ose i prokuruari nuk pranon të bëjë divorcin e asaj gruaje dhe nuk është e mundur të detyrohet asnjëri prej atyre të dyve që të bëjnë

divorcin e gruas, në këtë gjendje, gjykatësi, me autoritetin e tij ligjor, e divorcon këtë grua. Pas këtij divorci, ajo kryen pritjen ligjore katër muaj e dhjetë ditë. Pas kësaj kohe ajo ka të drejtë të martohet.

Verifikimi për burrin e humbur bëhet ose duke pyetur për atë në vendin ku ai ndodhet, ose gjykatësin e njoftojnë për atë personat që vijnë prej vendit ku supozohet se ai mund të ndodhet. Rruga më e mirë për verifikimin e tij mbetet që gjykatësi të ngarkojë një person të cilin ka besim prej banorëve të vendit dhe personi i ngarkuar prej gjykatësit të marrë në dorë verifikimin për burrin e asaj gruaje.

Më pas, i ngarkuari i shkruan gjykatësit për rezultatet e verifikimit. Është e mjaftueshme që verifikimi të vazhdojë aq kohë sa praktikohet zakonisht në raste të ngjashme dhe nuk është kusht të pyetet në të gjitha vendet ku mendohet se mund të ketë arritur ai.

Gjithashtu, nuk është kusht që verifikimi të jetë i vazhdueshëm dhe, pasi plotësohet verifikimi i kërkuar, në më pak se katër vjet, në atë mënyrë që ne mësojmë se vazhdimi i kërkimit nuk do të sjellë ndonjë gjë të re, detyrimi për gjetjen e burrit të asaj gruaje bie. Është detyrim që patjetër të pritët katër vjet, ashtu siç thuhet qartë në tekstet, domethënë bie detyrimi për të verifikuar, kur dihet se është punë e kotë, kurse detyrimi i gruas për të pritur katër vjet, mbetet ashtu siç është në dispozitën e ligjit të fesë.

Pas kësaj kohe ndodh divorci dhe gruaje kalon kohën e pritjes katër muaj e dhjetë ditë, por kjo grua s'ka detyrim të mbajë zi për burrin e saj të humbur.

Gjithashtu, gruaja ka të drejtën e shpenzimit gjatë ditëve të kohës pritjes ligjore, gjithashtu burri i humbur dhe gruaja e tij trashëgojnë njëri-tjetrin, derisa gruaja vazhdon të jetë në kohën e pritjes ligjore. Në qoftë se burri vjen para se gruaja e tij të përfundojë pritjen ligjore dhe para se ajo të martohet, fjala që anon më shumë është se burri s'ka rrugë të pretendojë për atë grua, aq më tepër s'ka rrugë të pretendojë për gruan kur ai e gjen gruan të martuar.

Argumentet për këtë çështje janë nxjerrë prej transmetimeve të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*). Prej këtyre argumenteve kemi transmetimin që tregon se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur në lidhje me burrin e humbur. Si do të veprohet me gruan e tij?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Për aq kohë sa ajo hesht e bën durim, hiqet dorë prej saj. Nëse ajo e ngre punën e saj te sundimtari i vendit, ai e shtyn kërkesën e saj (për divorc) për katër vjet, njëkohësisht i shkruan qeveritarëve vendorë të krahinave ku mund të ketë humbur buri i kësaj gruaje dhe ata pyesin rreth tij. Në qoftë se vijnë lajme se burri është gjallë, gruaja do të bëjë durim, por në qoftë se ajo nuk merr asnjë lajm rreth tij, derisa kalojnë katër vjet, atëherë thirret më i afërmi i burrit të humbur, të cilit i thuhet: “A ka pasuri i humburi?”*

*Nëse ai ka pasuri, atëherë shpenzo prej pasurisë së tij për gruan e tij. Nëse i afërmi i burrit shpenzon për gruan, ajo s'ka rrugë ligjore të martohet, në qoftë se i afërmi i burrit nuk pranon të shpenzojë për gruan, atëherë atë e detyron sundimtari të divorcojë gruan, e cila patjetër do të kalojë kohën e pritjes ligjore. Divorci ndodh kur ajo është e pastër. Në këtë gjendje, divorci i të afërmit, ose i kujdestarit bëhet si divorci i burrit. Nëse burri i kësaj gruaje vjen para se ajo të përfundojë pritjen e saj*

ligjore për shkak të divorcit të të afërmit, në këtë gjendje, divorci i të afërmit bëhet si divorci i burrit, domethënë, nëse burri vjen para se ajo të përfundojë pritjen ligjore dhe burri shpreh dëshirën që të kthehet te ajo, ajo menjëherë është gruaja e tij, por ajo është me dy divorce, pasi divorci i të afërmit konsiderohet se i është thënë tri herë fjala “Je e divorcuar.”. Në qoftë se gruaja e përfundon pritjen e saj ligjore para ardhjes së burrit, ose burri shpall për atë grua divorc të kthyeshëm, gruaja është e lejuar që me atë të martohen burra të tjerë dhe burri i parë s’ka rrugë ligjore të kthehet te ajo.”

Në një transmetim të dytë thuhet: “Nëse burri s’ka të afërm, gruan e divorcon sundimtari në prani të dy dëshmitarëve të drejtë dhe divorci i gjykatësit është si divorci i burrit, prandaj gruaja plotëson kohën e pritjes ligjore katër muaj e dhjetë ditë. Pastaj, nëse gruaja dëshiron, mund të martohet.”

### **15- Koha e pritjes ligjore për shkak të martesës së prishur**

Njëri prej dy bashkëshortëve e prish martesën me njërën prej shkaqeve që e bëjnë detyrim prishjen e martesës. Hollësitë, në lidhje me prishjen e martesës, i kemi trajtuar më sipër, në kapitullin “Martesa”, kur kemi trajtuar të metat fizike të burrit e të gruas dhe rastet e prishjes së martesës. Dispozita e prishjes së martesës është plotësisht si dispozita e divorcit, në të cilin nuk është detyrim që gruaja të kryejë pritjen ligjore, domethënë kur me atë grua burri nuk ka kryer marrëdhënie intime.

Nëse ajo është shtatzënë, koha e pritjes ligjore për atë grua plotësohet me lindjen e fëmijës, ose kur gruaja i ka menstruacionet të rregullta, ajo e plotëson kohën e pritjes ligjore të llogaritur me

tri pastrime, ose e plotëson kohën e pritjes ligjore të llogaritur me muaj, kur gruaja s'ka menstruacione, megjithëse është në moshën gjatë së cilës gratë kanë menstruacione dhe burri ka kryer marrëdhënie intime me të.

### ***16- Shpenzimi për gruan gjatë kohës që ajo plotëson pritjen ligjore***

Në kapitullin “Martesa”, në paragrafin “Shpenzimi për gruan” kemi shpjeguar se e divorcuara me divorc të kthyeshëm, shtatzënë ose jo, gëzon të drejtën e shpenzimit për atë gjatë pritjes ligjore.

Gjithashtu, kemi shpjeguar se gruaja që plotëson kohën e pritjes ligjore për shkak të vdekjes së burrit, nuk e gëzon të drejtën e shpenzimit për atë, edhe nëse është shtatzënë. Gjithashtu, kemi shpjeguar se e divorcuara me divorc përfundimtar, gëzon të drejtën e shpenzimit vetëm nëse ajo është shtatzënë. Është shpjeguar se nuk ka shpenzim për gruan me pengesë.

Në paragrafin “Koha e pritjes për kryerjen e marrëdhënieve intime të dyshimta”, të këtij kapitulli, kemi shpjeguar se gruaja me të cilën është kryer marrëdhënie intime e dyshimtë, nuk e gëzon të drejtën që të shpenzohet për të, edhe nëse është shtatzënë. Por ne e kemi bërë detyrim shpenzimin për shtatzënë e divorcuar me divorc përfundimtar, për shkak se ekziston një argument i veçantë. Por s'ka as argument të veçantë e as argument të përgjithshëm që e bën shpenzimin të detyrueshëm për gruan që kalon kohën e pritjes ligjore për shkak të prishjes së martesës, sepse origjina është: S'ka shpenzim për të.



## **17- Trashëgimia e ndërsjellë mes divorcuesit e të divorcuarës**

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur burri e divorcon gruan e tij me divorc të kthyeshëm, trashëgimia e ndërsjellë mes atyre të dyve nuk rrëzohet, madje ata trashëgojnë njëri-tjetrin, derisa gruaja të plotësojë kohën e pritjes ligjore.

Kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për këtë çështje, është përgjigjur: *“Burri trashëgon gruan dhe gruaja trashëgon burrin, nëse ai e ka divorcuar atë me divorc të kthyeshëm.”*

Në çështjen e trashëgimisë së ndërsjellë, s’ka dallim, nëse ai e ka divorcuar atë kur ishte i sëmurë nga sëmundja prej së cilës vdiq, apo ishte në gjendje të mirë shëndetësore, por trashëgimia e ndërsjellë rrëzohet me përfundimin e pritjes ligjore. Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për mostrashëgimi të ndërsjellë, nëse burri e ka divorcuar gruan me divorc të pakthyeshëm, kur është në gjendje të mirë shëndetësore, por nëse ai e ka divorcuar gruan në kohën që ishte i sëmurë me sëmundjen prej së cilës vdiq, gruaja e trashëgon burrin, edhe nëse ai e ka divorcuar atë me divorc të pakthyeshëm, por vetëkuptohet që në këtë gjendje e trashëgon vetëm nëse plotësohen kushtet vijuese:

a) Burri vdes para se të kalojë një vit i plotë nga data në të cilën ai ka divorcuar gruan. Nëse burri vdes, pasi kalon një ditë nga data e divorcit, qoftë edhe një orë më shumë se një vit, gruaja nuk e trashëgon burrin.

b) Gruaja të mos martohet para se të vdesë burri. Nëse gruaja martohet dhe pastaj gjatë vitit burri vdes, gruaja nuk trashëgon asgjë prej burrit.

c) Burri nuk shërohet prej sëmundjes gjatë së cilës ai e divorcoi gruan. Nëse burri shërohet prej sëmundjes që kishte dhe pastaj vdes gjatë vitit, gruaja nuk e gëzon të drejtën të trashëgojë prej pasurisë së burrit.

d) Divorci nuk është me kërkesën e gruas. Me lejen e Allahut, do të rikthehemi në këtë çështje në kapitullin “Trashëgimia”.

### **18- Ku e plotëson e divorcuara pritjen ligjore?**

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se e divorcuara me divorc të kthyeshëm e plotëson pritjen ligjore në shtëpinë e burrit të saj dhe burrit nuk i lejohet ta nxjerrë gruan prej shtëpisë. Gjithashtu, as gruas nuk i lejohet të dalë jashtë shtëpisë pa lejen e burrit, ndryshe ajo quhet grua që nuk i bindet burrit dhe për rrjedhojë rrëzohet detyrimi që ka burri për të shpenzuar për gruan.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se gruaja e divorcuar me divorc të përhershëm e kalon kohën e pritjes ligjore në çdo vend që ajo dëshiron, për shkak të ndërprerjes së lidhjes mes gruas e mes burrit, si dhe për shkak të rrëzimit të trashëgimisë së ndërsjellë mes burrit e gruas, si dhe për shkak se ajo nuk gëzon të drejtën që burri të shpenzojë për të gjatë kohës së pritjes ligjore, me përjashtim të rastit kur ajo është shtatzënë. Bazuar mbi këto që u thanë, burri s’ka të drejtë të mbajë gruan si të burgosur. Në lidhje me këtë çështje, kanë ardhur transmetime të shumta prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) por, në ditët e sotme s’ka ndonjë që vepron sipas këtyre transmetimeve, pasi e

divorcuara me divorc të kthyeshëm trajtohet siç trajtohet gruaja e huaj.

### ***19- Martesa me motrën e gruas në kohën që motra e saj plotëson pritjen ligjore***

Kur burri e divorcon gruan e tij me divorc të kthyeshëm, burrit nuk i lejohet të bëjë kontratë martese me motrën e të divorcuarës, pa përfunduar ajo kohën e pritjes ligjore, sepse e divorcuara me divorc të kthyeshëm është në dispozitën e gruas. Nëse divorci është i pakthyeshëm, lejohet që burri të bëjë kontratë martese me motrën e të divorcuarës para përfundimit të pritjes ligjore, për shkak të këputjes së lidhjes mes të divorcuarës me divorc të përhershëm dhe divorcuesit.

\* \* \*

## KTHIMI (er rexh'atu)

### **Kuptimi dhe legjitimiteti i fjalës “kthim”**

“Kthim” (er rexh'atu) do të thotë që divorcuesi e kthen gruan e tij që ai divorcoi pranë vetes dhe e mban atë nën mbrojtjen e tij. Origjina për kthimin është Libri i Allahut, Suneti dhe fjala e përbashkët e fukahave. Allahu i Lartësuar thotë:

“ **وَيُعَوِّلُهُنَّ أَحَقُّ بِرَدِّهِنَّ** ”

“...burrat e atyre kanë të drejtë më shumë se kushdo tjetër që t'i kthejnë ato (pranë vetes).” (Sure “El Bekare”, ajeti 228)

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

“ **فَإِذَا بَلَغَ أَجْلُهُنَّ فَأَمْسِكُوهُنَّ بِمَعْرُوفٍ أَوْ فَارِقُوهُنَّ بِمَعْرُوفٍ** ”

“Kur grave u afrohet mbarimi i afatit (të pritjes), atëherë i mbani ato me mirësi (kthehuni në jetën bashkëshortore), ose i ndani, ashtu siç është e arsyeshme...” (Sure “Et Talak”, ajeti 2), domethënë, kur afrohet përfundimi i kohës së pritjes ligjore,

menjëherë kthehuni te ato, me qëllim që të bëni jetë bashkëshortore dhe jo me qëllim që t'i dëmtoni ato.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Gruaja e divorcuar bën tualet, parfumohet dhe vesh rrobat që do, sepse Allahu, i Gjithëpushtetshëm thotë:*

“لَعَلَّ اللَّهَ يُحْدِثُ بَعْدَ ذَلِكَ أَمْرًا”

“...shpresohet që Allahu të bëjë pas kësaj diçka tjetër.” (Sure “Et Talak”, ajeti 1)

Kjo tjetra shpresohet të ndodhë në shpirtin e burrit dhe ai ta kthejë gruan pranë vetes.

Me një fjalë, vërtetimi i kthimit dhe lejimi i kthimit të gruas, është prej domosdoshmërive të ligjit të fesë islame.

### **Objekti i kthimit**

Objekti i kthimit është e divorcuara me divorc të kthyeshëm, derisa ajo vazhdon të jetë duke kaluar kohën e pritjes ligjore. Burri nuk mund të kthehet te ajo që s’ka kohë pritje, prandaj patjetër duhet të bëhet kontratë e re martese. Burri nuk kthehet tri herë te e divorcuara, nëse ajo vazhdon të jetë në kohën e pritjes, për faktin se ajo s’ka ndonjë burrë tjetër që ta bëjë atë grua të lejuar.

Gjithashtu, burri nuk kthehet as të gruaja e dalë prej martesës kundrejt pagesës nga ana e gruas, përveçse kur ajo heq dorë prej pagesës gjatë kohës së pritjes ligjore, me kusht që burri

ka dijeni se ajo hoqi dorë nga shpenzimi që do të bënte kundrejt divorcitet. Në këtë gjendje, për burrin lejohet të kthehet te gruaja me anë të divorcitet të kthyeshëm, ashtu siç e pamë më sipër, në kapitullin “Dalja e gruas prej martesës”.

### ***Forma e kthimit***

Kthimi realizohet me çdo fjalë që tregon kthimin dhe nuk ka nevojë të ketë një formulë të veçantë. Gjithashtu, kthimi realizohet me atë veprim që është i lejuar vetëm për bashkëshortët, kur burri ka qëllim kthimin, madje edhe kur nuk ka qëllim kthimin, siç është kryerja e marrëdhënieve intime, puthja, prekja e të tjera veprime. Është e kuptueshme që nuk mund të merret në konsideratë veprimi i burrit, kur ai është në gjumë, ose është i shkujdesur. Gjithashtu, nuk merret në konsideratë as veprimi i dyshuesit, për shkak se këto kategori burrash nuk mund të kenë qëllim kthimin e vërtetë.

Autori i librit “El Xheuahir” i përgjigjet atij që e ka kushtëzuar qëllimin e kthimit me veprim, me këto fjalë: “Ky është hulumtim i tekstit dhe i atyre që deklarojnë mbetjen e të divorcuarës në dispozitën e gruas gjatë kohës që ajo kalon pritjen ligjore. Gjatë kësaj kohe burrit i lejohet të kryejë marrëdhënie intime me të dhe nuk është e nevojshme që ai të ketë qëllim kthimin. Me këtë shpjegim bëhet e qartë se veprimet janë kthim, edhe nëse burri, me veprimin, nuk kishte qëllim kthimin, madje kjo është kërkesë e tekstit të kushtëzuar dhe e sentecave që janë dhënë në lidhje me çështjen e ndodhjes së kthimit, edhe kur burri s’ka qëllim kthimin.

Teksti i pakushtëzuar theksohet në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur burri frekuenton gruan e tij, pasi ajo e ka përfunduar kohën e pritjes ligjore, frekuentimi që ai i bën asaj, është kthim.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka gjykuar se frekuentimi i gruas së divorcuar nga ana e burrit është kthim dhe nuk ka vënë kusht që me frekuentimin të ndodhë me qëllim kthimin te ajo. Vetëkuptohet që mosvënia e kushtit është argument që tregon përgjithësimin.

Kthimi realizohet edhe me mohimin e divorcit, me kusht që mohimi të ndodhë gjatë kohës kur gruaja plotëson kohën e pritjes ligjore.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Të gjithë fukahatë janë për mohimin, sepse mohimi përmban kapjen pas kthimit, madje në librin “El Mesalik” thuhet se mohimi është më i arritur se kthimi i shprehur me fjalë, ashtu siç thuhet në tekstin: “Ai që mohon divorcin para se gruaja të përfundojë kohën e pritjes ligjore, mohimi i divorcit është kthim.”

Në një transmetim tjetër, thuhet: “Shkalla më e ulët e kthimit është që burri të puthë gruan, ose të mohojë divorcin.”

## ***Dëshmia për kthimin***

Dëshmia për kthimin është veprim i pëlqyer (*mustehab*) dhe nuk është veprim i detyrueshëm (*uàxhib*). Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Për këtë s’ka asnjë kundërshtim në mesin tonë, në mesin e shi’ave, duke shtuar origjinën dhe tekstet e

detajuara, ose suksesive. Imam Bakiri, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja goftë mbi të!*), në “Sahijhun” e Ibn Muslimit, ka thënë: “Divorci nuk mund të jetë pa dëshmitarë, kurse kthimi pa dëshmitarë është kthim, por është më mirë, nëse i sjell dëshmitarët më pas.”

Fjala e Allahut të Lartësuar:

“وَأَشْهِدُوا ذَوِي عَدْلٍ مِّنكُمْ”

“...dhe le të dëshmojnë dy burra të drejtë prej mesit tuaj...”  
(Sure “Et Talak”, ajeti 2), ka për qëllim të tregojë divorcin dhe jo kthimin. Për këtë çështje ne folëm në kapitullin “Divorci”, në paragrafin “Dëshmia për divorcin”.

### ***Braktisja e Islamit prej gruas gjatë kohës së pritjes ligjore***

Kur gruaja është duke plotësuar pritjen ligjore për shkak të një divorci të kthyeshëm dhe ajo braktis Islamin, para se të përfundojë kohën e pritjes ligjore, a është e vlefshme që burri të kthehet te kjo grua në kohën që ajo e braktisi Islamin?

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Hadaik”, për moslejimin e kthimit, sepse martesë me renegaten, që në fillim, është e pavlefshme, prandaj nuk është e vlefshme as vazhdimi i martesës me renegaten.



## **Konflikti**

1- Burri e gruaja kanë mosmarrëveshje në lidhje me origjinën e kohës së pritjes ligjore. Gruaja thotë: “Unë s’kam detyrim të kaloj kohën e pritjes ligjore, sepse ti nuk ke kryer me mua marrëdhënie intime, prandaj ti s’ke të drejtë të kthehesh te unë.”

Burri thotë: “Jo, ti ke detyrim të kalosh kohën e pritjes ligjore dhe unë kam të drejtën e kthimit, sepse kam kryer marrëdhënie intime me ty.” Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e gruas, krahas betimit të saj, sepse baza është moskryerja e marrëdhënieve intime, derisa të vërtetohet e kundërta.

2- Burri e gruaja bien dakord që gruaja ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore dhe kanë kundërshti njëri me tjetrin në lidhje me kthimin. Burri thotë: “Unë u ktheva.”

Gruaja thotë: “Kurrsesi.”

Në qoftë se kjo ndodh gjatë kohës që gruaja është në kohën e pritjes ligjore, pretendimi i burrit është pikërisht kthimi, plotësisht sikur ai të mohojë divorcin që në fillim. Në qoftë se kjo ndodh, pasi gruaja ka përfunduar kohën e pritjes ligjore, burri ka detyrim të vërtetojë që kthimi ka ndodhur brenda kohës së pritjes ligjore. Në qoftë se burri nuk sjell dot argument, atëherë merret në konsideratë fjala e gruas, krahas betimit të saj, sepse origjina është moskthimi dhe mbetet ndikimi i divorcit, derisa të vërtetohet e kundërta. Në rastin kur burri pretendon kthimin te ajo faktikisht, si për shembull, thotë se ka kryer marrëdhënie intime me të, atëherë gruaja betohet se burri nuk është kthyer.

Burri pretendon se ai është kthyer te ajo me veprime konkrete, si për shembull, ka kryer marrëdhënie intime me të, apo ka bërë veprime të tjera që bëhen mes burrit e gruas, bazuar mbi mospasjen dijeni për kthimin, kur burri pretendon kthimin me fjalë dhe gruaja ka dijeni për këtë.

3- Burri e gruaja bien dakord se ajo ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore dhe kanë kundërshtim në lidhje me vazhdimin e kohës së pritjes ligjore, ose me përfundimin e kësaj kohe. Gruaja thotë: “Unë e përfundova kohën e pritjes ligjore, në atë mënyrë që kthimi i burrit te ajo nuk është më i lejuar.”

Burri thotë: “Ajo e përfundoi kohën e pritjes që të mos shpenzohet për të.” Në lidhje me këtë çështje, pjesa më e madhe e fukahave, ose shumica e tyre, janë shprehur se merret në konsideratë fjala e gruas, krahas betimit të gruas, kur gruaja e kryen kohën e pritjes ligjore të llogaritur me menstruacionet. Merret në konsideratë fjala e burrit, kur gruaja e llogarit kalimin e kohës së pritjes ligjore me muaj.

Thënia më e drejtë është se në konsideratë merret fjalë e gruas në çdo çështje që ka të bëjë me kohën e pritjes ligjore. Kjo është e barabartë, qoftë kur konflikti është në lidhje me vazhdimin apo në mohimin e kohës së pritjes ligjore, qoftë kur gruaja e llogarit kohën e pritjes ligjore bazuar në ciklet e saj mujore, qoftë kur e llogarit me muaj, sepse kështu është fjala e përbashkët e fukahave, të cilët kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir”, bazuar në transmetimin që tregon se Imam Bakiri, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Menstruacionet dhe koha e pritjes ligjore u referohen grave dhe, kur gruaja i pretendon këto, ajo besohet.”

Gjithashtu, e Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Allahu i Lartësuar ka lënë në vlerësimin e grave tri gjëra: menstruacionet, pastrimin dhe shtatzëninë.”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) çështjen e vlerësimit për kohën e pritjes ligjore e ka lënë në dorën e gruas. Në të vërtetë, është detyrim që gruaja të besohet në lidhje me çështjen e kohës së pritjes ligjore dhe s’ka bërë asnjë dallim mes llogaritjes së kohës së pritjes ligjore me menstruacione dhe llogaritjes së kësaj kohe me muaj. Vetëkuptohet që lënia e hollësive është argument që vërteton se argumenti është përgjithësues. Nisur nga këtu, autori i librit *“El Urveh ue Mulhakātuha”*, ka thënë: *“Sikur ata të dy të kenë kundërshtime mes tyre, në lidhje me kryerjen e kohës së pritjes ligjore të llogaritur me menstruacionet, ose jo me menstruacione, përparësi ka fjala e gruas, sepse në lidhje me çështjen e vlerësimit të kohës së pritjes ligjore, patjetër që duhet të referohet te gruaja.*

Po kështu është kur burri e gruaja kanë kundërshtime në lidhje me kalimin e kohës së pritjes ligjore të llogaritur me muaj dhe të mosllogaritur me muaj. Në këtë gjendje merret në konsideratë fjala që është më e mbështetur.”

Autori i librit *“El Xhevahir”* ka thënë: *“Kur gruaja pretendon, ajo besohet dhe besimi i fjalës së saj nënkupton të theksohet, kur është e mundur vërtetësia e fjalës së saj, sepse thjesht mundësia e vërtetësisë së fjalës së saj, është e mjaftueshme për vërtetimin e pretendimit të saj.”*

Bazuar mbi këtë që u tha, dalin degë të shumta. Prej këtyre degëve është rasti kur ata të dy kanë kundërshtime në origjinën e shtatzënisë: kur gruaja pretendon se është shtatzënë, kurse burri e

mohon; ose kur ata të dy bien dakord në lidhje me shtatzëninë dhe kanë kundërshtim në lidhje me lindjen, nëse ka lindur më parë apo lindja ka ndodhur më vonë. Ky kundërshtim bazohet mbi divorcin. Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e gruas, sepse Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Ai e ka lënë shtatzëninë në dorën e gruas dhe nuk ka thënë lindja e fëmijës, ose lindja ndodhi më parë, ose më vonë. Mirëpo kur argumenti është i pakushtëzuar, nënkupton përgjithësim e gjithëpërfshirje.”*

Gjithashtu, prej këtyre degëve kemi rastin kur ata të dy bien dakord në lidhje me kohën e pritjes ligjore dhe me kthimin, por kanë kundërshtim në lidhje me faktin, nëse kthimi ishte pas përfundimit të kohës së pritjes ligjore, apo ka ndodhur gjatë kohës së pritjes ligjore. Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e gruas, ashtu siç është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Vlerësimi i kohës së pritjes ligjore i takon gruas dhe, kur ajo pretendon, besohet.”* Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka thënë këtë fjalë të tij pa asnjë kusht.

\* \* \*

## DIVORCI I GJYKATËSIT LIGJOR PËR SHKAK TË MOSSHPENZIMIT

A ka të drejtë gjykatësi ligjor të divorcojë gruan e një burri me imponim, kur burri nuk shpenzon për gruan?

Padyshim, gjykatësi ligjor ka të drejtë të divorcojë dhe njohja me argumentin do të bëhet në vijim, pasi të bëjmë parathënien e mëposhtme:

### ***Rëndësia e çështjes***

Unë nuk di ndonjë çështje të fik'hut që të ketë nevojë për prova dhe për guxim në shpjegimin e së vërtetës më shumë se sa kjo çështje. Natyrisht, pasi me këtë çështje janë pleksur shumë pësime dhe janë të shumta ankimimet për mosgjetje të një zgjidhjeje për këtë problem shoqëror.

Padyshim që ideja e divorcit, nga ana e gjykatësit ligjor, në vend të burrit, është një ide e vërtetuar në fik'hun xhaferrij dhe

bazuar mbi këtë, fukahatë e medh'hebit kanë dhënë fetva se gjykatësi ligjor ka të drejtë të divorcojë gruan e të humburit sipas kushteve që ne i përmendëm në kapitullin "Koha e pritjes ligjore", në paragrafin "Gruaja e të humburit".

Gjithashtu, fukahatë kanë dhënë fetva se gjykatësi ligjor ka të drejtë të divorcojë në vend të të çmendurit, kur këtë e kërkon interesi i të çmendurit. Në lidhje me këtë çështje kemi folur më sipër në kapitullin "Divorci", në paragrafin "Divorci i kujdestarit". Atëherë rezulton që ideja e divorcit të imponuar ekziston te imamitë dhe hadithi i mirënjohur "Divorci është në dorën e atij që merr kërcirin", nuk ka mbetur thjesht argument gjithëpërfshirës, por prej gjithëpërfshirjes së tij ka dalë edhe e drejta e gjykatësit për të divorcuar në vend të burrit të humbur dhe të çmendurit.

*Pyetje:* A ka dalë prej hadithit "Divorci është në dorën e atij që merr kërcirin" e drejta e gjykatësit ligjor për të divorcuar me forcë në vend të burrit, kur burri nuk shpenzon për gruan e tij për shkak se është ngushtë nga gjendja, ose për shkak mosbindje, ose për shkak të një ndaluesi tjetër, si për shembull, burri që nuk është pranë gruas, ka pasuri, por s'ka mundësi që ajo pasuri, ose një pjesë së saj të arrijë në vendin ku ndodhet gruaja.

Në radhë të parë, do të përmendim tekstet e ardhura në lidhje me këtë çështje prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut goftë mbi ta!*) pastaj do të parashtrijmë fjalët e fukahave. Më pas do të vazhdojmë trajtimin sipas asaj që mendojmë se duhet të shënohet.

## **Transmetimet**

Në “Sahijhun” e Rebij’ë dhe El fadl bin Jesar prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me komentimin e fjalës së Allahut të Lartësuar:

“وَمَنْ قَدِرَ عَلَيْهِ رِزْقُهُ فَلْيَنْفِقْ بِمَا آتَاهُ اللَّهُ”

**“...dhe ai që është ngushtë nga gjendja, le të shpenzojë prej asaj që i ka dhënë Allahu...”** (*Sure “Et Talak”, ajeti 7*), ka thënë: “Kur ai shpenzon për gruan aq sa duhet për ushqimin e për veshjen e saj, ndryshe bëhet ndarja e gruas prej burrit.”

Ebu Besijri në “Sahijhun” e tij tregon: Kam dëgjuar Imam Bakirin, babain e Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), të thotë: “Burri që ka një grua dhe nuk i siguron asaj veshje të mjaftueshme që ajo mbulojë pjesët e trupit që është detyrim të mbulohen dhe nuk i siguron asaj ushqim që ajo të mbajë trupin, Imami ka të drejtë të bëjë ndarjen e atyre të dyve.”

Një grup fukahash, këto dy transmetime i kanë cilësuar të shkallës “Sahijh”. Prej këtyre fukahave janë edhe autorët e librave “El Xheuahir”, “El Hadaik”, “Err Rrijad” dhe sejjid El Jezdij në librin “Mulhakàtul Urvetul Vuthka”.

## **Fjalët e fukahave**

Ibn Xhunejdi ka thënë: “Prej këtyre fjalëve mësohet se këta fukaha i kanë lejuar gjykatësit ligjor të divorcojë për shkak të mosshpenzimit. Gjithashtu, kanë lejuar gruan që ajo ta prishë martesën, domethënë ka lejuar të drejtën e gruas që ajo të kërkojë

prej gjykatësit ligjor të prishë martesën, ashtu siç kuptohet prej fjalës së tij të cituar prej Dëshmorit të dytë, në librin “El Mesalik”, në vëllimin 1, në kapitullin “Martesa”, në çështjen “Aftësia”.

Tekstualisht ai ka thënë: “Kur pamundësia e burrit për të shpenzuar për gruan është e përsëritshme, gruaja gëzon të drejtën për të prishur martesën. Në lidhje me këtë, janë dy fjalë. *Fjala e parë* është ajo që ka thënë Ibn Xhunejdi se gruaja ka të drejtën e përzgjedhjes, ashtu siç ka thënë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse burri shpenzon për gruan aq sa ajo të mbajë veten, së bashku me shpenzimet për veshmbathjen, ndryshe mes atyre të dyve bëhet ndarja.”

Allahu i Lartësuar, urdhëron në fjalën e Tij:

“فَأَمْسَاكُ مَعْرُوفٍ أَوْ تَسْرِيحُ بِإِحْسَانٍ”

“...ose kthim me të mirë (në jetën bashkëshortore), ose divorc me mirëkuptim...” (Sure “El Bekare”, ajeti 229)

Kthimi në jetën bashkëshortore, pa shpenzuar për gruan, është në kundërshtim me sjelljen e njerëzishme, prandaj ndarja e tyre bëhet e detyrueshme. Kur burri e ka të vështirë ta ndajë gruan për shkak se nuk ka mundësi të shpenzojë për të, atëherë prishjen e martesës e bën gjykatësi ligjor, me cilësinë e tij si kujdestar i gruas.”

Me fjalën “prishjen e martesës e bën gjykatësi ligjor”, duhet të kuptohet se gjykatësi vepron, vetëm pasi gruaja paraqit kërkesën, ndryshe, kur ajo është e kënaqur me gjendjen e saj, nuk mund të bëhet fjalë për lejimin e gjykatësit ligjor që ai ta divorcojë gruan në vend të burrit të saj.



Ibn Xhunejdi e ka bërë të veçantë lejimin e gjykatësit ligjor për të divorcuar, në rastin kur pamundësia e burrit për të shpenzuar për gruan përsëritet. Këtë fjalë të Ibn Xhunejdit e ka miratuar autori i librit “Err Rrijad” dhe El Behbehàij. Autori i librit “Reudàtul Xhen’nàt”, në pjesën e katërt të këtij libri, ka cituar se ai ka shkruar një studim në lidhje me dispozitën e kurorëzimit në gjendje të vështirë ekonomike. Këtë studim e ka emërtuar “Madh’herul Mukhtàr”, ku thuhet: “Ai ka shkruar deri në lejimin e prishjes së martesës prej gruas, edhe kur burri është pranë saj dhe jo vetëm që kundërshton të shpenzojë për gruan, por kundërshton edhe ta divorcojë atë, ose shkakun që burri nuk shpenzon për gruan është varfëria, Veç kësaj, burri s’ka asnjë lloj pasurie.”

Autori i librit “El Xheuahir” dhe autori i librit “El Hadaik”, në kapitullin “Kurorëzimi”, në çështjen “Aftësia”, si dhe sejjid Ebul Hasan El Asfehànij, në librin “El Uesijletul Kubrà”, në kapitullin “Ç’është thënë në lidhje me mohimin?”, janë shprehur: “Gjykatësit ligjor i lejohet të divorcojë gruan e një burri, kur ai burrë nuk shpenzon për gruan, megjithëse ka mundësi të përballojë shpenzimin dhe është në gjendje të mirë ekonomike, si dhe kur burri kundërshton të divorcojë gruan, edhe pse nuk shpenzon për të. Gjithashtu, gjykatësi ligjor e divorcon gruan, kur burri është në gjendje ekonomike të vështirë.”

Sejjid El Hakijm e ka lejuar divorcin e gjykatësit ligjor, kur burri s’ka mundësi të shpenzojë. Gjithashtu, ka lejuar që gjykatësi të divorcojë edhe gruan e martuar me martesë të ndërprerë, edhe kur burri ka mundësi të shpenzojë për gruan.

Në librin “Minhàxhu Sàlihijn”, në vëllimin 2, në faqen 161, botim i vitit 1381H, ka thënë: “Përrjashtohet mundësi që ai ta

divorcojë atë, gruan e atij që s'ka mundësi të shpenzojë për gruan, edhe nëse gruaja ngre çështjen e saj te gjykatësi ligjor. Atëherë gjykatësi e urdhëron burrin ta divorcojë gruan dhe vetëm, nëse burri nuk pranon të divorcojë gruan, atëherë gruan e divorcon gjykatësi ligjor.

Kështu veprohet edhe në rastin kur burri nuk shpenzon për gruan, megjithëse ka mundësi e fuqi të shpenzojë, prandaj, në këtë rast, gruas i lejohet ta ngrejë çështjen e saj te gjykatësi ligjor, i cili e detyron burrin të shpenzojë për gruan. Nëse burri kundërshton të shpenzojë për gruan dhe nuk pranon ta divorcojë gruan, veç kësaj është pamundur të shpenzohet prej pasurisë së tij, në këtë gjendje, gjykatësit ligjor i lejohet ta divorcojë gruan e këtij burri. Në lidhje me këtë çështje, s'ka dallim, nëse burri është pranë gruas, ose burri gjendet larg gruas."

Sej'jid El Jezdij, në librin "Mulhakàtul Urveh", në faqen 70, botim i vitit 1344H, thotë: "Nuk përjashtohet lejimi për gjykatësin ligjor që ai të divorcojë një grua me kërkesën e vetë gruas dhe ajo deklaron se nuk bën durim. Kështu veprohet edhe në rastin kur burri ka humbur dhe për të cilin dihet që jeton, por gruaja e tij e ka të pamundur të bëjë durim. Madje gjykatësi ligjor lejohet ta divorcojë edhe në vend të burrit, për të cilin dihet se ai ndodhet i mbyllur në një vend dhe e ka krejtësisht të pamundur të vijë. Gjithashtu, gjykatësi ligjor divorcon edhe në rastin kur burri është pranë gruas, por është në gjendje të vështirë ekonomike dhe s'ka mundësi të shpenzojë për ushqimin e veshmbathjen e gruas. Veç kësaj, gruaja e këtij burri nuk e duron këtë gjendje. Në të gjitha këto gjendje, apo edhe në gjendje të tjera të ngjashme, si për shembull, burri kundërshton të shpenzojë për gruan, megjithëse burri ka fuqi të shpenzojë, në këto gjendje, fjalët e fukahave

tregojnë qartë moslejimin e ndarjes së gruas prej gjykatësit ligjor. Por mund të flitet për lejimin e gjykatësit ligjor për të divorcuar, kur bazohemi në rregullin: Eliminimi i dëmit, veçanërisht kur gruaja është vajzë e re, të cilës i duhet të durojë gjatë gjithë jetës dhe do të bjerë në vështirësi shumë të rënda.”

### ***Përmbledhje e fjalëve të fukahave***

Prej këtyre fjalëve ne arrijmë në një përfundim: Këta fukaha, me fjalët e tyre, kanë lejuar që gjykatësi ligjor të divorcojë për shkak mosshpenzimi, por në të njëjtën kohë, disa fukaha e kanë specifikuar të drejtën e gjykatësit ligjor për të divorcuar gruan e atij që është në gjendje të rënduar ekonomike dhe s’ka mundësi të shpenzojë për gruan, ashtu siç thotë Ibn Xhunejdi dhe autori i librit “Err Rrijad”.

Disa fukaha të tjerë e kanë specifikuar këtë të drejtë të gjykatësit ligjor për të divorcuar gruan me martesë të ndërprerë, edhe kur burri ka fuqi të shpenzojë, si për shembull, autori i librit “El Hadaik” dhe autori i librit “El Xheuahir”.

Disa fukaha e kanë shtrirë lejimin e gjykatësit ligjor për të divorcuar në të dy rastet e lartpërmendura, si për shembull, se’j’jid El Hakijm dhe Es’se’j’jid El Jezdij.

Edhe ne priremi kah mendimi i këtyre dy të fundit dhe mendojmë se kriteri për lejimin e divorcit është pamundësia për të shpenzuar. Kjo është e barabartë, qoftë kur shkak për të mos shpenzuar është varfëria e pamundësia e burrit, qoftë kur shkak është inati i burrit, ose kundërshtimi i tij.

Gjithashtu, kjo është e barabartë, qoftë kur burri është pranë gruas, qoftë kur ai është larg saj, sepse shkakun që e bën të detyrueshëm lejimin e gjykatësit për të divorcuar, është fakti që gruaja nuk arrin të marrë të drejtën e shpenzimit, ashtu siç është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nuk ushqen gruan me atë ushqim që siguron fuqinë e saj trupore, atëherë Imami ka të drejtë të bëjë ndarjen e gruas prej këtij burri.”

Ky transmetim është argument që përfshin çdo burrë që nuk shpenzon për gruan e tij, për shkak se është ngushtë nga gjendja, ose për shkak se kundërshton të shpenzojë për gruan e vet, qoftë kur burri është pranë gruas, qoftë kur është larg saj. Në kohën tonë, dijetarët e mëdhenj kanë divorcuar disa gra për shkak se burri kundërshton të shpenzojë, ndërsa sej'jid Muhsinul Emijn ka divorcuar gruan e një burri të dënuar me burgim të përjetshëm.

Sej'jid Abdul Husejn Sherefud'dijn ka divorcuar gruan e një emigranti prej fisit Megàzijeh, kurse sej'jid Ebul Hasan El Asfehànij ka autorizuar disa shejkhlerë të divorcojnë dhjetëra gra punëtore. Gjithashtu, në të djeshmen e afërt, sejid El Hakijm është autorizuar të divorcojë gruan e një emigranti prej Surit (qytet i Libanit).

Më erdhën ndërmend shumë prej atyre të cilët unë kam besim në diturinë e tyre dhe gjej se ata, me vetëdije të plotë, kanë lejuar divorcin për shkak të mosshpenzimit për gruan, por ata frenohen nga frika e përhapjes së kaosit dhe do të vegjetojnë pseudodijetarët, ose ata që nuk janë besnikë në punët e fesë, për rrjedhojë, divorci do të bëhet me forcë dhe kundër vullnetit të burrit, pa u plotësuar pikat ligjore dhe shkaqet që e bëjnë divorcin të detyrueshëm.

Nga të gjitha këto rezulton se zgjidhja e vetme për këtë çështje mbetet që atë ta marrin në dorë vetëm dijetarët e mirënjohur si hulumtues e studiues, të njohur si burra të drejtë e të ruajtur prej mëkatesh.

\* \* \*

**BURRI I THOTË GRUAS:**

**“TË KAM SI NËNËN TIME!”** (edh’dhìhàr),

**BETOHET SE DO TË QËNDROJË LARG GRUAS** (el ijlàë)

**MALLKIMI I NDËRSJELLË** (el liàn)

***Edh’ dhìhàr: Burri i thotë gruas: “Të kam si nënën time!”***

Fjala e arabishtes “edh’dhìhàr”, në gjuhën shqipe përkthehet: Burri i thotë gruas: “Të kam si nënën time!”

(Për thjeshtim në vijim do të përdorim fjalën në gjuhën arabe). Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët se, kur burri i thotë gruas këtë fjalë, gruaja nuk është më hallall për atë burrë, domethënë se burri e ka të ndaluar rreptësisht të kryejë marrëdhënie intime me gruan, derisa të bëjë shlyerjen për fjalën që tha. Shlyerja është: lirimi i një robi. Nëse burri s’ka mundësi të lirojë një rob, ka detyrim të agjërojë dy muaj rresht dhe, nëse nuk e përballon dot agjërimin dy muaj rresht, u jep ushqim gjashtëdhjetë të mjeruarve.

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur burri kryen marrëdhënie intime me gruan, para se të plotësojë shlyerjen, ai konsiderohet kundërshtues i urdhrit të Allahut të Lartësuar. Në këtë gjendje, fukahatë kanë bërë detyrim për këtë shkelës plotësimin e dy shlyerjeve.

Që “*edh dhihàr*” të jetë i vlefshëm, fukahatë kanë vënë kusht që duhet të ndodhë në praninë e dy burrave të drejtë, të cilët dëgjojnë fjalën “*edh’ dhihàr*”, kur burri ia thotë gruas.

Gjithashtu, fukahatë kanë vënë kusht që gruaja të jetë në kohën e saj të pastrimit (pa menstruacione) dhe burri gjatë kësaj kohe pastrimi të gruas nuk ka kryer marrëdhënie intime me atë, plotësisht ashtu siç ishte edhe për të divorcuarën.

Fukahatë studiues kanë vënë kusht që burri duhet të këtë kryer marrëdhënie intime me gruan, ndryshe “*edh’ dhihàr*” nuk ndodh.

Origjina për vënien e një kapitulli të veçantë për “*edh’ dhihàr*”, në tërësinë e kapitujve të fik’hut, te të gjithë myslimanët janë fjalët e Kur’anit, në fillim të sures “El Muxhadele”.

Autori i librit “Muxhmeul Bejàn” ka përmendur: “Njëri prej shokëve të ngushtë të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe pikërisht Eus bin Samit kishte një grua me trup të bukur. Një ditë, kur ajo ishte në sexhde duke falur namazin e saj, Eusi e pa me synim dhe, pasi ajo përfundoi faljen e namazit, ai e dëshiroi gruan, por ajo nuk pranoi. Ndërkaq ai u zëmërua dhe i tha asaj: “Ti tani për mua je në vend të nënës time!”

Pasi nxori nga goja këtë fjalë, ai menjëherë u pendua, pasi “edh’dhahar” ishte divorci në kohën e injorancës para Islamit.

Megjithëkëtë, ai i tha gruas së tij: “Tani ti për mua je e ndaluar.”

Gruaja i tha: “Mos flit kështu, por shko te i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe pyete.”

Ai tha: “Më vjen turp ta pyes atë për të tilla gjëra.”

Atëherë gruaja i tha: “Lejomë mua, se e pyes unë.”

Ai i tha: “Shko e pyete.”

Gruaja shkoi te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Kur gruaja hyri te i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), pa Aishen që po i lante kokën dhe gruaja i tha: “O i Dërguari i Allahut, burri im, Eusi, me vuri kurorë, kur unë isha e re, kisha pasuri e njerëzit e familjes sime. Vazhduam të jetojnë së bashku dhe ai hëngri pasurinë time e konsumoi rininë time. Unë u ndava prej njerëzve të mi, ndërkaq vitet e mia përparonin dhe tani ai më mënjanoi, por u pendua. A ka ndonjë send që mund të më bashkojë mua me atë që të vazhdojmë jetën së bashku?”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) tha: “Mendoj se ti për atë je bërë e ndaluar.”

Gruaja tha: “O i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), betohem për Atë që të zbriti ty Librin, që Eusi nuk e ka përmendur fjalën “divorc”. Ai është babai i fëmijëve të mi dhe është njeriu më i dashur për mua.”



Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha gruas: “Në lidhje me çështjen tënde, nuk jam urdhëruar.”

Megjithëkëtë, gruaja vazhdoi të këmbëngulë te i Dërguari Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Rrihte shuplakat dhe thoshte: “Vetëm Allahut i ankojem për mjerimin tim! Vetëm Allahut i drejtohem për nevojën që kam dhe për gjendjen e rëndë që po kaloj! O Zoti im, zbriti Profetit Tënd atë që do të largojë prej meje këtë pësim të rëndë!”

Gruaja u rikthye te i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe filloi t’i flasë me përvuajtje: “O Profet i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), shikoje punën time!”

Ndërkaq Aishja i tha: “Priji fjalët e ankimet! A nuk e shikon fytyrën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*)?”

Kur të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i zbriste shpallja, fytyra i bëhej si të ishte i përhumbur në gjumë.

Më pas i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha gruas: “Shko e thirre burrin tënd.”

Kur burri erdhi, ai i lexoi atij fjalën e Allahut të Lartësuar:

”قَدْ سَمِعَ اللَّهُ قَوْلَ الَّتِي تُجَادِلُكَ فِي زَوْجِهَا وَتَشْتَكِي إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ يَسْمَعُ تَحَاوُرَكُمَا ۖ إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ. الَّذِينَ يُظَاهِرُونَ مِنْكُمْ مِمَّا هُنَّ أُمَّهَاتُهُمْ ۖ إِنَّ أُمَّهَاتُهُمْ إِلَّا اللَّائِي وَلَدْنَهُمْ ۖ وَإِنَّهُمْ لَيَقُولُونَ مُنْكَرًا مِنَ الْقَوْلِ وَزُورًا ۖ وَإِنَّ اللَّهَ لَعَفُوفٌ غَفُورٌ. وَالَّذِينَ يُظَاهِرُونَ مِنْ نِسَائِهِمْ ثُمَّ يَعُودُونَ لِمَا

قَالُوا فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مِّن قَبْلِ أَنْ يَتَمَاسًا ۚ ذَلِكُمْ تُوَعِّظُونَ بِهِ ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ. فَمَنْ لَّمْ يَجِدْ  
فَصِيَامَ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَتَمَاسًا ۚ فَمَنْ لَّمْ يَسْتَطِعْ فَاِطْعَامَ سِتِّينَ مِسْكِينًا ۚ ذَلِكَ لِتُؤْمِنُوا  
بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ ۗ وَتِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ ۗ وَلِلْكَافِرِينَ عَذَابٌ أَلِيمٌ“

**“Allahu i ka dëgjuar fjalët e asaj, që diskutoi me ty për burrin e vet dhe iu ankua Atij. Allahu e dëgjoi bisedën tuaj, sepse Ai dëgjon dhe shejkh gjithçka. Ata midis jush, që i ndajnë gratë e veta, duke u thënë se iu duken si nënat e veta, duhet ta dinë se ato nuk janë nënat e tyre. Nënat e tyre janë vetëm ato që i kanë lindur ata. Fjalët që ata thanë, janë të pahijshme dhe të pavërteta. Megjithatë, Allahu është Falës dhe Shlyes i gabimeve. Ata që i ndajnë gratë e veta në këtë mënyrë e pastaj duan të kthejnë mbrapsht atë që thanë, duhet të lirojnë një skllav (apo skllave), para se të preken përsëri. Kështu ju urdhërohet. Allahu i di të gjitha ato që bëni ju. Ai që nuk gjen (ndonjë skllav për të liruar), duhet që të agjërojë dy muaj rresht, para se të preken si bashkëshortë. E, nëse nuk mund ta mbajë agjërimin, atëherë duhet të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Kjo, që të tregoni besimin në Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Këta janë kufijtë e Allahut. Ndërsa për jobesimtarët ka vuajtje të mundimshme.”**  
(Sure “El Muxhàdeleh”, ajetet 1-4)

Pasi i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) mbaroi leximin e këtyre ajeteve, i tha burrit: “Ke mundësi të lirosh një rob?”

Burri tha: “Do të më shkonte e gjithë pasuria.”

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) përsëri i tha: “A mund të agjërosh dy muaj rresht?”

Burri tha: “Betohem në Allah! Nëse nuk ha tri herë në ditë, më erret shikimi dhe kam frikë se do të më zënë sytë perde.”

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “A ke mundësi të ushqesh gjashtëdhjetë të varfër?”

Burri tha: “Vetëm nëse më ndihmon ti, o i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).”

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Unë të ndihmoj me pesëmbëdhjetë “saë” dhe do të lutem për ty që të kesh begati.”

Burri mori ato që urdhëroi për të i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), u dha ushqim gjashtëdhjetë të varfërve, hëngri së bashku me të varfrit. Me këtë veprim gjeti zgjidhje puna e tij dhe puna e gruas së tij.

### ***El ijlä -Burri betohet se do të qëndrojë larg gruas***

Burri betohet në Allah, se ai do të heqë dorë nga kryerja e marrëdhënieve intime me gruan e tij. Baza për këtë janë ajetet 226-227 të sures “El Bekare”:

”لِّلَّذِينَ يُؤْلُونَ مِن نِّسَائِهِمْ تَرَبُّصُ أَرْبَعَةِ أَشْهُرٍ فَإِن فَاءُوا فَإِنَّ اللّهَ عَفُورٌ رَّحِيمٌ. وَإِن عَزَمُوا الطَّلَاقَ فَإِنَّ اللّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ“

“Ata që betohen se do të largohen prej grave të tyre, afati i pritjes është katër muaj dhe, nëse ata kthejnë, pa dyshim që Allahu është Falësi e Mëshirëmadhi. Dhe, nëse ata janë të

## **vendosur të bëjnë divorcin, pa dyshim që Allahu është Dëgjuesi, i Gjithëdituri.”**

Fukahatë kanë vënë kusht që burri të ketë kryer marrëdhënie intime me gruan, ndryshe nuk ndodh largimi i burrit prej gruas për shkak të betimit të tij.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se vendimi për të qëndruar larg prej gruas, ndodh kur burri betohet se do të heqë dorë nga kryerja e marrëdhënieve intime me gruan gjatë jetës së tij, ose për një kohë që është më shumë se katër muaj.<sup>1</sup>

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur burri kryen marrëdhënie intime me gruan gjatë katër muajve, ai ka detyrim të bëjë shlyerjen dhe me shlyerjen bie penguesi që ndalonte vazhdimin e jetës bashkëshortore.

Nëse kalojnë më shumë se katër muaj dhe burri nuk kryen marrëdhënie intime me gruan, nëse gruaja bën durim dhe është e kënaqur më këtë gjendje, atëherë ajo do të mbetet në zgjedhjen nga e cila ajo është e kënaqur dhe askush s'ka të drejtë të kundërshtojë këtë zgjedhje të gruas. Në qoftë se gruaja nuk bën durim, atëherë ajo ka të drejtë ta ngrrej punën e saj te gjykatësi dhe vetëm pasi kalojnë katër muaj<sup>2</sup>, gjykatësi e urdhëron burrin, ose të rrëzojë betimin e tij, ose të divorcojë gruan. Nëse burri refuzon, ai shtrëngohet dhe burgoset, derisa të zgjedhë njërën prej

---

<sup>1</sup> Sekret i përcaktimit të kësaj kohe është për shkak se gruaja ka të drejtë të kryejë marrëdhënie intime me burrin e saj, më e pakta një herë në katër muaj.

<sup>2</sup> - Shumica e fukahave kanë thënë se gjykatësi i jep afat burrit katër muaj, duke filluar që nga koha kur çështja është ngritur pranë tij dhe jo që prej kohës së betimit të tij.

dy punëve, ose kthim te gruaja, ose divorc, kurse gjykatësi s'ka të drejtë ta divorcojë me forcë gruan prej burri.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se shlyerja për thyerjen e betimit është që betuesi të zgjedhë mes dhënies ushqim dhjetë të varfërve, ose veshjes së tyre, ose të lirojë një rob. Nëse nuk ka mundësi për dy veprimet, atëherë agjëron tri ditë.

Theksojmë se betimi nuk merret në konsideratë, nëse nuk bëhet në Allahun e Lartësuar. Gjithashtu, nuk merret në konsideratë betimi i gruas për të ndaluar burrin, si dhe betimi i djalit për të ndaluar babain, duke përjashtuar punët që babai ka detyrim të plotësojë, apo për të hequr dorë prej veprimeve të ndaluara. Nuk merret në konsideratë betimi i asnjë njeriu, cilido qoftë ai, kur betohet se do të bëjë një punë, lënia e së cilës është shumë më e mirë se bërja e asaj pune, ose betohet të lërë një punë, bërja e së cilës është shumë më mirë se lënia e asaj pune, me përjashtim të betimit për të qëndruar larg gruas, pasi ky betim merret në konsideratë, megjithëse është shumë më mirë të hiqet dorë prej një betimi të këtillë.

### ***El liàn -Mallkim i ndërsjellë***

Nga pikëpamja gjuhësore, fjala arabe "el'liàn"- "mallkim i ndërsjellë", do të thotë përzënie e largim prej vetes, kurse në këndvështrimin e ligjit islam, mallkimi i ndërsjellë ndodh vetëm mes bashkëshortëve, sipas një mënyre të caktuar. Qëllimi i mallkimit të ndërsjellë është heqja e zbatimit të ndëshkimit fizik prej burrit që akuzon gruan e tij për kurvërim, ose i mohon gruas atësinë e fëmijës. Mallkimi i ndërsjellë bëhet vetëm në dy raste:

*Rasti i parë:* Burri akuzon për kurvëri gruan e tij ligjore, me të cilën ka bërë kontratë martese të përhershme dhe gruaja nuk është as shurdhe e as memece. Burri pretendon se e ka parë me sy, por s'ka argument ligjor që vërteton kurvërinë e gruas.

Në qoftë se mungon edhe njëri prej këtyre kushteve, si për shembull, gruaja është me kontratë martese të ndërprerë, ose gruaja është shurdhe, ose memece, ose burri nuk pretendon që e ka parë me sy, ose burri ka argument, në këto gjendje, s'ka mallkim të ndërsjellë.

*Rasti i dytë:* Burri mohon fëmijën që gruaja lind në shtratin e tij, çka e bën të mundur që fëmija t'i atashohet atij. Nëse gruaja e lind fëmijën pas gjashtë muajve e më shumë që nga koha e kryerjes së marrëdhënieve intime dhe nuk e ka tejkaluar kohën më të gjatë të shtatzënisë, ndryshe fëmija nuk i atashohet burrit, edhe pa bërë mallkimin e ndërsjellë.

Kur plotësohen kushtet dhe burri akuzon gruan e vet për kurvëri, ose i mohon atësinë fëmijës së saj, për këtë akuzë bëhet detyrim që mbi burrin të zbatohet ndëshkimi për atakimin e gruas në nder. Mbi burrin nuk zbatohet ky ndëshkim, nëse ai sjell argument ose bën mallkimin e ndërsjellë. Mënyra e bërjes së mallkimit të ndërsjellë është: Burri thotë në praninë e gjykatësit ligjor: "Kam dëshmitar Allahun se unë them të vërtetën në lidhje me akuzën që i bëj gruas sime, filanes." Këtë betim e përsërit katër herë me radhë, kurse herën e pestë dhe, pasi e ka këshilluar gjykatësi, ai thotë: "Mallkimi i Allahut rëntë mbi mua, nëse unë gënjej."

Pastaj gruaja thërret dëshmitar Allahun, katër herë me radhë se burri i saj gënjen për akuzën që i bën asaj. Herën e pestë ajo thotë: “Zemërimi i Allahut rëntë mbi mua, nëse ai thotë të vërtetën.”

Baza për mallkimin e ndërsjellë është fjala e Allahut të Lartësuar në ajetet 6-9 të sures “En Nûr”:

”وَالَّذِينَ يَرْمُونَ أَزْوَاجَهُمْ وَهُمْ لَا يَكْفُرُونَ لَهُمْ شُهَدَاءُ إِلَّا أَنْفُسُهُمْ فَشَهَادَةُ أَحَدِهِمْ أَرْبَعُ شَهَادَاتٍ بِاللَّهِ ۖ إِنَّهُ لَمِنَ الصَّادِقِينَ. وَالْحَامِسَةُ أَنَّ لَعْنَتَ اللَّهِ عَلَيْهِ إِنْ كَانَ مِنَ الْكَاذِبِينَ. وَيَدْرَأُ عَنْهَا الْعَذَابَ أَنْ تَشْهَدَ أَرْبَعَ شَهَادَاتٍ بِاللَّهِ ۖ إِنَّهُ لَمِنَ الْكَاذِبِينَ. وَالْحَامِسَةَ أَنَّ غَضَبَ اللَّهِ عَلَيْهَا إِنْ كَانَ مِنَ الصَّادِقِينَ.”

**“Nëse një burrë e akuzon gruan e tij pa pasur dëshmitarë të tjerë përveç vetes, ai duhet të betohet në Allahun katër herë, se thotë të vërtetën, dhe herën e pestë të kërkojë mallkimin e Allahut ndaj vetes, nëse ka gënjer. Ndërsa gruaja do të kursehet nga dënimi, nëse betohet për Allahun katër herë, se i shoqi është gënjeshtar dhe, herën e pestë, të kërkojë zemërimin e Allahut ndaj vetes, nëse i shoqi ka thënë të vërtetën.”**

Është detyrim që gjatë mallkimit të ndërsjellë të qëndrojnë të dy më këmbë dhe, pasi plotësohet mallkimi i ndërsjellë, me të gjitha kushtet, mbi këtë mallkim të ndërsjellë renditen dispozitat vijuese:

1- Prishja e kontratës së martesës. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Mallkimi i ndërsjellë (*el liàn*) nuk është divorc as nga pikëpamja e kuptimit gjuhësor të fjalës, as me ligjin e fesë dhe as me traditë. Në mallkimin e ndërsjellë nuk është kusht të jenë të gjitha kushtet e divorcit. Gjithashtu, mallkimit të ndërsjellë nuk i atashohen dispozitat e divorcit.

2- Për burrin që bën mallkimin e ndërsjellë, gruaja është e ndaluar përgjithmonë dhe atij nuk i lejohet të rikthehet te gruaja, ose të bëjë kontratë të re martese me të. Autori i librit “El-Xhevahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë problem, me tekst e me fjalën e përbashkët të fukahave.”

3- Heqja e ndëshkimit prej burrit për atakimin e gruas në nder, sepse betimi i tij katër herë me radhë, është në pozitën e argumentit të deponuar prej katër dëshmitarëve.

4- Ligjërisht prej burrit largohet fëmija, domethënë që ata të dy nuk trashëgojnë njëri-tjetrin dhe s’kanë detyrim të ushqejnë njëri-tjetrin. Për sa i përket gruas, fëmija është fëmija i saj ligjor dhe ajo është nëna e tij ligjore.

\* \* \*



## GJYKIMI (*el kadàu*)

### **Kuptimi i fjalës “gjykim”- “elkadàu”**

Nga ana gjuhësore, fjala arabe “*el kadàu*” ka disa kuptime, ndër të cilat është “plotësim”, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar:

“إِلَّا حَاجَةً فِي نَفْسٍ يَعْثُوبَ فَضَاهَا”

**“...përveç asaj dëshire që Jakubi e kishte në shpirt dhe Ai e kreu atë...”** (*Sure Jusuf*, ajeti 68), domethënë e plotësoi.

Një kuptim tjetër i kësaj fjale është “vrasje”, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar:

“فَوَكَرَهُ مُوسَى فَقَضَى عَلَيْهِ”

**“...Musai i ra me grusht dhe ai vdiq...”** (*Sure “El Kasas”*, ajeti 15), domethënë, e vrau atë.

Tjetër kuptim i fjalës “*el kadàu*” është “gjykim’”, ashtu siç ka ardhur në fjalën e Allahut të Lartësuar:

**“Allahu gjykon me drejtësi...”** (Sure “Gàfir”, ajeti 20)

Bazuar në këtë kuptim të kësaj fjale, fukahatë kanë vënë në librat e fik’hut kapitullin “Gjykimi”, duke pasur parasysh gjykimin mes dy kundërshtarëve, me qëllim ndalimin e armiqësive, largimin e konflikteve dhe ndalimin e të padrejtit për t’i bërë padrejtësi tjetrit.

Në kapitullin “Gjykimi”, fukahatë kanë shpjeguar kushtet që duhet të plotësojë personi për të qenë gjykatës dhe ku duhet të bazohet gjykatësi në bërjen e gjykimit, siç është pohimi, dëshmia, betimi, ose heqja dore prej këtyre që u thanë, ose në njoftimet që përhapen, ose në krahasimet.

### ***Kadiu, myftiu, muxhtehidi dhe fakijhu***

Posti i kadiut konsiston në detyrimin e njërit prej dy kundërshtarëve, që t’i japë kundërshtarit tjetër të drejtën që i takon, por vetëm pasi kjo e drejtë të vërtetohet te kadiu.

Posti i myftiut konsiston në shpjegimin e dispozitës ligjore, madje edhe krahas armiqësisë.

Muxhtehidi është dijetari që i nxjerr argumentet, duke u bazuar mbi dispozitën dhe fekijhu është dijetari që ka dijeni për dispozitën dhe argumentin mbi të cilin mbështet ajo dispozitë.

Të gjithë këta kanë një cilësi të vetme. Ndryshimi mes tyre qëndron vetëm te pozita e te konsiderata.

Nga ky këndvështrim, personi në të cilin bashkohen të gjitha këto cilësi, quhet kadi, duke marrë parasysh gjykimin që ai bën mes individëve me dispozita të veçanta. Ai quhet edhe myfti, duke pasur parasysh se fjalët e tij dalin prej dispozitave, quhet edhe muxhtehid-hulumtues, duke pasur parasysh se ai i nxjerr argumentet prej dispozitave.

Së fundi quhet edhe fakijh, kur kemi parasysh se ai është i ditur në fushën e dispozitave të ligjit.

### **Posti i kadiut**

Prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) transmetohet se ka thënë: *“Ai që bëhet gjykatës, të gjykojë punët e njerëzve, ka therur pa thikë.”*

Gjithashtu, në lidhje me gjykatësit, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Gjykatësit janë tre: dy gjykatës janë në zjarr dhe një gjykatës është në Xhenet. Gjykatësi që gjykon me të drejtën, ai është në Xhenet, gjykatësi që gjykon sipas dëshirave dhe interesit, ai është në zjarr, në zjarr është edhe gjykatësi që gjykon pa dituri.”*

Në një hadith tjetër, ai thotë: *“Gjykatësi është mbi tehun e urës së ndehur, mbi Xhehenemin.”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi ta!*) i tha Shurejhut: “O Shurejh, je ulur mbi një kolltuk, në të cilët ulet vetëm një profet, ose një i porositur prej profetit, ose një njeri i keq.”*

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kush gjykon për dy dirhemë më atë që nuk është në Librin e Allahut të Lartësuar, ai është qafir (mohues i fesë).”

## **Farzi kifajeh**

Gjykimi është prej *farzeve kifajeh*, ashtu siç është *farz kifajeh* lufta në rrugën e Allahut, urdhërimi për punë të mirë, dhënia e ndihmës personit që i është bërë padrejtësi, etj. Kur këtë punë e bëjnë disa, detyrimi për të tjerët bie. Nëse të gjithë nuk e bëjnë atë punë, atëherë të gjithë janë mëkatarë. Por ndodh që detyra e gjykimit bëhet edhe *farz kifajeh*, domethënë detyrë që duhet të kryhet patjetër, si për shembull, në rastin kur nuk gjendet gjykatës tjetër përveç atij dhe nevoja e kërkon që ai të jetë gjykatës.

## **1- Kushtet**

Vetëkuptohet që mendja e moshë madhore janë kushte themelore për gjykatësin, kurse kushtin që gjykatësi të jetë mysliman, fukahatë e kanë nxjerrë prej fjalës së Allahut të Lartësuar:

“وَلَنْ يَجْعَلَ اللَّهُ لِلْكَافِرِينَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ سَبِيلًا”

**“...Allahu kurrë nuk u mundëson mohuesve mbizotërim të plotë mbi besimtarët.”** (Sure “En Nisa”, ajeti 141)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ruhuni të mos gjykoheni mes jush te jomyslimanët, por shikoni të gjeni ndonjë burrë në

*mesin tuaj, që ka sado pak dijeni në punët e gjykimit dhe atë bëjeni gjykatës për të ndarë çështjet që kini me njëri-tjetrin, sepse unë atë e kam bërë gjykatës, prandaj shkoni të gjykoheni te ai."*

Argumenti për këtë është marrë prej fjalës së Imamit "në mesin tuaj".

## **2- Pastërtia e lindjes**

Pastërtinë e lindjes e kanë venë kusht fukahatë, sepse i linduri prej kurvërimit nuk lejohet të marrë në dorë punën e gjykimit. Për këtë fjalë të fukahave, me dëshminë e autorit të librit "El Xhevahir", s'ka as argument logjik e as tekst, ku ai thotë: "Fjala e përbashkët e fukahave që tregohet, janë kolonat mbështetëse, ndryshe kërkesa e argumenteve përgjithësues e të pakushtëzuara, është hyrja e tij."

Bazuar mbi supozimin se ky njoftim është i vërtetë dhe fjala e përbashkët e fukahave është realiteti konkret, kjo fjalë e përbashkët e fukahave nuk përbën argument. Më sipër, shumë herë kemi parë se te imamitë, fjala e përbashkët e fukahave, është argument vetëm kur dihet që fjala e tyre është nxjerrë prej fjalës së Imamit të ruajtur prej mëkateve, por ne këmbëngulim në të kundërtën, se kjo fjalë këtu nuk është nxjerrë prej fjalës së Imamit të ruajtur prej mëkateve. Por themi se vetë fukahatë e kanë nxjerrë kushtin e pastërtisë së lindjes prej faktit që i linduri prej kurvërimit, ose është mohues i fesë islame, ose ai është mysliman të cilit nuk i pranohet dëshmia. Derisa atij nuk i pranohet dëshmia, patjetër që ka më përparësi të mos pranohet gjykimi prej

tij. Mirëpo edhe kjo fjalë e fukahave bie në kontradiktë me fjalën e Allahut të Lartësuar:

“وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَىٰ”

“...askush nuk mban barrën e tjetrit...” (Sure “El En`àm”, ajeti 164)

### 3- Liria

Një grup fukahash janë shprehur se liria nuk është kusht për gjykatësin, sepse për këtë kusht s’ka bazë dhe argumentet janë përgjithësuese e gjithëpërfshirëse, domethënë përfshijnë cilindo që ka aftësi të jetë gjykatës, i lirë apo skllav qoftë ai.

Autori i librit “Mulhakàtul Urvetil Vuthkà” ka thënë: “Një grup fukahash është shprehur se liria nuk është kusht, madje për këtë fjalë ai thotë se ky është mendimi i shumicës së fukahave, sepse nuk ka argument që të tregojë se liria është kusht për gjykatësin.

Ajo që del më mirë në dritë prej fjalëve të fukahave është mosvënia e lirisë kusht, kur skllavit i jep pronari i tij.”

Autori i librit “Esh Sheràiu uel Xhevàhir” ka thënë: “Liria nuk është kusht.”

Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Kushti i lirisë është thjesht një pretendim.”

#### 4- Të jetë mashkull

Në lidhje me kushtin që gjykatësi të jetë mashkull, autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me hadithin: “S’kanë sukses njerëzit, kur punët e tyre i ka në dorë një grua” dhe në një hadith tjetër, ai ka thënë: “Gruaja nuk e merr në dorë punën e gjykimit.”

#### 5- Drejtësia

Drejtësia është prej kushteve më të rëndësishme për gjykatësin. Me fjalën e përbashkët të fukahave e me tekst, dituria s’ka ndonjë rëndësi të madhe pa drejtësinë. Është e mjaftueshme të kujtojmë fjalën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi ta!*), që u citua më sipër, kur ai i tha Shurejhut: “Në këtë kolltuk ulet vetëm një profet, ose një i porositur prej profetit ose një njeri i keq.”

Kjo fjalë është e mjaftueshme për të dëshmuar.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ruhuni shumë prej gjykimit, sepse gjykimi, në të vërtetë, i takon vetëm një Imami dijetar dhe të drejtë të dalë prej mesit të myslimanëve, ose një profeti, ose një të porosituri prej profetit.”

Më sipër kemi parë kuptimin e fjalës drejtësi, në kapitullin “Dëshmitë”, në paragrafin “Drejtësia”.

Bazuar mbi këto shpjegime, fukahatë kanë nxjerrë degëzime prej të cilave përmendim atë që kanë thënë një grup fukahash se ai që ka për të marrë një të drejtë nuk lejohet ta ngrëjë

kërkesën e tij te një gjykatës i padrejtë, madje as atëherë kur marrja e asaj të drejte nuk arrihet, nëse kërkesa nuk ngrihet te ai gjykatës, në kuptimin që e drejta e kërkuesit që do të gjykojë ky i padrejtë, do të shkojë e humbur. Fukaha të tjerë kanë thënë se lejohet ngritja e kërkesës te gjykatësi i padrejtë, vetëm nëse e drejta e kërkuesit është e vërtetuar dhe vetëm atëherë kur s'ka rrugë tjetër për të arritur të drejtën veçse duke e ngritur kërkesën te gjykatësi i padrejtë.

Prej këtyre degëzimeve është edhe rasti kur personi që ka për të marrë të drejtën, ka mundësi të arrijë të drejtën e tij, pa e ngritur çështjen te gjykatësi i padrejtë, megjithëkëtë ai e ngre çështjen te ai dhe gjykatësi i padrejtë gjykon me të drejtën, atij që do të marrë të drejtën që i takon, nuk i lejohet të marrë asgjë prej sendit të gjykuar, pavarësisht se ai send është e drejta e tij. Veprohet kështu sipas fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) të ardhur në transmetimin e përcjellë prej Ibn Handhaleh: *“Në të vërtetë, ai merr fitimin më të keq, edhe nëse e drejta e tij është e vërtetuar që ajo e drejtë i takon marrësit.”*

Fukaha të tjerë kanë bërë dallim mes borxhit dhe sendit konkret. Fukahatë kanë lejuar marrjen e të drejtës që është gjykuar me të drejtën, nëse objekti i gjykimit është send dhe kanë ndaluar marrjen e kësaj të drejte, nëse ajo e drejtë është borxh.

Kurse sej'jid El Hakijm, në pjesën e parë të librit *“El Mustemsek”*, nuk bën asnjë dallim mes sendit konkret dhe borxhit dhe ka gjykuar se është haram marrja e sendit dhe e borxhit edhe pse janë një e drejtë që duhet marrë.”

Në të vërtetë, ai që ka një të drejtë për të marrë, lejohet të kërkojë ndihmë edhe prej gjykatësit të padrejtë për të marrë të



drejtën e tij, kur marrja e të drejtës nuk arrihet pa u ngritur te ky gjykatës, në atë mënyrë kur personi të cilit i takon e drejta nuk gjen mënyrë tjetër përveçse duke e ngritur kërkesën e tij pranë atij gjykatësi të padrejtë. S'ka asnjë dallim, nëse e drejta që atij i takon ta marrë është send apo është borxh, sepse sprapsja e dëmit prej vetvetes është veprim i lejuar me ligj, sipas kushteve e rrethanave.

Ndodh që ngritja e kërkesës te gjykatësi i padrejtë është edhe veprim detyrë që duhet bërë, pasi nuk mund të arrihet e drejta pa u ngritur kërkesa te gjykatësi i padrejtë. Në këtë rast, ngritja e kërkesës te gjykatësi i padrejtë është veprim i lejuar i detyrueshëm. Kurse në lidhje me mëkatin e haramin, ato rëndojnë mbi atë që pengon e ndalon marrjen e të drejtës dhe jo mbi atë që ka për të marrë të drejtën e vet. Në lidhje me këtë çështje, autori i librit "El-Xhevahir" ka thënë: "Sikur arritja e të drejtës së tij të qëndronte në shikimin e çështjes nga ana e gjykatësit të padrejtë, është e lejuar që çështja të ngrihet te ky gjykatës, qoftë edhe për të ndaluar kundërshtarin që të mos e ngrejë çështjen vetëm pranë këtij gjykatësi të padrejtë, plotësisht ashtu siç është e lejuar të kërkohe ndihmë kundër të padrejtit, për të arritur të drejtën e tij, që i është bllokuar për shkak të padrejtësisë, atëherë mëkati rëndon vetëm mbi ndaluesin."

Më pas autori i librit "El Xhevahir" e nxjerr argumentin prej shpjegimit që ka dhënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) kur është pyetur në lidhje me komentimin e fjalës së Allahut të Lartësuar:

“وَلَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ وَتُدْلُوا بِهَا إِلَى الْحُكَّامِ”

**“Dhe mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit me rrugë të palejuar dhe mos u paraqitni me atë (me ryshfetin) te gjykatësit...”** (Sure “El Bekare”, ajeti 188)

Ai shkruan se burri e di që ai është i padrejtë dhe gjykatësi gjykon në favor të tij, megjithëkëtë ai nuk është i justifikuar të marrë atë që ai arriti në saje të gjykimit, kur e di se gjykatësi, me të vërtetë është i padrejtë.”

Kuptimi i kësaj shprehjeje është se ai është i justifikuar të marrë atë çka ai mori në saje të gjykimit, kur ajo realisht është e drejtë që i takon me të vërtetë.

### ***Hulumtimi (el ixhtihàd)***

Hulumtimi është i ndaluar dhe i lejuar. Është i ndaluar, kur bëhet në bazë të hamendjes, prirjeve e miratimeve dhe nuk arrin në gradën e vendosmërisë me anë të logjikës, siç ishte për shembull, që i linduri prej kurvërimit nuk lejohet të gjykojë punët e njerëzve, sepse vetë karakteret e njerëzve i largohen atij, ose skllavi s’ka të drejtë të marrë përsipër gjykimin e punëve, sepse ai vetë është person i urdhëruar e i imponuar, kurse gjykatësi është urdhërues e imponues.

Hulumtimi i lejuar bëhet i bazuar në Librin e Allahut, në Sunetin dhe në konceptin logjik të formës së prerë, si për shembull, është veprim i keq dënimi pa argument, ose shkaktari ekziston me ekzistencën e shkakut dhe eliminohet me eliminimin e tij.

Në mënyrë të përmbledhur, hulumtimi është nxjerrja e dispozitës ligjore prej burimit nga ajo ka dalë dhe që flet në mënyrë të prerë për atë dispozitë. Kjo është e barabartë, qoftë kur ky burim është tekst, qoftë kur është argument logjik dhe më pas zbatimi i kësaj dispozite në vendet përkatëse.

Hulumtuesi është ai që e nxjerr dispozitën prej burimit të saj dhe që e zbaton atë në vendin përkatës. Hulumtuesi është dy kategori: hulumtues absolut dhe hulumtues pjesor. Hulumtuesi absolut është personi që zotëron aftësinë e nxjerrjes dhe të zbatimit për të gjitha dispozitat ligjore pa asnjë përjashtim, kurse hulumtuesi pjesor është ai që ka mundësi të nxjerrë vetëm disa dispozita dhe nuk ka mundësi të nxjerrë disa dispozita të tjera.

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me mundësinë e tij, disa janë shprehur në favor të mundësisë së tij dhe disa të tjerë e kanë quajtur të besueshëm.

Këtë çështje e kam studiuar vetë dhe kam dhënë mësim disa herë rreth saj. Pastaj i jam kthyer po aq herë, madje kam shkruar në lidhje me këtë çështje disa herë dhe çdo herë në mënyrë më të hollësishme, derisa arrita në këtë përfundim: Aftësia e hulumtimit nuk mund të ndahet në pjesë dhe ai që ka fuqi të nxjerrë disa, ka fuqi t'i nxjerrë të gjitha dhe ai që e humb këtë aftësi për të gjitha, e ka të humbur edhe për disa.

Ti mund të thuash: Hulumtimi është i mundur në disa dispozita, edhe në mënyrë spontane, siç është çështja e kohës së namazit të sabahut pas lindjes së diellit, para lindjes së diellit, apo çështje të tjera të kësaj kategorie.

*Përgjigje:* Këto çështje dhe të ngjashme me këto, nuk janë objekt për hulumtimin, as për imitim, sepse ato janë çështje themelore në njohjen e të cilave është pjesëmarrës dijetari dhe ai që nuk ka dituri.

Sido që të jetë, gjykimi e dhënia e fetvave, janë të lejuara vetëm për një hulumtues absolut.<sup>1</sup>

Autori i librit “Miftàhul Keràmeh”, në vëllimin 10, në fillim të kapitullit “Gjykimi”, ka thënë: “Me fjalën e përbashkët të fukahave, nuk është i mjaftueshëm pjesëtimi, ashtu siç thuhet qartë në librin “El Mesalik” dhe në librin “El Kifajeh”, duke shtuar edhe fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Shikoni te ai që është prej jush, ashtu si tregon hadithi ynë. Ai shikon hallallin e haramin tonë dhe ka dijeni për dispozitat tona. Të jini të kënaqur që ai të jetë gjykatës, sepse dispozitat tona janë një tërësi e shtuar mbi njohjen që tregon përgjithësim.”

## **7- Vetëkontrollimi**

Gjykatësit i kërkohet të kontrollojë vetveten, në atë mënyrë që te ai të mos mbizotërojë harresa e hutimi, duke u ruajtur që të mos i humbë e drejta atyre që i takon.

---

<sup>1</sup> Ndjekësit e medh’hebit Hanefi nuk e vënë kusht drejtësinë dhe diturinë në lidhje me kadiun (gjykatësin) e myftiun (dhënësin e fetvave ligjore). Në tekstin e librit të njohur, me titull “Ibn Àbidijn”, në vëllimin 4, në faqen 212, botim i vitit 1325H, në kapitullin “Gjykimi”, tekstualisht thuhet: “Edhe mëkatari është prej atyre që dëshmojnë, për rrjedhojë ai mund të jetë edhe gjykatës.” Në librin “Fet’hul Kadijr”, në vëllimin 5, në faqen 456, në kapitullin “Gjykimi”, thuhet: “Për sa i përket emërimit të injorantit në post, te ne, është veprim i vlefshëm.”

## 8- Gjykatësi i arbitrazhit

Gjykatësi i arbitrazhit është personi për të cilin janë dakord dy kundërshtarët që ai të gjykojë problemin që ata të dy kanë mes tyre. Për gjykatësin e arbitrazhit kërkohen të njëjtat kushte që kërkohen për çdo gjykatës, siç ishte drejtësia, aftësia absolute për të hulumtuar dhe kushtet e tjera, pa të cilat nuk mund të jetë gjykatës, sepse vetëm te gjykatësi që i plotëson të gjitha kushtet, lejohet ngritja e çështjeve. Kjo është e barabartë, qoftë kur të dy kundërshtarët janë dakord që ai të jetë gjykatësi i tyre, qoftë kur nuk janë dakord. Nëse te gjykatësi nuk plotësohen të gjitha kushtet e kërkuara, gjykimi i tij nuk ekzekutohet, edhe sikur për atë të jenë së bashku fjalët e gjithë njerëzve e xhinëve.

Fukahatë kanë bërë detyrim praninë e gjykatësit të arbitrazhit në kohën kur jetonte Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe kur ekzistonte një gjykatës i emëruar prej tij. Në ditët tona, emërimi i gjykatësit, në përgjithësi, bëhet për cilindo që plotëson kushtet, por, pasi është vërtetuar fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Shikoni një burrë prej jush që ka dijeni për çështjet tona, atë bëjeni gjykatës mes jush, sepse unë atë e kam bërë gjykatës, prandaj gjykoni punët tuaja te ai.*”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Për gjykatësin e arbitrazhit është kusht të plotësojë të gjitha kushtet që plotëson gjykatësi i emëruar prej Imamit, përveç lejes.”, domethënë, në veçanti përveç shkresës për emërimin e tij prej Imamit.

## **Gjykimi i hulumtuesit**

Fukahatë e imamive kanë rënë në pajtim mes tyre se në çdo ndodhi, Allahu ka vënë një dispozitë, të cilën disa gjykatës e zbatojnë drejt, kurse disa gjykatës të tjerë gabojnë, kur gjykojnë sipas asaj dispozite. Gjykatësi që gabon, ka një shpërblim dhe gjykatësi që gjykon drejt, ka dy shpërblime, ashtu siç thuhet në hadithin e nderuar: Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Allahu i Plotpushtetshëm ka zbritur në Kur'an shpjegim për të gjitha çështjet e sendet, madje, betohem në Allah, nuk ka lënë asgjë për të cilën kanë nevojë njerëzit, prandaj asnjë njeri s'ka mundësi të thotë: “Sikur të ishte kjo, Allahu do ta kishte zbritur në Kur'an.”*

Gjithashtu, ai ka thënë: *“Nuk ka asnjë punë e asnjë send që nuk gjendet në Librin e Allahut e në Sunetin e të Dërguarit të Tij.”*

Pastaj tha: *“Në tërësi, aty gjendet çdo hallall e çdo haram dhe çdo gjë tjetër për të cilën kanë nevojë njerëzit, deri edhe për shtratin e për çdo gjurmë mbi lëkurën e trupit.”*

Gjykimi i hulumtuesit nuk e ndryshon gjykimin real ashtu siç është bërë, edhe sikur një hulumtues tjetër, në të cilin janë bashkuar të gjitha kushtet e kërkuara për hulumtuesin, thotë se hulumtuesi i parë ka gabuar dhe gabimin e tij e thekson me anë të argumentit të formës së prerë dhe jo me rrugë të shikimit e të hulumtimit, me të cilat lejohet atakimi i atij gjykimi, pasi gjykimi i dhënë ishte e kundërta e të dytit.

Ja edhe shembulli për sqarim: Dy hulumtues, në të cilët janë bashkuar të gjitha kushtet e kërkuara për hulumtuesin, kanë mendime të ndryshme në lidhje me shikimin e çështjes dhe hulumtimin rreth asaj çështjeje, si për shembull, njëri hulumtues

mendon se martesesa e vajzës nuk është e vlefshme pa lejen e kujdestarit të saj, kurse hulumtuesi tjetër mendon se martesesa e saj është e vlefshme, edhe pa lejen e kujdestarit.

Hulumtuesi i dytë shprehet për vlefshmërinë, për shembull, të martesës së Hindit, pa lejen e kujdestarit të saj. Në këtë gjendje, hulumtuesi që është shprehur për prishjen e kontratës së martesës, nuk ka të drejtë të atakojë gjykim e bërë, madje ai ka detyrë ta pohojë atë gjykim dhe të punojë sipas gjykimit të dhënë, sepse supozohet se secili hulumtues është mbështetur në mendimin se hulumtimi përmban gjykimin e drejtë dhe gjykimin e gabuar. Për rrjedhojë, atakimi i gjykimit të njërit prej këtyre dy hulumtuesve prej hulumtuesit tjetër është anim në njërin krah, sepse edhe një teori e veçantë nuk është argument për të hedhur poshtë një teori të veçantë si ajo.

Kur gjykatësi i parë mbështetet në shikim dhe për të dytin gabimi bëhet i qartë jo me anë të hulumtimit ose të shikimit, por me argument të formës së prerë, si për shembull, është arritur fjala e përbashkët e fukahave, ose është theksuar një ajet i Kur'anit që flet qartë për çështjen në fjalë, ose është arritur të gjendet një hadith me varg përcjellësish të pashkëputur, në atë mënyrë që është bërë argument i formës së prerë dhe merret si kriter për të drejtën të të gjithë hulumtuesit, nëse puna, me të vërtetë, qëndron kështu siç u përshkrua, atëherë i lejohet hulumtuesit të dytë të atakojë gjykimin e hulumtuesit të parë, madje është detyrim të atakohet ai vendim.

Me fjalë të shkurtra, kriteri për atakimin e gjykimit është dituria se ai gjykim është në kundërshtim me realitetin dhe jo se është në kundërshtim me hulumtimin e filanit.

Gjithashtu, lejohet atakimi i gjykimit, kur dihet se gjykatësi ka mangësi si hulumtues dhe neglizhon drejtësinë ligjore.

Kjo ishte çështja e gjykimit në analogji me gjykimin e gjykatësit tjetër. Në rastin kur gjykatësi gjykon mes dy kundërshtarëve dhe i jep të drejtën atij që nuk i takon, nëse personi të cilit gjykatësi me vendimin e tij i dha të drejtën dhe ai e di që kjo e drejtë, në të vërtetë, nuk i takon atij, personi përfitues prej këtij gjykimi nuk lejohet ta marrë atë send për të cilin u bë gjykimi për shkak të asaj që ekziston mes atij e mes Allahut, sepse vendimi i gjykatësit nuk e ndryshon realitetin, i cili, në të gjitha gjendjet, mbetet ashtu siç është.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Te ne, gjykimi zbatohet ashtu siç tregon ana e jashtme e tij dhe jo ana e tij e brendshme. Gjithashtu, personi që dëshmon në favor të sendit objekt gjykimi, i lejohet të dëshmojë vetëm nëse ai ka dijeni që dëshmia e tij është e vlefshme, ose ai nuk ka dijeni për gjendjen e sendit objekt i dëshmisë.”

### ***Gjykimi i ithtarëve të librave të mëparshëm te një gjykatës mysliman***

Në librin “El Xheuahir”, në kapitullin “Xhihadi”-“Lufta në rrugën e Allahut”, shprehjen e Mufijdit e gjejmë në përshtatje të plotë me çështjen që kemi në trajtim. Në mënyrë të përmbledhur aty thuhet: Sikur jomuslimanët të gjykohen te një gjykatës mysliman, a duhet të gjykohen ata me dispozitat e fesë së tyre, apo ata duhet të gjykohen me dispozitat e Islamit?



*Përgjigje:* Gjykatësi ka detyrim të shikojë: Nëse të dy kundërshtarët janë nën besën e shtetit islam, atëherë gjykatësi përzgjedh mes gjykimit të tyre me dispozitat e Islamit dhe mes heqjes dorë prej gjykimit të tyre dhe nuk e dëgjon fare ankimin, ashtu siç thuhet në ajetin 42 të sures “El Maide”:

“فَأَحْكُمْ بَيْنَهُمْ أَوْ أَعْرِضْ عَنْهُمْ ۚ وَإِنْ تُعْرِضْ عَنْهُمْ فَلَنْ يَصُدُّوكَ شَيْئاً ۚ وَإِنْ حَكَمْتَ فَأَحْكُمْ بَيْنَهُمْ بِالْقِسْطِ”

**“...gjykoi punët e tyre, ose qëndro larg tyre, nëse ti qëndron larg tyre, ata nuk të sjellin ty asnjë dëmtim, por nëse gjykon mes tyre, atëherë gjyko me drejtësi...”**

Imam Xhafer Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për dy burra ithtarë të librave të mëparshëm që kishin një konflikt mes tyre dhe të dy e ngritën çështjen te një gjykatës i tyre. Pasi gjykatësi i tyre vendosi për çështjen e atyre të dyve, personi për të cilin u vendos kundër, kundërshtoi dhe kërkoi të gjykohen te myslimanët. Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Ai gjykon mes atyre të dyve me dispozitat e Islamit.”

Në qoftë se të dy kundërshtarët jomyslimanë, ithtarë të librave të mëparshëm, nuk janë në besën e shtetit islam, por janë prej banorëve të tokave që nuk janë nën pushtetin e shtetit islam, gjykatësi mysliman nuk e ka detyrë të gjykojë çështjet e tyre, sepse nuk është detyrim që ata të hidhen kundër njëri-tjetrit, ashtu siç është gjendja për jomyslimanët që jetojnë në besën e shtetit islam.

Kur njëri prej dy kundërshtarëve është mysliman dhe kundërshtari tjetër është prej jomyslimanëve që gjenden në besën e shtetit islam, ose kundërshtari jomysliman nuk është në besën e

shtetit islam, gjykatësi ka detyrim të pranojë ankimin dhe të gjykojë mes atyre të dyve me atë që Allahu ka zbritur në ajetin 49 të sures “El Maide”:

”وَأَنِ احْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَاحْذَرْهُمْ أَنْ يَفْتُنُوكَ عَنْ بَعْضِ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ إِلَيْكَ”

**“Që ti të gjykosësh mes tyre me atë që ka zbritur Allahu, por mos ndiq dëshirat e tyre dhe ruhu shumë që ata të mos të të shmangin ty prej një pjese nga ato që ty të zbriti Allahu...”**

Sikur gruaja e jomyslimanit (prej ithtarëve të librave të mëparshëm), që është në besën e shtetit islam, ankohet kundër burrit të saj, i cili gjithashtu është prej ithtarëve të librave të mëparshëm dhe jeton nën besën e shtetit islam, kundër atij burri gjykohet me dispozitat e Islamit.

Nga sa u shpjegua më sipër, për ne myslimanët bëhet i qartë detyrimi që të ndërtojmë marrëdhënie të vlefshme edhe në mesin e bashkësive jomyslimane që jetojnë nën besën e shtetit islam, kur ato marrëdhënie janë në përpunje me fenë e tyre, derisa nuk janë paraqitur për gjykim te ne. Por kur ata vijnë të gjykojnë te ne myslimanët, është detyrim që ata t’i gjykojmë me dispozitat e Islamit në të gjitha gjendjet, ashtu siç e kërkojnë në tërësi ajetet e Kur'anit dhe hadithet që tregojnë për detyrimin që kemi ne myslimanët për të gjykuar me drejtësi.

\* \* \*

## ANKESA<sup>1</sup> (ed da'và)

### ***Kuptimi i fjalës “ankesë”***

Ankesë do të thotë: Një person i kërkon një personi tjetër të drejtën që ai pretendon se ka për të marrë prej tij. E drejta e pretenduar në ankesën e kërkuesit mund të jetë send, borxh, përzgjedhje, pjesë në ortakëri, birësim, bashkëshortësi, penalitet, etj.

Kolonat mbi të cilat ndërtohet ankesa dhe që patjetër duhet të ekzistojnë, janë tri: ankuesi, personi kundër të cilit ngrihet ankesa dhe e drejta e për të cilën bëhet ankesa. Kushtet e ankesës janë të shumta, disa kanë të bëjnë me ankuesin, disa të tjera kanë të bëjnë me personin kundër të cilit bëhet ankimi dhe disa të tjera prej këtyre kushteve kanë të bëjnë me të drejtën për të cilën bëhet ankesa.

---

<sup>1</sup> Duke filluar që këtu dhe deri në fundin e kapitullit “Gjykimi”, tekstin e kemi cituar prej librit tonë “Usûlul Ithbât”, pasi nuk kemi asgjë të re që të shtojmë. Qëllimi është që të mbledhin të gjithë kapitujt e fik’hut në pjesët e librit “Fik’hu i Imam Xhaferr Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*)”.

## **Ankuesi**

*Së pari*, do të flasim në lidhje me përkufizimin e ankuesit.

*Së dyti*, do të flasim në lidhje me kushtet e ankuesit.

*Së treti*, do të flasim në lidhje me detyrën e ankuesit.

Ankuesi është personi që, sikur të heshtë, do të heshtet edhe për të, domethënë, kur ai heq dorë prej konfliktit, nuk imponohet të ngrejë ankesë. Kjo është e barabartë, qoftë kur ankesën e ngre i pari ankuesi, qoftë kur ankesën e ngre përpara kundërshtari i tij. Me një fjalë, ankuesi është sulmuesi dhe personi kundër të cilit bëhet ankimi, është mbrojtësi.

Kjo përputhet me atë që është cituar prej ligjit francez, ku thuhet se ankuesi është personi që pretendon kundër realitetit që ishte më parë dhe prej ankuesit njihet edhe mohuesi. Ankuesi është personi që hesht, kur për atë heshtet dhe mohimi i tij vjen në përputhje me realitetin që kërkon origjina.

Ndodh që mohuesi shndërrohet në pretendues dhe pretenduesi në mohues, si për shembull: Një person pretendon se një tjetër i ka atij borxh dhe personi borxhmarrës pretendon mbajtjen e besës dhe shlyerjen e borxhit, kështu që ai bëhet pretendues, për rrjedhojë e ka detyrim të vërtetojë.

## **Dy pretenduesit**

Përkufizimi për ankuesin mund të jetë i vërtetë për njërin prej dy kundërshtarëve dhe nuk vërtetohet për kundërshtarin tjetër. Në këtë gjendje, ankuesi është pretenduesi dhe

kundërshtari i dytë është mohuesi. Por ndodh që përkufizimi i ankuesit të vërtetohet njëherësh për të dy kundërshtarët, si për shembull: Pronari i një ndërtese bie dakord me një person tjetër për t'i lëshuar atij me qira njërin prej apartamenteve të ndërtesës kundrejt një qiraje të caktuar, por para se qiramarrësi të transferohet, ndodh kundërshtimi mes atyre të dyve në lidhje me përcaktimin e apartamentit të lëshuar me qira.

Qiramarrësi thotë se është apartamenti nga ana perëndimore e ndërtesës, kurse pronari i ndërtesës thotë se është apartamenti nga ana lindore e ndërtesës. Në këtë gjendje, secili prej tyre, në të njëjtën kohë, është edhe pretendues edhe mohues, sepse pronari pretendon se i ka lëshuar me qira apartamentin e anës lindore dhe mohon të ketë lëshuar me qira apartamentin e anës perëndimore.

Qiramarrësi pretendon se ka marrë me qira apartamentin e anës perëndimore dhe mohon të ketë marrë me qira apartamentin e anës lindore. Këta dy persona fukahatë i kanë emërtuar “dy pretenduesit” dhe pretendimin e tyre e kanë emërtuar “Pretendim i ndërsjellë”.

Në këtë gjendje, gjykatësi ka detyrim të zbatojë mbi secilin prej atyre të dyve rregullin pretendues-mohues.

Gjithashtu, gjykatësi ka detyrim të shikojë: Nëse njëri prej tyre ka argument dhe tjetri s'ka argument, në këtë gjendje, gjykatësi vendos në favor të atij që ka argument. Në qoftë se të dy kundërshtarët kanë argument, merret në konsideratë argumenti që është më i fuqishëm prej dy argumenteve. Në qoftë se të dy argumentet janë të barabartë nga ana e fuqisë, rrëzohen të dy

argumentet dhe puna kthehet siç ishte para qiradhënies, domethënë gjykatësi vendos prishjen e kontratës së qiramarrjes që nga baza.

Në qoftë se qiradhënësi nuk ka argument, ose qiramarrësi nuk ka argument, ose që të dy nuk kanë argument, gjykatësi u parashtron të dyve betimin. Nëse njëri prej atyre të dyve betohet dhe tjetri nuk betohet, gjykatësi merr në konsideratë fjalën e atij që u betua, por në qoftë se të dy nuk pranojnë të betohen, ose betohen që të dy, gjykatësi e prish kontratën e qiramarrjes, ashtu siç veproi në rastin kur të dy argumentet ishin të barabarta.

### ***Kushtet e ankuesit***

Në lidhje me ankuesin kërkohen kushtet vijuese<sup>1</sup>:

1- Mendja dhe argumenti për këtë kusht është intuita dhe domosdoshmëria.

2- Mosha madhore, nuk dëgjohet ankesa prej fëmijës, edhe nëse është në moshën që dallon, për shkak të mosvlefshmërisë së pohimit dhe të betimit të fëmijës.

Sej'jid Kadhim, në librin "Mulhakàtul Urveh", ka thënë: "Prej fëmijës dëgjohen disa ankesa, për shembull, kur ai pretendon se një person e ka sulmuar dhe e ka rrëmbyer atë, ose

---

<sup>1</sup> Është interesante ajo që unë kam lexuar në lidhje me dëgjimin e ankesës, ashtu siç citohet prej ligjit anglez, i njohur me emrin "Ligji i 14 gushtit" për të mos dëgjuar në tërësi ankesën e atij që ngre ankesa të pavërteta. Ky ligj i dilte para fytyrës në të gjitha dyert e gjykatave, duke i thënë se ai mund ta paraqesë ankesë vetëm në saje të një vendimi gjyqësor të veçantë që e lejon fëmijën të ngrejë ankesën.

sulmuesi e ka çmendur duke e rrahur, ose i ka marrë paratë apo sendin që kishte në dorë, veçanërisht kur është frikë se personi kundër të cilit bëhet ankesa, mund të largohet dhe kështu humb e drejta e fëmijës. Vetëkuptohet se, kur e drejta vërtetohet, ajo nuk i jepet fëmijës në dorë, por i jepet kujdestarit të tij.

Nga ky shpjegim shikojmë se fëmija që dallon, ka në dorën e tij të gjitha veprimet që atij i sjellin dobi ose përmirësim dhe kujdestari, qoftë kur kujdestar është gjykatësi, qoftë kur nuk është gjykatësi, nuk ka të drejtë t'i kërkojë ato, sepse kushti i arritjes së pjekurisë seksuale dhe aftësia për t'u orientuar, në të vërtetë, janë marrë si mjet që çon drejt interesit të fëmijës dhe jo si qëllim në vetvete.

Fjala e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*): *“Lapsi është ngritur për fëmijën, derisa të arrijë pjekurinë seksuale.”*, ka qëllim heqjen e dënimit dhe të ndëshkimit prej fëmijës, pavarësisht nga vlefshmëria ose pavlefshmëria e marrëdhënieve të tij.

Unë nuk e kuptoj, përse nuk pranohet ankesa prej fëmijës që dallon, kur ankesa e tij përforcohet me faktin se ankesa e tij ngrihet në gjykatë dhe mbrohet në mënyrën më të plotë nga të gjitha anët.

Le të supozojmë se babai i fëmijës, ose kujdestari i tij ka shpenzuar e ka shpërdoruar pasurinë e fëmijës, derisa pasuria e tij gati është asgjësuar si pasuri, ose është asgjësuar pjesa më e madhe e pasurisë së fëmijës dhe kundër këtij shpërdoruesi askush nuk ka ngritur ankesë. Në këtë gjendje, shtrohet pyetja: A duhen lënë kujdestari, ose i porosituri të shkojnë akoma më thellë në

padrejtësinë dhe të mos pranohet ankesa e fëmijës kundër atyre të dyve, megjithëse fëmija është në gjendje të ruajë të drejtën e tij, por ankesa e tij nuk pranohet për shkak se fëmija nuk ka mbushur akoma moshën e caktuar?

S'ka dyshim që feja dhe logjika e bëjnë të domosdoshme pranimin e ankesës së fëmijës, pasi feja e logjika bëjnë thirrje për lirinë e plotë për të deklaruar ç'të dëshirojë. Gjithashtu, feja e logjika e bëjnë detyrim të formës së prerë për gjykatësin që të studiojë ankesën e ngritur te ai me hollësi dhe të gjykojë me të drejtën.

3- Ankuesi di të orientohet, pasi nuk dëgjohet ankesa prej mendjeshkurtrit të ngurtësuar, kur ankesa e tij kërkon të veprohet me pasurinë, por për ankesa të tjera ankesa e tij dëgjohet, si për shembull, ai ngre ankesën se është sulmuar, apo për ndodhi të tjera që ne i pamë në rastin e fëmijës, prandaj i përsërisim edhe për mendjeshkurtrin, pasi veprimet e tij të dobishme ekzekutohen, pavarësisht nga lloji që ato janë.

4- Ankesën e ngre vetë ankuesi, ose në vend të tij ankesën e ngre kujdestari i tij, ose ankesa paraqitet me prokurim, ose me testament, ose prej të afërmve, ose është lënë në mirëbesim që ankesa të ngrihet, ose prej atij që ka dijeni për të vërtetën e çështjes.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Prej shembujve të ngritjes së ankesës prej atij që ka dijeni për të vërtetën e çështjes, është edhe rasti kur një person ngre ankesë ndaj të vdekurit se ankuesi ka për të marrë borxh prej të vdekurit dhe ky i vdekur ka lënë fëmijë të vegjël. Supozohet se një burrë që s'ka lidhje me këtë borxh të pretenduar ka dijeni se i vdekuri e ka shlyer këtë borxh, madje personi që ka dijeni për çështjen e këtij borxhi, ka edhe dëshmitarë që i vdekuri e ka mbajtur besën në lidhje me



Me një fjalë, ankuesi duhet të ketë një lidhje me çështjen, nga çdo anë qoftë kjo lidhje. Nëse ankuesi është i huaj nga të gjitha anët me çështjen objekt ankimi, ankesa i tij nuk pranohet dhe një ankesë e tillë quhet ankesë pa u kërkuar, domethënë ankesë e bërë për bamirësi.

5- Një grup fukahash janë shprehur se, në tërësinë e kushteve, në lidhje me dëgjimin e ankesës, është kusht që pretenduesi të jetë i vendosur për sendin që ai pretendon, prandaj ankesa e tij nuk pranohet, në qoftë se ai thotë, për shembull, "Supozoj", apo thotë "Ka mundësi."

Fukaha të tjerë kanë thënë se vendosmëria nuk është kusht, por mjafton thjesht fakti i konfliktit, edhe nëse shkaku është supozimi, ose është thjesht një iluzion. Kjo është e vërteta, veçanërisht kur konflikti, në lidhje me sendin, nuk është prej

---

borxhin e marrë. Në këtë gjendje, personi që ka dijeni për këtë borxh ka të drejtë të ngrejë ankesë pranë gjykatësit për të shfajësuar të vdekurin. E njëjta gjë është edhe rasti kur ankuesi kërkon prej një miku të tij që është larg. Gjithashtu, prej shembujve të ngritjes së ankesës prej atij që ka dijeni për çështjen është edhe rasti kur kujdestari, ose i porosituri neglizhojnë në lidhje me pasurinë që ka nën kujdestari. Në këtë gjendje, personi i huaj që ka dijeni për këtë çështje, ka të drejtë të ngrejë ankesë kundër atyre të dyve, me qëllim që të bëjë mirë dhe të urdhërojë punën e mirë, por jo me qëllim diskreditimin për shkak të shkëputjes së lidhjeve mes ngritësit të ankesës dhe kujdestarit, ose të porositurit. Në këtë gjendje, gjykatësi ka detyrim të dëgjojë ankesën e ngritur prej këtij personi. Për sa i përket rastit, kur ankesa ngrihet për sendin e lënë në mirëbesim për ruajtje, do të thotë që ti i ke lënë ta ruajë pasurinë tënde një personi tjetër, por atë e sulmon një tjetër. Në këtë gjendje, ti ke detyrim të ngresh ankesë kundër sulmuesit, sepse i sulmuari është përgjegjës për amanetin tënd.

punëve të ankuesit, si për shembull, vrasja e vjedhja, shkujdesja ndaj sendit të lënë për ruajtje në mirëbesim, etj.

### ***Detyra e pretenduesit***

Të gjitha legjislacionet, të vjetra e të reja, pozitiviste dhe qiellore, kanë një fjalë të përbashkët: Pretenduesi ka detyrim të sjellë argument, kurse betimi është detyrim mbi mohuesin. Kur ti pretendon se prej një personi ke për të marrë një borxh, ose kundër tij pretendon ndonjë krim serioz, ti ke detyrim të sjellësh argument për pretendimin tënd, sepse origjina është pafajësia, derisa të vërtetohet e kundërta.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Origjina është argument i fuqishëm dhe dalja prej origjinës ka nevojë për një argument më të fuqishëm. Kur ti sjell argumentin që vërteton borxhin, kurse borxhmarrësi yt pretendon mbajtjen e besës, ai bëhet pretendues dhe, për rrjedhojë, ka detyrim të vërtetojë pretendimin e tij me argument, në të cilin të pasqyrohet origjina. Në këtë gjendje, gjykohet me mbetjen e borxhit, vetëm pasi është mësuar për ekzistencën e borxhit, derisa të mësohet mbajtja e besës dhe shlyerja e borxhit.

Rregulli “Pretenduesi ka detyrim të sjellë argument dhe mohuesi ka detyrim të betohet”, nuk do të thotë që argumenti nuk pranohet prej mohuesit në mënyrë absolute, madje argumenti i sjellë prej mohuesit, dëgjohet në disa forma, për shembull, mohimi i referohet vërtetimit. Këtë formë të dëgjimit të argumentit prej mohuesit, juristët e kohëve të reja e kanë quajtur kundërargument.

Një shembull në lidhje me kundërargumentin: Një grua pretendon se është gruaja ligjore e filan burri, kurse burri e mohon dhe për mohimin e tij sjell argument, i cili vërteton se ajo është grua ligjore e një burri tjetër; ose një person pretendon se filani i ka asgjësuar pasurinë, por edhe personi kundër të cilit bëhet ankesa sjell argument që vërteton se asgjësuesi i asaj pasurie është një tjetër dhe jo ai, duke shtuar faktin se ai thotë që për këtë ai ka dijeni. Në rastin kur pretendimi i mohuesit nuk i referohet vërtetimit, atëherë argumenti i këtij mohuesi nuk dëgjohej, sepse argumenti që flet thjesht për mohimin, në vetvete, është krejtësisht i pamundur, pasi cili është ai që e di se, për shembull, Zejdi nuk ka marrë borxh prej Halidit, ose prej ndonjë tjetri?

### ***Personi kundër të cilit ngrihet ankesa***

Në lidhje me personin kundër të cilit ngrihet ankesa, duhet të plotësohen kushtet vijuese:

1- Të jetë i mençur dhe të këtë arritur moshën e pjekurisë seksuale. Kush ka për të marrë ndonjë të drejtë prej të çmendurit, ose prej fëmijës, ankimin e ngre kundër kujdestarit. Bazuar mbi të drejtën e gjykatësit, të ndjekë rrugën që mund të sjellë më shumë dobi. Gjykatësit i lejohet të fusë fëmijën në ankesën e ngritur kundër tij, në atë mënyrë që fëmija merr pjesë në mbrojtjen së bashku me babain, ose me të porositurin. Ky rregull zbatohet, kur fëmija është në moshën që dallon dhe është i aftë të mbrohet.

2- Disa fukaha të imamive kanë thënë se është detyrim që personi kundër të cilit ngrihet ankesa, duhet të jetë i përcaktuar

personalisht. Sikur pretenduesi të thotë se njëri prej këtyre të dyve më vodhi paratë, ankesa e këtij pretenduesi nuk dëgjohet.

Studiuesit imami janë shprehur për vlefshmërinë e dëgjimit dhe mosvënien kusht për përcaktimin e personit, por gjykatësi e ruan ankesën me të gjitha anekset e argumentet e saj, derisa pretenduesi ta njohë personin kundër të cilit ai ngre ankesën.

Lejohet ngritja e ankesës edhe kundër atij që është larg vendit të tij, madje lejohet të shitet edhe pasuria e tij për të larë borxhin e tij, vetëm pasi borxhi të vërtetohet, por shumica e realizuar prej shitjes së pasurisë së tij nuk i jepet borxhdhënësit pa një garantues, kështu që personi që është larg, bazohet në argumentin e tij.

### ***E drejta për të cilën bëhet ankesa***

Në lidhje me të drejtën për të cilën bëhet ankesa, kërkohen kushtet vijuese:

1- Të jetë e njohur. Sikur një person të pretendojë kundër një tjetri një send të panjohur, si për shembull, kur pretenduesi thotë: “Unë kam për të marrë te ai një send, ose një rrobë, ose një libër.”, kjo ankesë e tij nuk dëgjohet, derisa pretenduesi të përmendë të gjitha cilësitë dalluese të sendit që ai pretendon, sepse gjykimi ndjek ankesën dhe, nëse sendi i pretenduar është i panjohur, edhe gjykimi do të jetë i panjohur, për rrjedhojë është i pamundur ekzekutimi i gjykimit. Fukahatë kanë veçuar ankesën e porosisë për sendin e panjohur, sepse lënia porosi e sendit të panjohur është e lejuar dhe për këtë fukahatë kanë thënë: “Sikur

një person të pretendojë kundër trashëgimtarit se në trashëgiminë e tij është lënë diçka edhe për të, ankesa e këtij pretenduesi dëgjohe, vetëm nëse pretenduesi sjell argument për pretendimin e tij. Në këtë gjendje, përzgjedhja i takon trashëgimtarit të përcaktojë sendin e pretenduar dhe prej tij pranohet edhe sendi më i paktë që ka një çmim, si për shembull, rrobë, ose një bastun, etj.

2- Ankesa të jetë për send logjik, domethënë, sikur një person që s'ka në pronësi asgjë, ngre ankesë kundër një tjetri se ka marrë borxh prej tij një milion lira, ose monedha të ngjashme. Kjo ankesë nuk dëgjohe. Gjithashtu, nuk dëgjohe ankesa e të voglit në moshë kundër më të madhit në moshë se ai është i biri i ankuesit, ose i verbëri pretendon se ka parë daljen e hënës së re.

3- Sendi i pretenduar që merret në pronësi, të jetë send që lejohet të merret në pronësi. Sikur ai të pretendojë se ka për të marrë një borxh, shkak për të cilin është kumari, ose pretendimi është kamatë, ose ndonjë send tjetër haram, kjo ankesë nuk dëgjohe.

4- Ankesa të jetë për një send të mundshëm dhe nuk dëgjohe, kur ankesa është diçka e kotë, si për shembull, dy vetë grinden në lidhje me madhësinë e sipërfaqes së globit tokësor, ose të diellit; ose një person pretendon dhuratën para se ta marrë atë në dorë, pasi në këtë gjendje dhurata nuk është e detyrueshme të ekzistojë si dhuratë, madje edhe nëse personi kundër të cilit ngrihet ankesa, e pohon dhuratën. Kriteri më i mirë për dëgjimin e ankesës është kur personi kundër të cilit ngrihet ankesa e pohon ankesën që ngre kundërshtari i tij. Në këtë gjendje, plotësimi i ankesës bëhet i detyrueshëm, megjithëkëtë duke marrë në konsideratë këmbënguljen e mohuesit në mohimin e tij, këtu duhet të ketë një rrugë për të ndarë konfliktin.

Sikur të supozohet se personi kundër të cilit është ngritur ankesa s'ka detyrim për asnjë send, megjithëkëtë ai e pohon, në këtë gjendje, ankesa nuk dëgjohet. Gjithashtu, ankesa nuk dëgjohet, kur ankesa ngrihet prej të porositurit ose prej të prokuruarit dhe pretenduesi s'ka argument, për shkak se pohimi i këtyre të dyve nuk zbatohet në të drejtën e porositësit ose të prokuruesit.

Gjithashtu, nuk kërkohet betim prej atyre të dyve, në asnjë gjendje. Bazuar mbi këtë shpjegim, rezulton se ai që ka për të marrë një të drejtë prej një personi që është larg, nëse ka argument, ai ngre ankesën e tij te gjykatësi, të cilin e vë në dijeni për të drejtën e tij, ndryshe marrja e të drejtës së tij shtyhet për në Ditën e Gjykimit. E njëjta gjë është edhe rasti kur dikush ka për të marrë një borxh prej një të vdekuri dhe pretendon se trashëgimtari ka dijeni për këtë borxh. Në këtë gjendje, trashëgimtarit i kërkohet të betohet se ai nuk ka dijeni për borxhin në fjalë.

Prej ankesave që s'pranohen në asnjë rast, është ankesa për diçka të pamundur, ankesat e quajtura "ankesa shterpë". Ka edhe ankesa për të cilat nuk pranohet të vërtetohen në asnjë gjendje, si për shembull, ai që pretendon se është mysliman. Por ka ankesa për të cilat pranohet të vërtetohen në favor ose kundër ankesës. Sqarimi për këto lloj ankesash do të trajtohet më poshtë. Rrugët mbi të cilat mund të mbështetesh për të vërtetuar konfliktet e grindjet, janë: pohimi, shkresa, shembuj të ngjashëm, argumenti, dora, tradita, veprimi që ka përhapje më të gjerë, pasja dijeni dhe betimi. Të gjitha këto quhen bazat e vërtetimit.

\* \* \*

## POHIMI (*el ikràr*)

### **Heshtja**

Kur ankesa plotësohet me të gjitha kushtet e saj, gjykatësi kërkon prej personit kundër të cilit ngrihet ankesa të përgjigjet, i cili, nga ana e tij, ose hesht, ose nuk pranon të përgjigjet, ose e ka të pamundur të përgjigjet, ose përgjigjet se nuk ka dijeni për realitetin për të cilin pyetet dhe thotë: “Nuk di as që është e vërtetë e as nuk e mohoj.” Përgjigjja e tij ose është mohim, ose është pohim.

Fukahatë imami kanë mendime të ndryshme, kur personi kundër të cilit është ngritur ankesa, hesht. Në lidhje me këtë gjendje, disa fukahatë imami kanë thënë: “Atë e burgos gjykatësi, derisa të përgjigjet, sepse çdo ankues ka të drejtë të marrë një përgjigje prej personit kundër të cilit ai ka ngritur ankesën, kushdo qoftë ai, duke marrë në konsideratë pozitën që ka ngritja e akuzës. Por ankuesi edhe mund të mos e kërkojë përgjigjen dhe miraton arrestimin e personit kundër të cilit ai ka ngritur ankesën.”

Në hadithin sherijf thuhet: “Burri burgoset, kur i dredhon borxhdhënësit të tij.”

S’ka dyshim se ankuesi është borxhdhënës për personin kundër të cilit ai ka ngritur ankesën, sepse borxhmarrësi, duke mos u përgjigjur, përpiqet të bëjë dredha, me qëllim që të zgjatet koha e shlyerjes së borxhit.

Në këtë fjalë, vihet re se edhe për burgosjen kemi të bëjmë me zgjatje të kohës, pasi vetë burgosja sjell zgjatjen e kohës së shlyerjes, posi zgjatja e kohës, është dëmtim i ankuesit.

Në këtë gjendje, gjykatësi i thotë personit kundër të cilit është ngritur ankesa: “Përgjigju, ndryshe unë të konsideroj dredharak dhe do të kërkoj betim prej ankuesit.”

Në goftë se ai vazhdon të heshtë, atëherë gjykatësi zbaton mbi të dispozitën e dredharakut dhe pas kësaj kërkon betim prej ankuesit.

Vlerësimi i kësaj gjendjeje është më mirë të lihet në dorën e gjykatësit, i cili mund të shikojë kushtet e ankesës e veshjet e saj, që të konsiderojë dredharak atë që hesht. Por gjykatësi mund të vendosë që të detyrojë ankuesin të vërtetojë ankesën e tij.

### ***S’kam dijeni***

Kur personi kundër të cilit është ngritur ankesa, thotë: “S’kam dijeni që kjo ankesë është e vërtetë, ose është e gabuar.”, gjykatësi ka detyrim të pyesë ankuesin: “A e vërteton fjalën se ai



s'ka dijeni për ankesën, apo e përgënjeshtrohet? A je i bindur se ai hiqet, kur thotë që s'ka dijeni?"

Nëse ankuesi e vërteton fjalën e personit kundër të cilit ai ka ngritur ankesën, atëherë ankesa nuk dëgjohet pa sjellë argument, domethënë se nuk është e mundur të gjykohet konflikti pa argumentin, sepse betimi për mohimin e realitetit nuk drejtohet ndaj personit kundër të cilit është ngritur ankesa, për shkak se ai s'ka dijeni.

Kështu qëndron puna edhe me betimin për mohimin e pasjes dijeni, sepse supozohet që ankuesi nuk e vërteton atë, por as heqja e betimit si detyrim prej ankuesit nuk është e mundur, sepse heqja e detyrimit është një degë prej orientimit të detyrimit për të kërkuar betim prej personit kundër të cilit është ngritur ankesa. Në këtë gjendje, rruga e vërtetimit reduktohet vetëm me argumentin dhe me asnjë rrugë tjetër përveç vërtetimit me argument.

Kështu bëhet edhe gjykimi në rastin kur edhe ankuesi thotë: "Edhe unë s'kam dijeni." Në këtë gjendje, shtrohet pyetja: Vallë ankuesi, vërtet s'ka dijeni, apo ai hiqet që s'ka dijeni?

Ankuesi shprehet se nuk ka dijeni për të drejtën e tij dhe thotë: "Në të vërtetë ai hiqet që s'ka dijeni, në një kohë që ai ka dijeni." Në këtë gjendje, gjykatësi i kërkon atij betim për mohimin e dijensës. Nëse personi kundër të cilit ngrihet ankesa, refuzon të betohet, vendoset kundër tij dhe, nëse ai betohet, kundër tij nuk bëhet gjykim për asgjë.

Megjithëkëtë ankesa nuk bie përfundimisht me këtë betim, sepse në këtë gjendje ankesa bie vetëm përkohësisht, në atë

mënyrë që më pas, kur në dorën e ankuesit të jetë argumenti ose argumentet e mjaftueshme, ai lejohet të ringrejë ankesën e tij dhe të shpallë argumentin e tij. Kur supozohet se personi kundër të cilit është ngritur ankesa, nuk betohet për të mohuar realitetin ashtu siç është, por bazuar mbi mohimin e pasjes dijeni, ai e mban ankesën të varur dhe nuk e ndan atë prej bazës.

Ky është gjykimi, kur personi kundër të cilit është ngritur ankesa, hesht, ose përgjigjet duke mohuar që ka dijeni. Por nëse ai pohon dhe ka leje të veprojë, në këtë gjendje, ai gjykohet sipas pohimit të tij. Pikërisht për këtë rast ne kemi vënë një kapitull të veçantë për pohimin, pohuesin, personin kundër të cilit pohohet dhe sendin për të cilin bëhet pohimi. Mund t'i referoheni këtij kapitulli.

### ***Pohimi me të drejtën e tjetrit***

Pohimi është argument vetëm kundër pohuesit, pasi në bazë të pohimit të tij, dënohet vetë pohuesi dhe nuk dënohet askush tjetër për shkak të pohimit të tij. Le të shikojmë një shembull: Një person i ka shitur një send një personi tjetër dhe, pasi shitja është plotësuar, vjen një i tretë dhe thotë: "Këtë send unë e bleva më përpara.", prandaj shitja e realizuar me një person tjetër, është e pavlefshme dhe s'ka asnjë efekt. Nëse shitësi e vërteton fjalën e këtij të treti dhe pohon në favor të tij se ai e ka blerë sendin më parë, pohimi i shitësit nuk merret në konsideratë, sepse marrja në konsideratë e pohimit të shitësit kërkon marrjen e sendit prej dorës së blerësit, por detyrimi mbetet dhe pohimi nuk zbatohet në të drejtën e asnjërit, përveç pohuesit.

Kjo dispozitë përputhet edhe me ligjet moderne pozitiviste, në të cilat tekstualisht thuhet se argumenti i pohimit reduktohet vetëm mbi pohuesin.

Me të njëjtën dispozitë gjykohet edhe rasti kur një grua pohon se në dukje ajo është e martuar me Zejdin, por ajo nuk është gruaja e tij ligjore, pasi në vërtetë ajo është gruaja e Amrit, i cili ka bërë më përpara kontratë martesë për të. Siç shihet, marrja në konsideratë e pohimit të saj bie në kundërshtim me të drejtën e Zejdit, por, nëse Zejdi vdes, ai e divorcon atë, gruaja kthehet te Amri dhe vepron sipas pohimit të saj vetëm pasi u hoq penguesi.

### ***Ndërmjet pohimit dhe vërtetimit***

Dëshmori i dytë, në librin “El Mesalik” dhe sej’jid Kàdhim në librin “El Mulhakàt”, kanë përmendur se pohimi ndahet prej argumentit:

*E para:* Pohimi është argument që reduktohet vetëm te pohuesi, kurse vërtetimi është argument që kalon te të gjithë. Për shembull: njëri prej trashëgimtarëve pohon se trashëgimlënësi i tij ka detyrim të shlyejë një borxh, patjetër që pohimi mbetet detyrim vetëm mbi pohuesin dhe ndodh e kundërta, kur borxhi dëshmohet me vërtetim, sepse vërtetimi është veprues mbi të gjithë trashëgimtarët.

*E dyta:* E drejta dëshmohet thjesht me ndodhjen e pohimit, pa qëndruar mbi gjykimin e gjykatësit. Kjo është e kundërta e

vërtetimit, sepse e drejta nuk dëshmohej thjesht me arritjen e vërtetimit, por patjetër që ka nevojë për gjykimin e gjykatësit.

Autori i librit “El Xheuahir”, në fillim të kapitullit “Ekzekutimet” (*el hudud*), ka cituar se një burrë erdhi te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe pohoi se ka vjedhur.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha atij: “A di të lexosh ndonjë pjesë prej Kur'anit?”

Burri tha: “Po, suren “El Bekare”.

Atëherë Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Për suren El Bekare” të dhurova dorën tënde.”

Pastaj Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), tha: “Kur ka argument, Imami s’ka të drejtë të falë, por, kur burri pohon kundër vetes së tij, dënimi mbetet në dorën e Imamit, nëse ai do, e fal, nëse do i pret dorën.”

Ky është dallimi i tretë.

### ***S’ka mohim pas pohimit***

Kjo shprehje lakohet shumë shpesh në gjuhët e ligjvënësve dhe të tjerëve, disa prej të cilëve kanë kuptuar se çdo mohim që vjen pas pohimit, në mënyrë absolute, ai mohim refuzohet pa asnjë ndalim, madje ata kanë shkuar deri aty sa të shprehen se kush thotë: “Ky send është i Zejdit.”, “Jo, jo, është i Amrit.”, për këtë pohues gjykohet se ai ka detyrim t’i japë Zejdit sendin në fjalë dhe Amrit një zëvendësues të sendit. Madje kanë shkuar edhe më

tej dhe kanë thënë: “Sikur ai të vazhdojë të thotë edhe një herë: “Jo, jo, sendi është i Halidit.”, “Jo, jo, sendi është i Sejidit.”, etj, ai ka detyrim që çdonjërit prej atyre që u ka përmendur emrin, t’u japë të plotë një zëvendësues të sendit. Siç mund të konstatosh, ky arsyetim nuk qëndron mbi ndonjë bazë logjike.

Detyrimi kërkon që, kur personi pohon dhe pastaj mohon, në këtë gjendje, shikohet: Nëse ai s’ka përmendur ndonjë shkak për mohimin e tij dhe, krahas mohimit, ai nuk pretendon ndonjë send në tërësi, ose pretendon një punë jo logjike, atëherë bëhet detyrim që këtij mohuesi dhe mohimit të tij të mos i kushtohet vëmendje, përveçse në një formë të vetme, kur ai pohon kundër vetes se ka kurvëruar. Atëherë, në bazë të këtij pohimi, bëhet detyrim që ai të ekzekutohet me gjuajtje me gur, por më pas ai e mohon pohimin e tij. Në këtë gjendje, në mënyrë absolute, prej tij lejohet mohimi dhe, për rrjedhojë, me fjalën e përbashkët të fukahave, bie detyrimi për të zbatuar ekzekutimin e tij me gjuajtje me gur.

Në qoftë se pohuesi përmend ndonjë shkak për mohimin e tij të vonuar dhe pretendon një send që zakonisht mund të ndodhë, ashtu siç u tha në shembullin e mësipërm, që ishte kur ai pohon shitjen dhe marrjen e sendit në dorë dhe pastaj mohon marrjen në dorë të sendit dhe thotë: “Pohova, ngaqë isha i sigurt se blerësi do të paguante çmimin pas pohimit.”

E njëjta gjë është edhe në rastin kur trashëgimtari pohon se babai i tij kishte borxh për të shlyer, por pas një farë kohe ai heq dorë prej pohimit të tij me pretendimin se pohimi i tij ishte i ndërtuar vetëm në diturinë që ai kishte se babai i tij i kishte kërkuar borxh personit që ka ngritur ankesën, por pas pohimit ai

gjen ndër shkresat e babait të tij edhe një shënim të borxhdhënësit, me të cilin vetë borxhdhënësi pohon shlyerjen e borxhit dhe mbajtjen e besës nga ana e borxhmarrësit, ose trashëgimtari pohues gjen që babai i tij kishte shkruar në një bllok të veçantë se ai e kishte shlyer të gjithë shumën e borxhit, në këtë gjendje, ankesa dëgjohet dhe pretenduesi ka detyrim të bëjë vërtetimin.

Me një fjalë, pohimi është argument kundër pohuesit, derisa nuk kemi dijeni për gënjeshtren e tij, ose kur sillet një argument ligjor që e kundërshton pohimin dhe, kur argumenti vihet përballë pohimit, ose ne mësojmë për gënjeshtren e pohuesit, në këtë gjendje, pohimi është fjalë boshe. Nisur nga ky shpjegim, fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët për të mos marrë në konsideratë pohimin e atij që pohon birësinë për një tjetër që është në të njëjtën moshë me pohuesin, ose në moshë të përafërt me të, madje edhe nëse pohimin e tij e vërteton pala tjetër, sepse realiteti, në vetvete, është krejtësisht i pamundur.

Herët e vonë, fjala e përbashkët e fukahave ka qenë se kushti themelor për pranimin e ankesës është që ankesa të mos jetë në kundërshtim me logjikën e me ligjin, ose të mos jetë në kundërshtim me mënyrën si veprohet zakonisht. Gjithashtu, është e njëjta gjë edhe në rastin kur sillet argument ligjor që pohimi, ose mohimi, apo veprime të tjera, janë bërë gabimisht.

Duhet të theksohet se mohimi pas pohimit nuk refuzohet në të gjitha llojet e në të gjitha format e tij, por refuzohet vetëm kur është thjesht mohim i pashoqëruar me një ankesë të mundshme dhe logjike. Por kur së bashku me ankesën bashkohen të gjitha veprimet që merren në konsideratë si kushte për vlefshmërinë e ankesës, në këtë gjendje, pohuesi, nga njëra anë,

është pohues dhe, nga ana tjetër, është pretendues, mbi të cilin zbatohen të gjitha dispozitat e ankuesit, si për shembull, personi që pohon borxhin dhe më pas pretendon mohimin kundër pohimit.

Por fukahatë, prej këtij rregulli, kanë veçuar rastin kur ai pohon për fëmijën dhe pastaj e mohon. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se një mohim i tillë, në asnjë rast, nuk dëgjohet, madje edhe sikur ai të përmendë për këtë një mijë e një shkaqe, pasi, në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë vënë një rregull përgjithësues që thotë: Përkatesia familjare, pasi është vërtetuar, nuk rrëzohet në mënyrë absolute.

Këtë rregull ata e kanë mbështetur në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Kur burri pohon fëmijën një orë, kurrë nuk mund të shpëtojë më prej tij.”*

Sikur çështjen ta trajtojmë nga ana e kundërt e saj, domethënë se ai pohon, pasi më parë kishte mohuar, ky pohim pranohet prej tij, sepse pohimi pas mohimit nuk e ngushton të drejtën e ankuesit, në të kundërt, është në përputhje të plotë me të drejtën e ankuesit, për faktin se është e kundërta e mohimit pas pohimit, i cili e ngushton dhe është në kontradiktë me të drejtën.

Autori i librit “El Urvetul Vuthkà”, në kapitullin “Martesa”, ka thënë: “Sikur një grua të ankohet kundër një burri dhe të pretendojë se ai është burri i saj, kurse burri e mohon, madje bën edhe betimin ligjor, por më pas burri heq dorë prej mohimit dhe kalon në pohim, ky pohim dëgjohet prej tij dhe, kur del në dritë pengesa për mohimin e tij, gjykohet se ata të dy janë burrë e grua.”

Nëse dikush thotë: “Ky është im bir jashtë martese (prej kurvërimit).”, ky pohim nuk dëgjohej prej tij, sepse origjina për çdo të lindur është, që ai i atashohet atij që e ka lindur, derisa të vërtetohet e kundërta. Sipas detyrimit të kësaj origjine, mbi babain rëndon detyrimi ta edukojë e të shpenzojë për këtë të lindur prej tij, kurse fjala e tij “im bir jashtë martese” është në kundërshtim me këtë të drejtë, pasi është pohim, ose gjysmë pohim me të drejtën e tjetrit, prandaj anulohet. Ky është gjykimi, kur ne nuk kemi dijeni për realitetin dhe nuk dimë, nëse ai thotë të vërtetën, apo gënjen. Për sa i përket rastit kur dihet se burri thotë të vërtetën, fëmija, në asnjë gjendje, nuk i atashohet atij.

### ***Pohimi për kurvëri e vjedhje***

Fukahatë imami ndajnë një fjalë të përbashkët se kurvërimi nuk vërtetohet me një pohim të vetëm. Kjo është e barabartë, qoftë kur pohimi vjen prej anës së burrit, qoftë kur pohimi për kurvërim vjen prej anës së gruas, por patjetër pohimi duhet të përsëritet katër herë dhe jo vetëm një herë, krahas faktit që pohuesi të ketë arritur moshën e pjekurisë seksuale, të jetë i mençur, të dijë të bëjë zgjedhjen e tij dhe të jetë i lirë.

Këtë rregull fukahatë imami e kanë nxjerrë prej këtij njoftimi: Një burrë, i quajtur Maiz bin Malik, erdhi te i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe i tha: “Unë kurvërova.”

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e la këtë person. Pastaj ai i erdhi përsëri dhe i tha të njëjtën fjalë, ashtu siç i tha herën e parë. Përsëri i Dërguari i



Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e la. Burri vazhdoi të pohojë, derisa u bënë katër herë që i thotë: “Unë kurvërova.”

Herën e katërt Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Mos je i çmendur?”

Burri tha: “Jo.”

Përsëri Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Mbase e ke puthur, ose i ke bërë ndonjë shenjë me sy, ose vetëm e ke shikuar.”

Burri tha: “Jo.”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Domethënë ke kryer marrëdhënie intime me të?” Burri tha: “Po.”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Kreve marrëdhënie intime me të, derisa ti depërtove plotësisht te ajo?”

Buri i tha: “Po.”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Depërtove te ajo, ashtu siç depërton furça në flakonin e rimelit dhe ashtu siç rrëshqet litari në pus?”

Burri tha: “Po.”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “A e di ti ç’është kurvërimi?”

Burri tha: “Po, unë kreve me të veprimin haram, që burri e kryen hallall me gruan e tij.”

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Çfarë qëllimi ke me këtë fjalë?”

Burri tha: “Dua të më pastrosh.”

Vetëm pas këtij pohimi, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) urdhëroi që ky person ekzekutohej me gjuajtje me gur.

Dialogu që pamë, në radhë të parë, tregon se Allahu i Lartësuar, në asnjë gjendje, nuk e do përhapjen e imoralitetit. Kjo është e barabartë, qoftë kur përhapësi është vetë ai që e bën imoralitetin, qoftë kur përhapësi është një tjetër. Gjithashtu, kjo është e barabartë, qoftë kur përhapësi thotë të vërtetën, qoftë kur ai flet pa asnjë bazë.

Veç kësaj, dialogu i mësipërm tregon se pohimi mund të jetë argumenti më i fuqishëm i neneve të kodit civil, por ai mund të jetë edhe argumenti më i pafuqishëm i neneve të kodit penal. Pikërisht këtë e theksojnë tekstualisht edhe ligjet moderne.

Fukahatë imami ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur personi që kryen imoralitetin e mohon imoralitetin e kryer prej tij, megjithëse më parë ai e kishte pohuar vetë, në këtë gjendje, bie detyrimi për të zbatuar mbi të ekzekutimin, domethënë se zbatimi i dënimit për kryerje të imoralitetit është lënë në dorën e pohuesit, i cili, nëse dëshiron, rrezikon të sakrifikohet dhe, nëse dëshiron, tërhiqet nga pohimi.

Fukahatë imami, gjithashtu, ndajnë një fjalë të përbashkët për rastin kur pohuesi pendohet (bën teubeh) për imoralitetin e kryer, atëherë çështja lihet në dorën e Imamit (pushtetit), i cili, nëse do, zbaton mbi atë dënimin me ekzekutim dhe, nëse do, e fal.

Fukahatë imami ndajnë një fjalë të përbashkët se veprimet e tjera të ndaluara, për të cilat zbatohen ndëshkimet fizike, me përjashtim të kurvërimit, si për shembull, pirja e pijeve dehëse, vjedhja, atakimi në nder pa argument, mbi pohuesin nuk zbatohet

dënimi pa e pohuar ai vetë dy herë me radhë se ka bërë atë veprim të ndaluar dhe patjetër që është në moshë madhore, është i mençur dhe di të bëjë zgjedhjen e tij. Kur ai e mohon, pasi më parë e kishte pohuar bërjen e asaj punë të ndaluar që e bën të detyrueshëm ndëshkimin fizik, me përjashtim të ekzekutimit me gjuajtje me gur, pohimi i tij nuk dëgjohej. Prej tij dëgjohej mohimi, kur ai ka pohuar veprimin që bën detyrim ekzekutimin e tij me gjuajtje me gur, por jo për veprimet e tjera.

\* \* \*

## SHKRESA DHE TREGUESIT

Në ligjet njerëzore, shkresa ka një rëndësi shumë të madhe për vërtetimin e faktit, madje disa juristë kanë thënë se bazë për vërtetimin është, që ajo të jetë me shkresë, me përjashtim të atyre veprimeve që janë përjashtuar prej këtij rregulli. Madje borxhet jo tregtare nuk vërtetohen me rrugë tjetër përveçse me shkresë, kur borxhi është më tepër se shuma e caktuar me ligj, e cila, në ligjin egjiptian është dhjetë gine, ose pesëdhjetë lira në ligjin libanez, me përjashtim të rasteve kur vërtetohet ekzistenca e një ndaluesi moral, ose material, që borxhi të mos jetë i shkruar, ose kur borxhdhënësi ka humbur dokumentin që vërteton borxhin për ndonjë shkak jashtë vullnetit të tij

Me një fjalë, ligjvënësi, me kohë, e ka konsideruar shkresën bazë e rregull për të vërtetuar. Argumenti i tij për këtë është se dëshmia e dëshmitarëve gjithmonë është e ekspozuar ndaj qenies së saj gabim, për shkak të dobësisë së kujtesës, ose mossaktësisë. Gjithashtu, dëshmia është e ekspozuar ndaj animit e hakmarrjes, ryshfetit, prishjes së besës, ekzagjerimit, etj.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Disa ligjvënës kanë konstatuar se edhe shkresa është e ekspozuar ndaj falsifikimit.

## **Kur'ani dhe shkrimi i borxhit**

Rëndësia e shkresës përputhet nga shumë anë edhe më atë që thuhet qartësisht në Kur'anin Famëlartë dhe pikërisht të ajetin 282 të sures “El Bekare”:

”يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا تَدَايَيْتُمْ بِدِينٍ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى فَاكْتُبُوهُ وَلْيَكْتُب بَيْنَكُمْ كَاتِبٌ بِالْعَدْلِ وَلَا يَأْب كَاتِبٌ أَنْ يَكْتُبَ كَمَا عَلَّمَهُ اللَّهُ فَلْيَكْتُبْ وَلْيُمْلِلِ الَّذِي عَلَيْهِ الْحَقُّ وَلْيَتَّقِ اللَّهَ رَبَّهُ وَلَا يَبْخَسَ مِنْهُ شَيْئًا فَإِن كَانَ الَّذِي عَلَيْهِ الْحَقُّ سَفِيهًا أَوْ ضَعِيفًا أَوْ لَا يَسْتَطِيعُ أَنْ يُمِلَّ هُوَ فَلْيُمْلِلْ وَلِيُّهُ بِالْعَدْلِ وَاسْتَشْهِدُوا شَهِيدَيْنِ مِنْ رِجَالِكُمْ فَإِن لَّمْ يَكُونَا رَجُلَيْنِ فَرَجُلٌ وَامْرَأَتَانِ مِمَّن تَرْضَوْنَ مِنَ الشُّهَدَاءِ أَن تَضِلَّ إِحْدَاهُمَا فَتُذَكَّرَ إِحْدَاهُمَا الْأُخْرَىٰ وَلَا يَأْب الشُّهَدَاءُ إِذَا مَا دُعُوا وَلَا تَسَاءَمُوا أَن تَكْتُبُوهُ صَغِيرًا أَوْ كَبِيرًا إِلَىٰ أَجَلِهِ ذَلِكُمْ أَقْسَطُ عِنْدَ اللَّهِ وَأَقْوَمُ لِلشَّهَادَةِ وَأَدْنَىٰ أَلَّا تَرْتَابُوا إِلَّا أَن تَكُونَ تِجَارَةً حَاضِرَةً تُدِيرُونَهَا بَيْنَكُمْ فَلَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَلَّا تَكْتُبُوهَا وَأَشْهِدُوا إِذَا تَبَايَعْتُمْ وَلَا يُضَارَّ كَاتِبٌ وَلَا شَهِيدٌ وَإِن تَفَعَّلُوا فَإِنَّهُ فَسُقٌ بِكُمْ وَاتَّقُوا اللَّهَ وَيُعَلِّمُكُمُ اللَّهُ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ“

**“O ju që keni besuar! Shkruajeni huan që ia jepni njëri-tjetrit për një afat të caktuar. Le ta shënojë atë me drejtësi një shkruer ndërmjet jush; asnjë shkruer të mos ngurrojë që ta shënojë ashtu siç e ka mësuar Allahu. Ai le të shënojë, kurse borxhliu le të diktojë dhe le t’i frikësohet Allahut, Zotit të vet, duke mos lënë mangët asgjë nga borxhi! Në qoftë se borxhliu është mendjelehtë ose i mitur, ose i tillë që nuk është në gjendje të diktojë, atëherë le të diktojë saktësisht kujdestari i tij. Thirrni dy dëshmitarë prej njerëzve tuaj e, nëse nuk gjeni dy dëshmitarë burra, atëherë thirrni për dëshmitarë një burrë dhe dy gra, nga ata që i quani të përshtatshëm; në mënyrë që, nëse njëra grua harron, t’ia kujtojë tjetra. Dëshmitarët nuk duhet të kundërshtojnë kurdo që të thirren. Mos e lini pa e shënuar**

**borxhin, qoftë i vogël apo i madh, duke shënuar edhe afatin e pagimit. Kjo mënyrë është më e drejtë para Allahut, më e saktë për dëshmi dhe më e përshtatshme për të mos dyshuar. Por, nëse është fjala për mallin që qarkullon nga dora në dorë, atëherë nuk do të keni gjynah, nëse nuk e shënoni atë. Thirrni dëshmitarë, edhe kur të lidhni kontrata për shitblerje dhe të mos dëmtohet as shkruesi, as dëshmitari. Nëse bëni të kundërtën, atëherë keni bërë gjynah, prandaj ruajuni Allahut! Allahu ju mëson ju; Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.”**

Kur ne bëjmë krahasim mes fjalëve të këtij ajeti të nderuar të Kur'anit Famëlartë dhe mes ligjeve të vendosuar nga njeriu, dalim me përfundimet vijuese:

1- Ajeti i Kur'anit dhe ligji urdhërojnë shkrimin e borxhit, me qëllim ruajtjen e së drejtës.

2- Ligjvënësi jofetar ka përjashtuar prej shkrimit borxhin e vogël, kurse Kur'ani Famëlartë nuk bën asnjë dallim mes borxhit të vogël e borxhit të madh, sepse që të dy borxhet janë një e drejtë që duhet të merret dhe e drejta nuk copëzohet, veçanërisht kur e shikojmë nga ana e detyrimit për kujdesin dhe ruajtjen e së drejtës.

3- Ligjvënësi jofetar dhe Kur'ani nuk shikojnë ndonjë problem, nëse lihet shkresa për mallrat që tregtohen në dorë, për faktin se vetë tregtia, nga karakteri i saj, kërkon shpejtësi në marrëdhënie, por Kur'ani Famëlartë e ka kushtëzuar tregtinë me gjendjen, domethënë që shitja të realizohet me para në dorë dhe jo me pagesë të vonuar, kurse ligji jofetar nuk e ka këtë kusht.

4- Ligjvënësi jofetar dhe Kur'ani, që të dy vënë në konsideratë praninë e dy dëshmitarëve gjatë bërjes së shkresës.<sup>1</sup>

### ***Fukahatë dhe shkresa***

Pavarësisht nga sa u tha, shumica e fukahave të medh'hebeve (shkollave juridike islame) nuk e kanë bërë detyrim shkresën as për borxhin, as për shitblerjen e as për punë të tjera, por urdhrin e ajetit të nderuar, për të hartuar shkresë, e kanë mbartur në gradën e veprimit të pëlqyer (veprim mustehab), madje shumë fukaha, në kapitullin e borxhit, në lidhje me dispozitën për të hartuar shkresë, nuk janë shprehur as negativisht e as pozitivisht.

Ahmed Nesh'et, në librin "Risàletul Ithbàt", ka thënë: "Dijetarët që janë shprehur për të konsideruar veprim të pëlqyer bërjen e shkresës, janë ndikuar nga mirëbesimi i njerëzve në kohën e tyre, të cilët ishin me të vërtetë fetarë, qofshin dëshmitarë, qofshin kontraktues."

Në të vërtetë, ky orientim të habit shumë, pasi mendimi në mirësinë e njerëzve, qoftë edhe duke supozuar që mirësia ka ekzistuar në atë kohë, te dijetarët e fesë islame nuk përbën argument për të komentuar Kur'anin dhe largimin e ajeteve prej

---

<sup>1</sup> Autori i librit "Muxhmeul-Bejàn" në komentimin e fjalës së Allahut të Lartësuar: "وَاسْتَشْهَدُوا شَهِيدَيْنِ مِنْ رِجَالِكُمْ" - "**kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë burra prej mesit tuaj...**" ka thënë: 'Kërkoni të dëshmojnë për shkresën dy burra prej burrave tuaj. Ligji jofetar e merr në konsideratë praninë e dy dëshmitarëve gjatë hartimit të kontratave zyrtare, plotësisht ashtu siç shprehet ajeti i nderuar i Kur'anit Famëlartë.

kuptimit të jashtëm që shprehin fjalët e Kur'anit. Prandaj detyrimisht duhet të jetë një shkak tjetër, i cili ose mund të jetë detyrimi që ka ushtruar gjendja e vështirë ekonomike që vërtetimi të reduktohet me shkresën, ose ekziston ndonjë hadith që e shpjegon ajetin e nderuar, ose gjendet diçka tjetër që e bën shkresën detyrim.

Cilido që të ketë qenë shkaku për thënien e tyre, që bërja e shkresës është veprim mustehab, ai nuk është qëllimi ynë që të shprehemi e të themi që shkresa është detyrim të bëhet, apo hartimi i shkresës është veprim i pëlqyer, pasi qëllimi ynë i parë është që të flasim për shtrirjen e ndikimit të shkresës, sipas pikëpamjes së fukahave për vërtetimin e të drejtës pas ekzistencës së shkresës.

Shkresa, si shkresë, te fukahatë nuk është asgjë mbi të cilën mund të mbështetesh për të vërtetuar të drejtën, sepse personi kundër të cilit është ngritur ankesa, nëse e pohon shkresën, kjo njohje, nga ana e tij, hyn në kapitullin e pohimit.

Ai e mohon shkresën, megjithëse shkresën e dëshmojnë dëshmitarët që kanë asistuar hartimin e saj se ajo shkresë ka dalë prej vetë atij, kjo është dëshmi me pohim, sepse shkresa është "motra" e pohimit dhe është në gradën e dytë të argumenteve që tregojnë atë që është në brendësi të shpirtit, ashtu siç ka thënë autori i librit "El Xhevahir".<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Këtë shprehje ai e ka sjellë në fillim të kapitullit "Testamenti": "Domosdoshmëria e argumentimit të anës së jashtme të punëve, është si fjalët, pasi shkresa është "motra" e fjalëve, të cilat janë në gradën e dytë për të treguar gjendjen e asaj që është në brendësi të shpirtit dhe kështu ajo merr përparësi ndaj punëve." Këtë ne e kemi përmendur në kapitullin "Martesa", në



Nëse shkresa është bërë pa dëshmitarë dhe pa pohim, gjykatësi e anashkalon dhe nuk bazohet fare mbi atë shkresë. Autori i librit “El Mustened” ka thënë: “Nuk lejohet dëshmia vetëm me shikimin me sy prej dëshmitarit se ajo u shkrua e u vulos, nëse në atë shkresë nuk përmendet ngjarja, pavarësisht se mund të jemi të sigurt që s’ka falsifikim. Këtë fakt askush nuk e kundërshton, ose krahas asaj shkrese s’ka ndonjë fakt tjetër që ta zëvendësojë shkresën.”

### ***Treguesi dhe shkresa e thjeshtë***

Ndër të tjera, fukahatë kanë përmendur se, kur trashëgimtari gjen një porosi me shkrimin e trashëgimlënësit të tij; ose gjen një qese në të cilën ka para dhe mbi qesen është shkruar: “Kjo qese është lënë në mirëbesim për ruajtje prej filanit.”; ose trashëgimtari gjen të shkruar mbi kapakun e një libri se ky libër është vakëf,<sup>1</sup> të gjitha këto shënime s’kanë asnjë vlerë, vetëm nëse

---

paragrafin 4, “Formula”, ku kemi parë se ejjid El Hakijm e ka vënë këtë shprehje në librin “El Mustemsek”, ku tregon se martesë ndodh edhe me shkresë, kur shkresa e tregon qartë argumentin.

<sup>1</sup> Autori i librit “Mulhakatul Urveh” në fundin e kapitullit “Vakëfi”, ka thënë: “Kur në ato që ka lënë i vdekuri, del në dritë një letër, ku shkruhet se filan pronë e tij është vakëf, nuk vendoset që ajo është vakëf, edhe nëse prona e përmendur në atë shkresë arrihet të merret në dorë dhe të jepet. Nëse letra e gjetur është me shkrimin e të vdekurit e me vulën e tij, duke supozuar se ai, me të vërtetë, e ka shkruar letrën me qëllim që të lërë vakëf pasurinë në fjalë, ai ka të drejtë ta bëjë këtë gjë.” Edhe ne e miratojmë Es’sejjidin në lidhje me ekzistencën e shkrimit, pa marrje në dorë dhe pa e dhënë, por ne jemi në kundërshtim me Es’sj’jidin, për rastin kur është arritur marrja në dorë me vullnetin e shkruarit e me lejen e tij, sepse, ana e jashtme e veprimeve, është argument si ana e jashtme e fjalëve, ashtu siç e pohon këtë fare qartë vetë sejjidi, në librin “El Urvetul Vuthkà”, në faqen 405, botim i shtëpisë botuese “El Irfàn”.

shkruesi i këtyre shënimeve, i ka bërë ato pohime para vdekjes së tij, ose trashëgimtari ka dijeni të plotë se ato shënime janë plotësisht të vërteta. Fukahatë kanë thënë se, nëse gjendja është kështu si u parashtrua, ato sende mbeten ashtu siç është lënë shënimi. Por fukahatë nuk kanë theksuar as që gjykatësi ka të drejtë të gjykojë këto shkresa dhe as që ai e ka detyrim të mbështetet mbi ato shkresa në procesin e gjykimin.

Në të vërtetë, këto që u thanë, tregojnë se fukahatë kanë qëndruar dhe vazhdojnë të mosveprojnë në lidhje me gjykimin e mosgjykimin e pasurive, mbështetur në një shkresë të pavërtetuar me argument dhe jo me pohim.

## ***Treguesit***

Prej treguesve ka që janë ligjore dhe për të cilat ligjvënësi është shprehur qartë me tekst dhe ky tekst e bën detyrim për gjykatësin që ai, në mënyrë absolute, duhet të punojë sipas treguesve. Kjo është e barabartë, nëse prej treguesve ka arritur, ose nuk e ka arritur të marrë dijeni për të drejtën objekt gjykimi, siç ishin pohimi, argumenti dhe dora.

Prej treguesve janë edhe ato që shoqërojnë ankesën dhe ndodhitë e ankesës. Këta quhen tregues me objektivitet dhe janë dy llojesh:

*Lloji i parë:* Tregues prej të cilëve arrihen dituri të detyrueshme logjike, domethënë: Kushdo që merr dijeni për atë tregues, cilido qoftë ai, si për shembull, kur një njeri pretendon se ajo kafshë është pronë e tij që prej një viti dhe më pas rezulton se

mosha e kafshës është më pak se kaq, ose ai thotë se shtëpia që është në dorën e Zejdit, e ka blerë prej Amrit dhe më pas bëhet e qartë se Amri gjatë jetës së tij asnjëherë nuk ka pasur shtëpi në pronësi; ose tregues të tjerë prej të cilëve arrihet të mësohet ndërprerja, për të gjithë njerëzit pa asnjë përjashtim. Pa dyshim që ky është argument që vjen pas, por sekreti, në vërtetimin e atij argumenti dhe vënia e tij në konsideratë, arrihet vetëm duke pasur dijeni, por jo se është argument në vetvete. Marrja për bazë e këtij rregulli, është pjesë e kapitullit “Dituria e gjykimi”, për të cilin do të flitet më poshtë.

*Lloji i dytë:* Tregues objektivë prej të cilëve nuk arrihet dituri e prerë. Edhe këta tregues nuk përbëjnë argument mbi të cilin mund të mbështetet vendimi e gjykimi, por këta tregues mund të përforcojnë e të mbështesin njërin prej bazave të vërtetimit, si për shembull, armiqësia e ashpër mes të vrarit dhe mes atyre që dëshmojnë kundër vrasjes, veçanërisht kur vrasësi është në lëvizje, ose armiqësia e ashpër mes vrasësit e të vrarit ishte për gjakmarrje. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ata që kanë dëshmuar më parë kundër tij për vjedhje.

Këta tregues mund të bëhen të dobët si argumente dhe mund të shuajnë origjinën e vërtetimit, ose treguesit mund të bëjnë detyrim për më shumë vërtetim e hetim, si për shembull, dikush ka dijeni se filani është i pafajshëm dhe njeri i qetë, megjithëkëtë ai dëshmon kundër këtij njeriu se ka kryer krim, ose ai që ka nevojë për fuqi e ndihmë dëshmon kundër një të çmenduri se është i pafuqishëm. Tregues të këtij lloji janë aq të shumtë, sa nuk numërohen dot.

## **Fjalët që i vishen imamit**

Më sipër u shpjegua se gjykatësi nuk lejohet të gjykojë me tregues, nëse prej atyre treguesve nuk arrihet të mësohet nevoja logjike, duke ditur se Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) i vishen gjykime, në të cilat ai është bazuar në tregues që nuk kërkojnë dituri. Ndër këto veshje kemi rastin kur ai është pyetur për një burrë që ka vjellë lëngje alkoolike. Ai tha: “Atë që volli, e ka pirë.”

Ne dyshojmë në lidhje me këtë njoftim që i është veshur Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), pasi ai, pijen dehëse mund ta ketë pirë pa e ditur që ajo është pije dehëse, ose e ka pirë për mjekim, ose edhe mund të jetë imponuar.

Hadithi i ardhur me rrugë të pashkëputur përcjellësisht prej sunive dhe prej sh’ave, vërteton se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Dënimet fizike me dyshime nuk zbatohen.”

Bazuar mbi këtë hadith, të gjithë fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se ai që pretendon diçka të tillë, pretendimi i tij dëgjohet dhe bie dënimi për ndëshkim fizik.

*Një shembull:* Dy gra kishin konflikt në lidhje me një djalë, për të cilin të dyja gratë pretendonin se ishte djali i saj. Kur këtë çështje e ngritën te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ai urdhëroi të sillnin një shpatë dhe tha: “Nëse të dyja nuk tregoni të vërtetën, djalin do ta ndaj në dy gjysma dhe do t’i jap secilës nga një gjysmë.”

Njëra prej atyre dy grave ishte dakord që djali të ndahej në dy gjysma, kurse gruaja tjetër kundërshtoi dhe tha: “Le ta marrë ajo djalin.”

Atëherë Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ia dha djalin gruas që kundërshtoi vrasjen e djalit, sepse ajo ishte nëna e atij djali, kurse gruaja që ishte dakord që djali të ndahej në dy gjysma, nuk kishte të bënte fare me djalin.

Ky njoftim është akoma më larg se njoftimet e tjera të këtij lloji që janë thënë më parë, por, edhe nëse njoftimi është i vërtetë, duket qartë se Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), me këtë mënyrë veprimi, e detyroi gruan të pohojë dhe në bazë të pohimit të gruas, ai zbuloi se cila prej dy grave ishte dakord për vrasjen e djalit. Me këtë pohim të veçantë ai zbuloi se ajo që pranoi vrasjen e djalit, nuk e kishte djalë. Bazuar mbi këtë tregues, ai bëri një gjykim të veçantë për një çështje të veçantë, që nuk mund të bëhet për një çështje tjetër.

\* \* \*

## DËSHMIA (*Esh Shehadetu*)

### ***Pretenduesi ka detyrim të sjellë argument***

Legjislacionet qiellore dhe legjislacionet njerëzore kanë një fjalë të përbashkët: “Pretenduesi ka detyrim të sjellë argument, kurse mohuesi (i pretendimit) ka detyrim të betohet.”

Në rastin kur pretenduesi ka argument, ai lejohet të mos e përdorë argumentin dhe kërkon betimin e mohuesit, domethënë se ai ka të drejtë të përzgjedhë mes sjelljes së argumentit dhe betimit të kundërshtarit të tij. Gjithashtu, edhe mohuesi ka të drejtë të përzgjedhë mes betimit dhe sjelljes së argumentit për pafajësinë e tij, nëse kjo është e mundur të dëgjohet, si për shembull, kur kërkohet që duhet t’i referohesh vërtetimit, në këtë gjendje, gjykatësi nuk ka të drejtë të përzgjedhë për të hulumtuar argumentin që ai dëshiron, ose të orientojë veprimin mbi të cilin ai ka dëshirë të hulumtojë, pasi ai, para çdo gjëje, ka detyrim të bëjë dallimin ndërmjet pretenduesit e mohuesit që të kuptohet gjithçka që kërkohet prej tij: Nëse personi kundër të cilit është ngritur ankesa, mohon, gjykatësi i thotë pretenduesit, pra, ngritësit të ankesës, kur ai s’ka paraqitur argument: “Ke detyrim të sjellësh

argumentin. Gjithashtu, ke të drejtë të betohesh kundër kundërshtarit tënd.”

Në qoftë se ankuesi sjell dy dëshmitarë, drejtësia e të cilëve njihet nga përvoja, ose drejtësia e dy dëshmitarëve mësohet me anë të një vërtetimi pafajësie, veç kësaj, dëshmia e atyre të dyve është e njëjtë dhe përputhet me sendin objekt i ankesës, gjykatësi i thotë ankuesit: “Nëse te ti gjendet diçka që e denoncon dëshminë e atyre të dyve, paraqite sa më shpejt.”

Në qoftë se ai i kërkon afat, gjykatësi e shtyn gjykimin tri ditë dhe, nëse ai nuk sjell ndonjë gjë logjike, atëherë gjykohet sipas kërkesës së dëshmisë.

Për dëshmitë ne kemi vënë një kapitull të veçantë.

### ***Kushtet e dëshmitarit***

Është kusht që dëshmitari të jetë i mençur, të ketë arritur moshën e pjekurisë seksuale, të jetë njeri i drejtë, të jetë mysliman, të mos jetë në armiqësi. Dëshmitari, me dëshminë e tij, nuk synon të tërheqë ndonjë përfitim për veten e tij, ose me dëshminë e tij dëshmitari largon ndonjë dëm prej vetes. Hollësitë, në lidhje me këtë çështje, i kemi parë në kapitullin “Dëshmitë”.

### ***Rruga për njohjen e cilësive të dëshmitarit***

Gjatë dëgjimit të fjalëve të ankuesit, gjykatësi ka mundësi të mësojë e të dallojë ankesën e qartë prej ankesës jo të qartë. Gjithashtu, gjykatësi, gjatë dëgjimit, ka mundësi të dallojë e të

njohë prej fjalëve të ankuesit veprimet që përbëjnë faj dhe veprimet e drejta, por mund të mësojë e të dallojë edhe ankesën e pamundur, etj.

Gjykatësi ka mundësi të mësojë thjesht duke dëgjuar dëshminë, domethënë ai shikon, nëse dëshmia përputhet, ose nuk përputhet me ankesën: Dallon, nëse ankesa tregon vërtetim, ose tregon mohim, nëse dëshmia bëhet vullnetarisht, ose jo vullnetarisht.<sup>1</sup>

Për sa u përket kushteve që janë detyrim të kërkohen për dëshminë e për dëshmitarin, si për shembull, dihet që dëshmia është rezultat i një njohjeje të thellë dhe jo rezultat i pandihmave, apo që dëshmitari është njeri i drejtë dhe nuk është as armik e as i afërm me palët në gjykim, por të gjitha këto dhe të tjera si këto, kanë nevojë të vërtetohen me mjete mbi të cilat mbështetet gjykatësi.

Në vijim do t'i trajtojmë këto mjete:

### ***Rruga e njohjes me burimin e dëshmisë***

Fukahatë imami, nga njëra anë, kanë folur për detyrat e dëshmitarit dhe, nga ana tjetër, kanë folur për detyrat e gjykatësit ndaj dëshmisë.

Gjithashtu, fukahatë kanë bërë detyrim për dëshmitarin si rregull tërësor dhe si kriter i përgjithshëm që dëshmitari dëshmon, vetëm nëse ka dijeni për çështjen objekt i ankesës, ndryshe ai heq

---

<sup>1</sup> Dëshmi të vullnetshme kemi kur dëshmitari dëshmon vetë para se atë ta pyesë gjykatësi.



dorë prej dëshmisë. Vetëkuptohet që prej këtij rregulli fukahatë kanë veçuar lejimin e dëshmisë për përkatësinë familjare dhe për vdekjen, ose për ndodhi të tjera specifike të kësaj kategorie, për të cilat do të flitet më poshtë.

Dëshmia patjetër është e bazuar në shumicën e fakteve dhe në përhapjen që ato kanë. Disa fukahatë kanë thënë: “Në të vërtetë, kjo kërkesë është shkak për dituri. Bazuar mbi këtë dituri, kriteri mbetet i përgjithshëm, ashtu siç është.”

Në librin “Fet’hul Kadijr” të hanefive (praktikuesit e shkollës juridike hanefi) thuhet se dëshmitarit nuk i lejohet të dëshmojë asgjë që ai nuk e ka parë me sy, përveç përkatësisë familjare, vdekjes, kurorëzimit, hyrjes së dhëndrit te nusja, ose për aftësinë e gjykatësit, për të gjitha këto çështje ai ka leje të dëshmojë, nëse ai vetë ka dijeni, ose dëshmon duke u bazuar në njoftimin që ka marrë prej një personi të i cili ai ka besim.”

Me pas, fukahatë imami kanë pasur kundërshtime mes tyre: Nëse dëshmitari ka të drejtë absolute të dëshmojë, bazuar mbi dijeninë që ai ka për çështjen objekt i gjykimit. Kjo është e barabartë, qoftë kur ka marrë dijeni për çështjen, ngaqë e ka parë vetë me sy, qoftë kur ai e ka mësuar prej ndonjë tjetri, apo për atë nuk lejohet të dëshmojë, nëse nuk ka mësuar për çështjen me anë shqisave e me shikim?

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Është e mjaftueshme të merret dituri me çfarëdo rruge të mundshme. Madje një grup prej fukahave, ndër të cilët edhe autori i librit “El Mustened”, ka thënë: “Dëshmia është e lejueshme, edhe kur është e bazuar në rregullin e shoqërimit, si për shembull, sikur ai të

thotë: “Unë e dija se në të kaluarën shtëpia ishte e Zejdit.” Në këtë gjendje, sipas rregullit të shoqërimit, mbetet pronësia dhe dëshmia e tij është dëshmi në përgjithësi, krahas faktit që ai ka dijeni që Zejdi edhe mund të këtë shitur shtëpinë, ose e ka dhuruar.

Kjo është në analogji me dëshminë e dëshmitarit e me burimin e dëshmisë, kurse në analogji me gjykatësin, ai ka të drejtë të marrë në konsideratë se dëshmitari ka dëshmuar, duke pasur dijeni për çështjen dhe ai nuk ka dëshmuar i bazuar në mundësinë e ndodhjes, ose me hamendje, sepse dëshmia del vetëm prej shikimit me sy.

Pikërisht kjo është pasja dijeni për çështjen, por nuk do të thotë që gjykatësi është i detyruar të pranojë dëshminë e dëshmitarit, ngaqë ai kishte dijeni dhe të gjykojë sipas kësaj dëshmie, sepse s’ka asnjë detyrim logjik ose ligjor mes rregullit që shikimi me sy është burim për dëshminë dhe mes detyrimit për të punuar sipas kësaj dëshmie.<sup>1</sup>

Ky rregull, nga disa anë, përputhet me ligjet e kohëve të reja, në të cilat tekstualisht thuhet se vlerësimi i dëshmisë i takon gjykatësit.

Supozim nuk do të thotë që burimi i dëshmisë është pasja dijeni, por as mosdetyrimi për të pyetur dëshmitarin për shkakun

---

<sup>1</sup> Mulla Aliu, në librin “Gjykimi”, ka thënë: “Nga ana e jashtme, kryerja e dëshmisë rezulton se ajo bëhet me vendosmëri, derisa nuk dihet ndonjë kundërshtim.” Autori i librit “Mulhakatul Urveh” ka thënë: “Ajo që dihet prej rrugës ligjore është mbartja e fjalës së dëshmitarit mbi realitetin dhe nuk është detyrim që dëshmitari të pyetet për shkakun.” Me fjalën “realitet”, ai ka qëllim realitetin të dëshmitari. Autori i librit “El Mustened”, në vëllimin 2, në kapitullin “Gjykimi dhe dëshmitë”, ka thënë: “Lejimi i dëshmisë nuk bën të detyrueshëm lejimin e gjykimit.”

nuk do të thotë që gjykatësit nuk i lejohet të pyesë dëshmitarin për shkakun, pasi gjykatësi ka të drejtë të pyesë për shkakun dhe për të tjera punë. Gjykatësi ka të drejtë t'i drejtojë dëshmitarit çdo pyetje, e cila i mundëson atij që me anë të asaj pyetjeje, ai të zbulojë të vërtetën, me kusht që gjykatësi i lë dëshmitarit liri të plotë në lidhje me mënyrën e njoftimit, në zgjedhjen e fjalëve.

Gjithashtu, gjykatësi ka të drejtë të heqë dorë prej pyetjes, derisa dëshmitari të përfundojë dëshminë. Në qoftë se dëshmitari ndalon, gjykatësi nuk e shtyn dëshmitarin të rrezikojë. Nëse dëshmitari rrezikon, gjykatësi nuk i flet dëshmitarit me dashamirësi që ai të përmbahet në dëshminë e tij, përveçse kur është fjala për të drejtat e Allahut të Lartësuar, ashtu siç e pamë në kapitullin "Pohimi".

Autorët e librave "Esh Sheràiu", "El Xheuahir", "El Mesalik" dhe fukahat të tjerë prej imamive, kanë thënë: "Vetëkuptohet se, kur gjykatësi dyshon për dëshminë, qoftë edhe në njërin anë prej anëve të dëshmisë, ose gjykatësi konstaton dobësi kujtese të dëshmitarit, ose gjykatësi dyshon në mprehtësinë e shikimit të tij, vetëkuptohet që gjykatësi ka të drejtë ta shtrëngojë dëshmitarin dhe ta vërë atë në pozitë të vështirë, madje ky veprim i gjykatësit është veprim i pëlqyer (mustehab). Por kur dëshmitari është prej atyre që kanë burrëri, është largpamës dhe ka mendje të mprehtë, është haram që ai të shtrëngohet. Në asnjë gjendje, shtrëngimi i këtij dëshmitari nuk lejohet.

Bazuar mbi këtë shpjegim, për gjykatësin lehtësohet shumë rruga për të mësuar, nëse dëshmitari ka dijeni për dëshminë që bën, apo ai dëshmon pa pasur dijeni për dëshminë e tij, sepse gjykatësi ka të drejtë ta konsiderojë dëshminë që ajo e ka burimin

në pasjen dijeni pa e pyetur dëshmitarin, por niset vetëm nga ana e jashtme të dëshmisë. Gjithashtu, gjykatësi ka të drejtë të studiojë e ta pyesë dëshmitarin për shkakun dhe pastaj të ecë mbi atë që arriti e zbuloi te ai.

### ***Rruga për njohjen e drejtësisë***

Më sipër kemi thënë se për dëshmitarin ishin kusht që ai të jetë mysliman, të jetë i mençur, të ketë arritur moshën e pjekurisë seksuale, të jetë njeri korrekt, të jetë i drejtë, të mos jetë në armiqësi e as i afërm me palët.

Gjithashtu, pamë se rrugët që çojnë në njohjen e çdo njëres prej këtyre cilësive, janë aq të shumëllojshme e aq të ndryshme sa ç'janë vetë cilësitë, prandaj, para se të trajtojmë rrugët me të cilat ne arrijmë te këto cilësi, e shikojmë të domosdoshme të bëjmë shpjegimin e mëposhtëm: Kurrë nuk ka ndodhur që dy juristë të ligjeve të vjetra e të reja të kenë kundërshtime mes tyre në lidhje me aksiomën: Çdo send për të cilin dyshohet për origjinën e për ekzistencën e tij, ashtu siç është, ose dyshimi është në lidhje me kushtin për ndaluesin, ai send është i anuluar, sepse origjina është mosekzistenca e tij, derisa të vërtetohet e kundërta, domethënë që ne nuk rendisim asnjë ndikim për ekzistencën e tij, përveçse kur ai send vërtetohet me argument.

Kjo është e barabartë, qoftë kur ekzistenca e atij sendi është kusht për ekzistencën e një sendi tjetër, qoftë kur ai send është ndalues për ekzistencën e atij sendi, për shembull, ne dyshojmë se filani e ka shitur apo nuk e ka shitur arën e tij. Origjina është mosndodhja e shitjes.

Ne mësojmë se formula e shitjes, në mënyrë të prerë, ka dalë prej gojës së tij, megjithëkëtë ne dyshojmë, nëse formula ka dalë prej tij në kohën që ai kishte arritur moshën e pjekurisë seksuale, e cila është kusht për vlefshmërinë e shitjes. Origjina është mosarritja e pjekurisë seksuale. Kur ne mësojmë për ekzistencën e formulës dhe njëherësh mësojmë edhe për arritjen e moshës së pjekurisë seksuale, por dyshojmë, nëse shitja ka ndodhur nën presionin e imponimit që është prishës i shitjes, origjina është mospasja imponim, derisa të vërtetohet e kundërta. Prandaj kushdo që pretendon ekzistencën e ndonjë sendi prej këtyre që u thanë, ai ka detyrim ta vërtetojë.

Bazuar mbi këtë dispozitë, del degëzimi: ekzistenca e kushtit patjetër kërkon arritjen e ekzistencës së kushtit me anë të shqisave, ose me argument. Kur nuk arrihet të mësohet ekzistenca e atij kushtit, ne nuk gjykojmë me ekzistencën e kushteve, sepse dyshimi në ekzistencën e kushtit nënkupton dyshimin, nëse me të vërtetë ai është kusht, madje kërkon gjykimin për mosekzistencën e tij.

Për sa i përket mosekzistencës së penguesit, ne nuk kemi nevojë të arrijmë atë me argument, por thjesht dyshimi në ekzistencën e penguesit është i mjaftueshëm për të gjykuar në lidhje me mosekzistencën e tij, sepse origjina është mosekzistenca e tij, derisa të vërtetohet e kundërta, ashtu siç është gjendja, kur ne dyshojmë në arritjen e imponimit, që është ndalues për vlefshmërinë e shitjes.

Ne mësuam se kushti ka nevojë për vërtetim dhe penguesi është i mjaftueshëm për mohimin e origjinës në lidhje me mosekzistencën e atij kushti, kur s'ka argument që të tregojë për

ekzistencën e tij. Gjithashtu, ne mësuam se Islami, arritja e moshës së pjekurisë seksuale, mendja, drejtësia dhe korrektësia ishin kushtet për pranimin e dëshmisë. Mësuan se armiqësia dhe afërsia janë pengues për pranimin e dëshmisë. Pasi të gjitha këtu u bënë të qarta, ne mësuam se gjykatësi s'ka nevojë të studiojë e të pyesë në lidhje me armiqësinë e për afërsinë e dëshmitarit, sepse, qoftë armiqësia, qoftë afërsia, janë prej penguesve që i mohon origjina dhe nuk janë prej kushteve që kanë nevojë të vërtetohen me argument.

Kur gjykatësi studion, ose pyet në lidhje me armiqësinë e me afërsinë, ai e bën këtë me qëllim përforcimi dhe për të pasur sa më shumë vërtetim, ose për të tërhequr vëmendjen se afërsia dhe armiqësia e ndajnë pranimin e dëshmisë. Sido që të jetë gjendja, vetëm personi kundër të cilit dëshmohet, mban përgjegjësi për ndikimin e armiqësisë e të afërsisë, duke supozuar se që të dyja ekzistojnë, prandaj, kur personi kundër të cilit bëhet dëshmia, parashtron ankesë kundër dëshmisë, në këtë gjendje, gjykatësi ka detyrim të vërtetojë që ekziston njëra prej atyre të dyjave, domethënë që ekziston ose armiqësia, ose afërsia.

Pas këtij përshkrimi, do të fillojmë të shpjegojmë rrugët që tregojnë se kushtet e kërkuara për dëshmitarin janë të plota.

Për sa i përket vërtetimit që dëshmitari është mysliman, çështja e këtij dëshmitari është një punë fare e lehtë, sepse paraqitja e Islamit është e mjaftueshme për të vërtetuar që ai është mysliman, madje nuk pranohet asnjë ankesë prej kujtdo që bëhet kundër qenies mysliman të atij që e demonstroi Islamin e tij.

Arritja e moshës së pjekurisë seksuale, mendja dhe vetëpërmbajtja, mësohen nga ana e jashtme e gjendjes. Në qoftë se argumentet nuk dalin në shesh për gjykatësin, në atë mënyrë që çdo rrugë që ai shikon, çon drejt njohjes e sigurisë dhe nuk kushtëzohet me ndonjë rrugë të veçantë, sepse çështja e arritjes së këtyre kushteve, si dhe e kushteve të tjera, është një çështje objektive, vlerësimi i argumentit që çon në njohjen e çështjes i lihet vetëm gjykatësit.

Sikur personi kundër të cilit dëshmohet të pohojë se dëshmitari ka arritur moshën e pjekurisë seksuale, është i mençur dhe e kontrollon vetveten, ky pohim është i mjaftueshëm, kur gjykatësi sigurohet me këtë pohim. Sido që të jetë, rruga që çon në njohjen dhe në arritjen e moshës së pjekurisë seksuale, mendjes dhe vetëkontrollit është shumë e lehtë.

Për sa i përket kërkesës që dëshmitari të jetë njeri i drejtë, nëse gjykatësi e njih dëshmitarin, ai e merr në konsideratë dëshminë e tij, pa qenë nevoja të kërkojë një rekomandim që vërteton drejtësinë e dëshmitarit, domethënë, gjykatësi s'ka nevojë të kërkojë dikë që të japë garanci se dëshmitari i çështjes është njeri i drejtë, pasi qëllimi i fundit prej rekomandimit, është vërtetimi që pohon drejtësinë dhe me të cilin gjyqtari praktikisht mëson se dëshmitari është njeri i drejtë.

Në qoftë se gjykatësi nuk e njih dëshmitarin, nëse dëshiron, e merr përsipër vetë të hulumtojë në lidhje me drejtësinë e dëshmitarit, ose gjykatësi ia bën të qartë pretenduesit se ai ka një vërtetim të dëshmuar prej dy burrave të njohur për drejtësinë e tyre, të cilët dëshmojnë se dëshmitari është njeri i drejtë, sepse vërtetimi për pastërtinë e figurës së dëshmitarit është prej fakteve

shoqëruese të argumentit, prandaj ashtu siç kërkohet argument prej pretenduesit, po ashtu kërkohet argument edhe për vërtetimin që dëshmon pastërtinë e figurës së dëshmitarit të drejtë.

Kur kundërshtari pretendon se dëshmitari është mëkatar, pretendimi i tij dëgjohet, por ai ka detyrim të vërtetojë pretendimin e tij. Nëse ai e vërteton pretendimin e tij me argument, dëshmia rrëzohet, ndryshe ankesa e tij hidhet poshtë. Kur ankuesi ka qëllim të vërtetojë drejtësinë e dëshmitarëve të tij, ose personi kundër të cilit është ngritur ankesa ka qëllim të atakojë dëshmitarët, është detyrim që rekomandimi që vërteton drejtësinë dhe ankesa, të jenë të fshehtë.

Sikur kundërshtari të vërtetojë se të dy dëshmitarët janë burra të drejtë, por pretendon se ata të dy gabojnë, në këtë gjendje, a pranohet dëshmia e këtyre dy dëshmitarëve, krahas supozimit që gjykatësi s'ka dijeni për gjendjen e dy dëshmitarëve?

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Mospranimi është më i fuqishëm, sepse miratimi i kundërshtarit për të gjykuar kundër tij me dëshminë e atyre të dyve, nuk sjell asnjë dobi në vlefshmërinë e gjykimit, ashtu siç nuk sjell asnjë dobi miratimi i tij me dëshminë e dy dëshmitarëve mëkatarë."

Fjala e këtij autori përputhet plotësisht me ligjet moderne, në të cilat thuhet: "Kur të dyja palët bien dakord për dëshminë e një dëshmitari të caktuar, gjykatësi nuk detyrohet të punojë sipas konsensusit të arritur mes dy palëve në konflikt, sepse është krejtësisht e pavlefshme që të dyja palët të bien dakord në lidhje



me një rrugë vërtetimi, e cila e kushtëzon gjykatësin të mos ndjekë rrugën e shprehur tekstualisht në ligjin përkatës.”

Pasi gjykatësi është siguruar se të gjithë kushtet e argumentit janë pa asnjë ndalues, i thotë personit kundër të cilit është ngritur ankesa: “Pretendon se ata të dy, me dëshminë e tyre, shpifin kundër teje?” Nëse ka diçka, gjykatësi e dëgjon dhe pastaj punon sipas kërkesës së origjinave.

Kush mendon pak në atë që ne thamë më sipër, do të gjejë se fik’hu xhaferij, në lidhje me bazat e gjykimeve dhe ngritjes së ankesave, në disa çështje, përputhet me ligjet moderne, si tekst e si frymë dhe në disa çështje të tjera, ai përputhet si frymë e si tekst.

Në këtë gjendje, gjykatësi ka të drejtë t’i bëjë dëshmitarit pyetjet që ai mendon se duhen bërë, madje gjykatësi ka të drejtë të vërë në pozitë të vështirë dëshmitarin, kur dyshon te vetë dëshmitari e te dëshmia e tij dhe, pasi gjyqtari sigurohet, pyet kundërshtarin se ç’do të thotë në lidhje me dëshmitarin dhe, ashtu siç thamë, rekomandimi që vërteton drejtësinë e dëshmitarit dhe atakimi i tij, bëhen në fshehtësi dhe jo hapur.

Ligji e ka lënë vlerësimin e dëshmisë në dorën e gjykatësit. Gjithashtu, ligji e detyron gjykatësin të mbështetet në dëshminë e njeriut të drejtë, në të njëjtën kohë ligji ka lënë në dorën e gjykatësit të drejtën për të përzgjedhur rrugën që ai mendon se duhet të ndiqet për të mësuar drejtësinë e dëshmitarit, apo që dëshmitari është njeri korrekt, apo për të mësuar kushtet e tjera që kërkohen për dëshmitarin. Kjo çështje, në të vërtetën e saj, i referohet rregullit: “Vlerësimi i dëshmisë së dëshmitarit lihet në dorën e gjykatësit, qoftë edhe vetëm nga disa anë.”

## **Ankesa e ndërsjellë dhe mbizotërimi i argumentit**

Më sipër kemi trajtuar se ankesa mund të ndodhë mes ankuesit dhe personit që e mohon ankesën, por mund të ndodhë që ankuesi dhe personi kundër të cilit ngrihet ankesa të pretendojnë të dy të njëjtin send, domethënë se çdonjëri prej dy kundërshtarëve, në të njëjtën kohë, mund të konsiderohet edhe pretendues, edhe mohues.

Në lidhje me këtë çështje, në disa faqe më sipër kemi përmendur jo pak shembuj, por këtu do të përmendim edhe dy shembuj të tjerë, me qëllim që të japim shpjegim më shumë, si dhe për faktin se fukahatë kanë treguar një kujdes të veçantë ndaj këtyre shembujve dhe kanë folur gjerë e gjatë për këto shembuj:

1- Të dy pretenduesit kanë konflikt për një send, për të cilin asnjëri prej atyre të dyve s'ka dorë mbi sendin objekt i konfliktit, si për shembull, një monedhë metalike, ose një thikë që është gjendur në një vend dhe këtë objekt e kanë parë të dy njëherësh, prandaj çdo njëri prej atyre të dyve thotë: "Monedha, ose thika më takon mua." dhe mohon që t'i takojnë tjetrit, domethënë ai pretendon pronësinë e tij personale mbi atë send dhe mohon që sendi të jetë pronë e shokut të tij.

Kur çështja ngrihet te gjykatësi, ai shikon: Nëse të dy ose vetëm njëri s'ka argument, i vë të dy të betohen. Nëse betohet vetëm njëri prej dy pretenduesve, kurse tjetri nuk pranon të betohet, në këtë gjendje, sendi i takon atij që u betua. Nëse betohen të dy, atëherë të dy janë të barabartë.

Nëse njeri prej atyre të dyve ka argument dhe tjetri s'ka argument, sendi i takon atij që ka argumentin. Në qoftë se të dy

sjellin argument, animi do të jetë me drejtësi dhe sipas numrit, përparësi do të ketë argumenti që ka dëshmitarët më të drejtë. Nëse të dy argumentet janë të barabarta nga ana e drejtësisë, atëherë merr përparësi argumenti që ka më shumë dëshmitarë.

Nëse të dy argumentet janë të barabarta si drejtësi dhe si numër, atëherë gjykatësi hedh short mes dy pretenduesve, atij që i del emri në short, betohet dhe gjykatësi vendos që sendi t'i jepet atij. Në qoftë se atij që i bie shorti, nuk betohet, atëherë betohet tjetri dhe gjykohet që sendi t'i jepet atij që u betua. Në qoftë se të dy e kanë argumentin të barabartë dhe asnjëri prej atyre të dyve nuk pranon të betohet, atëherë sendi ndahet në dy gjysma të barabarta dhe çdo njëri prej tyre merr nga një gjysmë të sendit objekt i konfliktit.

2- Të dy kanë konflikt për një send, të cilin të dy e kanë në dorë, si për shembull, të dy banojnë në një shtëpi. Pastaj secili prej tyre pretendon se shtëpia është e gjitha pronë e tij. Nëse njëri prej tyre, ka argument dhe tjetri s'ka argument, shtëpia i jepet atij që ka argument. Nëse të dy kanë argument, shtëpia pjesëtohet mes tyre, madje edhe kur njëri prej dy argumenteve është më i fuqishëm si drejtësi dhe më i madh si numër, në rastin e shtëpisë, predominimi i argumentit të njërit mbi argumentin e tjetrit nuk është veprues ashtu siç ishte veprues në çështjen e mësipërme.

Sekreti për mosdominin qëndron në faktin se, në çështjen e mësipërme, supozohej që asnjë prej tyre nuk kishte në dorë sendin, domethënë se, në këtë rast, kemi përplasje mes dy argumenteve, sepse secili prej dy argumenteve ka dalë i bazuar mbi sendin. Prandaj në çështjen e mësipërme, dominimi i njërit argument mbi argumentin e tjetrit, sipas fortësisë dhe numrit,

bëhet veprim i detyrueshëm, kurse në këtë çështje, për të cilën supozohet se secili prej dy pretenduesve ka dorë në gjysmën e shtëpisë dhe në të njëjtën kohë ka edhe argument.

Gjithashtu, supozohet se argumenti i çdo përdoruesi të shtëpisë vërteton pronësinë vetëm mbi gjysmën që ai konkretisht ka në dorë dhe nuk vërteton pronësinë e tij mbi gjysmën tjetër të shtëpisë, prandaj rezultati del: Mungesë kundërshtimi mes dy argumenteve dhe, kur s'ka kundërshtim, nuk mbetet më vend për dominimin e argumentit të njërit mbi argumentin e tjetrit.

Kjo është ajo që ne kemi kuptuar prej fjalës së autorit të librit "Esh Sheràiu", i cili thotë: "Dora e secilit prej tyre mbi gjysmën dhe tjetri sjell argument. Në këtë gjendje, për atë gjykohet me atë që ka në dorë shoqëruesi i tij."

Me komentimin e kësaj fjale, nuk lind nevoja për të zbatuar procesin e dominimit të njërit argument mbi argumentin tjetër, bazuar mbi fortësinë dhe numrin.

Në lidhje me këtë çështje, në librin "El-Xhevahir", në kapitullin "Gjykimi", thuhet: "Gjykohet mes tyre, me ndarjen në dy gjysma, pa short dhe pa shikuar dominimin e njërit argument mbi argumentin tjetër, nga pikëpamja e fortësisë së drejtësisë, ose e numrit më të madh. Unë këtë e gjej pa asnjë kundërshtim të fukahatë e mëvonshëm."

Në qoftë se të dy pretenduesit s'kanë argument, ose ka argument vetëm njëri pretendues, betohen të dy dhe shtëpia ndahet në mënyrë të barabartë mes tyre. Në qoftë se njëri prej atyre të dyve nuk pranon të betohet dhe betohet tjetri, atëherë shtëpia i jepet atij që betohet, me kusht që ai të betohet se e gjithë

shtëpia i takon vetëm atij dhe shoku i tij s'ka asnjë të drejtë mbi atë shtëpi." ("El Xhevahir", "El Mesalik")

### ***Kontradikta mes dy argumenteve***

Kontradikta mes dy argumenteve ndodh vetëm nëse puna me njërin prej dy argumenteve kërkon përgënjeshttrimin e argumentit tjetër, në atë mënyrë që të dy argumentet, në asnjë gjendje, nuk mund të jenë së bashku, si për shembull, kur njëra prej dy grave dëshmon se filani i ka shitur shtëpinë e tij Zejdit mëngjesin e filan dite, kurse gruaja tjetër dëshmon se shitja është bërë për Amrin në të njëjtën kohë; ose gruaja e parë thotë se ky është djali i Khalidit, kurse gruaja e dytë thotë se ai është djali i Khalilit. Kur gruaja e parë dëshmon se shitja është kryer dje, kurse gruaja e dytë thotë që shitja është bërë sot, këtu nuk kemi kontradiktë, prandaj merret në konsideratë shitja e bërë më përpara dhe lihet pas dore shitja e bërë më pas, sepse shitja që erdhi më pas nuk ka ndodhur për pronën, pasi ka vetëm një pronë.

I ngjashëm me këtë shembull është edhe rasti sikur njëra prej atyre dy grave të dëshmojë shitjen për Ibrahimin, madje përcakton edhe kohën dhe pastaj gruaja tjetër dëshmon që shitja është bërë për Selimin, por ka thënë, pa përmendur ndonjë kusht dhe pa përcaktuar një kohë të veçantë në lidhje me shitjen, në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e gruas së parë, e cila bëri një përcaktim dhe lihet pas dore fjala e gruas së dytë, e cila e tha fjalën në përgjithësi, për faktin se ka mundësi që shitja për Selimin të jetë

arritur më vonë se shitja e bërë për Ibrahimin, prandaj fjala e kësaj gruaje për shitjen s'ka asnjë ndikim.

Kur ndërmjet dy argumenteve vërtetohet kontradiktë dhe është e pamundur që dy argumentet të bashkohen mes tyre, qoftë edhe në një rën prej anëve me të cilën ne zhvilluam procesin e predominimit të argumentit të njërit mbi argumentin e tjetrit vetëm nga pikëpamja e drejtësisë dhe numrit, i japim përparësi argumentit, dëshmitë e të cilit i gjejmë më të drejta e më të besueshme se të argumentit tjetër.

Në qoftë se të dy argumentet, janë të barabarta si nga ana e drejtësisë, ashtu edhe nga pikëpamja e besueshmërisë, atëherë i japim përparësi argumentit që ka më shumë dëshmi. Nëse janë të barabartë edhe nga pikëpamja e drejtësisë dhe e numrit, atëherë mes dy kundërshtarëve hidhet short dhe atij që i del emri, betohet dhe gjykohet në favor të tij. Nëse ai nuk e shikon të arsyeshme të betohet, atëherë sendi objekt konflikti ndahet në dy pjesë të barabarta dhe secili merr gjysmën e sendit.

Konfliktualiteti vërtetohet mes dy dëshmitarëve e të ngjashmëve me ta; ose konfliktualiteti mes një dëshmitari burrë e dy dëshmitareve gra e të ngjashme me to. Por në asnjë gjendje nuk mund të vërtetohet konfliktualiteti mes një dëshmitari dhe betimit, ose dy dëshmitarëve e betimit, ose një dëshmitari burrë e dy dëshmitareve gra dhe betimit, sepse dëshmitari e betimi, për asnjërin, nuk vërtetohet emri argument, që të ketë mundësi të ndodhë konfliktualiteti, çka është e kundërta e dy dëshmitarëve, ose e një dëshmitari dhe dy dëshmitareve, pasi secili prej tyre është një argument i plotë dhe konfliktualiteti mes tyre vërtetohet. ("El Xhevahir", El Mesalik").

## **Argumenti dhe dora**

Kur sendi është në dorën e një personi dhe më pas sendin e pretendon një tjetër, nëse ky tjetri ka argument, gjykohet në favor të atij që ka argumentin. Nëse ai tjetri s'ka argument, betohet personi që ka sendin dhe ankesa nuk pranohet. Personi që e ka sendin, mendon se nuk duhet të betohet, atëherë sendi i takon ankuesit, pasi ai të betohet. Nëse ankuesi nuk betohet, atëherë ankesa rrëzohet.

Kur secili prej tyre sjell argument, në lidhje me këtë çështje, fukahatë imami janë shprehur me thënie të ndryshme dhe kanë dhënë sqarime të shumta, por ne do të përmendim vetëm katër prej këtyre thënieve:

*E para:* Dhënia përparësi argumentit të atij që është jashtë, domethënë ankuesit, ndaj argumentit të atij që është brenda, domethënë atij që e ka sendin në dorë.

*E dyta:* Është e kundërta e të parës, domethënë i jepet përparësi argumentit të atij që është brenda ndaj argumentit të atij që është jashtë.

*E treta:* Referim në procesin e predominimit të argumentit të njërit mbi argumentin e tjetrit, nga pikëpamja e drejtësisë dhe e shumicës.

*E katërta:* Praktikimi i shortit, duke i dhënë përparësi argumentit të atij që i del emri.

Autori i librit "El Mustened", pasi citon thëniet dhe argumentet për secilën thënie, ka preferuar thënien e parë, domethënë se, në përgjithësi, ai i jep përparësi argumentit të atij

që është jashtë. Madje këtë thënie ai ia atribuon dijetarëve më të mëdhenj të mëparshëm dhe të tjerëve, duke thënë se argumenti është detyrim për ankuesin dhe betimi kërkohet prej mohuesit dhe këtu pretendues rezulton personi që është jashtë, kurse mohues është personi që e ka sendin në dorë. Atëherë, bazuar mbi thënien e parë, argumenti i të jashtmit, kur ai e sjell argumentin, pranohet, sepse, si origjinë, argumenti kërkohet prej tij dhe nuk pranohet argumenti prej tjetrit, sepse, si origjinë, ai argument nuk kërkohet.

Në librin “El Xheuahir” thuhet se në mesin e dijetarëve imami ka përhapje shumë të madhe thënia “Argumenti i të jashtmit ka përparësi ndaj argumentit të atij që ka sendin në dorë.”

Të dy argumentet dëshmojnë pronësinë në përgjithësi, domethënë pa e bërë të qartë shkakun e pronësisë, me kushtin që të dy argumentet janë të barabarta, nga pikëpamja e drejtësisë dhe si numër dëshmish.

Padyshim që animi i shumicës së dijetarëve kah kjo thënie i jep përparësi argumentit të atij që është jashtë ndaj argumentit të atij që është brenda.

Edhe dijetarët e shkollës juridike malikij ndajnë të njëjtin mendim me imamin në lidhje me predominimin e njërit argument mbi argumentin tjetër, kur të dy argumentet janë të barabarta nga pikëpamja e drejtësisë dhe e numrit.

Ndjekësit e shkollës juridike hanefij, shafij dhe hanbelij, e mohojnë tërësisht predominimin e njërit argument mbi argumentin tjetër, sepse predominimi i njërit argument mbi argumentin tjetër te ata,



s'ka asnjë ndikim, kur të dy argumentet janë të barabarta nga pikëpamja e drejtësisë dhe e numrit të dëshmimeve, janë shprehur për rrëzimin e dy argumenteve, në mënyrë absolute. Gjendja mbetet sikur ata të dy të mos kishin asnjëherë argument.

## **Çështje**

### **1- Gjykimi me dëshmi fals**

Në librin “Fet’hul Kadijr”, në vëllimin 2, në kapitullin “Martesa”, në faqen 389 dhe në vëllimin. 5, në kapitullin “Gjykimi”, në faqen 492, si dhe në librin “El Furuk”, në vëllimin 4, në faqen 41, botim i vitit 1346H, në Dallimin 223, thuhet: “Kur dy dëshmitarë bëjnë dëshmi fals në prani të gjykatësit, në lidhje me divorcin e një gruaje dhe gjykatësi, në bazë të dëshmisë së dy dëshmitarëve, vendos për divorcimin e saj, të dy dëshmitarët lejohen të martohen me atë grua, edhe pse secili ka dijeni për dëshminë fals që bëri, sepse vendimi i gjykatësit është prishës i martesës së gruas.

E njëjta gjë është edhe kur të dy dëshmojnë te gjykatësi në lidhje me shitjen e një robëreshe dhe gjykatësi, në bazë të dëshmisë së tyre, gjykon që shitja është kryer. Në këtë gjendje, në bazë të këtij argumenti, personi për të cilin gjykatësi gjykoi në favor të tij, ka të drejtë të blejë robëreshën dhe të kryejë marrëdhënie intime me të, edhe pse e di mirë që bëri dëshmi fals, sepse vendimi i gjykatësit zbrit në pozitën e shitjes për personin për të cilin ai vendosi në favor të tij.”

Kjo ishte fjala e autorit të librit “El Furùk”. Në të njëjtin kuptim është fjala që thuhet në librin “FET’hul Kadijr”.

Imamitë kanë thënë se vendimi i gjykatësit nuk bën hallall haramin dhe nuk bën haram hallallin, pasi vendimi i gjykatësit, në të vërtetë, jepet për të përkrahur hallallin dhe jo haramin, sepse vendimi i gjykatësit është një mjet për të vërtetuar të drejtën e për të bërë pa vlerë të gabuarën, prandaj ai që ka dijeni se ajo punë është e kundërta e të drejtës dhe e realitetit, atij nuk i lejohet të punojë me atë punë dhe, kur gjykatësi vendos kundër personit të gjykuar, ai shkon te një gjykatës tjetër, te i cili ngre ankesën kundër gjykatësit të parë se ai ka gjykuar kundër tij me rrugë mëkati e me ryshfet, duke i vërtetuar të dytit se gjykatësi nuk u thellua të studiojë çështjen dhe gjykatësi, me vendimin e tij, kundërshtoi një argument të formës së prerë të ligjit të fesë. Gjykatësi i dytë e ka detyrim të atakojë vendimin e parë dhe ta prishë atë vendim.

Disa fukahave imami kanë thënë se nuk duhet të dëgjohej ankesa kundër gjykatësit, sepse ankesa është poshtërim për postin e gjykatësit. Autori i librit “El Mustened” u përgjigjet atyre fukahave: “S’ka asnjë problem, nëse gjykatësi poshtërohet, madje ai duhet të poshtërohet, pasi në poshtërimin e tij ka lartësim të Islamit, vetëkuptohet, nëse me të vërtetë ai është prej atyre gjykatësve që duhet të poshtërohet.

Fjala e fukahave imami përrputhet me hadithin e nderuar: “Ju vini te unë të zgjidhni grindjet që keni mes jush, mbase disa prej jush janë më të mprehtë në paraqitjen e argumentit se disa të tjerë dhe unë gjykoj sipas asaj që dëgjoj prej atij. Por nëse unë kam shkëputur një pjesë prej të drejtës së vëllait të tij, ai le të mos e

marrë, sepse, në të vërtetë, unë i kam shkëputur atij një pjesë prej zjarrit.”

Kur as gjykimi i zotërisë së profetëve nuk e ndryshon realitetin, si do ta ndryshojë realitetin gjykimi i njerëzve të tjerë?

Sa larg është thënia e hanefive dhe thënia e atij grupi fukahash të imamive që janë shprehur: “Burri vendos të divorcojë gruan e tij në prani të dy burrave, për të cilët ai beson që janë njerëz të drejtë. Por, në vetvete, ata të dy nuk janë burra të drejtë, prandaj asnjërit prej tyre nuk i lejohet të martohet me atë grua, pasi ajo të përfundojë kohën e pritjes ligjore.”

## **2- Tërheqja prej dëshmisë**

Më sipër thamë se, kur bëhet e qartë që të dy dëshmitarët kanë dhënë dëshmi fals, vendimi i gjykatësit atakohet edhe pas zbatimit të vendimit, për shkak se u mësua që vendimi ishte në kundërshtim me realitetin. Kur të dy dëshmitarët tërhiqen prej dëshmisë, atëherë shikohet: Nëse të dy dëshmitarët tërhiqen para gjykimit, gjykatësi heq dorë prej gjykimit dhe, nëse të dy dëshmitarët tërhiqen prej dëshmisë së tyre, pasi gjykimi është bërë, gjykimi nuk atakohet, edhe kur nuk është zbatuar, sepse tërheqja e dëshmitarëve prej dëshmisë, në vetvete, përmban të vërtetën dhe rrenën.

Bazuar mbi këtë rregull, kur të dy dëshmitarët dëshmojnë se filani e ka divorcuar gruan e tij dhe gjykatësi merr vendim për divorcin, por më pas bëhet e qartë falsiteti i dëshmisë së dy dëshmitarëve, në këtë gjendje, marrëdhënia bashkëshortore

mbetet ashtu siç ishte para dëshmisë. Kur të dy dëshmitarët tërhiqen prej dëshmisë së tyre, pa asnjë komplikim, gruaja nuk kthehet te burri i saj, ashtu siç është shprehur autori i librit “El Xheuahir”, kurse autori i librit “El Mesalik” këtë thënie e atashon te fukahatë imami më të dëgjuar.

Më pas shikohet: Nëse burri ka kryer marrëdhënie intime me gruan, të dy dëshmitarët nuk i garantojnë burrit asgjë prej shumës së kurorës, sepse ai ka përfituar dhe ka përjetuar kënaqësinë e jetës me atë grua, por, nëse burri s’ka kryer marrëdhënie intime me gruan, të dy dëshmitarët i garantojnë atij gjysmën e shumës së kurorës, sepse burri, megjithëse e ka paguar shumën e kurorës, s’ka pasur asnjë përfitim prej martesës.

Autori i librit “El Xheuahir”, pasi e ka përmendur këtë çështje, ka thënë: “Te unë kjo është fjala më e fuqishme.”

Po kështu janë shprehur edhe hanefitë, në librin Fet’hul-Kadijr”. Në kapitullin “Dëshmitë”, thuhet: “Kur njëri prej dëshmitarëve tërhiqet prej dëshmisë dhe nuk tërhiqet dëshmitari tjetër, dëshmitari që e tërheq dëshminë, i paguan burrit të gruas gjysmën e asaj shume që ai ka paguar, kurse ai që i mbetet dëshmisë së tij, nuk paguan asgjë. Kur dëshmon një burrë e dy gra dhe njëra prej tyre tërhiqet prej dëshmisë, ajo ka detyrim të paguajë një të katërtën e shumës që ka paguar burri.”

Dy burra të drejtë rekomandojnë për dëshmitarë dy burra që ata i konsiderojnë të drejtë dhe këta dy burra të rekomanduar dëshmojnë para gjykatësit, por ata të dy nuk kanë dijeni për gjendjen dhe pas gjykimit e zbatimit të vendimit, dy rekomanduesit e drejtë tërhiqen prej rekomandimit dhe burrat

thonë: “I menduam për burra të drejtë. Më pas u bë e qartë e kundërta dhe rezultoi se ata të dy janë mëkatarë në dëshminë e tyre.”

Nëse puna qëndron kështu siç u shtrua, dy rekomanduesit garantojnë plotësisht ashtu siç garantojnë dy dëshmitarët që bëjnë dëshmi fals. (“El Xheuàhir”)

### **3- Në kontrata**

Një shtëpi është në dorën e pronarit të saj dhe një person tjetër pretendon se atë shtëpi ai e ka blerë prej pronarit dhe i ka pagur atij çmim të plotë. Pronari i shtëpisë mohon shitjen dhe marrjen e çmimit. Më pas vjen një i dytë dhe paraqet të njëjtin pretendim si i pari, domethënë se edhe ky i dyti e ka blerë shtëpinë dhe i ka paguar pronarit edhe çmimin, por pronari i shtëpisë e mohon pretendimin e këtij të dytit, ashtu siç mohoi pretendimin e të parit.

Nëse secili argument përmend datën e shitjes, e cila përmendet disa herë, shitja e parë mbetet e vlefshme dhe prishet shitja e bërë më vonë. Nëse data është e njëjtë, ose të dy argumentet janë pa datë dhe nuk e kanë përmendur datën asnjëherë, në këtë gjendje, bëhet e detyrueshme të ndiqet procesi i predominimit të njërit argument mbi argumentin tjetër, për shkak se pasuria është vetëm një dhe nuk mund të jetë pronë e plotë e dy personave. Në këtë gjendje, merr përparësi argumenti më i fuqishëm nga pikëpamja e drejtësisë dhe e besueshmërisë. Në rast se të dy argumentet janë të barabarta nga ana e drejtësisë, merr përparësi argumenti që ka më shumë dëshmi dhe, nëse janë të

barabartë nga ana e drejtësisë dhe e numrit të dëshmimeve, atëherë praktikohet hedhja e shortit mes dy pretenduesve.

Me sipër shpjeguan se malikitë (ndjekësit e shkollës juridike islame të imam Malikut) përputhen me imametë, në lidhje me predominim e argumentit të njërit pretendues mbi argumentin e pretenduesit tjetër, por malikitë nuk janë shprehur për hedhjen e shortit, ashtu siç veprohet te imametë, kurse hanefitë, shafitë dhe hanbelitë (ndjekësit e shkollave islame të imamet Ebu Hanife, të Imam Shafijit e të Imam Hanbelit) janë shprehur në mënyrë të prerë për rrëzimin e dy argumenteve, edhe në rastin kur njëri prej dy argumenteve tregon më shumë drejtësi dhe ka numër më të madh dëshmish.

Kjo ishte në analogji me dy pretenduesit, kurse në analogji me pronarin e shtëpisë, është e mundur bashkimi mes dy argumenteve, pasi është prej veprimeve të mundshme, që ai ta ketë shitur shtëpinë dy herë dhe ka marrë në dorë çmimin e shtëpisë prej dy pretenduesve, prandaj ai ka detyrim t'i kthejë çmimin pretenduesit që nuk pranohet sipas argumentit të tij, ose i kthen një send të barasvlershëm me çmimin. Për rrjedhojë, rezultati do të mbështetet mbi vlerësimin e falsitetit të dy argumenteve, pasi, në realitet, ai humb jo vetëm shtëpinë, por edhe ndonjë send të barasvlershëm me çmimin e shtëpisë, kurse, mbështetur mbi përgënjeshtimin e njërit prej argumenteve dhe miratimin e argumentit tjetër, ai humb vetëm shtëpinë. Nëse të dy argumentet janë të vërteta, s'kemi as person që ka bërë padrejtësi e as person të cilit i është bërë padrejtësi.

Ky është problemi i gjykimit, i cili mbështetet në argumente e në diskutim dhe jo në njohjen e të panjohurës, as edhe në rrugët

shkencore të prekshme, që atakojnë realitetin, qoftë edhe nëntëdhjetë për qind, por mbështetet në atë që ka thënë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*):  
 "...Mbase ndonjëri prej jush e parashtron më mirë argumentin e tij..."

Mirëpo humbja e të drejtës së atij që i takon, nuk është punë e lehtë. Pikërisht për këtë njofton edhe hadithi i nderuar: "Ai që është bërë gjykatës, në të vërtetë, ther pa thikë. Gjykatësit janë tri kategori: dy gjykatës janë në zjarr dhe një gjykatës në Xhenet. Gjykatësi tjetër është mbi tehun e urës së ndehur mbi Xhehenemin..."

Falënderimi e mirënjohja me e thellë i takojnë vetëm Allahut, që më shpëtoi mua prej këtij tehu, pasi u vura në provë me atë.

#### **4- Kontradikta në dëshmi**

Ashtu siç ishte kusht përputhja mes dëshmisë dhe ankesës, po kështu është kusht që edhe dy dëshmitarët të dëshmojnë të njëjtën gjë, duke theksuar se ndryshimi në fjalë nuk e dëmton dëshminë, si për shembull, njëri prej dy dëshmitarëve dëshmon se ka kërkuar borxh njëqind për t'i shlyer brenda muajit, kurse tjetri dëshmon se ai e ka marrë shumën e lartpërmendur prej tij, me kusht që t'ia shlyejë pas një muaji. Kur dëshmitë e tyre ndryshojnë në kuptim, si për shembull, kur i pari dëshmon se ai e ka marrë borxhin dhe i dyti, me dëshminë e tij, e pohon borxhin, në këtë gjendje, borxhi nuk vërtetohet, për shkak të mosvërtetimit të njërit prej dëshmitarëve okularë, sepse borxhi nuk është pohim dhe

argumenti nuk plotësohet për të dy, madje as për njërin prej atyre të dyve.

Në këtë gjendje, argumenti anulohet. Vetëkuptohet se, kur ankuesi betohet së bashku me njërin prej dëshmitarëve, vendoset në favor të atij që betohet, pasi për të drejtat pasurore gjykohet edhe vetëm me një dëshmitar e me betim.

Veç kësaj, kemi edhe fjalët që kanë thënë autorët e librave “Esh Sheràiu”, El Xheuahir”, “El Mesaik” dhe fukaha të tjerë imami, fjalë të cilat më parë unë nuk i miratoja, pasi mendoja se puna duhej lënë në vlerësimin e gjykatësit dhe në hulumtimin e tij. Por më pas hoqa dorë prej mendimit të parë, kur konstatova se e drejta qëndronte nga ana e fukahave dhe u binda që gjykatësi, në asnjë gjendje, nuk është e mundur të konsiderojë një dëshmi të këtillë argument të plotë, sepse pohimi, edhe nëse është zbatuar në favor të pohuesit, s’ka asnjë lidhje mes pohimit për ekzistencën e borxhit dhe mes ekzistencës së borxhit realisht, pasi është e mundshme që njeriu të pohojë jo ashtu siç është realiteti për shkak se ashtu e kërkojnë interesat e tij të veçanta dhe, kur pohimi si pohim nuk është vetë borxhi e as që ka lidhje me borxhin real, rezulton e vlefshme fjala që kanë thënë fukahatë në lidhje me mospërputhjen e fjalës së dy dëshmitarëve për të njëjtin send dhe as për dy sende që realisht kanë lidhje me njëri-tjetrin.

Kështu janë shprehur shafitë dhe hanefitë (libri “Fet’hul Kadijr”). Autori hanbeli, i librit “El Mugnij”, ka thënë: “Kur njëri prej atyre të dyve dëshmon me punë dhe tjetri dëshmon me pohim, dëshmia plotësohet dhe punohet sipas kësaj dëshmie.”



Sikur njëri prej tyre të pohojë një dinar dhe tjetri pohon një dirhem, ose dëshmon për një rrobë të bardhë dhe tjetri dëshmon për një rrobë të zezë, ose njëri prej dëshmitarëve pohon që e ka shitur shtëpinë në mëngjes për një mijë, kurse tjetri pohon se e ka shitur në të njëjtën kohë për dy mijë, ose njëri dëshmitar pohon se ai e ka shitur shtëpinë natën, kurse tjetri pohon se e ka shitur ditën, ose njëri dëshmitar e ka shitur në treg, kurse tjetri dëshmon se e ka shitur në shtëpi, në qoftë se në dëshmi ka ndonjë send prej këtij lloji, dëshmia nuk plotësohet dhe nuk lejohet të punohet me këtë dëshmi dhe ankuesi ka të drejtë të betohet së bashku me dëshmitarin, dëshmia e të cilit përputhet me ankesën e tij. Gjykimi bëhet në favor të tij, pasi ai të betohet.

Me një fjalë, argumenti nuk plotësohet, përveçse kur të dy dëshmitarët dëshmojnë për të njëjtën punë, për të njëjtën kohë, për të njëjtin vend dhe për të njëjtën cilësi. Prej jetëshkrimit të gjykatëseve të ligjit të fesë dhe gjykatësve civilë të kohëve të vjetra e të kohëve të reja mësohet se kontradikta në fjalët e dëshmitarëve është rrëzuese e dëshmisë.

Kur dëshmitari nuk shpjegon qartë kohën, vendin e të tjera elemente të dëshmisë, gjykatësi ka të drejtë t'i drejtojë dëshmitarit aq pyetje sa të dëshirojë dhe patjetër pyetjet e tij kanë lidhje me objektin e ankesës, sidomos kur këtë gjë e kërkon prej gjykatësit personi kundër të cilit bëhet ankesa.

Sikur njëri prej dy dëshmitarëve të dëshmojë për një mijë dhe dëshmitari tjetër dëshmon për dy mijë, dëshmia për një mijë vërtetohet me dy dëshmitarët, kurse mijëshi i dytë vërtetohet vetëm me një dëshmitar dhe me betim, sepse mijëshi i parë, në të

gjitha gjendjet, është i njohur, kurse për mijëshin e dytë ka dëshmuar vetëm njëri prej dy dëshmitarëve. (libri “El Xheuahir”)

Ebu Hanife (themeluesi i shkollës juridike islame hanefi) ka thënë se nuk vërtetohet asgjë dhe te ai vërtetohet një mijëshe, kur njëri prej dy dëshmitarëve dëshmon një mijë dhe dëshmitari tjetër dëshmon për një mijë e pesëqind. Sekretet këtu qëndron në vënien në konsideratë të përputhjes së dëshmitarëve në fjalë e në kuptim. Por kur dy dëshmi përputhen si kuptim dhe nuk përputhen si fjalë, dëshmia nuk pranohet. Në këtë gjendje, fjala për një mijë mund të ekzistojë me dëshminë e të dyve në shembullin e dytë, pasi aty kemi përputhje në fjalë e në kuptim, për rrjedhojë, dëshmia pranohet. Por në shembullin e parë, fjala “një mijë” gjendet vetëm në dëshminë e njërit prej dy dëshmitarëve, për rrjedhojë kemi ndryshim në fjalët e dy dëshmitarëve në lidhje me njëmijëshen. Në këtë gjendje, ankesa rrëzohet, derisa të dy dëshmitarët të bien dakord për njëmijë edhe si kuptim dhe kështu një mijëshi mbetet i njohur në të gjitha gjendjet.

### ***5- Dëshmia jo në procedurë gjyqësore***

Kur para teje dëshmojnë dy burra të drejtë se gruaja, me të cilën je martuar, është motra jote prej qumështit, ose ti ke marrë borxh një shumë të caktuar prej filanit dhe pastaj ke harruar, ose ti ke detyrim të agjërosësh kaza disa ditë prej muajit të Ramazanit, ose ti ke taksur, ose je betuar, ose ky është mëkatar, ose është burrë i drejtë, ose ata dëshmojnë para teje që filani është studiues, ose ai tjetri është injorant, apo ata të dy dëshmojnë para të tjerëve punë të tjera, vallë a është detyrim për ty të rendisësh efektet e punës,

bazuar mbi dëshmitë e atyre të dyve, edhe nëse me atë dëshmi nuk gjykon gjykatësi, por gjendet një palë e dytë që kundërshton e është në konflikt?

S'ka as dyshim e as kundërshtim se, kur ti arrin të mësosh e të jesh i bindur për ato që të thuhën, është detyrim për ty të rendisësh efektet, edhe nëse dëshmitarët që dëshmuan te ti nuk janë burra të drejtë, madje e ke detyrim renditjen e efekteve të atyre veprimeve që t'u thanë, edhe nëse ti e mëson këtë vetëm prej dëshmisë së një dëshmitari.

Nëse dëshmojnë dy burra të drejtë dhe prej dëshmisë së atyre të dyve nuk arrihet as të merret dijani e as siguri e plotë, në këtë gjendje, fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, në lidhje me këtë çështje. Shumica e fukahave janë shprehur se mbetet detyrim të veprohet sipas dëshmisë, sepse argumenti është dokument që duhet të ndiqet në subjektet e jashtme dhe nuk ndalohet punimi me atë argument në procedurat gjyqësore dhe gjykatësi gjykon, madje shehu El Hamedànij, në librin "Misbàhul Fakijh", ka thënë: "Në ligjin e fesë islame, kjo është prej punëve aksiomë."

Gjithashtu, në lidhje me këtë çështje, kemi edhe njoftime të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), prej të cilave kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Të gjitha sendet, janë të bazuara mbi këtë, derisa për ty të bëhet e qartë një send tjetër, ose për atë send sillet argument."

Gjithashtu, prej atyre njoftimeve kemi përsëri fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Kur te ti dëshmojnë besimtarët, vërtetoje fjalën e tyre."

Kjo është një thënie përgjithësuese, që shërben jo vetëm në rastin e konflikteve mes palëve, por edhe në raste të tjera. Përsëri prej atyre njoftimeve është edhe fjala tjetër e tij: “I prokuruarari nuk pezullohet, derisa pezullimi t’i vijë atij me dokument, ose vetë prokuresi i thotë gojarisht që je i pezulluar.”

Shejkh El Hamedanij, në fundin e kapitullit “Pastrimi” të librit të lartpërmendur, thotë: “Pranimi i argumentit, në raste konflikti dhe dhënia përparësi e argumentit mbi dorën, tregon pranimin e argumentit me përparësi të prerë jo në raste konflikti, pasi shumica e fukahave janë mjaftuar edhe me fjalën e njërit prej dy dëshmitarëve, kur ajo fjalë është e besueshme...”

## **6- Nuk dihet se cilit besim i përket**

Një burrë vdes dhe nuk dihet se në ç’fe besonte ai në kohën e vdekjes dhe para vdekjes, gjithashtu nuk dihet se ç’fe kishin prindërit e tij. Ky njeri ka lënë dy djem, njëri është mysliman dhe tjetri nuk është mysliman. Djali i tij mysliman thotë: “Babai im vdiq në fenë islame, për rrjedhojë këtij duhet t’i takojë trashëgimia e plotë.”

Djali tjetër thotë se babai i tij nuk vdiq mysliman, në këtë gjendje, trashëgimia ndahet në dy pjesë të barabarta.

Pasi kemi supozuar se nuk kemi dijeni për gjendjen e prindërve të të vdekurit, gjithashtu nuk kemi dijeni as për gjendjen e mëparshme e të mëpasshme të këtij të vdekuri dhe pas këtij supozimi nuk gjejmë ndonjë bazë në ligjin e fesë që të përcaktojë, ose që të tregojë se Islami i të vdekurit qëndron mbi

mohimin e tij, ose mohimi i të vdekurit qëndron mbi Islamin e tij, pasi s'ka argument as prej Librit të Allahut, as prej Sunetit, as me fjalën e përbashkët të fukahave, që të thotë se për cilindo që dyshohet, nëse ai është mysliman, ai njeri është mysliman. Kur ne shprehemi për pastërtinë e tij, në të vërtetë, ne shprehemi vetëm për pastërtinë, sepse për pastërtinë ka vend për dyshim.

Dihet se si origjinë, çdo njeri është njeri i lirë dhe jo se ai është mysliman. E njëjtë me çështjen e mësipërme është edhe kur ne shprehemi për pastërtinë e lëkurës së përdorur, të përpunuar, në tokat e vendeve islame, në këtë rast, ne kemi vënë anën e jashtme mbi origjinën, por ne e kemi thënë këtë fjalë duke punuar me transmetimin e Is'hàk bin Am'màrit, në të cilën tekstualisht thuhet: "S'ka problem të falet namazi mbi një lëkurë të punuar në Jemen dhe në lëkurët që janë punuar në trevat islame, ose shumica e atyre që i kanë punuar janë myslimanë."

Kur nuk gjendet një origjinë që përcakton njëri prej dy anëve, atëherë çështja trajtohet siç trajtohet ankesa e ndërsjellë, në të cilën besohet në çdo mysliman e në çdo jomysliman, ashtu siç e pamë në shembullin e dy djemve të të vdekurit, ku në të njëjtën kohë djali është edhe pretendues edhe mohues. Djali mysliman pretendon se babai i tij ishte mysliman dhe hedh poshtë që babai i tij ishte mohues, kurse djali jomysliman pretendon se babai i tij nuk ishte mysliman dhe mohon Islamin e babait të tij.

Bazuar mbi këtë dëshmi, nëse njëri prej atyre të dyve ka argument dhe tjetri nuk ka, punohet sipas argumentit. Nëse të dy kanë argument, atëherë veprohet me procesin e predominimit mes dy argumenteve, duke i dhënë përparësi argumentit që ka përhapje më të madhe nga pikëpamja e drejtësisë. Kur të dy

argumentet janë të barabarta nga pikëpamja e drejtësisë, atëherë i jepet përparësi argumentit që ka më shumë dëshmi. Kur janë të barabartë nga ana e drejtësisë dhe si numër, atëherë hidhet shorti.

Në qoftë se të dy nuk kanë argument, ose vetëm njëri prej tyre s'ka argument, çështja mes tyre gjykohet me betim dhe, kur myslimani betohet, kurse jomyslimani nuk betohet, e gjithë trashëgimia i takon të parit. Në qoftë se betohet jomyslimani dhe myslimani nuk betohet, në këtë rast, trashëgimia ndahet në dy pjesë të barabarta. Në qoftë se betohen të dy, atëherë tre të katërtat e trashëgimisë i jepen djalit mysliman dhe një e katërta i jepet vëllait të tij jomysliman, sepse gjysma e trashëgimisë, në të gjitha gjendjet, i takon vëllait mysliman. Kjo është e barabartë, qoftë kur i vdekuri është mysliman, qoftë kur ai nuk është mysliman, pasi kundërshtimi qëndron vetëm në gjysmën e trashëgimisë. Bazuar mbi vlerësimin që i vdekuri është mysliman, e gjithë trashëgimia e tij i takon djalit mysliman, kurse bazuar mbi vlerësimin që i vdekuri nuk është mysliman, trashëgimia e këtij të vdekuri ndahet në dy pjesë të barabarta.

Në të gjitha argumentet që janë në dorën time, nuk kam gjetur asnjë fukahë prej imamive që të ketë kundërshtim në lidhje me këtë çështje, mbase edhe mund të ketë ndonjë objeksion që unë nuk kam qëlluar të shikoj në të, pavarësisht nga studimi e gjurmimi i thellë që unë kam bërë. Por ata mund ta kenë kundërshtuar dispozitën, duke u bazuar në dyshimin mbi Islamin e tij, në mënyrë të përgjithshme dhe për këtë ata kanë qenë të vendosur në kundërshtimin e kësaj dispozite, megjithëse s'ka ndonjë shenjë dalluese e as ndonjë origjinë që të përcaktojë, ose të tregojë që Islami është dominues mbi mohimin e atij njeriu, ose mohimi i tij është dominues mbi Islamin e tij.

Autori i librit “El Xheuahir”, në kapitullin “Fëmija i dështuar, i hedhur për tokë”, ka thënë: “Bazat logjike kërkojnë mosgjykimin e fëmijës së dështuar as si mysliman e as si jomysliman, sepse origjina kërkon moslindjen e tij prej jomyslimanit, ashtu siç e kërkon moslindjen e tij prej myslimanit.”

Autori i librit “El Urvetul Vuthkà” ka thënë: “Dispozitat e Islamit nuk zbatohen mbi të panjohurin, përveç pastërtisë.”

Në këtë fjalë atë e mbështet edhe sejjid El Hakijm në librin “El Mustemsek”, si dhe Esejjid El Khujij në librin “Et Tenkijh”.

Me një fjalë, fukahatë imami, të gjithë, ose më të dëgjuarit prej tyre, janë shprehur se origjinë për njeriun është liria dhe jo Islami i tij.

\* \* \*

## DORA

### ***Imamitë dhe dora***

Në lidhje me dorën, imamitë kanë folur në librat e fi'kut dhe në librat e bazave të fik'fut, madje e kanë tjerrë shumë gjatë fjalën rreth "dorës", ashtu siç e kam parë unë të shtrohet në librat e imamive, në krahasim me librat e medh'hebeve (shkollave juridike islame) dhe në librat e ligjeve moderne që unë kam. Në të gjithë këto libra, fukahatë imami kanë folur në lidhje me kuptimin e fjalës "dorë", caktimin e burimeve të fjalës "dorë", argumentit për të marrë "dorën" në konsideratë. Është fjala për argumente që kanë përhapje të gjerë dhe që mund të mbështetesh mbi to. Gjithashtu, kanë folur edhe për kontradiktën mes këtyre argumenteve dhe argumenteve të tjera, kanë folur edhe për shkakun e për garantimin, si pasojë e dorës. Ata kanë folur edhe për argumentet në lidhje me pastrimin dhe pastërtinë e dorës, përfshirë edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me dorën.



## ***Kuptimi i togfjalëshit “vënie dorë”***

Vënie dorë mbi një send do të thotë që personi që e ka sendin në dorën e tij, ka mundësi të veprojë me sendin ashtu siç vepron pronari me pronën e tij, pa asnjë kundërshtues, siç është mbjellja e bimëve apo e pemëve në një tokë, pronë personale, banimi, ndërtimi apo shembja e shtëpisë, hipja mbi kafshën, veshja e rrobës, ose shitja e këtyre sendeve apo dhënia e këtyre sendeve me qira, ose dhurimi apo dhënia hua e atyre sendeve.

Me fjalë të përmbledhura, fukahatë s’kanë ndonjë terminologji të veçantë në lidhje me vënien dorë, pasi, në të vërtetë, fukahatë, në lidhje me vërtetimin e togfjalëshit “vënie dorë”, i referohen traditës dhe, kur kanë kundërshtime mes tyre, në lidhje me një burim që ka të bëjë me vënien dorë, ose edhe me ndonjë çështje tjetër, ata e gjykojnë çështjen mes tyre duke iu referuar traditës.

## ***Argumenti i vënies dorë mbi pronën***

Dy vetë nuk grinden që vënia dorë tregon pronësinë. Sekreti për këtë është rruga e të mençurve dhe veprimi i njerëzve në bazë të kësaj rruge para dhe pas ardhjes së ligjit. Në të vërtetë, ligji pohoi dhe i vuri vulën kësaj rruge veprimi me njoftime të shumta, prej të cilave do të mjaftohemi të përmendim njoftimin e Hafsit, i cili e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) me këto fjalë: “Kur unë shikoj një send në dorën e një burri, a lejohet të dëshmoj se ai send është i tij?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Po.”

Hafsi tha: “Unë dëshmoj që sendi, në të vërtetë, është në dorën e tij dhe nuk dëshmoj që sendi është i tij, pasi sendi mund të jetë i ndonjë tjetri.”

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) i tha: “A është hallall të blihet prej tij?”

Hafsi tha: “Po.”

Imam Sadikun (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Mbase sendi është i ndonjë tjetri, atëherë nga e nxore që ty të lejohet ta blesh atë send prej tij, ta bësh atë send pronën tënde dhe më pas të thuash: ‘Ky send më përket mua.’, madje edhe betohesh për atë send dhe nuk të lejohet të thuash që më parë sendi ishte pronë e atij që e kishte. Sikur kjo të mos ishte e lejuar, myslimanët nuk do të kishin treg.”<sup>1</sup>

Dora e merr fuqinë e saj prej praktikës së traditës dhe nga vënia e vulës nga ana e ligjit mbi këtë praktikë. Urtësia në përdorimin e kësaj praktike dhe e vënies së vulës, nga ana e ligjit mbi praktikën e traditës, qëndron në vetë ndërtimin e jetës shoqërore dhe në vijimësinë e jetës në rrugën e saj natyrale, pa sjellë konfuzion në regjimin.

## **Pasuritë, ndodhitë, përkatësia familjare**

Padyshim që vënia e dorës mbi pasuritë është tregues i pronësisë. Kjo është e barabartë, qoftë kur sendet janë të lëvizshme, qoftë kur janë të palëvizshme. Gjithashtu, vënia e

---

<sup>1</sup> Ai ka përmendur myslimanët. Qëllimi i përdorimit të kësaj fjale është të tregojë të gjithë njerëzit, por ai ka veçuar myslimanët, sepse myslimanët në atë kohë ishin shumica e popullsisë.

dorës tregon pronësinë mbi sendet, njëkohësisht tregon edhe pronësinë mbi dobitë. Një person banon në shtëpinë e Zejdit me argumentin se ai e ka marrë shtëpinë me qira prej tij. Më pas vjen një tjetër dhe i thotë: “Unë jam qiramarrësi dhe jo ti.” Personi i dytë bëhet pretendues, prandaj ka detyrim të sjellë argument, kurse personi që banon në shtëpinë në fjalë, nuk ka detyrim të sjellë vërtetim, sepse dora e tij dëshmon në favorin e tij.

Vetëkuptohe, sikur konflikti të ndodhë mes pronarit dhe banuesit dhe i pari i thotë të dytit: “Ti je duke banuar padrejtësisht e me forcë në pronën time.”, kurse banuesi i thotë: “Jo, unë e kam marrë shtëpinë me qira prej teje.”, banuesi bëhet pretendues, prandaj ka detyrim të bëjë vërtetimin, ndërsa pronari, megjithëse është mohues, nuk mund të ngarkohet të betohet, sepse dora, në të vërtetë, tregon pronësinë mbi dobitë.

Është kështu, kur nuk ka kundërshtim nga ana e pronarit. Por nëse ka kundërshtim, jo, sepse dobitë ndjekin sendin dhe nuk transferohen prej pronarit të sendit, përveçse me justifikues ligjor, siç mund të jetë qiramarrja e huadhënia. Nëse qiramarrësi pretendon se ka një justifikues të tillë, ai ka detyrim të vërtetojë pretendimin e tij.

Kjo ishte në lidhje me sendet e me dobitë, kurse për sa u përket ndodhive e pasurive, si për shembull, kur dy vetë janë në konflikt për një grua, e cila është me njërin prej atyre të dyve, ose në lidhje me atësinë e një fëmijë që është në shtëpinë e një njeri prej dy personave në konflikt, madje fëmija është ndër njerëzit që ai ka në ngarkim, a tregon dora që gruaja është bashkëshorte e atij që e ka këtë grua në shtëpi dhe fëmija është djali i atij te i cili gjendet fëmija, në këtë mënyrë, ai që e ka në dorë është mohues

dhe pala tjetër është pretendues, për rrjedhojë atij i kërkohet të bëjë vërtetimin për pretendimin të tij?

*Përgjigje:* Në të vërtetë, dora nuk tregon pronësi personale, me përjashtim të pasurive, kurse në lidhje me ndodhitë dhe përkatësinë familjare, dora kurrë s'ka ndikim, kur dihet që gruaja, në shembullin që pamë, i takon atij me të cilin ajo është, derisa të vërtetohet e kundërta, por jo dorës, për faktin se u punua me anën e jashtme të gjendjes së myslimanit dhe mbartjen e veprimeve të tij si veprime të vlefshme.

Në lidhje me fëmijën, nëse personi te i cili gjendet fëmija, ka pohuar dhe ka njohur se ai fëmijë është fëmija i tij, para se të vijë një tjetër që do të kundërshtojë njohjen e pohimin e tij në lidhje me fëmijën, ai që e ka fëmijën, ka përparësi që të mbajë fëmijën.

Në qoftë se ai nuk ka pohuar atësinë për fëmijën, në këtë gjendje, të dy personat në konflikt janë të barabartë. Në qoftë se njëri prej atyre të dyve ka argument, gjykohet në favor të personit që ka argumentin. Nëse të dy sjellin argument, atëherë mes atyre të dyve hidhet shorti.

Kështu mund të vazhdonim me shembuj të tjerë, prej të cilëve konstatohet që dora s'ka asnjë ndikim. ("El Xheuahir", El Mesalik", "El Bulgah")

## ***Gjendja e dorës***

Vënia dorë nuk tregon pronësi përveçse me dy kushte themelore:

*Kushti i parë:* Nuk dihet si filloi vënia e dorës mbi sendin, në atë mënyrë që nuk dihet se cili ishte shkaku që ndodhi vënia e dorës, nuk dihet, nëse shkaku ishte shitja, apo dhurimi, apo qiradhënia, apo rrëmbimi. Për shembull, dihet aq ajo shtëpi, në të kaluarën, ishte e Zejdit dhe pas një kohe shikohet që shtëpia është në dorën e Amrit, i cili vepron me shtëpinë siç vepron pronari me pronën e tij. Por ne nuk dimë cili është shkaku që shtëpia kaloi në dorën e Amrit, nuk dimë as si filloi vënia e dorës mbi atë shtëpi.

Në këtë gjendje, vënia e dorës, pa asnjë dyshim, tregon pronësinë dhe nuk zbatohet rregulli i shoqërimit. Kur ne dimë se personi që ka vënë dorën, në të vërtetë e kishte marrë shtëpinë me qira prej pronarit të saj, por pas një kohe ne dyshojmë, nëse shtëpia kaloi apo jo te ai në saje të ndonjë lejuesi ligjor, dora s'ka asnjë ndikim që të tregojë pronësinë mbi sendin, por ne bëjmë shoqërimin e gjendjes së dorës, e cila ishte më parë mbi atë shtëpi.

Bazuar mbi këtë rregull, themi: Kur shtëpia është në dorën e një personi, por një tjetër ka pretendim për shtëpinë dhe pretenduesi thotë: "Kjo është prona ime dhe ia kam dhënë atij me qira para disa vitesh, madje ai nxjerr shkresa që vërtetojnë qiradhënien, ose sjell dëshmitarë për këtë, dora bie si argument që tregon pronësinë, për rrjedhojë, ai që banon në atë shtëpi, s'ka të drejtë të protestojë për këtë, por ai ka detyrim të vërtetojë pronësinë me një rrugë tjetër dhe jo me rrugën e vënies dorë, domethënë, të vërtetojë me anë të asaj rruge që shtëpia ka kaluar te ai në saje të një kaluesi ligjor. Në rastin kur s'ka argument, vënisi i dorës ka detyrim të betohet për të vërtetuar se e ka marrë me qira dhe gjykohet në favorin e tij.

*Kushti i dytë:* Sendi që gjendet në dorë, patjetër duhet të jetë i atillë që nga natyra e tij, pranon transportimin e transferimin, marrjen në pronësi dhe dhënien në pronësi. Nëse sendi nuk i pranon veprimet e mësipërme, siç është vakëfi, i cili nuk pranon pronësinë mbi të, përveçse në gjendje të veçanta, dora rrëzohet si argument që tregon pronësinë. Ne e dimë që ajo arë, në të kaluarën, ka qenë vakëf dhe pas një kohe e shikojmë që ara është në dorën e një personi, i cili vepron me arën dhe ne dyshojmë: A ka kaluar ara te ai me shitje, sepse gjendet një lejues për shitjen e vakëfit, apo jo?

Nëse puna qëndron kështu, nuk lejohet të gjykohet në favor në atij që ka vënë dorën, duke u mbështetur mbi vënien e dorës së tij.

Gjithnjë jemi në këtë shembull: Pronarët e vakëfit janë në konflikt me atë që ka vënë dorën mbi arën që më parë ishte vakëf. Ata thonë: “Kjo arë ishte vakëf dhe vazhdon të jetë vakëf.”

Vënësi i dorës thotë: “Ara është prona ime dhe unë jam ai që veproj.” Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e pronarëve të vakëfit, prandaj vënësi i dorës ka detyrim të sjellë argument që prona ka kaluar te ai në sajë të një transferuesi ligjor, pasi atij nuk i sjell asnjë dobi fakti i vënies dorë.

\* \* \*

## TRADITA DHE PËRHAPJA MË E GJERË

Në faqet e mësipërme pamë se gjykimi bëhet me pohim, me argument e me dëshmitarë për atë që ka argument e dëshmitarë. Disa herë gjykimi bëhet edhe me dorën për atë që e ka sendin në dorë. Këtë kapitull e kemi vënë për të parë çështjet, duke u bazuar te tradita dhe përhapjen më të gjerë, nëse gjykohet me këto të dyja apo jo. Duke vlerësuar se me këto të dyja gjykohet, shtrohet pyetja: Në këto të dyja, domethënë me dorën e me përhapjen më të gjerë, gjykohet në të gjitha gjendjet, apo me këto të dyja gjykohet vetëm në gjendje të veçanta?

### *Tradita*

Për traditën, fukahatë kanë dhënë përkufizime të shumta, por më logjik rezulton të jetë përkufizimi që përkon me zakonin që praktikojnë njerëzit në blerjet e në shitjet e tyre, ose në qiradhënien e në qiramarrjen, si dhe në të gjitha marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, në atë mënyrë që personi që flet, i lejohet të shqiptojë një fjalë me të cilën ai ka qëllim një kuptim për një

veprim të caktuar, pa përmendur kushtëzimet, bazuar mbi kuptimin që ato kanë sipas traditës.

Për shembull, libanezi thotë: “Këtë e kam blerë me një lirë.” Prej fjalës së këtij personi kuptohet lira libaneze, pa dhënë asnjë cilësi, ose, kur irakiani thotë: “Atë e kam blerë me një dinar.”, prej fjalës së tij, gjithashtu, kuptohet dinari irakian.

Në lidhje me traditën, do ta flasim vetëm në tri drejtime.  
*Drejtimi i parë:* A është tradita prej burimeve të legjislacionit?

*Drejtimi i dytë:* A është tradita rrugë për specifikim e personifikim të objektit me të cilin ka lidhje gjykimi ligjor?

*Drejtimi i tretë:* A gjykohet me traditën?

### ***Tradita dhe legjislacioni***

S’ka dyshim që tradita, në vetvete, nuk është prej burimeve të legjislacionit, domethënë nuk është rrugë e vlefshme për të njohur dispozitat ligjore. Është e kuptueshme se, kur tradita, si zakon, ishte vepruese për ndonjë send në kohën e ligjvënësit dhe atë traditë ai ka arritur ta shikojë me sytë e vet, ose për atë ka dëgjuar, duke shtuar faktin se ai as nuk e ka ndaluar e as nuk e ka refuzuar atë traditë veprimi, megjithëse kishte fuqinë dhe nuk kishte ndonjë pengues që ta ndalonte atë traditë, ose ta refuzonte atë, ky fakt ishte një firmosje e traditës nga ana e ligjvënësit, sepse, në të vërtetë, ai bashkohet me traditën në këtë burim.



Bazuar mbi këtë fakt, veprimi i kryer nuk është më veprim sipas traditës, por është veprim sipas Sunetit, i cili siç dihet përmbledh fjalën e Ligjvënësit, punën e tij dhe pohimin e tij.

### ***Tradita dhe objektet ligjore***

Mbështetja mbi traditën bëhet për të njohur objektin dhe për të caktuar kuptimin me të cilin ka lidhje gjykimi ligjor, kur kjo është e vërtetuar për subjektin për të cilin në ligj nuk ka të vërtetë të veçantë. Po japim një shembull: Ligjvënësi thotë: “Haraçi (taksa e tokës) është me garantim... S’ka dëmtim e as përgjigje dëmtimit me dëmtim... Punët vlerësohen sipas qëllimit (nijetit).”

Sipas shprehjes së juristëve të fushës së bazave të fik’hut, ne i referohemi traditës për dyshimet arbitrare dhe jo për dyshimet objektive.<sup>1</sup>

### ***Tradita dhe gjykimi***

Raporti i traditës me gjykimin është plotësisht si raporti i gjykimit me legjislacionin. Tradita, në vetvete, nuk është rrugë për

<sup>1</sup> Kur ne dyshojmë për qëllimin e ligjvënësit e për objektivitetin e tij, në atë mënyrë që nuk dimë nëse ajo çështje, apo punë te ai është hallall ose është haram, në këtë gjendje, dyshimi është në gjykim. Është quajtur kështu sepse dyshimi është në gjykimin ligjor dhe jo në objektin e gjykimit. Ne mësojmë për një gjykim ligjor dhe objekti i gjykimit nga jashtë na duket i dyshimtë, si për shembull, ne mësojmë që ligjvënësi ka bërë haram verën dhe ka bërë hallall uthullën. Më pas ne dyshojmë në lidhje me një lëng të veçantë, nëse lëngu në fjalë është verë apo është uthull, dyshimi është objektiv, për shkak se dyshimi ndodh në specifikim e objektit në gjykim dhe jo në vetë gjykimin, ashtu siç rezultojnë gjendja në dyshimin arbitrar.

të njohur gjykimin ligjor, por disa herë tradita mund të jetë rrugë për të specifikuar objektin me të cilin ka lidhje gjykimi.

Gjithashtu, tradita nuk mund të jetë prej bazave të vërtetimit për gjykimin, por disa herë tradita mund të jetë një mjet për të njohur sendin për të cilin grinden dy kundërshtarët, kështu që tradita mund të ndikojë në gjykim vetëm nga kjo anë dhe asgjë më shumë. Me kalimin e kohës zakoni mund të ndryshojë, për rrjedhojë koha asgjëson edhe traditën e bazuar mbi atë zakon, por së bashku me traditën zhduket edhe ndikimi i saj.

Autori i librit “El Xheuahir”, në kapitullin “Martesa”, në paragrafin “Shuma e kurorës”, ka thënë: “Kur të dy bashkëshortët kanë mosmarrëveshje në lidhje me dorëzimin e shumës së kurorës, merret në konsideratë fjala e gruas, krahas betimit të saj. Njoftimet tregojnë se për bazë merret fjala e burrit, kur ai ka kryer marrëdhënie intime me gruan dhe jo fjala e gruas.”

Nëse do të mbartim çështjen, duke u bazuar mbi zakonin e kohës së kaluar, do të gjejmë që shuma e kurorës dorëzohet para se burri të kryejë marrëdhënie intime me gruan, por më pas u hoq dorë prej këtij zakoni, atëherë ne i referohemi origjinës së gjykatësit për mosdorëzimin e shumës së kurorës, derisa të vërtetohet e kundërta.

Siç shihet, zakoni ka ndikim në përcaktimin e sendit për të cilin grinden dy kundërshtarët. Në lidhje me këtë çështje, në vijim do të përmendim shembujt vijues:

1- Kur dy burra bien dakord që kontrata e shitjes është bërë, për shembull, me njëqind dinarë dhe njëri prej atyre të dyve thotë: “Ne ramë dakord që shuma të jetë dinari i vendit.”,

domethënë monedha që përdorin njerëzit tani mes tyre, kurse tjetri pretendon: “Jo, ne ramë dakord për dinarë të huaj.”, ose ai thotë se ne ramë dakord për dinarin që kanë përdorur njerëzit e kohës. Nëse puna qëndron kështu, merret në konsideratë fjala e të parit, krahas betimit të tij, kurse të dytit i kërkohet të sjellë argument.

2- Burri ble një send dhe më pas në atë send ai gjen diçka për të cilën ai nuk kishte më parë dijeni dhe pretendon se ajo diçka, në sendin që ai bleu, është një e metë që e bën detyrim kthimin e sendit të blerë. Shitësi thotë: “Kjo që thotë ky, nuk është e metë.”

Ne e kemi gjykuar çështjen sipas traditës me njerëz që kanë përvojë dhe në bazë të fjalës së tyre, vendosëm.

3- Kur jepet me qira një shtëpi dhe as qiramarrësi e as qiradhënësi nuk kanë biseduar në lidhje me taksat që vë bashkia për ruajtjen, pastrimin, taksën e tendave, apo taksa të tjera, më pas ndodh konflikti dhe qiramarrësi thotë: “Këto taksa janë për pronarin.”, kurse pronari thotë: “Jo, këto taksa i takojnë qiramarrësit.”, në këtë gjendje, ne i referohemi traditës dhe zakonit që ndiqet.

4- Burri shet një kalë. A hyn shala dhe freri në sendin e shitur? Ai shet një kafshë barrëse. A hyn barra në kafshën e shitur? Ai shet një kopsht. A hyn muri rrethues në kopshtin e shitur? Ai shet një shtëpi. A hyjnë në shitjen edhe çelësat e dyerve dhe pemët që janë në oborrin e shtëpisë? Për të gjitha këto si dhe për të tjera gjëra si këto që u thanë, ne i referohemi traditës, derisa

nuk ka tekst që të tregojë të kundërtën, ose derisa të gjejmë një shembull të ngjashëm që të përcaktojë hyrjen ose daljen.

5- Kur gruaja dhe burri banojnë së bashku në të njëjtin vend dhe më pas gruaja i kërkon burrit që ai të paguajë shpenzimet që i takojnë asaj për kohën që ajo ishte së bashku me burrin, në këtë gjendje, ankesa e gruas nuk pranohet, duke punuar me zakonin dhe me anën e jashtme të gjendjes, nga e cila mësohet se burri e ka kryer detyrimin për të shpenzuar për gruan e tij.

Fukahatë kanë folur gjatë në lidhje ato që përfshijnë fjalët “shtëpi”, “kopsht”, “tokë”, “skllav”, “kalë”, etj dhe traditën në lidhje me këto sende ata e kanë bërë pikë referimi.

Autori maliki (ndjekësi i shkollës juridike islame të imam Malikut), i librit “El Furùk”, në vëllimin 3, në faqen 199, thotë: “Të gjitha këto fjalë gjykohen me zakonin.”

Autori imami (ndjekës i shkollës juridike islame të imamive) i librit “El Xheuahir”, në kapitullin “Sendet e tregtueshme”, thotë: “Kur burri shet pemën që ka fruta, në të gjitha gjendjet, frutat i takojnë shitësit, përveçse kur ka një traditë me të cilën në gjykim, dilet prej këtij rregulli.”

Del detyrë të tërhiqet vëmendja e të theksohet që, në asnjë gjendje, nuk duhet të heqim nga mendja faktin se tradita si traditë nuk është prej burimeve të gjykimit dhe as nuk i referohemi traditës për të dalluar të vërtetën prej të pavërtetës, por ne mbështetemi te tradita, kur është e nevojshme për të njohur kuptimet e fjalëve dhe gjithçka që ndjek këto kuptime, për të cilat kanë grindje dy të konfliktuarit.

E vërteta është se me traditën s'ka gjykim, edhe nëse ndodh që tradita ka ndikim në gjykim, sepse gjykim me traditën do të thotë që tradita të jetë ndarëse mes të vërtetës e të pavërtetës, por tradita nuk është ndarëse me të cilën vendoset në favor ose kundër njërit prej dy të konfliktuarve. Unë nuk them se ka ndonjë fekih (jurist të ligjit të fesë islame) që të shprehet në favor të kësaj teze, ose që mbështet fjalën e atij që kërkon ta përdorë traditën si argument. Natyrisht që në disa raste, edhe mund të gjykohet me anën e jashtme të punëve, si për shembull, dikush ka drekuar në një shtëpi tjetër dhe pastaj i zoti i shtëpisë i ka kërkuar atij të paguajë çmimin e ushqimit që hëngri. Ai që hëngri, thotë: "Unë hëngra si mik dhe shtëpia jote nuk është restorant."

Rregulli i respektimit të pasurisë dhe garantimi i pasurisë kërkon që ai që hëngri ushqimin, të jetë pretendues, kurse i zoti i shtëpisë të jetë mohuesi, krahas faktit që ne nuk dyshojmë se për bazë merret fjala e atij që hëngri drekën. Por ky do të ishte veprim me sigurinë e zemrës dhe jo veprim i bazuar në anën e jashtme të çështjes.

### ***Përhapja më e gjerë***

Fjalët "përhapje më e gjerë", "shtrirje", "e dëgjuar", kanë të njëjtin kuptim, domethënë se ajo fjalë është dëgjuar prej një grupi njerëzish, për të cilët përjashtohet mundësia që ata kanë rënë dakord dhe janë marrë vesh mes tyre për të gënjer, në atë mënyrë që prej fjalës të tyre të gënjeshtër, të arrihet të besohet se ajo është e vërteta. Autori i librit "El Xheuahir" ka folur në lidhje me përhapjen më të gjerë në tri anë:

## **1- Përhapja më e gjerë dhe puna**

Puna e njeriut, sipas përhapjes më të gjerë, mes njeriut e mes Zotit të tij, pavarësisht nga dëshmia dhe gjykimi, si për shembull, kur dihet se ai truall, apo ajo tokë s'është vakëf, ose filanja është gruaja e filanit, ose kjo shtëpi është e pushtuar, ose filani është dijetar, ose ai tjetri është injorant, ose është i drejtë, ose është mëkatar, ose ai, në të vërtetë është biri i filanit e të tjera si këto, padyshim që njerëzit, në lidhje me këto çështje, janë mbështetur dhe vazhdojnë të mbështeten mbi atë veprim që ka përhapje më të gjerë.

Bazuar mbi këtë përhapje më të gjerë që praktikohet për njohjen e faktit, ata sistemojnë efektet. Kjo është e barabartë, qoftë kur marrja dijeni rreth çështjes arrihet në mënyrë të prerë, qoftë kur arrihet me supozim.

Në kapitullin e mësipërm theksuam se disa studiues prej dijetarëve tanë të fesë kanë gjykuar edhe me një njoftim të vetëm për çështjet kur gjykatësi ka siguri se nuk do të ketë as kundërshtim e as konflikt.

## **2- Përhapja më e gjerë dhe dëshmia**

Për sa i përket dëshmisë, bazuar mbi veprimin me përhapje më të gjerë dhe argumentimit para gjykatësit, nisur nga fakti se është veprim i përhapur dhe shumë i dëgjuar, në lidhje me këtë çështje, do të shikojmë sqarimin e mëposhtëm.

Nëse mësimi arrihet në saje të veprimit që ka përhapje më të gjerë, në mënyrë absolute, lejohet dëshmia duke u mbështetur

në veprimin që ka përhapje më të gjerë, përveç punëve të veçanta, të cilat fukahatë i kanë përjashtuar me tekst. Këto punë të përjashtuara janë shtatë: përkatësia familjare, prona në përgjithësi, domethënë pa përmendur shkakun e pronës, siç mund të jetë shitje, blerje, trashëgimi, etj, për të cilat, nëse bëhet i qartë shkakun, dëshmia rrëzohet, martesë, vakëfi, lirimi i skllavit, kujdestaria dhe vdekja. Disa fukaha janë mjaftuar të veçojnë vetëm tri punë: përkatësinë familjare, martesën dhe pronën. Një tjetër ka përmendur pesë, duke shtuar mbi këto tri të fundit martesën dhe vakëfin. Sido që të jetë, kushti themelor për dëshminë është pasja dijëni, por fukahatë kanë lejuar edhe dëshminë e bazuar në veprimin që ka përhapje më të gjerë në lidhje me punët e lartpërmendura, në rast se nuk arrihet të merret dijëni.

Ka përparësi që dëshmitari të dëshmojë ekzistencën e veprimit që ka përhapjen më të gjerë, në lidhje me punën objekt gjykimi dhe pastaj këtë veprim me përhapje më të gjerë ai e shtron para gjykatësit, i cili, nga ana e tij, shpreh mendimin e tij në lidhje me veprimin që ka përhapje më të gjerë.

Të katër medh'hebet ndajnë një fjalë të përbashkët se dëshmia e mbështetur në veprimin që ka përhapje më të gjerë, është e vlefshme në lidhje me përkatësinë familjare dhe lindjen, por kanë kundërshtime në lidhje për punët e tjera.

Hanefitë kanë thënë se pranohet edhe në lidhje me vdekjen, kurorëzimin dhe hyrjen e burrit te gruaja.

Hanbelitë kanë thënë se pranohet në lidhje me vdekjen, kurorëzimin, pronën në përgjithësi dhe vakëfin.

Shafitë kanë thënë se pranohet në lidhje me vdekjen dhe pronën (librat: “El Muhedh’ dheb”, “El Mugnij”, “Fet’hul Kadijr”, kapitulli “Dëshmitë”).

### **3- Përhapja më e gjerë dhe gjykimi**

Kur përhapja më e gjerë vërtetohet te gjykatësi, ai gjykon me të. Kjo është e barabartë, qoftë kur për atë merret dijeni, qoftë kur nuk arrihet të merret dijeni, plotësisht si gjykimi me argument e me pohim. Mohuesi nuk ka të drejtë të atakojë e të kundërshtojë gjykimin. Por gjykimi me përhapjen më të gjerë, reduktohet në përkatësinë familjare, pronën në përgjithësi, martesën dhe vakëfin.

Në të vërtetë, gjykimi, bazuar në përhapjen më të gjerë, lejohet për shkak se ashtu kanë vepruar fukahatë dhe prej asaj që mësohet prej disa njoftimeve (libri “El Xheuahir”, kapitulli “Gjykimi”).

Para se ta lëmë këtë kapitull, do të theksojmë dy punë të rëndësishme, që, në fakt, janë përmbledhje e asaj që u tha më sipër:

*E para:* Dallimi mes traditës dhe përhapjes më të gjerë qëndron në faktin se me traditën as nuk gjykohet e as nuk mund të mbështetet mbi atë, si rrugë për të vërtetuar gjykimin, por tradita mund të bëhet pikë referimi për të mësuar kuptimin e fjalëve për të cilat dy të konfliktuarit kanë mosmarrëveshje në lidhje me qëllimin për të cilin përdoren ato fjalë, kurse me përhapjen më të gjerë gjykohet dhe gjykatësi, në gjykimin e tij,



mbështetet mbi veprimin që ka përhapje më të gjerë, duke e konsideruar njëren prej bazave ligjore, për të vërtetuar në lidhje me punët që ne i përmendëm më sipër.

*E dyta:* Dallimi mes dëshmisë dhe gjykimit qëndron në faktin se dëshmia patjetër duhet të jetë rezultat i dijenisë së qartë, ashtu siç thuhet në hadithin e nderuar, sikur të shikosh diellin, me përjashtim të rasteve të veçanta që ne i përmendën në paragrafin e mësipërm. Gjykimi lejohet me pasjen dijeni edhe me supozim, sepse gjykatësi gjykon çështjet me pohim, me argumente, me betime, me dorën e me përhapjen më të gjerë, edhe nëse dituria nuk arrihet për të.

Rezultati përfundimtar, për të gjitha këto, është: Me të gjitha punët me të cilat lejohet dëshmia, nuk mund të lejohet gjykimi me to. Dëshmitari mund të dëshmojë për një punë për të cilën ai ka dijeni dhe gjykatësi nuk gjykon, pasi jo çdo punë me të cilën lejohet gjykimi, është e lejueshme që me atë të dëshmohet.

Gjithashtu, gjykatësi mund të gjykojë me betim. Krahas kësaj, dëshmitarit nuk i lejohet të dëshmojë me betimin e tij në favor të asnjërit, cilido qoftë ai person.

\* \* \*

## DITURIA E GJYKATËSIT

### **Ndikimi i diturisë së gjykatësit në gjykim**

#### ***Shkaqet e diturisë***

Shkaqet e pasjes dituri për çështjen janë aq të shumta, sa nuk numërohen, por prej këtyre shkaqeve ne na interesojnë vetëm ato shkaqe që kanë lidhje me ankesën e ngritur te gjykatësi, i cili arrin të mësojë prej tyre ngjarjet që ngrihen në ankesë, ose me njëjërën prej anëve të ankesës. Dituria e gjykatësit, në lidhje me ngjarjen objekt i konfliktit të ngritur në ankesë, ndahet në dy pjesë: *E para:* Dituria për gjykatësin arrihet jashtë gjykatës, para konfliktit dhe para ngritjes së ankesës.

*E dyta:* Dituria arrin te gjykatësi gjatë shqyrtimit të ankesës dhe prej këtij shqyrtimi, gjykatësi mëson për ngjarjet që shtrohen e për veshjet që i bëhen ankesës. Pikërisht kjo dituri është qëllimi i këtij kapitulli dhe duke vënë në konsideratë shkaqet e kësaj diturie, kjo dituri është si më poshtë:

1- Verifikimi e shikimi i gjykatësit, kur objekti i ankesës është prej ngjarjeve të zakonshme.

2- Shembuj të ngjashëm objektivë jo prej mjekësisë ligjore, por prej atyre shembujve të ngjashëm, të cilët gjykatësi, në saje të zgjuarsisë e me intuitën e tij i nxjerr prej debatit që bëjnë palët rreth objektit të konfliktit, si dhe prej mashtrimeve të të konfliktuarve.

3- Punë të përgjithshme të njohura përfundimisht te të gjithë njerëzit, si për shembull, shurdhi nuk dëgjon dhe i verbëri nuk shikon. Kur i pari dëshmon se ka dëgjuar pohimin dhe i dyti se ka parë ngjarjen, të dyve nuk u kushtohet asnjë vëmendje.

4- Mjekësia ligjore. Prej mjekësisë ligjore janë edhe fjalët e ekspertëve.

5- Parimet e përgjithshme ligjore, si për shembull, koha më e paktë e shtatzënisë është gjashtë muaj dhe koha më e gjatë e saj është një vit. Mbi këtë bazë gjykatësi vendos mohimin e fëmijës, ose atashimin e fëmijës, pa kërkuar betimin e pa kërkuar argumente, por vetëm pasi ka mësuar për datën e kryerjes së marrëdhënieve intime, domethënë se ai që pretendon në kundërshtim me këtë parim, ankesa e tij nuk pranohet që në fillim, sepse ai pretendon diçka që nuk vërtetohet ligjërisht.

## ***Baza në gjykim***

Para se të flasim për diturinë që ka gjykatësi, me të gjitha kushtet e pjesët e diturisë, do të bëjmë këtë parashtrim:

Bazë në gjykim dhe në të gjitha obligimet është që ato të kryhen e të miratohen ashtu siç janë në të vërtetë, me anë të diturisë së formës së prerë dhe nuk lejohet kryerja e miratimi i

atyre gjërave me ndonjë rrugë tjetër që nuk ka të bëjë me diturinë, me përjashtim të rasteve kur ligjvënësi ka vënë tekst për të vepruar me ndonjë rrugë të veçantë dhe vetëm atëherë ndiqet kjo rrugë e veçantë në kohën e kryerjes së punës, edhe nëse dituria nuk është arritur. Por këtu, sekreti i kërkesës së bazës që kryerja e punës të bëhet me arritjen e diturisë dhe jo pa dituri, do të thotë që obligimi, në të vërtetë, realizohet vetëm në saje të diturisë së plotë, sepse vetëm dituria e plotë nuk mund të rrëzohet, përveçse me një dituri të plotë të ngjashme. Në asnjë rast ajo nuk mund të rrëzohet me dyshim e me supozim, për faktin se më e fuqishmja nuk mund të rrëzohet me të pafuqishmen, o Zot i madh, me përjashtim të rasteve, kur ekziston argumenti i arritur prej diturisë, që thotë se, në disa gjendje, duhet të mjaftohemi me supozimin, por edhe ky mjaftim, në të vërtetën e tij, është një punë që detyrimisht përfundon në dituri të plotë, qoftë edhe me ndërmjetësues.

Vetë ligji ka argumente të formës së prerë që lejojnë gjykimin me baza, që nuk njoftojnë dijeninë dhe vendosmërinë, siç është: pohimi, argumenti, dora, përhapja më e gjerë. Sekretin në të gjitha këto qëndron në lehtësimin dhe që puna të zgjidhet sa më thjesht. Sikur rrugët e gjykimit të ishin të kufizuara vetëm me arritjen e diturisë në lidhje me çështjen, gjykimi nuk do të mbyllej, për rrjedhojë, të drejtat do të humbnin dhe kaosi do të ishte i përgjithshëm.

Disa fukaha kanë shkuar deri aty sa të thonë se realiteti, ashtu siç është, nuk kërkohet në gjykim, por në gjykim kërkohet ajo ku çojnë argumentet e betimet, ashtu siç është hadithi i nderuar: “Unë gjykoj mes jush me argumente dhe me betim”. Kur ai thotë dëshmoj dhe gjykoj, kuptimi i kësaj fjale është se ai

dëshmon realitetin dhe gjykon me realitetin, përveçse kur sillet një argument me të cilin vërtetohet që gjykatësi nuk ka të drejtë të gjykojë me realitetin, por ai duhet të gjykojë me dëshminë e dëshmitarëve, apo me të tjera rrugë të lejuara të gjykimit dhe jo me rrugë të tjera, të cilat, si argumente, nuk janë asgjë. Prandaj s'kanë asnjë ndikim në ligjin e fesë. Përveç kësaj, janë në kundërshtim me logjikën e me argumentin logjik.

Mund të ndodhë që argumenti prej Librit të Allahut e prej Sunetit të tregojë se, në radhë të parë, gjykatësi është i detyruar të gjykojë me realitetin. Për sa i përket hadithit: "Unë gjykoj mes jush me argumente e me betime", ky hadith ka të bëjë me shumicën e rasteve, kur s'ka dituri për realitetin. Gjykimi me argumente e me betime do të bëhet vetëm atëherë kur s'ka rrugë tjetër përveç kësaj rruge, ndryshe do të ishte i lejuar gjykimi me argument e me betim, edhe kur arrihet të mësohet që argumenti e betimi janë të rremë, por këtë nuk e thotë askush.

Sido që të jetë gjendja, është e rëndësishme të kujtojmë e të mos harrojmë se gjykimi me dituri nuk ka nevojë për argument, sepse është gjykim sipas kërkesave të bazës dhe pas arritjes së ditorisë, s'mund të ketë gjë tjetër, kurse gjykimi pa dituri ka nevojë për argument të formës së prerë.

### ***Ligjet moderne dhe imamët e medh'hebeve***

Bazuar mbi atë që thamë më sipër, shtrohet pyetja: Kur gjykimi bëhet me ditorinë e arritur, s'ka nevojë për argument, kurse gjykimi pa dituri ka mungesë argumenti, si është e mundur që ligjet moderne, fukahatë e katër medh'hebeve dhe një pjesë e

fukahave imami të ndajnë një fjalë të përbashkët se gjykatësit nuk i lejohet të gjykojë me diturinë e arritur dhe për gjykimin e tij të mos mbështetet në asnjërën prej informacioneve të tij?

*Përgjigje:* Kur krerët e legjislacioneve moderne thonë se gjykatësi nuk lejohet të gjykojë me diturinë e tij, kanë qëllim të shpjegojnë se gjykatësi nuk ka të drejtë të vihet para sfidave për hir të gjykimit, kur të vendosë për realitetin, për të cilin ai kishte dijeni edhe më përpara. Prandaj ankuesi ka të drejtë ta lërë vlerësimin e çështjes në dorën e një gjykatësi tjetër dhe ai të jetë dëshmitar e jo gjykatës.

Juristët, në asnjë rast, nuk e kanë lejuar vënien e gjykimit para sfidës dhe pastaj ai të gjykojë në kundërshtim me atë që mësoi. Fjalën e atyre fukahave, që kanë ndaluar gjykatësin të gjykojë me atë që ka mësuar, ne mund ta mbartim mbi pretekstin. Bazuar mbi këtë shpjegim, nuk kemi kontradiktë mes fjalës së atij që ka thënë: “Gjykatësit nuk i lejohet të gjykojë me diturinë e tij.” dhe mes fjalës së atij që thotë “Origjina e kërkon si detyrim të ndiqet dituria e arritur në të gjitha sendet, kur s’ka as ndalues logjik e as ndalues ligjor, që rruga e gjykimit mes njerëzve, në disa kushte e gjendje, të mos jetë sipas diturisë që ka arritur gjykatësi.

### ***Gjykimi, në kundërshtim me diturinë***

Më sipër thamë që baza e parë kërkon gjykimin me diturinë e arritur, derisa të vërtetohet e kundërta. Gjithashtu, është vërtetuar lejimi i gjykimit me argumente e me rrugë të tjera, edhe nëse nuk është arritur dituria. Gjithashtu, thamë se në disa gjendje bëhet e domosdoshme të dilet prej kësaj baze, por jo duke punuar

vetëm me supozime, të cilat edhe mund të bashkohen me realitetin, por duke punuar me punë që janë në kundërshtim me diturinë dhe të vendoset pa realitetin.

Një shembull në lidhje me këtë që u tha: Dikush i ka lënë në ruajtje një burri dy dirhemë. Më pas vjen një i dytë dhe i le atij në ruajtje vetëm një dirhem, të cilin ai e vuri së bashku me dy dirhemët e parë. Rastësisht, njëri prej tre dirhemëve u asgjësua, jo nga shkujdesja e as ngaqë ruajtësi vuri dorë. Në lidhje me këtë gjendje, të gjithë fukahatë janë shprehur se gjykatësi të gjykojë me të drejtën dhe e ka detyrim të vendosë që i pari të marrë një dirhem e gjysmë, kurse i dyti të marrë një gjysmë dirhemi, pavarësisht se ai la për ruajtje një dirhem, krahas diturisë që ai ka që ky gjykim është në kundërshtim të plotë me realitetin, sepse dirhemi që u asgjësua, mund të ishte njëri prej dy dirhemëve që la i pari dhe kështu për atë mbetet vetëm një dirhem, megjithëkëtë ai mori një dirhem e gjysmë.

Nëse dirhemi i asgjësuar do të ishte dirhemi që la për ruajtje i dyti, atëherë për atë nuk do të mbetej asgjë, megjithëkëtë edhe i dyti mori një gjysmë dirhemi.

Kur mbyllen rrugët për njohjen e realitetit, arrihet ortakëria përfundimtare mes të dyve, për shkak të përzierjes që ndodhi vetëm në një dirhem, sepse njëri prej dy dirhemëve, i takon të parit. Kjo është e barabartë, qoftë kur dirhemi i asgjësuar është prej dirhemëve të tij, qoftë kur dirhemi i asgjësuar ishte dirhemi i tjetrit, sepse shembullin ne e ngritën mbi supozimin që ky dirhem ishte i të parit dhe dirhemi i asgjësuar është vetëm një dirhem. Në këtë gjendje, patjetër njëri prej dy dirhemëve ekziston dhe i jepet të parit me vetëdije të plotë, kurse dirhemi që mbetet, ndahet mes

tyre në dy gjysma të barabarta. Rezultati përfundimtar është: Ai që la në ruajtje dy dirhemë, merr një dirhem e gjysmë dhe ai që la në ruajtje një dirhem, merr gjysmë dirhemi. Kështu ka ardhur edhe në transmetimin e përcjellë prej Imam Sadikut (*Paqja goftë mbi të!*).

Gjithashtu, gjykatësi gjykon në kundërshtim me diturinë e arritur, kur dy vetë pretendojnë të njëjtin send, i cili patjetër i takon njërit prej dy pretenduesve, por të dy s'kanë argument, ndërkaq çdo njëri prej atyre të dyve pretendon se ai send i takon atij dhe askujt tjetër. Në këtë gjendje, ata të dy betohen dhe sendi ndahet në dy gjysma mes atyre të dyve, krahas diturisë se njëri prej tyre bëri betim të rremë, kurse betimi i tjetrit ishte i vërtetë dhe sendi për të cilin ata kanë konflikt, është i atij që bëri betim të vërtetë. Por pasi rruga për të njohur realitetin u mbyll, për të mbyllur konfliktin, ndarja e sendit në dy pjesë u bë e detyrueshme.

Bazuar mbi medh'hebin e Ebu Hanifes, realiteti mund të zbulohet plotësisht e me qartësi dhe është e mundur të punohet me atë realitet pa asnjë ndalues, megjithëkëtë gjykatësi gjykon në kundërshtim me realitetin, edhe pse e di mirë që po vendos në kundërshtim me realitetin, megjithëse i ka të gjitha mundësitë të marrë në konsideratë realitetin.

Në librin "Ikhtilaf Ebu Hanifes ue ibn Ebu Lejla" i autorit Ebu Jusuf, nxënësi i Ebu Hanifes, në faqen 183, botim i vitit 1358H, është fjala për librin "Mijzànu Sha'rànij", në kapitullin "Mallkimi i ndërsjellë", ka ardhur se Ebu Hanifja ka thënë: "Sikur burri të largohet prej gruas me të cilën u martua, e më pas gruas i vjen lajmi i vdekjes së burrit dhe, pasi kalon kohën e pritjes ligjore,



gruaja martohet, me burrin e dytë ajo lind fëmijë. Pas një kohe vjen burri i parë, fëmijët e lindur prej burrit të dytë i atashohen burrit të parë dhe i mohohen të dytit.”

Bazuar mbi këtë shpjegim, kur ka konflikt i pari me të dytin për fëmijët e lartpërmendur dhe të dy e ngrenë çështjen te gjykatësi, është detyrim që gjykatësi të gjykojë në favor të atij që ishte larguar dhe i mohon fëmijëve babain e tyre të vërtetë, pa asnjë argument e pa betim, megjithëse e di mirë që gjykimi i tij është në kundërshtim me realitetin dhe ai ka mundësi të punojë sipas këtij realiteti.

Me anë të kësaj hyrje, ne mësuam se gjykatësi është i ndaluar, te shumica e fukahave dhe te dijetarët e ligjeve, të gjykojë me diturinë që kishte arritur të merrte para ndodhjes së konfliktit dhe para ngritjes së çështjes te ai. Ne kemi përmendur shkaqet, prej të cilave mund të jetë edhe dituria që arrin gjykatësi gjatë studimit që ai bën mbi ankesën.

### ***Shikimi me sy***

Pa dyshim që gjykatësi ka të drejtë të zbulojë gjatë studimit të ankesës realitetin material objekt i konfliktit dhe ta shikojë atë objekt me sytë e tij, duke ditur se dituria që ai arrin, në lidhje çështjen, me anë të shikimit me sy, është prej bazave të vërtetimit, prandaj nuk lind nevoja për ndonjë veprim tjetër.

Një shembull në lidhje me këtë çështje: Një person merr një mëditës kundrejt pagës ditore për të ndërtuar një shtëpi, sipas kushteve për të cilat ata kanë rënë dakord. Pasi mëditësi mbaron

punën, punëmarrësi i thotë mëditësit: “Punën nuk e ke kryer sipas kushteve të punës.”

Mëditësi thotë: “Jo, e kam kryer ashtu siç duhet.” Në këtë gjendje, gjykatësi ka të drejtë të inspektojë dhe të gjykojë pa qenë nevoja për argumente e për betim.

E njëjta gjë është edhe rasti kur një grua ka pretendim ndaj burrit të saj se shtëpia që ai ka përgatitur për të banuar ajo, nuk është e përshtatshme, në këtë gjendje, gjykatësi ka të drejtë, me kërkesën e gruas, ose edhe pa kërkesën e saj, të shkojë vetë e të shikojë shtëpinë dhe pastaj të gjykojë sipas asaj që pa.

Nëse gjykatësi nuk shkon vetë dhe të dyja palët kanë rënë dakord të caktojnë një ekspert, të cilin e miraton edhe gjykatësi, në këtë gjendje, gjykatësi merr në konsideratë fjalën e ekspertit, por bazuar në rregullin: “Gjykatësi ka të drejtë të hulumtojë”, ai edhe e rrëzon fjalën e ekspertit, pavarësisht nga marrëveshja e mësipërme.

Në qoftë se palët në konflikt nuk kanë rënë dakord me njëri-tjetrin në lidhje me caktimin e ekspertit, atëherë gjykatësi e miraton vetë ekspertin. Nëse gjykatësi arrin të marrë dituri prej fjalës së ekspertit, gjykatësi gjykon me diturinë që mori, ndryshe e pezullon gjykimin e çështjes, sepse supozimi nuk ka asgjë të përbashkët me të vërtetën, përveçse kur supozimi tregon se është argument që e ndjekin. Vetëkuptohet se, kur gjenden shembuj të ngjashëm që mund të bashkohen me fjalën e ekspertit, arrihet siguria e formohet bindja e plotë, atëherë gjykimi është i mundur dhe është i lejuar të bëhet, ndryshe gjykatësi e rrëzon krejtësisht ankesën.

## ***Gjykatat e ligjit të fesë***

Nga sa u tha më sipër, për ne bëhet e qartë ajo që ngjet në gjykatat ligjit të fesë në Liban, ku merret në konsideratë fjala e ekspertit, prej së cilës gjykatësi zbulon detyrimin për shtëpinë e bindjes (gruaja i është bindur burrit) në ankesën e mësipërme në lidhje me detyrimin që ka burri të shpenzojë për gruan dhe pamë se gjykatësi u mbështet në pohimin e ekspertit, edhe sikur prej fjalës së tij të mos ketë arritur diturinë. Por nga mbështetja mbi këtë bazë, bëhet e qartë se gjykimi i bërë nuk është ndërtuar në asnjë bazë të ligjit të fesë.

## ***Shembujt e ngjashëm***

Janë shembujt e ngjashëm që shoqërojnë ankesën dhe për të cilët gjykatësi, me zgjuarsinë e tij prej debatit mes palëve në konflikt, arrin në një përfundim. Por këta shembuj të ngjashëm, as nuk hyjnë në ndonjë rregullore të veçantë e as nuk i bashkon ndonjë ndarës i përbashkët, sepse ata janë aq të ndryshëm sa ç’janë të ndryshme ankesat dhe të dy pretenduesit. Por nuk ka dyshim në lidhje me lejimin e gjykimit me diturinë e arritur prej shembujve të ngjashëm, pasi supozohet që shembujt e ngjashëm lidhen me ngjarjet e ankesës dhe nuk mund të ndahen prej saj, por ato nuk kanë asnjë vlerë, nëse janë shkak për të marrë dituri.

Patjetër që gjykatësi mendon se ato mbështesin ose i dobësojnë bazat e vërtetimit. Më sipër kemi folur në lidhje me shembujt e ngjashëm në kapitullin “Shembujt e ngjashëm dhe shkresa”.

## ***Parimet e përgjithshme***

Më sipër thamë se parime të përgjithshme janë ato që njerëzit janë të përbashkët në marrjen e diturisë prej atyre parimeve, siç ishte shembulli i mësipërm, shurdhi dëshmon, ngaqë ka dëgjuar pohimin dhe i verbëri dëshmon ngaqë e ka parë ngjarjen, ose pretendimi i atij që thotë se kjo është kafsha ime dhe se ajo kafshë ka lindur në shtëpinë e tij që prej një viti, por më pas bëhet e qartë se mosha e kafshës është më pak ose më shumë se një vit. Prandaj vetëkuptohet që gjykimi me diturinë e marrë prej këtyre parimeve, nuk ka nevojë për argument, madje as edhe te ai që e ndalon gjykatësin të gjykojë me diturinë që ka arritur të marrë, sepse këto parime janë informacione të natyrshme dhe të pavarura prej ankesës.

## ***Mjekësia ligjore***

Qëllimi me termin mjekësi ligjore janë të gjitha veprimet që bëjnë specialistët për të analizuar gjakun, për të marrë shenjat e gishtave, për të ekzaminuar shkrimet e rrobat për të mësuar prej këtij ekzaminimi se kush i kishte pasur ato libra e rroba, apo ekzaminimin e djegieve për të mësuar shkaqet që sollën djegien, apo të bombave për të mësuar vendin ku ato janë prodhuar, madje deri edhe në ekzaminimin e gurëve e të dheut, si dhe të materialeve të tjera, ku mendohet se i akuzuari mund të ketë lënë ndonjë shenjë prej shenjave personale. Për mjekësinë ligjore janë ndërtuar laboratorë e institucione në Amerikë e në Evropë, të cilat i vizitojnë grupe studiuesish prej të gjithë shteteve e vendeve.

Imami Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka parakaluar të gjithë në lidhje me ekzaminimin dhe ekspertizën. Në këtë shembull të tij ne gjejmë një bazë për të gjykuar sipas të dhënave të mjekësisë ligjore. Për ilustrim të çështjes, le të shikojmë ngjarjen e mëposhtme: Një grua kishte qëllim të bënte për vete një burrë prej ensarëve. Madje gruaja përdori edhe mjete për ta joshur atë burrë. Kur ajo e pati të pamundur të arrinte dëshirën e saj, atëherë thuri një kurth. Mori një vezë, e theu dhe të bardhën e vezës e derdhi mbi rrobat e saj e mes kofshëve. Pastaj u paraqit te Ymeri dhe tha: “Filan burrë më përdhunoi.”

Ymeri deshi të dënonte të riun e akuzuar. Ymeri i tha burrit: “Do të vërtetosh urdhrin tim.”

Ndërkaq Ymeri i thotë Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Si mendon o Ebu Hasan?”

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Më sillni ujë të valuar.” Filloi të derdhë ujin mbi njollën e bardhë, derisa ajo u nda prej rrobës, pastaj të bardhën e ndarë prej rrobës e futi në gojën e tij dhe, kur e njohu shijen e të bardhës, e nxori jashtë. Pastaj u kthye kah gruaja, derisa vetë gruaja pohoi.

Urtësia në këtë ngjarje qëndron në faktin se, edhe pse është e mbështetur në pohim dhe jo në ekzaminim e në prova, përsëri ngjarja tregon qartë se ekzaminimi është njëra prej bazave në ligjin e fesë islame.

Shembull tjetër nga veprimi i Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) në këtë drejtim është rasti kur te ai u paraqitën dy gra dhe kërkuan që ai të gjykonte mes tyre. Njëra grua kishte lindur djalë dhe gruaja tjetër kishte lindur vajzë në të njëjtën kohë e në të

njëtin vend. Secila prej dy grave pretendonte se ajo ishte nëna e djalit. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) peshoi qumështin e dy grave dhe qumështi i njëres grua rezultoi më i lehtë në peshë se qumështi i gruas tjetër. Nisur nga kjo ekspertizë, ai gjykoi se nëna e vajzës ishte ajo me qumësht me peshë më të lehtë dhe gruaja që kishte qumështin me peshë më të rëndë, ishte nëna e djalit.

Këtë njoftim, edhe pse fukahatë nuk e konsiderojnë bazë prej bazave të vërtetimit dhe argument mbi të cilin ata mund të mbështeten në të tilla çështje, ai është si njoftimet e mësipërme dhe tregon ekzistencën e të dhënave të arritura me anë të mjekësisë ligjore në trashëgiminë tonë islame dhe në mënyrë të veçantë, njoftimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja Allahut qoftë mbi ta!*).

Në njoftimet e tyre tregohet se një grua ankohet që burri i saj është impotent, mirëpo burri e mohon ankimin e gruas. Atëherë burri u fut në ujë të ftohtë. Nëse penisi i tij do të mblidhej, gjykimi bëhet me fjalën e burrit dhe, nëse penisi i tij do të lëshohej, gjykimi bëhet me fjalën e gruas.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Me këtë njoftim kanë punuar dy djemtë e Babujehit dhe Ibn Hamzai dhe e kanë neglizhuar fukahatë e mëvonshëm, sepse nuk kanë qenë të sigurt në saktësinë e atij njoftimi, si dhe për mungesën e sigurisë në disiplinën e atij njoftimi, sepse fjala e mjekëve, në shumicën e rasteve, prodhon supozim në lidhje me saktësinë.

Gjithsesi, fjala e mjekëve nuk është rrugë ligjore, çka do të thotë: Sikur fjala e mjekëve të ishte në kuadrin e disiplinës dhe të njoftohej prej shkencës, patjetër që do të ishte rrugë ligjore dhe do të merrej në konsideratë.

Specialistët e kësaj fushe kanë pohuar se mjekësia ligjore nuk kërkon dijëni të formës së prerë për dyshimin në të gjitha ato që kjo shkencë paraqit e përshkruan, por ajo njofton dituri, siç është marrja e shenjave të gishtave të dorës, me të cilat specialistët përcaktojnë identitetin e të akuzuarit, sepse ekspertizat kanë vërtetuar që çdo njeri i ka të veçanta shenjat e gishtave, megjithëse njerëzit mund të kenë ngjashmëri mes tyre në fytyrë, ose në tipare, ose në ndonjë drejtim tjetër, por është e pamundur të jenë të ngjashme shenjat e gishtave.<sup>1</sup>

Prej mjekësisë ligjore mund të mos arrihet marrja e diturisë, megjithëkëtë mjekësia ligjore, me ekspertizën e saj, i jep gjykatësit një rrëzë prej hallkave të vargut të argumenteve, ose eksperti i mjekësisë ligjore përforcon ndonjë hallkë të vargut të argumenteve që mund të jetë paraqitur e dobët, siç është ekzaminimi i shkrimit, ose ekzistenca e një rrëze prej shenjave të personit të akuzuar, e gjetur në vendin e krimit, ose shenjat e krimit, megjithëse të gjitha këto të dhëna, nuk bëjnë detyrim që në gjykim të anohet e të supozohet bazuar mbi këto të dhëna, sepse ato nuk njoftojnë dituri.

Padyshim që dituria e arritur me anë të mjekësisë ligjore, me përjashtim të përkatësisë familjare, është argument që ndiqet, plotësisht si dituria e arritur prej deduksioneve logjike dhe prej parimeve të përgjithshme, në të cilat njerëzit janë të përbashkët. Por nga të dhënat e mjekësisë ligjore, nuk lind më nevoja që

---

<sup>1</sup> Përcaktimi i identitetit të të akuzuarit me anë të shenjave të gishtave nuk pranon dyshim dhe i akuzuari s'ka të drejtë të kundërshtojë kundër shenjave të gishtave në asnjë gjendje, por i akuzuari ka të drejtë të vërtetojë se vajta e tij në vendin e krimit ishte për një motiv të ligjshëm dhe për ndonjë motiv për të kryer krim.

dituria të arrihet prej ndonjë burimi tjetër, ose prej ndonjë tradite të afirmuar prej ligjvënësit, sepse dituria e marrë prej mjekësisë ligjore është argument në vetvete, madje është burim për të gjithë argumentet, përveç argumentit ligjor, madje me fjalën e ligjvënësit. Dituria e marrë prej mjekësisë ligjore është argument që merret në konsideratë dhe me atë vihen edhe kushte.

Do të theksojmë edhe një herë se dituria e arritur prej mjekësisë ligjore, prej lidhjes logjike e veshjeve të ankesës është një gjë dhe informacionet e veçanta, të cilat gjykatësi i mëson jashtë gjykatës e ankesa, janë një gjë të tjetër. Të gjithë fukahatë e juristët që e ndalojnë gjykatësin të gjykojë me këto dituri që ai merr, kanë qëllim t'i vënë detyrim gjykatësit që ai të marrë në konsideratë vetëm atë dituri që ka arritur të marrë prej mjekësisë ligjore dhe prej deduksionit ligjor.

Kur dituria nuk merret prej mjekësisë ligjore, atëherë puna lihet në vlerësimin e gjykatësit e në hapësirën e bindjes së tij, ose vlerësimin ai e bën duke u mbështetur mbi shembullin e ngjashëm, si njëri prej rrugëve që shërbejnë për vërtetim, ose si argument për të dobësuar ngjarjet, sepse specifikimi i ngjarjeve të jashtme, është prej sendeve objektive, prandaj nuk i referohemi ligjvënësit për të shpjeguar dhe për të njohur të vërtetën e atyre sendeve, pasi, në të vërtetë, njohjen e specifikimin ne e arrijmë me rrugët e njohura që praktikohen te njerëzit. Nisur nga këto shpjegime, rezulton se i akuzuari ka të drejtë të plotë të vërtetojë të kundërtën me të gjitha rrugët dhe të vërë në dyshim të dhënat e marra prej mjekësisë ligjore kundër tij, ose të kundërshtojë shembujt e ngjashëm. Kjo është e barabartë, qoftë kur prej atyre të dhënave merret dijëni, qoftë kur janë të dhëna prej të cilave nuk



merret dijani, përveç argumenteve për të cilat kemi tekst prej ligjvënësit.

Nisur nga rëndësia që ka gjykimi me të dhënat e mjekësisë ligjore në gjykatat e kohës, ishte e domosdoshme të theksohej roli i mjekësisë ligjore.

## ***Përmbledhje***

Në mënyrë të përmbledhur, themi: Çdo shembull i ngjashëm që ka lidhje me ankesën, gjykatësit i lejohet të mbështetet në shembullin e ngjashëm dhe mbi atë shembull të ngjashëm të ndërtojë gjykimin e tij, krahas ekzistencës së dijenisë së formës së prerë që ai ka. Kjo është e barabartë, qoftë kur shembulli i ngjashëm është prej llojit të mjekësisë ligjore, qoftë kur është prej deduksioneve logjike, qoftë kur është prej ndonjë burimi tjetër, për faktin e thjeshtë se dituria nuk ndahet mes një shkaku e një shkaku tjetër. Kur nuk arrihet dituria, atëherë vlerësimi i shembullit të ngjashëm i lihet gjykatësit. Nëse gjykatësi e shikon të arsyeshme, e shtron shembullin e ngjashëm, nëse mendon ndryshe, anon kah ndonjë argumenti tjetër, sipas bindjes që ai ka formuar dhe qetësisë së zemrës që ai gjen, në raport me lidhjen që ai ka me Krijuesin e tij të Gjithëpushtetshëm.

\* \* \*

## BETIMI (*el jeminu*)

Betimi është prej rrugëve më të rëndësishme mbi të cilat është ndërtuar gjykimi, duke theksuar se betimi është ligjësuar për të ndarë konfliktet dhe jo për të vërtetuar e për të zbuluar realitetin. Në lidhje me betimin, do të flasim sipas renditjes vijuese:

### ***Detyra e mohuesit***

Më sipër thamë se ankuesi, pretenduesi, është personi që, sikur të heqë dorë, patjetër që ankesa lihet, kurse personi kundër të cilit ngrihet ankesa, mohuesi, edhe sikur të heqë dorë, ai nuk mund të lihet. Nga ky këndvështrim, detyra e pretenduesit konsiston në përforcimin e pretendimit të tij me argument, kurse detyra e mohuesit konsiston në betimin që duhet të bëjë. Mund t'i kërkohej të betohet edhe pretenduesit, si për shembull, kur personi i besueshëm pretendon se sendi që ai kishte nën ruajtje, u asgjësua as për shkak se mbi atë send është vënë dorë prej tij e as për shkak të moskujdesit për sendin nga ana e tij.

Ndodh që mohuesit të mos i pranohet betimi, si për shembull, kur ai është i prokuruar, ose kujdestar, ose i porositur.

Sido që të jetë, në shumicën e rasteve, personi që betohet është mohues dhe ai që ka argumentin është pretendues. Këtë çështje fukahatë e kanë referuar në fuqinë e mohimit e të marrjes më forcë, sepse mohimi përputhet me origjinën dhe dobësinë e vërtetimit, për shkak të kundërshtimit që i bën mohuesi vërtetimit. Në këtë gjendje, pretenduesi i rikthehet argumentit që të ballafaqojë argumentin me një argument më të fuqishëm.

### ***Kushtet e betuesit***

Për betuesin janë të njëjtat kushte që veprojnë për kontratat dhe veprimet obliguese: mendja, arritja e moshës së pjekurisë seksuale dhe aftësia e betuesit për të përzgjedhur, duke shtuar mbi këto edhe të drejtën e betuesit për të kërkuar rrëzimin e ankesës, si dhe të drejtën e tij për t'u betuar pa kërkesën e gjykatësit, domethënë të drejtën e tij për të bërë betim të vullnetshëm, por nuk është i vlefshëm betimi i të prokuruarit, i të porositurit dhe i kujdestarit.

Gjithashtu, nuk është i vlefshëm as betimi i mendjeshkurtrit për punët që ai e ka të ndaluar të veprojë.

Vetëkuptohet se, kur personi me mangësi ka për të marrë borxh prej një tjetri dhe borxhmarrësi pretendon se ai ia ka dorëzuar shumën e borxhit të porositurit, por i porosituri mohon të ketë marrë shumën në fjalë, në këtë gjendje, prej të porositurit kërkohet që ai të betohet. Duhet theksuar se, në raport me të porositurin, kjo është një ankesë personale. Kur i porosituri betohet, gjykohet mbetja e borxhit mbi borxhmarrësin. Nëse i porosituri nuk e pranon të betohet dhe betohet pretenduesi, në

këtë gjendje, gjykohet se shumën ka detyrim ta paguajë i porosituri, sepse mospranimi e refuzimi është në pozitën e miratimit në favor të pretenduesit, ose, nëse dëshiron, thuaj: “Ai është personi që gjykoi kundër vetes së tij, derisa kishte një rrugëdalje e hapësirë për të dalë prej gjykimit. Kriteri për vlefshmërinë e betimit është që sendi për të cilin kërkohet betimi, të jetë punë e vetë betuesit, ose ai ka dijeni për punën e një tjetri, pasi të dyja këto janë prej punëve të tij.

Për sa i përket kriterit për formën e për mënyrën e betimit nga ana e betuesit, fukahatë kanë thënë: “Nëse pretendimi ka lidhje me punën e betuesit, ai betohet për atë që është realisht. Nëse pretendimi ka lidhje me punën e një tjetri, ai betohet për të mohuar se nuk ka dijeni për atë punë.”

Në të vërtetë, ky kriter është ndërtuar duke pasur në konsideratë shumicën e rasteve, por kriteri i vlefshëm e i saktë është që betimi të bëhet pas përgjigjes së betuesit. Nëse betuesi përgjigjet, ai mohon realitetin dhe, në mënyrë absolute, betohet kundër realitetit. Nëse ai përgjigjet duke mohuar se nuk ka dijeni, ai betohet për të mohuar pasjen dijeni pa asnjë dallim në gjendjet mes asaj që sendi për të cilin ai betohet të jetë në favorin e tij dhe prej punëve të tij, ose prej punëve të një tjetri.

Kur ankuesi pretendon në prani të trashëgimtarit se trashëgimlënësi i tij ka marrë kredi, ose ka rrëmbyer dhe trashëgimtari përgjigjet se trashëgimlënësi i tij as nuk ka marrë kredi e as nuk ka rrëmbyer, patjetër që betohet në mënyrë të prerë. Nëse ai përgjigjet se ai nuk ka dijeni në lidhje me këtë pretendim, në këtë gjendje, ai betohet për të mohuar pasjen dijeni.

## Objekti i betimit

Objekti i betimit është e drejta për të cilën kërkohet betimi dhe është kusht që gjykimi, me këtë betim, të jetë i vlefshëm, qoftë vërtetim, qoftë mohim, në atë mënyrë sikur të betohet, mohuesi gjykohet për pafajësinë e tij, ose kur betohet pretenduesi, vërtetohet e drejta e tij. Kjo e drejtë përfshin sendin, borxhin, kontratat obliguese, deliktet, gjendjet personale etj, me përjashtim të të drejtave të Allahut, domethënë dënimet e ndëshkimet (*el hudud*). Për sa i përket betimit shterp, nuk është i vlefshëm ndërtimi i gjykimit mbi këtë lloj betimi dhe asnjërit prej dy të konfliktuarve nuk i thuhet ti je pretenduesi dhe ti tjetri je mohuesi.

Prej shembujve të kësaj çështjeje përmendim rastin, kur një burrë i shet shtëpinë e tij Zejdit. Më pas vjen një i tretë dhe pretendon se ai e ka blerë atë shtëpi më përpara. Kur shitësi e mohon ta ketë shitur shtëpinë më parë, atij nuk i kërkohet të betohet, pasi, edhe sikur ai të pohojë për shitjen e mëparshme, pohimi i tij nuk merret në konsideratë, sepse e drejta i takon një tjetri. Kur betimi s'ka asnjë ndikim, për betimin nuk mbetet më objekt për të cilin kërkohet betimi.

E njëjta gjë është kur një person i thotë një tjetri: "Unë te ti kam një dëshmi dhe të kërkoj që atë dëshmi ta bësh para gjykatësit.", mirëpo ai mohon dhe thotë: "Te unë ti s'ke asnjë dëshmi." Në këtë gjendje, mohuesit nuk i kërkohet betim, sepse, edhe sikur ai të pohojë, kundër tij nuk gjykohet asgjë, sepse mohuesi i dëshmisë mban përgjegjësi vetëm para Allahut.

## **Formula e betimit**

Fukahatë e medh'hebeve ndajnë një fjalë të përbashkët: Betimi bëhet vetëm në Allahun e Lartësuar dhe në asgjë tjetër. Nuk thuhet: "Pasha Kur'anin!", ose "Betohem për profetët!", ose "Betohem për Ditën e Fundit!", ose "Betohem për Qaben!", ose "Betohem për engjëjt!", etj.

Në hadithin e nderuar thuhet: "Mos u betoni në asgjë tjetër përveçse për Allahun. Kush betohet për Allahun, besojeni. Kur për sendin betohet në Allah, le të jeni të kënaqur me atë send dhe, nëse ai nuk është i kënaqur, kjo nuk është prej Allahut."

Në një hadith tjetër, thuhet: "Kush betohet, le të betohet vetëm në Allah, ose le të heshtë."

Për betimin, fukahatë kanë përmendur disa forma: formula, por të gjitha kanë të njëjtin kuptim. Prej këtyre formave betimi kemi: "*uell'llàhi*"- "Pasha Allahun! Betohem në Allah!", duke e reduktuar betimin vetëm në emrin e lartë Allah; ose betohet duke thënë "*ull'llàhi là ilàhe il'là hù*"-"Pasha Allahun, që s'ka Zot tjetër përveç Atij!", ose mbi betimin e mëparshëm shton edhe dy fjalë prej emrave të bukur të Allahut dhe thotë: "*ull'llàhi l'ledhij là ilàhe il'là huve semij'ul alijm*" Pasha Allahun, që s'ka Zot tjetër përveç Atij, Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri!".

Jomyslimani betohet në përputhje me kushtet e vendosura në fenë e tij, por betimi i tij pranohet, edhe kur preferon të thotë: "Pasha Allahun!", ose "Betohem në Allah!", ose "Për Allah!".

Te imamijtë është veprim i pëlqyer (*mustehab*) që betimi në Allah të shoqërohet me emrat e bukur të Allahut që shprehin frikësim, domethënë që betuesi ka të drejtë të betohet edhe sipas kësaj formule: “*ull’lāhil muhlikil mudriki t’tālibil gālibil muntekimil xheb’bār*”-“Pasha Allahun, Shkatërruesin, Arritësin, Kërkuesin, Mposhtësin, Asgjësuesin!”.

Kjo është formula ligjore e betimit dhe kundërshtari nuk ka të drejtë të imponojë formulën e betimit që ai dëshiron.

### ***Ndarjet e betimit***

Ligjvënësit e sotëm e kanë ndarë betimin në dy lloje: në betim gjyqësor, domethënë betimi i bërë në sallën e gjykimit dhe në betim jo gjyqësor, që është betimi i bërë jo në sallën e gjykimit, plotësisht ashtu siç është te ata, te ligjvënësit e ligjeve, në lidhje me pohimin.

Më pas, betimin gjyqësor ata e kanë ndarë në dy lloje: betim i vendosur, domethënë, betimi që i kërkon kundërshtari kundërshtarit të tij në pamundësi për të vërtetuar të drejtën e tij me argument, por ai e kërkon betimin, me qëllim që të ndahet konflikti. Akoma më tej ata e kanë ndarë betimin në betim plotësues, domethënë betimi që i kërkon gjykatësi njërit prej dy të konfliktuarve, me qëllim që të plotësohen argumentet që ai ka në dorë.

Te imamitë s’ka asnjë ndikim betimi që bën betuesi pa lejen e gjykatësit. Kjo është e barabartë, qoftë kur betimi bëhet në sallën e gjykimit, qoftë kur bëhet jashtë sallës së gjykimit. Për sa i përket

fjalëve që zakonisht kundërshtari i thotë kundërshtarit tjetër: “Betohu dhe unë të toleroj”!, ose “Betohu dhe unë të liroj prej akuzës!” dhe ai betohet. Me këtë betim, betuesi nuk detyrohet me asgjë dhe ankesa mes atyre të dyve mbetet ashtu siç ishte.

Vetëkuptohe se, kur është e pamundur ardhja e origjinës në sallën e gjykimit për shkak sëmundje, ose për ndonjë shkak tjetër dhe i kërkohet betimi, në këtë gjendje, gjykatësit i lejohe të autorizojë dikë që ta zëvendësojë atë në marrjen e betimit. Ky betim është në të njëjtën pozitë sikur betimi të ishte bërë në sallën e gjykimit. Është e rëndësishme që betimi të ketë ndodhur me lejen e gjykatësit hulumtues. Nëse betimi bëhet pa lejen e gjykatësit, është thjesht fjalë pa vlerë, qoftë edhe kur betimi bëhet në sallën e gjykimit. Betimi është ligjor dhe gjykatësi, bazuar mbi atë betim, merr vendim, kur betimi arrihet me lejen e gjykatësit, qoftë edhe kur arrihet, gjithnjë me lejen e gjykatësit, në ndonjë vend tjetër dhe jo në sallën e gjykimit.

Kush ndjek fjalët e fukahave dhe i krahason ato me thëniet e juristëve të ligjeve moderne, do të gjejë se thëniet e të dyja palëve, në lidhje me ndarjen e betimit, në rezultanten, janë së bashku dhe betimin e ndajnë në: betim përfundimtar dhe betim jo përfundimtar. Gjithashtu, do të gjejë se kundërshtimi mes fukahave e juristëve të rinj qëndron në besueshmërinë e në përputhjen dhe secila palë mendon se betimi përfundimtar është betimi me të cilin mbështetet ankesa. Por juristët e rinj e kanë bërë betimin përfundimtar të dalë prej ankesës, ose prezantimin e ankesës me betim të cilin kundërshtari ia kërkon kundërshtarit.

Ky betim atakohet, kur një person ankohet ndaj një trashëgimtari, duke pretenduar se në dorën e tij është trashëgimia



që i ka lënë trashëgimlënësi dhe ky trashëgimtar ka dijëni se pretenduesi ka për të marrë një borxh prej trashëgimlënësit, mirëpo trashëgimtari e mohon që ka dijëni për borxhin e pretenduar dhe betohet që të mohojë se ai nuk ka dijëni. Ky betim i trashëgimtarit e rrëzon pretendimin e pasjes dijëni për borxhin, por nuk rrëzon ankesën për borxhin. Pas këtij betimi, ankuesit i lejohet të sjellë argumente për të mbështetur pretendimin e tij. Bazuar mbi këtë që u tha, betimi nuk është përfundimtar, megjithëse i është kërkuar prej kundërshtarit dhe jo prej gjykatësit.

O Zoti madh, vetëm nëse thuhet që ai betim është përfundimtar në raport me pretendimin e pasjes dijëni për borxhin.

Betimi plotësues mund të jetë përfundimtar, siç është betimi që i bashkohet dëshmitarit në të drejtat pasurore, megjithëse juristët e rinj e konsiderojnë betim jo përfundimtar. Sido që të jetë, betimi përfundimtar, ashtu siç e kuptojmë ne, është betimi me të cilin mbështetet kapitulli i konfliktit e armiqësia e ndërsjellë, kurse betimi jo përfundimtar është betimi që, në këtë kapitull, mbetet i hapur plotësisht, duke theksuar që betimi jo përfundimtar është më afër argumentimit të fjalës betim jo përfundimtar që përdoret në terminologjinë e juristëve të rinj.

Fukahatë imami e kanë ndarë betimin përfundimtar në dy pjesë: betim i mohimit dhe betim i vërtetimit, ashtu siç thuhet në gjykimin e mulla Aliut, duke theksuar se prej betimit të vërtetimit del betimi i refuzuar, betimi i bashkëngjitur, si dhe betimi memorizues (betimi me të cilin kërkohet ruajtja).

## **Betimi i mohimit**

Më sipër kemi përmendur se personi kundër të cilit bëhet ankesa: ose hesht, ose pohon, ose mohon. Në lidhje me dispozitën e heshtjes e të pohimit, kemi folur. Tani do të njihemi me dispozitën e mohimit.

Kur personi kundër të cilit ngrihet ankesa, përgjigjet negativisht, domethënë e mohon ankesën, gjykatësi e pyet ankuesin: “A ke argument?” Nëse ai ka argument, e paraqit argumentin, ndryshe gjykatësi i lë të kuptojë se ai ka të drejtë të kërkojë prej kundërshtarit të tij që ai të betohet. Nëse ai e kërkon betimin, atëherë gjykatësi i kërkon kundërshtarit të betohet, por gjykatësit vetë nuk i lejohet të kërkojë betim prej tij pa kërkesën e ankuesit, sepse betimi është një e drejtë e veçantë që i takon vetëm ankuesit, i cili mbase ka interes të kërkojë betimin, me shpresë se do të arrijë pajtim, ose mohuesi do të heqë dorë prej qëndrimit të tij, ose ai parashikon ekzistencën e dëshmitarëve, ose ndonjë gjë tjetër.

Gjithashtu, as mohuesit nuk i lejohet të nxitojë të betohet pa i kërkuar gjykatësi betimin. Kur mohuesi betohet pa i kërkuar gjykatësi betim, ose ai betohet me kërkesën e gjykatësit, por pa kërkesën e ankuesit, betimi i tij mbetet fjalë boshe.

Kur mohuesi betohet me kërkesën e ankuesit dhe me kërkesën e gjykatësit, ankesa rrëzohet dhe pas kësaj ankuesi s’ka të drejtë të kërkojë asgjë, madje edhe sikur ai të ketë në favor të ankesës së tij një mijë argumente.

Gjithashtu, pas këtij betimi ankuesi s’ka të drejtë të vërtetojë gënjeshtren e betuesit me ndonjërin prej rrugëve të

vërtetimit, ashtu siç thuhet në hadithin e nderuar: “Betimi e fshin të drejtën e ankuesit”

Në hadithe të tjera tregohet se dikush është ankuar te Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) me këto fjalë: “Një hebre më tradhtoi me një mijë dirhemë. Për këtë gjë ai u betua. Më pas doli se ai kishte te unë mall. A të marr prej mallit të tij, që është te unë si kompensim për pasurinë time?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha ankuesit: “Nëse ai të tradhtoi ty, ti mos e tradhto atë. Nëse ai të bëri padrejtësi, ti mos i bëj atij padrejtësi dhe mos hyr në atë kallëp me të cilin ti qortove atë. Sikur ti të mos kishe kërkuar betim prej tij e të mos ishe i kënaqur me betimin e tij, patjetër që do të urdhëroja të marrësh prej pasurisë së tij, që gjendet në dorën tënde, por ti mbete i kënaqur me betimin, mirëpo dhe betimi e ka fshirë pretendimin që kishe te ai.”

Kjo është edhe brendia e asaj që thuhet në ligjet moderne, në të cilat shprehet qartë: Kur kundërshtari mbetet i kënaqur prej betimit të kundërshtarit të tij, konsiderohet heqje dorë prej të drejtës së pretenduar.

Nuk është e nevojshme të silllet shpjegim se betimi merret në konsideratë praktikisht dhe jo për shkak të gatishmërisë për betim. E theksojmë këtë të vërtetë të qartë për faktin se ka gjykatës që i thonë ngritësit të ankesës: “Duhet të mjaftohemi me këtë gatishmëri, sepse ai që ka gatishmërinë të betohet, është plotësisht si ai që betohet, për rrjedhojë, për ankuesin nuk mbetet më asnjë rrugë për të marrë të drejtën e tij. Nëse me rrugën e betimit mund të arrihet ndonjë send, ankesa mbetet ashtu siç ishte.”

Kur ankuesi thotë: “Nuk e pranoj betimin e personit kundër të cilët është ngritur ankesa.”, ashtu siç ndodh në disa raste, gjykatësi i thotë ankuesit se ai ka të drejtë të bëjë njërën prej

tri përzgjedhjeve: ose të sjellë argument kundër kundërshtarit të tij, ose të pranojë betimin e mohuesit, ose të heqë dorë prej ankesës së tij, duke i lënë të kuptojë se ai s'ka të drejtë të veprojë arbitrarisht sipas mendjes së tij, edhe nëse i është i bindur me zgjedhjen e tij, ndryshe gjykatësi e shtyn shqyrtimin e çështjes për aq kohë sa ai mendon se është e nevojshme. Nëse ankuesi vazhdon të këmbëngulë në mendimin e tij, atëherë ankesa refuzohet përkohësisht, domethënë se ankuesi ka mundësi ta ringrejë atë ankesë, kur të ketë gati argumentet, ose kur të jetë dakord për të pranuar betimin e kundërshtarit. Me një fjalë, gjykatësi s'ka të drejtë të refuzojë betimin e kundërshtarit të ankuesit e as të ndalojë ankuesin, që të sjellë argument, derisa ankuesi vazhdon të këmbëngulë në ankesën e tij.

Gjykatësi, nga ana e tij, s'ka të drejtë të kërkojë betim prej mohuesit, me argumentin se ai është kujdestari i të pamundurit, sepse kujdestaria e gjykatësit është specifike vetën në garantimin e të pamundurit që ai të marrë të drejtën e tij.

Autori i librit "El Xheuahir", në kapitullin "Gjykimi", ka thënë: "S'ka argument që të tregojë se gjykatësi zë vendin e të ndaluarit, qoftë për detyrimet që duhet të plotësojë i ndaluari, qoftë për të drejtat që ai duhet të marrë, domethënë që i pamunduri është dy persona: njëri është personi që duhet të plotësojë detyrimin dhe tjetri është personi që ka për të marrë të drejtën, domethënë se gjykatësi është kujdestar për të parin, që, siç thamë, është personi të cilit i kërkohet të plotësojë detyrimin. Nëse ai nuk e plotëson detyrimin, atëherë gjykatësi e merr me forcë të drejtën prej tij. Kurse për të dytin, domethënë për të pamundurin që ka për të marrë të drejtën, gjykatësi nuk mund të jetë kujdestar për të dhe betimi i mohuesit këtu është një e drejtë që i takon

vetëm ankuesit dhe nuk është detyrim që ai duhet të plotësojë, por kjo, domethënë, burimi, nuk është përgjithësues për rregullin.

### ***Betimi i refuzuar***

Tani e mësove se, kur personi kundër të cilit ngrihet ankesa betohet, ankesa e pretenduesit rrëzohet përfundimisht. Nëse ai nuk betohet, atëherë gjykatësi i kërkon ankuesit të betohet. Nëse ankuesi refuzon të betohet, atëherë refuzimi është i përbashkët.

Para çdo gjëje duhet të theksojmë se nuk lejohet kalimi i betimi prej mohuesit te personi kundër të cilit është ngritur ankesa, përveçse me dy kushte.

*Kushti i parë:* Ankuesi është i vendosur në ankesën e tij dhe, nëse është supozues ose dyshues, atëherë nuk lejohet që betimi të sprapsset prej tij. *Kushti i dytë:* E drejta që rëndon mbi personin kundër të cilit është ngritur ankesa, të jetë e vetë ankuesit dhe jo e drejtë e ndonjë tjetri, i cili mund të jetë i prokuruar, ose kujdestar, ose i porositur, betimi prej tij nuk është i vlefshëm, sepse është e drejtë që i takon një tjetri, mirëpo betimi i tjetrit nuk vërtetohet. Kur mungon njëri prej këtyre dy kushteve, s'ka as refuzim, për shkak se është i pamundur të ndodhë. Kur vërtetohen të dy kushtet së bashku, refuzimi është i vlefshëm.

Bazuar mbi këtë rregull, kur ankuesi është i vendosur dhe origjinal, mirëpo personi kundër të cilit është ngritur ankesa, e hedh poshtë betimin e ankuesit, nëse ankuesi betohet, atëherë vërtetohet ankesa e tij dhe vendoset me të drejtën e tij kundër personit mbi të cilin është ngritur ankesa. Nëse ankuesi tërhiqet

prej betimit të refuzuar, ankesa e tij, kundër mohuesit, rrëzohet përfundimisht.

Kur mohuesi abstenon, domethënë refuzon të betohet dhe në të njëjtën kohë kundërshton, a gjykon gjykatësi kundër tij vetëm për shkak të refuzimit të tij për të mos u betuar, apo gjykatësi e kalon betimin te ankuesi?

Hanefitë dhe hanbelitë kanë thënë se gjykohet kundër tij thjesht për faktin se ai refuzon të betohet dhe për shkak të kalimit të betimit te ankuesi, kur ankesa është për pasuri, ose për ndonjë qëllim me të cilin arrihet pasuri.

Malikitë kanë thënë se duhet të refuzohet në ankesat pasurore.

Shafitë kanë thënë se refuzimi është i domosdoshëm në të gjitha ankesat. ("El Mugnij", vëll. 9, K. "Gjykimet")

Imamitë kanë kundërshtime mes tyre dhe pjesa me e madhe e fukahave imami janë shprehur se gjykatësi nuk gjykon me refuzimin e personit kundër të cilit është ngritur ankesa, pasi gjykatësi ka të drejtë të kërkojë betim prej ankuesit.

Autori i librit "El Xheuahir", pasi ka përmendur gjerë e gjatë argumentet e të dyja palëve dhe i ka diskutuar ato nga ana logjike, ka thënë: "Me këtë për ty bëhet e qartë se në argumentet e të dyja palëve ka vend për të shikuar, pasi në tekst s'ka shpjegim për detyrën e gjykatësit për këtë qëllim."

Derisa teksti nuk e bën detyrim mbi gjykatësin të refuzojë, ne jemi së bashku me autorin e librit "Esh'sheràiu", i cili ka preferuar gjykimin, thjesht për shkak të frenimit për t'u betuar.

*Argumenti ynë i parë* është: Këtu s'ka kujdestari për gjykatësin, sepse e drejta i takon abstenuesit dhe kjo e drejtë është refuzimi, sepse gjykatësi është kujdestar vetëm për të pamundurin që nuk e shlyen dot detyrimin që ka, ashtu siç e përmendëm disa rreshta më sipër.

*Argumenti ynë i dytë*: Për abstenuesin ka hapësirë e vend dalje për gjykimin kundër tij, pasi ai ka mundësi të betohet pa u vënë në pozitë, derisa ka dijeni që është krejtësisht i pafajshëm dhe nuk mban asnjë përgjegjësi. Atëherë frenimi i tij për të mos u betuar, përbën një pohim që vërteton se e drejta është te ai, prandaj ai ka detyrim ta plotësojë atë të drejtë. Pikërisht për këtë është thënë: "Ai që frenohet prej përzgjedhjes, në të vërtetë, ka përzgjedhur."

Rezultati do të jetë: Abstenuesi është ai që gjykon veten me veten e tij. Fjala më e përmbledhur do të rezultojë në këto forma:

- 1- Kur betohet mohuesi, rrëzohet ankesa e pretenduesit.
- 2- Kur mohuesi e kalon betimin mbi ankuesin dhe ankuesi frenohet të betohet, gjithashtu e ka humbur ankesën e tij.
- 3- Kur betohet ankuesi, pasi mbi të është hedhur betimi, gjykohet në favor të pretendimit të ankuesit.
- 4- Kur frenohet të betohet mohuesi dhe abstenon të betohet e të refuzojë betimin, gjykohet kundër mohuesit, thjesht për faktin se ai u frenua të betohet.

### ***Betimi plotësues***

Është plotësisht veprim i saktë që ky betim të emërtohet betim plotësues, domethënë betimi që përfshihet në dëshminë e një dëshmitari të vetëm, ose në dëshminë e dy grave për të vërtetuar të drejtat pasurore. Më sipër është folur për këtë, në kapitullin “Pjesët e të drejtave”, pjesë e kapitullit “Dëshmia”.

### ***Betimi memorizues (ruajtës)***

Nuk dëgjohet ankesa e paraqitur prej trashëgimtarëve kundër trashëgimlënësit të tyre për ndonjë të drejtë prej të drejtave pasurore, përveçse kur i vdekuri ka lënë pasuri në duart e trashëgimtarëve. Sikur i vdekuri të mos ketë lënë asgjë, ose ka lënë pasuri në dorën e të tjerëve dhe jo në dorën e trashëgimtarëve, ankesa nuk pranohet në çdo formë e gjendje që mund të jetë ngritur, sepse trashëgimtari, në këtë gjendje, është plotësisht si një i huaj, domethënë si një person që s’ka asnjë lidhje me atë trashëgimi.

Kur i vdekuri lë pasuri në dorën e trashëgimtarëve, ankesa kundër të vdekurit dëgjohet, ose ankesa vërtetohet vetëm me argument dhe me betimin e ankuesit. Pikërisht ky është betimi memorizues. Qëllimi me këtë betim është vërtetimi se borxhi mbetet në ngarkim të të vdekurit, deri në kohën e vdekjes së tij dhe borxhdhënësi as nuk e shkarkon të vdekurin prej përgjegjësisë për të shlyer borxhin, as nuk pohon dot që e ka marrë borxhin, ose që është kompensuar për borxhin.



Këtë betim, Imam Shafiji e ka bërë detyrim në ankesat kundër fëmijës e kundër të çmendurit, kurse Imam Maliku këtë betim e ka bërë detyrim për personin që jeton, kur ankesa është për një send dhe nuk e ka bërë detyrim në ankesat e ngritura për borxhin. (“El Furûk”, vëll. 4)

Ndër librat e fik’hut që gjenden te unë, s’kam gjetur ndonjë tjetër përveç imamive që të këtë shtuar këtë betim në argumentimin e ankesës kundër të vdekurit. Sido që të jetë, ky betim mbase mund të jetë detyrim i veçantë në ankesën kundër të vdekurit, vetëm nëse bëhet fjalë për borxh dhe për sende, me kusht që ankuesi të jetë origjinal, jo i prokuruar, ose i porositur, ose kujdestar, madje as trashëgimtar. Gjithashtu, kërkohet që ankuesi të jetë i vendosur në ankesën e tij, të mos jetë as supozues e as dyshues, duke ditur se asnjërit prej këtyre që u përmendën nuk i kërkohet betim.

Sikur prej kujdestarit dhe të porositurit të mos pranohej ankesa e mbështetur vetëm me argument, patjetër që e drejta e atyre të dyve do të shkonte humbur. Vetëkuptohet që gjykatësi ka detyrim të dyfishojë punën e tij në hetimin e në hollësitë mbi ankesën kundër të vdekurit, kundër fëmijës dhe kundër të çmendurit, pasi kujdestarin dhe të porositurin gjykatësi i ngarkon me përkujdesje të plotë. Kjo është e barabartë, qoftë kur ankesa është për send, qoftë kur është për borxh.

Kur borxhdhënësi ka për të marrë prej të vdekurit dhe sjell vetëm një dëshmitar, ky dëshmitar ka detyrim të betohet dy herë, njërin betim e bën si plotësues për argumentin dhe betimin e dytë e bën si betim memorizues.

Autori i librit “El Xheuahir”, në kapitullin “Gjykimi”, ka thënë: “Kjo thënie qëndron, në radhë të parë, madje është thënia më e fuqishme.”

Autori i librit “Mulhakatul Urveh”, ka thënë: “Në të vërtetë, kjo është më e dukshme dhe më e qëndrueshme.”

Patjetër duhet të tërheqim vëmendjen për disa punë që kanë lidhje me këtë çështje:

*Prej këtyre punëve kemi:* Ky betim, në të vërtetë, është i vlefshëm, vetëm kur bëhet me kërkesën e gjykatësit dhe nuk është i vlefshëm, kur bëhet me kërkesën e trashëgimtarit, as kur ankuesi dëshmon pa i kërkuar gjykatësi të betohet.

*Prej këtyre punëve kemi:* Kur trashëgimtari ka dijeni për borxhin që kishte detyrim të shlyente i vdekuri, ai duhet të mbajë besën e të shlyejë borxhin pa qenë nevojë të ngrihet ankesë, apo të sillt argument, apo të betohet.

*Prej këtyre punëve kemi:* Kur personi që ka për të marrë të drejtën e ka vënë në dijeni trashëgimtarin për të drejtën e tij dhe kërkon prej tij të betohet për mohimin që bën se ai është vënë në dijeni prej borxhdhënësit, por trashëgimtari refuzon të betohet, në këtë gjendje, vërtetohet e drejta që duhet të plotësojë në raport me pjesën e tij të trashëgimisë.

*Prej këtyre punëve kemi:* Kur i vdekuri ka thënë: “Kushdo që pretendon se te unë ka ndonjë të drejtë për të marrë.”, ai thotë të vërtetën. Kjo fjalë e të vdekurit është porosi dhe, në këtë gjendje, e drejta e kërkuar nxirret prej një të tretës së trashëgimisë, përveçse kur e drejta e tij vërtetohet me argument ligjor.

*Prej këtyre punëve kemi:* Kur një person pretendon se ka për të marrë borxhin prej një personi tjetër, por pas ngritjes së ankesës te gjykatësi dhe para daljes së vendimit, personi mbi të cilin pretendohet borxhi, vdes, në këtë gjendje, mjaftohet vetëm me argumentin dhe s'ka përse të kërkohet betim.

### ***Gënjeshttra e betuesit***

Kur gënjeshttra e betuesit bëhet e qartë, qoftë kur betues është ankuesi, qoftë personi kundër të cilit është ngritur ankesa, si gjykohet në këtë gjendje?

*Përgjigje:*Gënjeshttra e betuesit herë mësohet prej pohimit të tij, si për shembull, ai përgënjeshton vetveten dhe ka thënë qartë se e drejta i takon kundërshtarit të tij dhe ai ka gënjyer në betimin e tij, herë tjetër mund të mësohet me ndonjë rrugë tjetër dhe jo me pohimin e vetë betuesit, apo kur vetë thotë betuesi thotë se ka gënjyer.

Nëse betuesi përgënjeshton vetveten, gjykimi i bërë në bazë të atij betimi, prishet dhe ai që ka për të marrë të drejtën, lejohet të kërkojë të drejtën e tij prej betuesit me të gjitha rrugët. Kur gënjeshttra e betuesit mësohet prej argumenteve e prej shembujve të ngjashëm, përveç pohimit, askush s'ka të drejtë të kërkojë prej tij ndonjë send, përveçse kur gjykatësi prish gjykimin e tij.

Vetëkuptohet, se kushdo që ka dijeni për gënjeshtren e betuesit, ai ka detyrim të rendisë efektet e diturisë së tij, si për shembull, sikur ai të betohet se shtëpia që është në dorën e tij, është pronë e tij, kurse ti e di që ajo shtëpi është pronë e Zejdut dhe

ty nuk të lejohet ta blesh atë shtëpi, ose ta marrësh atë shtëpi me qira prej këtij betuesi, gjithashtu, nuk të lejohet të veprohet me atë shtëpi me asnjë lloj veprimi, përveçse me lejen e pronarit të saj original, por askujt, madje as vetë pronarit nuk i lejohet të kërkojë ndonjë send prej atij betuesi.

Ky është edhe dallimi që ne përmendëm mes faktit kur betuesi përgënjeshton vetveten dhe mes faktit, kur ne mësojmë për gënjeshtren e betuesit me ndonjë rrugë tjetër, përveç rrugës së pohimit, duke ditur se gënjeshttra, në të dy rastet, është e vërtetuar në të dyja gjendjet.

Në të vërtetë, ky dallim s'ka mbështetës tjetër përveç tekstit dhe veneracionit ndaj fjalës së ligjvënësit, ashtu siç ka thënë autori i librit "El Xheuahir".

Si përfundim, po themi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Betimi e fshin të drejtën që është në sendin objekt i betimit dhe e bën pa vlerë gjithçka që pretendon ankuesi."

Prej këtij teksti mësohet se ankuesi që ka për të marrë të drejtën, e drejta e ankuesit nuk ekziston më për atë, pas betimit të gënjeshtërt dhe bëhet sikur kjo e drejtë e tij të mos ekzistonte fare, me përjashtim të rastit kur betuesi përgënjeshton veten e tij dhe pohon se është e vërtetuar e drejta që ai duhet të plotësojë.

\* \* \*

## POROSITË (el uesaja)

### **Kuptimi i fjalës “el uesaja”**

Fjala arabe “el uesàjà”, është shumësi i fjalës “uesij’jeh”. Kjo fjalë përdoret në disa kuptime: në kuptimin e arritjes së një sendi. Kur ti, për shembull, thua: “Lashë porosi sendin me një send.”, kur ti e arrin sendin me atë send.

Përdoret për paraqitjen te tjetri me një send, kur prej tij kërkohet që ai të bëjë një punë.

Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe në kuptimin e urdhrit e të porosisë, ashtu siç ka ardhur në fjalën e Allahut të Lartësuar:

“وَأَوْصَانِي بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ”

“...dhe më ka urdhëruar me (të fal) namaz e me (të jap) zekat...”  
(Sure “Merjem” ajeti 31)

Kjo fjalë përdoret, kur dikush porosit një tjetër të bëjë ndonjë veprim të veçantë me pasurinë e tij pas vdekjes së tij. Pikërisht ky kuptim është qëllimi në këtë studim. Shumë fukaha këtë porositje e kanë njohur me emrin testament dhe kanë thënë se

testament do të thotë marrje në pronësi e një sendi të caktuar, ose e një dobie të dalë prej sendit në fjalë pas vdekjes së porosilënësit. Ky kusht i fundit, domethënë pas vdekjes, patjetër duhet të theksohet, me qëllim që të nxirren jashtë testamentit veprimet që bën vetë njeriu me pasurinë e tij gjatë jetës së tij, sepse ato veprime të tij s'kanë të bëjnë fare me testamentin.

### ***Ligjërimi i testamentit***

Testamenti është ligjëruar me Librin e Allahut, me Sunetin dhe me fjalën e përbashkët të fukahave, madje ligjërimi i testamentit është bërë ndër domosdoshmëritë e ligjit të fesë. Theksojmë se disa ajete të Kuranit Famëlartë dhe disa transmetime janë mbartur në kuptimin për të nxitur optimizmin dhe me kaq mjafton, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar, në suren “El Bekare”, në ajetin 180:

“كُتِبَ عَلَيْكُمْ إِذَا حَضَرَ أَحَدَكُمُ الْمَوْتُ إِنْ تَرَكَ خَيْرًا الْوَصِيَّةَ لِلْوَالِدَيْنِ وَالْأَقْرَبِينَ بِالْمَعْرُوفِ”

**“Për ju është bërë obligim ashtu siç është e drejta që kur ndonjërit prej jush i afrohet vdekja dhe lë pasuri, ai të shkruajë testamentin më të mirë për prindërit e për të afërmit...”**

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Ai që nuk e bën mirë testamentin e tij, kur i afrohet vdekja, kjo është një mangësi në burrërinë e në mendjen e tij.”

Fukahatë kanë një fjalë të vetme se bërja e testamentit është veprim i pëlqyeshëm (*mustehab*). Për këtë thënie ata janë bazuar në

fjalën “kutibe”-“u shkrua”, është bërë obligim, të ajetit të mësipërm. Disa fukaha janë shprehur se shkrimi i testamentit është obligim taksativ, por shumica e fukahave kanë thënë se shkrimi i testamentit është obligim, kur testamentlënësi ka për të shlyer detyrime që kanë të bëjnë me të drejtat e Allahut, ose me të drejtat e njerëzve, pasi testamentlënësi ka menduar vdekjen dhe ka frikë se të drejtat që ai ka detyrim të shlyejë, do të humbin pas vdekjes së tij. Pikërisht në këtë kuptim është mbartur e vërteta e njoftimit: *“Ai që vdes pa bërë testamentin, vdes siç vdisnin në kohën e injorancës para Islamit.”*

## **Formula**

Kushdo që ndjek burimet e testamentit, do të shikojë se testamenti nuk bëhet vetëm sipas një modeli. Në disa raste testamenti bëhet nisur thjesht prej ofertës, pa qenë nevojë të dëgjohet përgjigjja e pranimit, si për shembull, dikush i lë porosi një tjetër, që me pasurinë që ai do të lërë, të shlyejë borxhin që ka detyrim të shlyejë porosilënësi, ose i lë atij porosi që, pas vdekjes së tij, të kujdeset për fëmijët e tij. Kjo lloj porosie quhet Testament mbrojtjeje (kujdestarie).

Gjithashtu, pranimi nuk është kusht, kur testamenti është bërë pa adresë të përcaktuar, por është bërë në përgjithësi, si për shembull: për të varfrit, ose për xhamitë, në atë mënyrë që testamenti bëhet i zbatueshëm me ofertën dhe me vdekjen e testamentlënësit, duke theksuar se zbatimi i këtij testamenti është detyrim referimi te gjykatësi ligjor për të disponuar një argument

të nxjerrë prej jetëshkrimit e prej punës së fukahave të mëparshëm e të mëvonshëm.

Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Sikur testamenti të ishte një zhargon popullor, patjetër që do të transferohej te ai zhargon, pa asnjë kundërshtim.”

Për disa fukaha të tjerë pranimi është i nevojshëm, pasi testamenti mund të plotësohet, vetëm pasi është pranuar, si për shembull: Dikush lë testament që prej pasurisë së tij t’i jepet një send një personi të caktuar. Ky lloj testamenti quhet Testament plotësues.

Siç shihet, s’ka asnjë kuptim të thuhet se testamenti është kontratë, kur ka të bëjë me dhënie pasurie një personi të caktuar dhe është rrëzim i të drejtës për pasurinë e për të tjera veprime, sepse s’ka asnjë ndalues ligjor e logjik që sendi të jetë kontratë në një vend dhe rrëzim i të drejtës në një vend tjetër, në ndjekje të objektit rreth të cilit rrotullohen emrat ekzistues e jo ekzistues.

Oferta pa asnjë kusht vjen prej testamentlënësit, kurse pranimi realizohet prej të ngarkuarit me zbatimin e testamentit. Oferta dhe pranimi realizohen me fjalë, me punë, ose me shkrim, pasi kriteri është ai që ne dimë, domethënë vullneti i testamentlënësit, ose jemi të sigurt për ekzistencën e vullnetit të tij që ne e kemi mësuar nëpërmjet njërit prej mjeteve të shprehjes, pavarësisht nga lloji i atij mjeti dhe s’ka asnjë ndikim, nëse vullneti ekziston realisht, ose është i shprehur me ndonjërin prej rrugëve të njohura të ndjekësit e zakoneve e të traditës, por jo për mjetet, të cilat nuk mund të jenë qëllim për të shpjeguar çështjen që kemi në trajtim.



*Pyetje:* Kur ti gjen mjetin që shpreh anën e jashtme të vullnetit, por ne dyshojmë, nëse kjo është apo nuk është argument që duhet marrë në konsideratë. Ç' duhet të bëjmë?

*Përgjigje:* Kur ne dyshojmë në origjinalitetin e shprehjes, nëse ky mjet është shprehur, ose nuk është shprehur, në këtë rast, në asnjë gjendje, nuk lejohet të mbështetemi mbi atë mjet të shprehur, për shkak të moslejimit për t'u mbështetur mbi supozimet, kur për çështjen ekziston argument, atëherë si mund të dyshohet? Nëse mjeti është argument taksativ, në lidhje me qëllimin, atëherë mbështetja mbi mjetin që tregon qëllimin, është detyrim, qoftë ai mjet fjalë, punë ose shenjë, sepse pas diturisë s'mund të ketë asgjë tjetër.

Kur mjeti është argument i supozuar, atëherë shikohet: Nëse marrja në konsideratë e atij mjeti tregon ndonjë argument ligjor, si për shembull, dëshmia e dy burrave të drejtë, ose është prej rrugës së njerëzve të mençur e prej zakoneve të tyre, atëherë merret në konsideratë, ndryshe është vetëm fjalë e kotë.

Pa dyshim që ana e jashtme e fjalëve, nëse bazohemi te tradita, është argument, sepse ndjekësit e traditës nuk mbështeten mbi hamendësime që kundërshtojnë anën e jashtme të çështjeve, përveçse kur ka shembuj të ngjashëm që tregojnë për atë mjet.

Ndërsa shkresa te ndjekësit e traditës është e njëjtë si fjala. Kjo është e barabartë, qoftë kur mbajtësi i shkresës e ka regjistruar atë në ndonjë institucion zyrtar, qoftë kur nuk e ka regjistruar, qoftë kur dëshmon kundër vetvetes, qoftë kur nuk dëshmon kundër vetvetes, qoftë kur është i aftë të flasë, qoftë kur nuk është i aftë të flasë, qoftë kur është larg vendit të vet, qoftë kur është në

vendin e vet, me kusht që ne të dimë se shkresa është e shkruar me dorën e tij.

Gjithashtu, dimë që teksti i shkresës tregon gatishmërinë e tij për plotësimin e brendisë së asaj shkrese dhe teksti i shkresës e miraton këtë gatishmëri të tij. Kështu janë edhe fjalët e shkruara që tregojnë qëllimin, pasi edhe fjalët janë në dispozitën e fjalës së shprehur me gojë dhe të shkresës. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Lejohet që pranimi të jetë punë, e cila tregon miratimin për ofertën. Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim.”

Derisa lejohet që pranimi të jetë punë, gjithashtu, lejohet që edhe oferta të jetë punë, pasi që të dyja, domethënë oferta e pranimi janë pjesë të kontratës. Me një fjalë, testamenti formulohet sipas praktikës, ashtu siç formulohet edhe me të tjera mjete.

Për sa i përket shenjës që shpreh qëllimin, ajo konsiderohet argument në pamundësi për të shprehur qëllimin me fjalë dhe ai s’ka tjetër mjet për të shprehur qëllimin përveç shenjës. Por kur ka mundësi të flasë, ose të shkruajë, në këtë gjendje, shenja nuk është asnjë send, sepse shprehja e qëllimit me shenja nuk është as prej veprime të njerëzve të mençur e as prej zakoneve të tyre, kur ata kanë fuqi e aftësi që të shprehin qëllimin me fjalë për punë të rëndësishme, siç mund të jetë testamenti, etj. Sikur të supozohet se ekziston një vend, banorët e cilit mbështeten mbi bërjen me shenjë, megjithëse kanë aftësi të shprehin me fjalë, patjetër që shenjat e tyre do të ishin argument që ndiqet.

Në përgjithësi, ne dimë fare mirë që ligjvënësi nuk u ka vënë kushte njerëzve që ata të ndjekin këtë rrugë apo një rrugë tjetër për të shprehur e për të treguar qëllimet e tyre, me

përrjashtim të rasteve të veçanta, siç është martesë e divorci, por ka bërë detyrim mbi të gjitha mbajtjen e besës për kontratat që ata bëjnë me njëri-tjetrin, të përmbahen në kushtet e kontratave dhe me kaq mjafton. Bazuar mbi këtë që u tha, çdo gjë që te njerëzit e një grupi tregon ose shpreh qëllimin, ajo gjë është argument mbi të cilën lejohet mbështetja.

### ***Tërheqja prej testamentit***

Testamenti është veprim i lejuar dhe nuk është veprim i detyrueshëm, qoftë kur është kontratë, qoftë kur është rrëzim, sepse supozohet që testamenti është marrje pasurie në zotërim pas vdekjes së lënësit të pasurisë. Gjithashtu, mbi testamentin nuk renditet asnjë ndikim gjatë kohës që jeton testamentlënësi. Bazuar mbi këtë shpjegim, lejohet që testamentlënësi të tërhiqet prej testamentit të bërë, derisa ai vetë është gjallë, qoftë edhe kur bëhet fjalë për të marrë në zotërim pasurinë e një personi të veçantë, i cili pranon ta marrë atë pasuri.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Testamentlënësi ka të drejtë të tërhiqet prej testamentit që bëri, por kjo tërheqje e tij prej testamentit duhet të ndodhë, derisa ai është në këtë jetë.*”

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: “*Burri ka të drejtë të ndryshojë testamentin e tij, ai i jep lirinë skllavit për të cilin kishte urdhëruar të mbetej në pronësi të tij, lë në pronësi të tij skllavin për të cilin kishte urdhëruar t’i jepej liria, i jep atij që nuk i jepte, nuk i jep atij që i kishte dhënë dhe të gjitha këto testamentlënësi i bën, derisa nuk ka vdekur.*”

Vetëkupto het se për atë që e dëgjon testamentin, nuk lejohet të ndryshojë ndonjë gjë prej atij testamenti, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar në Librin e Tij famëlartë, në suren “El Bekare”, në ajetin 181, në lidhje me ndryshimin e testamentit:

“فَمَنْ بَدَّلَهُ بَعْدَ مَا سَمِعَهُ فَإِنَّمَا إِثْمُهُ عَلَى الَّذِينَ يُبَدِّلُونَهُ إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ”

**“Dhe ai që bën ndryshimin e tij (testamentit), pasi e ka dëgjuar (ditur) atë, mëkati rëndon mbi ata që e ndryshojnë atë, Allahu është Dëgjuesi, i Gjithëdituri.”**

Forma të tërheqjes prej testamentit kemi, kur testamentlënësi vepron me sendin e lënë testament në atë mënyrë që mundësohet transferimi i atij sendi prej pronësisë së tij, si për shembull, me shitje, ose me dhurim, ose duke i tjetërsuar formën, si për shembull, grurin e bluan, miellin e gatuan bukë, copën e stofit e bën rrobë, etj.

Meqenëse testamenti është veprim i lejuar, është i lejuar edhe vonimi i pranimit nga ana e personit për të cilin testamentlënësi ka lënë testamentin, edhe nëse pranimi, nga ana e atij personi, vjen pas një kohe të gjatë.

Në lidhje me këtë çështje, kemi folur në mënyrë të detajuar në pjesën e tretë, në kapitullin “Kushtet e kontratës”, në paragrafin “Vijueshmëria (el muvalat)”.

## ***Pranimi e mospranimi prej personit për të cilin lihet testamenti***

Kur ai i lë testament një personi një send të caktuar, personi për të cilin lihet testamenti, e merr atë send në pronësi, as vetëm me vdekjen e testamentlënësit e as vetëm me pranimin prej tij, pasi patjetër duhet të ndodhin të dyja, domethënë vdekja e testamentlënësit dhe pranimi prej tij.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo është thënia që ka përhapjen më të gjerë, aq sa duket se gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, madje, nga ana e jashtme, është fjalë e përbashkët e fukahave.”

Padyshim që pronësia realizohet me pranimin nga ana e personit për të cilin është lënë testamenti vetëm pas vdekjes së testamentlënësit, por a mjafton vetëm pranimi i tij gjatë kohës që ishte gjallë testamentlënësi?

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorëve të librave “El Xheuahir” dhe “Miftahul Kerameh” se ai pranim është i mjaftueshëm dhe nuk e kanë bërë detyrim ripërtëritjen e pranimin për herë të dytë pas vdekjes së testamentlënësit, për shkak të vërtetësisë së emrit testament dhe kontratë.

Gjithashtu, fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” se, kur personi për të cilin lihet testamenti, e ka refuzuar testamentin gjatë kohës kur jetonte testamentlënësi, ai ka të drejtë ta pranojë testamentin pas vdekjes së tij, sepse testamenti është marrje në pronësi pas vdekjes. Refuzimi i asaj pronësie gjatë kohës që jetonte

testamentlënësi, është në pozitën e mospranimit të pasurisë së tjetrit. Sipas shprehjes së autorit të librit “El Mesalik”, ai pranim ka ndodhur gabim, domethënë anulohet.

Kur ai e refuzon testamentin menjëherë pas vdekjes së testamentlënësit, gjithashtu, ka refuzuar që në fillim të punës para se ta pranojë, testamenti prishet që në bazë, për rrjedhojë, prej ofertës për testamentin s’ka mbetur asnjë ndikim. Kur ai pranon pas refuzimit, atij nuk i kushtohet më vëmendje. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Të gjithë fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për këtë çështje dhe kjo fjalë e tyre është argument.”

Fukahatë kanë një fjalë të vetme me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe më dëshminë e autorit të librit “El Mesalik” se, kur personi për të cilin lihet testamenti, refuzon pas vdekjes, pranimi e refuzimi i tij s’janë asnjë send, për shkak se pronësia është stabilizuar. Po kështu është edhe kur ai pranon pas vdekjes, apo pranon para vdekjes së testamentlënësit. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo është thënia që ka përhapjen më të gjerë, aq sa duket se gëzon fjalën e përbashkët të fukahave.

Gjithashtu, edhe tekstet janë me shumicë e të njëpasnjëshme për mosmarrjen në konsideratë të vdekjes.”

Personi i veçantë për të cilin lihet testamenti ka të drejtë të pranojë diçka prej sendit të lënë testament. Gjithashtu, ai ka të drejtë të mos pranojë një pjesë të atij testamenti, sepse testamenti është thjesht bamirësi, prandaj nuk është detyrim përputhja e pranimit me ofertën.

## **Testamentlënësi**

Është kusht që testamentlënësi të ketë aftësi për të vepruar me pasurinë, sepse nuk lejohet lënia e testamentit prej të voglit që nuk dallon, as prej të çmendurit, sepse as i vogli e as i çmenduri nuk kanë vullnet dhe as nuk mund të mbështetesh në fjalët e atyre të dyve.

*Pyetje:* Kur burri që e lë testamentin, është i mençur, por më pas ai çmendet, në këtë gjendje a priset testamenti i lënë prej tij?

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Testamenti nuk priset me ardhjen e çmendurisë, ashtu siç nuk priset me ardhjen e gjendjes së humbjes së ndjenjave, apo me ardhjen e gjendjeve të ngjashme, në të cilat mungon mendja, edhe nëse kjo gjendje vazhdon deri në vdekjen e njeriut.”

Në librin “El Mesàbijh” thuhet: “Nuk bëhet i pavlefshëm me ardhjen e çmendurisë e të gjendjes së humbjes së ndjenjave. Kjo është e barabartë, qoftë kur gjendja vazhdon deri në vdekje, qoftë kur ndërpritet.”

Autori i librit “Bulgatul Fakijh” ka thënë: “Me fjalën e përbashkët të fukahave, testamenti nuk bëhet i pavlefshëm me shfaqjen e çmendurisë e të humbjes së ndjenjave të testamentlënësit. Kështu e ka treguar gjyshi ynë, në librin “El Misbàhu”, edhe nëse bëhen të pavlefshme të gjitha kontratat e lejuara me shfaqjen e çmendurisë e të humbjes së ndjenjave, siç mund të jetë prokurimi e të ngjashme me të, për shkak se dallimi është i qartë mes kontratave të lejuara dhe testamentit, sepse vdekja është kusht për zbatimin e testamentit, vetëkuptohet që

është me më shumë përparësi mosprishja e testamentit me shfaqjen e vdekjes e të humbjes së ndjenjave.”

Gjithashtu, nuk lejohet testamenti i të imponuarit, për shkak se mungon vullneti dhe dihet se nuk ka testament prej mendjeshkurtrit, për shkak se ai është i ndaluar të veprojë me pasurinë, por është thënë që lejohet kur ai lë testament për bamirësi e për punë të mira.

Autori i librit “El Urvetul Vuthkà”, ka thënë se testamenti i mendjeshkurtrit kurrësi nuk është i vlefshëm, duke punuar me thënie të përgjithësuese të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur njeriu arrin moshën në të cilën ai ndihet burrë, mbi të shkruhen punët e tij të këqija, shkruhen edhe punët e tij të mira dhe për atë lejohen të gjitha punët, përveçse kur është i pafuqishëm, ose mendjeshkurtër.”

Fakti që Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka lënë ndarjen mes testamentit e punëve të tjera, është argument për mbetjen e testamentit në dispozitën e ndalimit.

Për sa i përket të ngurtësuarit për shkak falimentimi, testamenti i tij është i vlefshëm, kur nuk ka lidhje me pasurinë e ngurtësuar për llogari të borxhdhënësve.

Fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” se ai që plagos vetveten ose vetëhelmohe, me qëllim vetëvrasjen dhe pastaj ai lë testament, testamenti i tij nuk është i vlefshëm, por nëse ai e lë testamentin para vetëvrasjes dhe pastaj vetëvritet, testamenti i tij pranohet.



Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që lë testament dhe pastaj kryen vetëvrasjen. A zbatohet testamenti i tij?

Ai është përgjigjur: *“Nëse ai e ka bërë testamentin para se në trupin e tij të shkaktojë ndonjë dëmtim, për shembull, plagë, ose ndonjë punë tjetër nga e cila ai shpreson të vdesë, testamenti i tij është i vlefshëm në një të tretën e pasurisë së tij, por nëse e lë testamentin, pasi në trupin e tij ndodhi plagosja, ose bëri ndonjë punë prej së cilës ai shpreson të vdesë, testamenti i tij nuk lejohet.”*

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit *“El Xheuahir”* dhe janë shprehur se, kur fëmija mbush dhjetë vjeç, lejohet të lërë testament për punë të mira e për bamirësi, ashtu siç shpjegojnë transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), të cilat disa dijetarë kanë thënë se janë dymbëdhjetë transmetime. Prej këtyre transmetime përmendim fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Kur djali mbush dhjetë vjeç, ai lejohet të lirojë skllavin, të japë sadaka, ose lë testament në një kufi të caktuar për punë të mira ose për ndonjë të drejtë.”* Të gjitha këto punë të tij janë të vlefshme.

### ***Personi për të cilin lihet testamenti***

Është kusht që personi për të cilin lihet testamenti, të ekzistojë në kohën e bërjes së testamentit, kurse testamenti i lënë për atë që nuk ekziston, është i pavlefshëm, sepse testamenti është marrje në pronësi e pasurisë, sepse nuk mund të përfytyrohet marrje në pronësi prej atij që nuk ekziston, ashtu siç nuk mund të përfytyrohet vendosja e asaj që ekziston në atë që nuk ekziston,

pasi në të vërtetë, është e vlefshme qëndrimi mbi brendinë e të atashuarës mbi atë që nuk ekziston, në ndjekje të brendisë së mëparshme të asaj që ekziston. Prej këtij shpjegimi është i vlefshëm testamenti i lënë për një kategori të caktuar, si për shembull, për të varfrit e për dijetarët, duke i parë ata vetëm si individë, për faktin se, kur testamenti lihet për një kategori të përmendur, pranimi nuk është kusht të jetë prej gjithë individëve të asaj kategorie. Siç shihet, kjo është e kundërta me pranimin prej personit të caktuar për të cilin lihet testamenti, pasi pranimi prej tij është kusht i detyrueshëm, ashtu siç e shpjeguam më sipër.

Testamenti është i vlefshëm për fëmijën në barkun e nënës, me kusht që ne kemi dijani për ekzistencën e shtatzënisë në kohën e bërjes së testamentit, kurse testamenti për shtatzëninë që do të jetë, është testament për dikë që nuk ekziston. Dituria për shtatzëninë në kohën e bërjes së testamentit reduktohet në dy rrugë. *Rruga e parë*, gruaja e lind fëmijën të gjallë brenda një kohe më pak se koha e shtatzënisë, që siç kemi thënë, është gjashtë muaj që prej bërjes së testamentit, në atë mënyrë nuk është e mundur që fëmija të lindë i gjallë në më pak se gjashtë muaj.

*Rruga e dytë*: Gruaja e lind fëmijën poshtë kohës më të gjatë të shtatzënisë, që sipas thënies më të vërtetuar është një vit, me kusht që gruaja të mos ketë burrë, si për shembull, burri ka lënë testament për fëmijën në barkun e nënës. Më pas burri vdes dhe gruaja nuk është martuar pas tij. Kur burri lë testament dhe gjithnjë ka qëndruar me gruan, më pas burri vdes dhe pas gjashtë muajve, ose më shumë se gjashtë muaj gruaja lind fëmijën, ky testament nuk është vlefshëm, domethënë fëmijës që ishte në barkun e nënës nuk i jepet asgjë si person për të cilin është lënë testamenti, për shkak të mundësisë së përtëritjes pas testamentit

dhe gruaja e lind fëmijën për gjashtë muaj. Por kjo nuk do të thotë që fëmija nuk i atashohet të vdekurit dhe se ai fëmijë nuk trashëgon, jo, fëmija i atashohet të vdekurit dhe trashëgon, duke ditur që testamenti është një gjë dhe trashëgimia është një gjë tjetër.

Vetëkuptohe se, kur gruaja e lind fëmijën një vit pas vdekjes së burrit, atësia e atij fëmije për të vdekurin mohohet në mënyrë të prerë. Hollësitë në lidhje me këtë çështje, me lejen e Allahut të Lartësuar, do të jepen në kapitullin “Trashëgimia”.

Kur burri lë testament për fëmijën në barkun e nënës dhe gruaja lind binjakë, djalë e vajzë, sendi i lënë testament ndahet përgjysmë mes djalit e vajzës në mënyrë të barabartë, sepse testamenti është dhënie dhe nuk është trashëgimi.

Testamenti lejohet për të huajin dhe për trashëgimtarin. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, duke shtuar edhe argumentet e pakushtëzuara në lidhje me testamentin, të ardhura në Librin e Allahut e në Sunetin e Profetit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” se testamenti është i vlefshëm edhe për jomyslimanin që është në besën e shtetit islam, domethënë të jomyslimanit që paguan taksën e kokës (*xhizjen*), në bazë të së cilës shteti islam i garanton atij jetën, nderin e pasurinë. Vlefshmëria e testamentit për jomyslimanin është saktësuar në ajetin 8 të sures “El Mumtehineh”:

“لَا يَنْهَأُكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ لَمْ يُقَاتِلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُمْ مِنْ دِيَارِكُمْ أَنْ تَبَرُّوهُمْ وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ”

**“Allahu nuk u ndalon t’i bëni mirë e të mbani drejtësi ndaj atyre që nuk ju luftuan ju për shkak të fesë dhe nuk ju dëbuan ju prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësi.”**

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me vlefshmërinë e testamentit të lënë për jomyslimanin që nuk është në besën e shtetit islam. Një grup fukahash, ndër të cilët edhe autorët e librave “El Mesalik” dhe “El Xheuahir”, janë shprehur për lejimin e testamentit edhe për jomyslimanët që nuk janë në besën e shtetit islam, për shkak se testamenti është dhuratë dhe dhurata është e lejuar t’i jepet jo vetëm myslimanit, por edhe jomyslimanit që nuk është në besën e shtetit islam, si dhe të tjerëve. Përveç kësaj, duhet të theksohet që testamenti, nga vetë kuptimi i fjalës “testament”, ka një dallim të dukshëm. Ky dallim qëndron në faktin se dhurata është marrje e sendit në pronësi gjatë kohës kur jeton dhuruesi, kurse “testament” do të thotë marrje në pronësi e atij sendi vetëm pas vdekjes së testamentlënësit. Pikërisht për këtë shkak, ka deklaruar autori i librit “El Mesalik”, se testamenti është i lejuar të lihet edhe për jomyslimanin që nuk është në besën e shtetit islam.

Fukahatë, argumentin për këtë lejim, e kanë nxjerrë prej fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Sendin e lënë me testamenti jepja personit për të cilin është porositur, edhe nëse ai është jehudi ose kristian, sepse Allahu i Lartësuar thotë:

“فَمَنْ بَدَّلَهُ بَعْدَ مَا سَمِعَهُ فَإِنَّمَا إِثْمُهُ عَلَى الَّذِينَ يُبَدِّلُونَهُ”

**“Dhe ai që bën ndryshimin e tij (testamentit), pasi e ka dëgjuar (ditur) atë, mëkati rëndon mbi ata që e ndryshojnë atë...”** (*Sure “El Bekare”, ajeti 181*)

Theksojmë se fjala “jehudi” e “kristian” përmbledh edhe jomyslimanin që jeton nën besën e shtetit islam, si dhe jomyslimanin që nuk jeton nën besën e shtetit islam.

Autori i librit “El Xheuahir” i përgjigjet atij që pretendon se jomyslimani që nuk jeton nën besën e shtetit islam nuk mund të ketë pronësi me këto fjalë: “Pretendimi i pamundësisë që jomyslimani që nuk jeton në besën e shtetit islam, nuk mund të ketë pronësi, flet qartë për ndalimin, por argumenti më i fuqishëm dhe absolut është për lejimin e jomyslimani të marrjes në pronësi edhe prej jomyslimanit, pa bërë asnjë dallim mes jomyslimanit që jeton nën besën e shtetit islam dhe jomyslimanit që nuk jeton nën besën e shtetit islam.”

Veç kësaj, duhet të theksohet se jomyslimani që nuk jeton nën besën e shtetit islam, ndodh që të jetë bamirës për ndonjë njeri, i cili, nga ana e tij, lë testament për këtë jomysliman, si shpërblim për bamirësinë e tij, pra, është plotësisht sikur ai i bën atij një dhuratë. Por fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët në lidhje me lejimin e dhuratës edhe për jomyslimanin.

*Shënim:* Diçka e vogël turbullon shpirtin, është fakti që tradhtarët, të cilët nxisin armiqtë e fesë e të atdheut dhe maskohen pas emrit të Islamit, pikërisht ata janë njerëzit më të ligj e më dëmtues për Islamin e për myslimanët, se sa ata që e shpallin luftën e armiqësinë sheshit.

## **Personi për të cilin lihet testamenti vdes para testamentlënësit**

Kur personi për të cilin lihet testamenti vdes para testamentlënësit, a prishet testamenti, apo trashëgimtarët e personit për të cilin është testamenti zënë vendin e të vdekurit?

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” për vlefshmërinë e testamentit, kur testamentlënësi këmbëngul në testamentin e tij dhe nuk është tërhequr prej testamentit, për rrjedhojë, trashëgimtarët e personit për të cilin është lënë testamenti zënë vendin e tij, domethënë ata përfaqësojnë rolin e tij, në refuzimin e në pranimin e testamentit.

Nëse trashëgimtarët nuk e refuzojnë testamentin, sendi i lënë testament është pronë private e tyre dhe ata e pjesëtojnë atë send mes tyre, siç pjesëtohet trashëgimia: për një mashkull dy pjesë të një femre dhe nuk pjesëtohet siç pjesëtohet testamenti, që siç u tha më sipër, pjesëtohet në mënyrë të barabartë mes trashëgimtarëve.

Imam Bakiri, babai i Imam Sadikut (*Paqja goftë mbi të!*), ka thënë: “Kush lë testament për një person, goftë i pranishëm ose jo dhe ky person për të cilin u la testamenti, vdes para testamentlënësit, testamenti u takon trashëgimtarëve të personit për të cilin u la testamenti, përveçse, kur testamentlënësi është tërhequr prej testamentit të lënë.”

*Një pyetje e dytë:* Në këtë gjendje, a transferohet sendi i lënë me testament prej testamentlënësit te i vdekuri dhe prej të vdekurit te trashëgimtarët e të vdekurit, në atë mënyrë që dispozita e pasurisë së lënë me testament të jetë si dispozita e sendeve të tjera të lëna prej tij, siç mund të jenë varësia e atyre

sendeve prej borxhit, zbatimi i testamentit të lënë prej asaj pasurie, apo transferimi ndodh që në fillim prej testamentlënësit dhe pa ndërmjetësues te trashëgimtarët e të vdekurit për të cilin ishte lënë testamenti, gjithnjë duke u bazuar mbi rregullin që ai send nuk ka lidhje me borxhin dhe nuk zbatohet testamenti prej vetë personit për të cilin është lënë testamenti.

*Përgjigje:* Trashëgimtarët e marrin në mënyrë të drejtpërdrejtë pasurinë e lënë testament prej testamentlënësit dhe pa ndërmjetësim dhe sendi i lënë me testament, pa asnjë kusht hyn në pronësi të trashëgimlënësit të tyre, sepse ai ka vdekur gjatë kohës kur testamentlënësi ishte gjallë. Vetëkuptohet se ai s’kishte pronësi mbi sendin e lënë testament gjatë kohës që jetonte.

Patjetër që trashëgimtarët trashëgojnë prej sendit të lënë testament edhe të drejtën e refuzimit e të pranimit, ashtu siç qëndron puna me të drejtën e përzgjedhjes. Nëse ata e refuzojnë sendin e lënë trashëgimi, atëherë për ata s’ka asnjë send. Nëse ata e pranojnë sendin e lënë me testament, pronësia mbi atë send transferohet te ata drejtpërsëdrejti prej testamentlënësit, sepse pranimi i tyre është pjesë prej shkakut që sjell pronësinë mbi sendin e lënë me testament.

Veç kësaj, kemi edhe fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Testamenti u takon trashëgimtarëve të personit për të cilin është lënë testamenti.”*

Kjo fjalë e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon qartë për marrjen e sendit në pronësi prej trashëgimtarëve. Gjithashtu, tregon edhe transferimin e asaj pasurie që në fillim te trashëgimtarët. Bazuar mbi këtë rregull, nuk merret prej pasurisë

së lënë me testament borxhi që ka personi për të cilin është lënë testamenti dhe as testamenti i tij.

### ***Caktimi i personit për të cilin lihet testamenti***

Ndodh që testamentlënësi të caktojë me emër personin të cilit ai i lë pasuri me testament si për shembull thotë: “Këtë e lë me testament për Zejdin.”, ose këtë xhami të përcaktuar, ose, mund të përmendet edhe një shtresë shoqërore, si për shembull, për të mjeruarit prej ndonjë katastrofe natyrore, ose e lë testamentin për bamirësi e për punë të mira.

Kur testamentlënësi, që në fillim nuk e përmend fare drejtimin për të cilin ai e lë testamentin e tij, në këtë gjendje, testamenti është pa vlerë. Kur ai e cakton në testament një person të veçantë, ose një xhami të veçantë dhe më pas ai përzgjedh ta lërë atë send me testament për dy vetë ose për më shumë, kështu që caktimi lë vend për dyshim, atëherë sendin e lënë testament për personin në fjalë ne e nxjerrim me anë të shortit. Në qoftë se përzgjedhjen e kufizon për shumë njerëz, ose testamenti është për ndonjë institucion të veçantë dhe testamentlënësi ka harruar të caktojë me emër atë institucion, kjo pjesë e pasurisë së tij, e lënë me këtë testament, shpenzohet, nuk shkon për institucionin e pashquar, por shpenzohet për punë të mira e për bamirësi.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Sipas fjalës së përbashkët të fukahave më të dëgjuar, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një njeri që ka lënë një testament dhe testamentlënësi mban mend vetëm një send. Si do të veprohet me sendet e tjera?



Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha pyetësit: “Pjesët e tjera shpenzoi për punë të mira.”

## **Sendi i lënë testament**

Sendi i lënë testament është objekti i testamentit, domethënë që është send konkret i lënë me testament. Në sendin e lënë testament është kusht të dihet qëllimi i testamentlënësit për ta lënë pikërisht atë send me testament dhe ligjërisht është veprim i lejuar. Nuk është i vlefshëm testamenti për sende që s’kanë vlerë, siç mund të jetë lëvozhga e bajames, ose lëvozhga e arrës, apo sende të tjera të cilat te praktikuesit e traditës as nuk shiten, as nuk bëhen dhuratë e as nuk lihen testament. Nuk lihet testament as vera e as derri, apo sende të tjera, të cilat ligjërisht janë të ndaluara të merren në pronësi.

Nuk është kusht që sendi i lënë me testament të ekzistojë në kohën e bërjes së testamentit. Madje testamenti është i vlefshëm për çdo send që është e mundshme që ai send të ekzistojë, si për shembull, i vogli që do të lindë kafsha barrëse; ose një dobi, si për shembull, frutat që do të japë pema; ose ndonjë punë, si për shembull, lë testament të ndërtohet një xhami; ose ai send është një e drejtë e lënë në ruajtje, në mirëbesim, si për shembull, testamenti për të hequr përgjegjësinë për borxhin, ose prej garantimit.

Madje fukahatë kanë lejuar edhe lënien testament të asaj pasurie që ai s’ka mundësi ta dorëzojë, si për shembull, shpendët në ajër, ose kafshën që ka marrë arratinë, apo sendin që i është

rrëmbyer me dhunë dhe gjendet në dorën e një mizori të fuqishëm.

Akoma më shumë, fukahatë kanë lejuar për testamentlënësin të depërtojë deri në skajet më largëta të kufijve të sendeve të paqarta dhe të thotë: “Jepini filanit, pak ose shumë, ose një pjesë, ose në hise, ose pjesën pas ndarjes.”

Me një fjalë, ai që ndjek tekstet dhe sentencat ligjore (*fetvatë*), do të shikojë se është e lejuar të lihet testament për çdo send, me përjashtim të atyre sendeve që kanë dalë jashtë këtij rregulli me argument, si për shembull, lënia testament e pasurisë së tjetrit, verës, ose dërrit.

Kur testamentlënësi e bën testamentin me fjalë të përgjithshme, me të cilat, nga ana e traditës, ose edhe nga ana gjuhësore, nuk mund të arrihet vlerësimi, domethënë që ato fjalë të komentohen sipas tekstit, nëse ai nuk ia ka lënë përzgjedhjen trashëgimtarit dhe personit për të cilin ai lë testamentin, jepet aq sa për atë dhënie mund të vërtetohet emri “vetëfinancim.”<sup>1</sup>

\* \* \*

---

<sup>1</sup> Fukahatë e kanë zgjatur shumë fjalën për shpjegimin e fjalës “pjesë”, “send”, “hisja prej shortit”, ose pjesa prej pjesëtimit e të tjera. Kush dëshiron më shumë informacion, le t’i referohet librit “El Xheuahir”, vëllimit 4, kapitullit “Testamenti”, si dhe librit “Bulgatul Fakijh”.

## MIDIS PASURISË BAZË DHE NJË TË TRETËS

Porosia e lënë testament, a nxirret prej pasurisë bazë, apo nxirret prej një të tretës? Përgjigjja për këtë pyetje kërkon shkoqitjen si më poshtë:

### **1- Vetëm farz pasuror**

Kur testamenti lihet për të kryer një farz pasuror, i papërzier me ndonjë farz trupor, si për shembull, me borxhet ndaj njerëzve, ose me borxhet ndaj Allahut të Gjithëpushtetshëm, siç janë një e pesta dhe zekati, ose ndalimi i padrejtësive dhe shlyerjet për moskryerjen e detyrimeve të urdhëruara, Për të gjitha këto, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët, që shuma e duhur për plotësimin e atij farzi nxirret prej pasurisë bazë, kur testamentlënësi vetë nuk e ka caktuar që ajo shumë të nxirret prej një të tretës, ashtu si porositi Allahu i Lartësuar në ajetin 11 të sures “En Nisa”:

“مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصِي بِهَا أَوْ دَيْنٍ”

“...pas kryerjes së testamentit ose shlyerjes së borxhit...”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që nuk e kishte dhënë të plotë zekatin gjatë gjithë jetës së tij. Kur mendoi se po i afrohej vdekja, bëri llogarinë për të gjitha shumat që kishte lënë mangët dhe kishte detyrim të jepte. Në këtë gjendje, ai la testament që kjo shumë të ndahej prej pasurisë së tij dhe t'i jepet atij që ka të drejtë të marrë zekat.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Lejohet dhe e gjithë kjo shumë nxirret prej pasurisë bazë që ai ka lënë, sepse plotësimi i këtij detyrimi është në pozitën e shlyerjes së borxhit, domethënë që është plotësisht sikur ai të kishte borxh për të shlyer. Në këtë gjendje, trashëgimtarët nuk marrin asgjë, derisa të nxirret zekati për të cilin ai ka lënë testament.”*

Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“...kjo është në pozitën e borxhit.”*, do të thotë: Plotësisht sikur ai të kishte borxh për të shlyer.

Kjo fjalë e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) është e qartë dhe tregon për të gjitha llojet e borxhit, domethënë qoftë borxh ndaj Allahut, qoftë borxh ndaj njerëzve.

## **2- Farzi është pasuror dhe njëherësh trupor**

Kur testamenti është lënë për kryerjen e një farzi pasuror dhe njëherësh trupor, siç është Haxhi, i cili kryhet me pasuri, sepse ka nevojë për shpenzim, por njëherësh është edhe farz trupor, sepse në brendinë e Haxhit ka veprime trupore, siç veshja e Ihramit, tavafi dhe saji, përfshi edhe punët e tjera të Haxhit që kryhen fizikisht.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se shpenzimet për testamentin e lënë për të kryer Haxhin nxirren prej pasurisë së tij bazë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka vdekur dhe nuk ka dhënë zekatin në shumën pesëqind dirhemë, gjithashtu nuk ka kryer as Haxhin islam, por ka lënë për imamët treqind dirhemë. Gjithashtu, ka lënë porosi që të kryejnë Haxh për të.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Haxhin për të e kryen njeriu më i afërm i tij dhe pjesa tjetër shpenzohet për plotësimin e zekatit.”*

Në një transmetim të dytë, tregohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka vdekur dhe ka lënë testament që të kryejnë Haxh për të. Si duhet të veprohet?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Nëse duhet të kryhet Haxh farz, domethënë ai vetë nuk e ka bërë Haxhin islam më përpara, shuma për plotësimin e këtij testamenti nxirret prej pasurisë bazë, sepse ky Haxh është në pozitën e borxhit që ai ka detyrim të shlyejë. Nëse ai ka bërë Haxh më përpara, domethënë që Haxhi i lënë porosi prej tij, është Haxh mustehab, shuma e nevojshme për kryerjen e këtij Haxhi nxirret prej një të tretës.”*

Veprohet siç u shpjegua, sepse Haxhi i parë, krahas mundësisë për kryerjen e tij, ishte Haxh farz, prandaj shuma për kryerjen e atij Haxhi nxirret prej pasurisë bazë, kurse Haxhi i dytë, ishte Haxh nafile, prandaj shuma për kryerjen e këtij Haxhi nxirret prej një të tretës, ashtu siç do të shikojmë në vijim.

Vlen të theksohet se Haxhi është adhurim farz dhe si i tillë, si të gjitha farzet e të gjitha llojeve, shuma nxirret prej origjinës, madje edhe kur ai nuk ka lënë porosi për plotësimin e atyre detyrimeve.

Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka vdekur dhe nuk ka kryer Haxhin islam dhe nuk ka lënë porosi që të kryejnë Haxh për të, megjithëse është i pasur. Si duhet të veprohet? Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Haxhi kryhet për atë me shpenzime të nxjerra prej pasurisë bazë që ai ka lënë dhe nuk lejohet të kryhet me shpenzime të nxjerra prej ndonjë pasurie tjetër.”*

### **3- Farzi është vetëm trupor**

Kur porosia është lënë për kryerjen e një farzi trupor, si: agjërimi e namazi, fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Bulgah” dhe me dëshminë e sejjid El Jezdiy në studimin e tij “Munxhizàtul Merijd”, botuar në fundin e margjinaturës së librit “El Mekasib”. Ata janë shprehur se shpenzimet për plotësimin e kësaj porosie nxirren prej një të tretës, nëse ai ka porositur plotësimin e atij farzi dhe nuk është detyrim nxjerrja e kësaj shume, nëse ai nuk ka lënë porosi të plotësohet ai farz, edhe kur dihet se ai ka lënë pasuri. Vetëkuptohe se djali i madh i të vdekurit fal për babain e tij namazet që ai ka lënë dhe agjëron atë agjërim që ai nuk ka agjëruar, sipas atij rregulli që kemi treguar në pjesën e parë, në kapitullin “Falja kaza e namazit”, në paragrafin “Djali i madh plotëson farzet kaza për të dy prindërit e tij”, si dhe në pjesën e

dytë, në kapitullin “Agjërimi dhe kryerja kaza e agjërimit”, në paragrafin “Agjërimi kaza për të vdekurin prej të afërmit të tij”.

*Pyetje:* Përse është detyrim nxjerrja e shpenzimeve për plotësimin e farzit pasuror prej pasurisë bazë, edhe kur është lënë testamenti i formës së prerë, që shpenzimet për plotësimin e atij farzi trupor të mos nxirren prej pasurisë bazë, madje edhe kur s’ka lënë testament për kryerjen e atij farzi, por shpenzimet nxirren prej një të tretës, kur ai ka lënë testament për kryerjen e atij farzi.

Disa fukaha e kanë reduktuar përgjigjen duke thënë se farzi pasuror ka lidhje me mbajtjen e besës nga ana e borxhmarrësit, mirëpo i vdekuri nuk ka më si ta mbajë besën, për rrjedhojë, e drejta transferohet prej mirëbesimit në lënien e pasurisë dhe vetëkuptohet që ky transferim, natyrshëm, bëhet mbi pasurinë bazë, sepse është kërkesë pasurore për atë që ka lënë pasuri. Por kur ai, mbajtjen e besës e ka kushtëzuar me ndonjë punë dhe vdes, në këtë gjendje, objekti nuk ekziston më, për rrjedhojë, nuk kemi transferim të mbajtjes së besës te pasuria e lënë prej tij, duke pretenduar se ai ka lënë pasuri, kur në fakt ai nuk ka lënë pasuri.

Mund të konstatohet se ky është thjesht një miratim, por është më e pëlqyeshme të thuhet: Shpenzimi për të paguar dikë për të plotësuar agjërimin nxirret prej pasurisë bazë, apo nxirret prej një të tretës? Kjo çështje ka nevojë për argument, por as në tekste e as nga ana logjike, për këtë argument nuk ka asnjë gjurmë.

#### 4- Jo farz

Testamenti është lënë për plotësimin e një pune që nuk është as farz pasuror e as farz trupor, por puna lidhet me plotësimin e një bamirësie. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se ky testament ekzekutohet vetëm në masën e një të tretës së pasurisë, kur ekziston trashëgimtari. Kjo është e barabartë, qoftë kur testamentlënësi e ka lënë këtë testament në kohën që ishte sëmurë, qoftë kur ishte në gjendje të mirë shëndetësore, sepse hapësira për plotësimin e këtij testamenti është vetëm një e treta dhe ekzekutohet e plotë. Nëse shpenzimi për plotësimin e asaj porosie kërkon më shumë se një të tretën, do të kemi varfërim të zbatuesit të testamentit, i cili detyrohet të paguajë shumën mbi një të tretën, prandaj ai duhet të ketë edhe lejimin prej trashëgimtarëve të tjerë. Vetëm nëse të gjithë trashëgimtarët e lejojnë shtesën, testamenti ekzekutohet i plotë.

Nëse trashëgimtarët e kundërshtojnë shtesën, testamenti zbatohet vetëm në masën e një të tretës. Nëse disa prej trashëgimtarëve e lejojnë shtesën dhe nuk e lejojnë disa të tjerë, testamenti ekzekutohet në të drejtën e lejuesve për shtesën mbi një të tretën dhe s'ka asnjë ndikim për lejimin e trashëgimtarit, përveçse kur lejimi ka dalë prej një të mençuri, të rrituri dhe që di të orientohet në punët e tij.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave dhe njoftimet për këtë çështje janë të shumta, ose transmetimet janë suksesive. Prej këtyre teksteve përmendin njoftimin që tregon se një burrë i tha të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*):



“Unë kam pasuri dhe më trashëgon vetëm një vajzë. A të jap sadaka dy të tretën e pasurisë që kam?”

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Jo.”

Përsëri burri e pyeti: “Po gjysmën?”

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) tha: “Jo.”

Burri e pyeti edhe një herë: “Po një të tretën?”

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) tha: “Një e treta, edhe një e treta është shumë. T’i lësh trashëgimtarët e tu të pasur, është më mirë se t’i lësh të varfër, që edhe ata të japin për njerëzit.”

Fjala e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*): “t’i lësh trashëgimtarët e tu të pasur”, kuptohet: Kur trashëgimlënësi nuk ka trashëgimtar, atij i lejohet të lërë testament për dhënien sadaka edhe më shumë se një të tretën e pasurisë, pasi nuk kemi as padrejtësi e as bllokim.

Në këtë kuptim, kanë ardhur transmetime të shumta prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*). Prej këtyre transmetimeve është edhe fjala që Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha për burrin që ishte në çastin e fundit të jetës: “një e treta e pasurisë së tij, nëse ai nuk ka lënë testament, trashëgimtarët nuk kanë të drejtë të firmosin për të dhënë një të tretën.”

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: “Një e treta, edhe një e treta është shumë.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka vdekur dhe nuk ka lënë as trashëgimtar e as testament. Si duhet të veprohet? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai lë testament për pasurinë e tij, për kë të dëshirojë prej myslimanëve, për të varfrit, si dhe për ata që kanë mbetur rrugës e s’kanë para të kthehen në vendin e tyre.”

Tekstet, njoftimet dhe thëniet që janë në kundërshtim me këtë fjalë të Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) janë të gjitha të parregullta e të lëna.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” se, kur trashëgimtari e lejon testamentin edhe për më shumë se një të tretën, pas vdekjes së testamentlënësit, ai ka detyrim ta mbajë besën për lejimin që dha dhe nuk ka të drejtë të heqë dorë prej lejimit të tij. Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, kur ai e ka lejuar për më shumë se një të tretën, para vdekjes së tij. A ka detyrim apo jo trashëgimtari ta mbajë besën për këtë lejim?

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El-Xhevahir” se mbajtja e besës për këtë shtesë, para vdekjes, është detyrim, ashtu siç është detyrim, kur lejimi ka ndodhur pas vdekjes.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka lënë testament për një send në prani të trashëgimtarëve të tij, por pas vdekjes së këtij burri, trashëgimtarët e prishën testamentin. Shtrohet pyetja: A kanë të drejtë trashëgimtarët të refuzojnë atë që ata vetë pohuan?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kjo nuk u takon atyre dhe testamenti i lejuar është detyrim mbi ta.”

Vlen të theksohet se, kur lejimi për më shumë se një të tretën është prej trashëgimitarit, kjo do të thotë firmosje e porosisë së testamentlënësit dhe ekzekutim i testamentit, por në asnjë rast nuk është dhuratë prej trashëguesit për personin për të cilin është lënë testamenti, i cili patjetër duhet ta marrë atë në dorën e tij.

Gjithashtu, mbi testamentin nuk janë vepruese dispozitat e dhurimit. Në lidhje me çështjen e fundit, autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në mesin tonë këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim.”

### ***Krahas borxhit s’ka as trashëgimi e as testament***

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se nuk as ndarje të trashëgimisë e as zbatim të testamentit, përveç testamentit që ka të bëjë me plotësimin e ndonjë farzi pasuror, vetëm pasi prej pasurisë së lënë të nxirren të gjitha llojet e detyrimeve pasurore dhe vetëm, nëse tepron ndonjë gjë, atëherë zbatohet testamenti në një të tretën e pasurisë që ka mbetur. Dy të tretat pjesëtohen për trashëgimtarët, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar:

“مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصِيَنَّ بِهَا أَوْ دَيْنٍ”

**“...pas kryerjes të testamentit të lënë, ose pas shlyerjes së borxhit...”** (Sure “En Nisa”, ajeti 12)

Qëllimi me fjalën testament, në ajetin e lartpërmendur, është për kryerjen e një farzi me anë të pasurisë, madje shpenzimi

për plotësimin e këtij farzi nxirret prej pasurisë bazë, ashtu siç e pamë më sipër, edhe kur ai nuk ka lënë testament për plotësimin e atij farzi.

### ***Një e treta në kohën e marrjes në dorë***

Llogaritja e një të tretës prej pasurisë që është lënë, bëhet në kohën kur trashëgimtari e merr atë në dorë dhe jo në kohën e bërjes së testamentit e as në kohën e vdekjes së testamentlënësit. Kur testamentlënësi bën testamentin dhe më pas atë e vret ndonjë vrasës, prej të cilit është marrë edhe shuma për shlyerjen e gjakut; ose testamentlënësi, kur ishte gjallë, ka vënë një rrjetë dhe pas vdekjes së tij në atë rrjetë bie një shpend, ose peshk, këto i bashkohen pasurisë bazë të lënë dhe prej saj nxirret një e treta.

Imam Bakiri, babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një burrë që ka lënë testament në një të tretën, apo në një të katërtën, ndërkaq testamentlënësi vritet. Si duhet të veprohet? Ai është përgjigjur: *“Ky testament lejohet prej trashëgimisë së tij dhe prej shumës për shlyerjen e gjakut të tij.”*

### ***Disa porosi në një testament***

Më sipër thamë që shpenzimet për plotësimin e farzit pasuror nxirren prej pasurisë bazë, kurse shpenzimet për plotësimin e farzit trupor dhe për kryerjen e testamentit të lënë për punë bamirësie, nxirren prej një të tretës, pasi është ndarë prej pasurisë bazë shuma e duhur për plotësimin e detyrimeve që kryhen me pasuri. Bazuar mbi këtë rregull, nëse këto tre lloje

porosish janë të mbledhura në një testament të vetëm, fillohet me kryerjen e farzit pasur dhe shpenzimet për këtë farz nxirren prej pasurisë bazë.<sup>1</sup> Pastaj shikohet në një të tretën prej asaj që ka mbetur, nëse ajo mjafton për kryerjen e farzit trupor.

Nëse prej një të tretës mbetet për plotësimin e bamirësisë, nëse një e treta nuk mjafton për të kryer farzin trupor, ose për të plotësuar bamirësinë dhe trashëgimtari e lejon, atëherë testamenti zbatohet mbi të gjithë pasurinë e lënë. Në qoftë se një e treta nuk mjafton për plotësimin e testamentit, kur trashëgimtari nuk e lejon të merret jashtë një të tretës, fillohet me kryerjen e farzit trupor, njëri pas tjetrit sipas renditjes që ka vënë testamentlënësi në testamentin e tij.

Sikur testamentlënësi të ketë thënë: “Paguani dikë të falë për mua një namaz për një vit dhe të agjërojë për mua një muaj.”, fillohet me namazin dhe, sikur ai të ketë thënë në testamentin e tij: “...një muaj agjërim plus një vit namaz”, fillohet me agjërimin.

Kur testamentlënësi ka pëlqyer një punë prej farzit trupor, shikohet: Nëse testamentlënësi i ka bashkuar porosinë në një fjalë të vetme, për shembull, ka thënë: “Jepini Xhemalit e Sulejmanit një mijë.”, mirëpo një e treta është vetëm pesëqind, në këtë gjendje kjo shumë ndahet mes atyre të dyve.

<sup>1</sup> Kur te ai është një e drejtë nga e cila varet e drejta e penglënies, ose një e pesta, ose zekati, ose e taksura, apo diçka tjetër që është në këtë dispozitë, kjo e drejtë ka përparësi para gjithë të drejtave, madje edhe qefinjsja e të tjera të ngjashme. Pastaj nxirret shuma për qefinin dhe për sende të tjera që kanë të bëjnë me përgatitjen e të vdekurit, punë që të vdekurit, sipas ligjit të fesë, duhet t’i bëhen patjetër. Pastaj nxirren farzet pasurore dhe të tjera detyrime sipas renditjes që u shpjegua më lart.

Nëse paraqitet një tjetër dhe thotë: “Jepni Xhemalit pesëqind dhe po kaq jepni edhe Sulejmanit.”, shuma i jepet të parit dhe testamenti për të dytin anulohet, sepse pjesa e parë e testamentit e përfshiu të gjithë një të tretën dhe për të dytin nuk mbeti asgjë.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Porosia e parë u zbatua, për faktin se ndodhi pikërisht aty ku duhej të ndodhte dhe ndodhi aty ku ishte caktuar të ndodhte, kurse pjesa tjetër e testamentit mbetet pa subjekt që të ketë lidhje me pjesën e zbatueshme të testamentit, domethënë me një të tretën, përfundimisht kemi pavlefshmërinë e pjesës së dytë të testamentit, ashtu si tregohet në njoftimin e Hamranit prej Imam Bakirit, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili është pyetur për një burrë, që në kohën kur po vdiste, la porosi: “Jepni lirinë filan skllavi e filanit, derisa përmendi pesë.” Kur u shikua në një të tretën, ajo nuk arrinte as një të tetën e shumës së vlerës së pesë skllëve për të cilët ai urdhëroi t’u jepej liria. Si duhet të veprohet në këtë gjendje?

Imami tha: “Shikohet te personi që ai përmendi me emër dhe fillohet më dhënien e lirisë së tyre. Shikohet sa është shuma e një të tretës dhe prej kësaj shume, i jepet liria të parit që ai përmendi, pastaj të dytit, pastaj të tretit, më pas të katërtit dhe në fund të pestit. Në qoftë se një e treta nuk e mbulon shumën për të pesë skllëverit dhe në fakt nuk e mbulon, domethënë që me një të tretën nuk mbulohet dhënia e lirisë së skllavit të pestë, kjo do të thotë se testamentlënësi e liroi skllavin e pestë pas një të tretës, shumë të cilën ai e ka në pronësi, prandaj lirimi i skllavit të pestë nuk lejohet.”

Edhe pse burimi i transmetimit ishte dhënia e lirisë skllavit, dispozita është e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse për të gjitha porositë e përmbledhura në një testament të vetëm, të çdo lloji qofshin punët e lëna në testament, sipas argumentit të dalë prej shpjegimit që ka përmendur në fjalën e tij “kjo do të thotë se skllavin e pestë testamentlënësi e liroi pas një të tretës, shumë të cilën ai e ka në pronësi.”

Bazuar mbi shpjegimin e mësipërm, kur ai lë testament një të tretën për një person dhe pastaj lë porosi për një të katërtën e pasurisë, ose për një të gjashtën për një person tjetër, porosia është e vlefshme për të parin dhe anulohet për të dytin, sepse testamentlënësi s’ka më shumë se një të tretën. Ajo u konsumua vetëm me porosinë e parë dhe nuk ka mbetur asgjë për porosinë e dytë.

*Pyetje:* Është prej veprimeve të lejuara që porosia e dytë të jetë kthim prej një pjese të porosisë së parë, në masën e një të katërtës, ose një të gjashtës?

*Përgjigje:* Ne e mohojmë këtë lejim, si dhe mundësinë e kthimit, krahas mbetjes së porosisë së parë në gjendjen e saj, sepse, kur vërtetohet objekti për porosinë e parë, për të dytën nuk mbetet më objekt.

Vetëkuptohet se, kur ai lë porosi për një të tretën, në favor të një personi dhe pastaj lë porosi për një të tretën për një person të dytë, porosia e dytë është kthim prej porosisë së parë, për shkak “të kontradiktës në varësinë e porosisë që e bën të detyrueshme marrjen e shumës së caktuar, si dhe për shkak se personi për të cilin është lënë porosia, ka ndryshuar, për rrjedhojë s’mbetet gjë

tjetër përveç kthimit.”, ashtu siç është shprehur autori i librit “El Xheuahir”.

### ***Porosia e lënë me sende për trashëgimtarët***

Kur trashëgimlënësi lë testament për çdo trashëgimtar një send të veçantë, të barabartë me pjesën e tij të trashëgimisë, testamenti është i vlefshëm dhe zbatimi i tij është detyrim. Për shembull, trashëgimlënësi thotë: “Kopshti për dy djemtë e Ibrahimit, shtëpia për vëllain e tij, Hasanin, parcela e tokës, për vajzën time, Merjemin.”

Në këtë testament s’ka favorizim, prandaj testamenti zbatohet i plotë, për shkak se nuk ka mbivënie të së drejtës së një trashëgimtari mbi të drejtën e ndonjërit prej trashëgimtarëve.

### ***Pjesa që merret zakonisht dhe sendi i veçantë***

Kur pasuria e lënë testament është pjesë që merret zakonisht, si një e treta, ose një e katërta prej tërësisë së pasurisë së lënë, ose prej një sendi të veçantë, personi për të cilin është lënë testamenti, ka të drejtë ta marrë sendin në pronësi, thjesht me vdekjen e testamentlënësit, qoftë kur pasuria e lënë testament nuk është e pranishme, qoftë kur ajo është e pranishme dhe personi për të cilin është lënë testamenti është ortak me trashëgimtarët, domethënë që ai merr pjesën e tij në pasurinë që është e pranishme. Gjithashtu, do të marrë pjesën e tij, kur të arrihet edhe pasuria që nuk është e pranishme.



Kur pasuria e lënë me testament është një send i veçantë, i përcaktuar e i pavarur, personi për të cilin është lënë testamenti nuk e merr atë send në pronësi, përveçse kur vlera e saj është dyfishuar në dorën e në zotërimin e trashëgimtarëve. Kur supozohet se testamentlënësi ka pasuri, të cilat nuk i ka në dorë, ose ka për të marrë borxhe dhe sendi për të cilin është lënë testamenti, është më shumë se një e treta e pasurisë që gjendet në dorën e trashëgimtarëve, ata kanë të drejtën e plotë ta kundërshtojnë personin për të cilin është lënë testamenti.

Gjithashtu, ata kanë të drejtë të ndalojnë që ai të mos marrë më shumë se një të tretën e totalit, domethënë një e treta e gjithë trashëgimisë, në mënyrë të veçantë, kur ajo pasuri, mund të humbë, ose kur është vështirë marrja e saj në dorë. Në qoftë se prej pasurisë që nuk është e pranishme arrihet diçka, personi për të cilin është lënë testamenti ka të drejtë të marrë prej mbetjes së sendit të lënë me testament në sasinë që është e barabartë me një të tretën e asaj pasurie.

### ***Testamenti për dobinë e përhershme***

Padyshim që testamenti për dobitë është i vlefshëm, si dhënia e shtëpisë me qira, banimi në atë shtëpi, frutat e kopshtit, qumështi i deleve, apo të tjera sende prej të cilave dalin dobi. Kjo është e barabartë, qoftë kur dobitë janë caktuar për një kohë të kufizuar, qoftë kur do të vazhdojnë për sa kohë të jetë edhe sendi që i jep ato dobi.

Kur dobitë nuk janë të përhershme, por janë të kufizuara për një kohë të caktuar, në këtë rast, çështja është shumë e

thjeshtë, sepse sendi ka një çmim, duke e marrë sendin në dorë dhe duke nxjerrë dobinë e tij. Po japim një shembull: Testamentlënësi e ka përcaktuar kohën e përfitimit prej dobive të kopshtit në pesë vjet. Në radhë të parë, bëhet vlerësimi i kopshti.

Për shembull, kopshti vlerësohet dhjetë mijë. Bëhet një vlerësim i dytë, duke zbritur dobinë për pesë vjet. Nëse dobia rezulton pesë mijë, prej kësaj shume nxirret një e treta, ndryshe personi për të cilin është lënë testamenti do të marrë aq sa është një e treta e një viti, ose edhe më shumë. Kjo llogaritje bëhet, kur nuk e lejon trashëgimtari, por, kur dobia është e përhershme, çmohet i gjithë kopshti së bashku me dobinë dhe gjendja është sikur të ishte në përfitimin e dobisë së përkohshme.

*Pyetje:* Si dhe me se do të vlerësohet sendi, dobia e të cilit vazhdon të jetë negative, pasi prej sendit që nuk ka dobi, nuk ka as çmim?

*Përgjigje:* Ndodh që kemi të bëjmë me dobi që kanë çmim, edhe pse çmimet mund të jenë të vogla, për shembull, prej kopshtit mund të përfitohet prej degëve të thata që thyhen prej trungjeve të pemëve të atij kopshti. Kur kopshti asgjësohet prej ndonjë shkakut, përfitohet toka e kopshtit; kur shembet shtëpia dhe në atë shtëpi nuk ka banuar personi për të cilin ajo ishte lënë me testament, trashëgimtari përfiton gurët dhe tokën e asaj shtëpie; ose kur theret delja, përfitohet prej mishit e prej lëkurës së saj. Sido që të jetë, sendi i lënë me testament, nuk është pa përfitim e pa dobi.

## Vërtetimi i testamentit

Testamenti vërtetohet me dëshminë e dy burrave të drejtë, ashtu siç thonë argumentet e pakushtëzuara, që e bëjnë detyrim të punohet me atë dëshmi.

Gjithashtu, testamenti vërtetohet me tekst e me fjalën e përbashkët të fukahave, madje, në raste domosdoshmërie, testamenti vërtetohet edhe me dëshminë e jomyslimanëve që jetojnë në kujdestarinë e shtetit islam. Prej këtyre teksteve kemi fjalën e Allahut të Lartësuar në ajetin 106 të sures “El Maide”:

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا شَهَادَةُ بَيْنِكُمْ إِذَا حَضَرَ أَحَدَكُمُ الْمَوْتُ حِينَ الْوَصِيَّةِ اثْنَانِ ذَوَا عَدْلٍ مِّنكُمْ أَوْ  
آخَرَانِ مِنْ عِبْرِكُمْ إِنْ أَنْتُمْ صَرْتُمْ فِي الْأَرْضِ فَأَصَابَتْكُمْ مُصِيبَةُ الْمَوْتِ ۖ تَحْسِبُونَهُمَا مِنْ بَعْدِ الصَّلَاةِ  
فَيُقْسِمَانِ بِاللَّهِ إِنْ اَرْتَبْتُمْ لَا نُشْرِي بِهِ فَمَنَّا وَلَوْ كَانَ دَا قُرْبَىٰ”

**“O besimtarë! Kur t’ju afrohet vdekja, me rastin e lënies së testamentit, le të dëshmojnë dy të ndershëm prej jush ose dy të tjerë që nuk janë prej jush, nëse fatkeqësia e vdekjes ju zë ndërsa jeni duke udhëtuar nëpër botë. Mbajini ata pas namazit dhe, nëse dyshoni në ndershmërinë e tyre, le të betohen në Allahun (duke thënë): “Ne nuk do ta shesim betimin me kurrfarë çmimi edhe nëse është fjala për çfarëdo të afërmi dhe dëshminë që na urdhëron Allahu nuk do ta fshehim, sepse, atëherë do të ishim vërtet keqbërës”.**

Sqarimet për këtë çështje janë dhënë në pjesën e pestë, në kapitullin “Dëshmia”.

Gjithashtu, testamenti për pasuri vërtetohet me dëshminë e një burri të drejtë dhe me betimin e tij, ose me dëshminë e një burri të drejtë dhe me dëshminë e dy grave të besueshme.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë komplikim, për shkak se argumentet janë të pakushtëzuara dhe argumentet për çështjen që po trajtojnë, janë gjithëpërfshirëse.”

Gjithashtu, testamenti për pasuri vërtetohet me dëshminë e katër grave. Për tre të katërtën e pasurisë testamenti vërtetohet me dëshminë e tri grave; për gjysmën e pasurisë, vërtetohet me dëshminë e dy grave dhe për një të katërtën e pasurisë, testamenti vërtetohet me dëshminë e një gruaje.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në lidhje me këtë çështje, s’ka asnjë kundërshtim. Bazë për këtë janë njoftimet e shumta, prej të cilave përmendim fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), të përcjellë prej Rebij’ë, në lidhje me dëshminë vetëm të një gruaje, e cila u ndodh pranë një burri në çastin kur po i afrohej vdekja. Ai bëri testament dhe aty nuk ndodhej asnjë burrë. A është i vlefshëm testamenti i lënë prej tij?

Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “*Sipas dëshmisë së asaj gruaje, testamenti lejohet vetëm në një të katërtën e pasurisë për të cilën ai la testament...*”

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: “*Dëshmia e asaj gruaje lejohet vetëm për një të katërtën e testamentit, kur gruajeja është myslimane dhe nuk dyshohet në fenë e saj.*”

Nëse do të jemi të ngurtë në tekst, do të shikojmë se testamenti nuk vërtetohet për gjysmën, madje nuk vërtetohet as për një të katërtën me dëshminë e vetëm të një burri, as i gjithë testamenti, nuk vërtetohet me dëshminë e dy grave dhe me betim.

Në analogji, me vërtetimin e të gjithë testamentit me dëshminë e vetëm të një burri dhe me betim.

Fukahatë e medh'hebit imamij janë të ngurtë me tekstin dhe autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Për shkak të ndërrimit të dispozitës, bazuar mbi interesa që e reduktojnë logjikën prej koncepteve të saj."

Për sa i përket porosisë e përgjegjësisë së një personi që të kryejë një punë për të vdekurin, ajo kurrë nuk vërtetohet pa dëshminë e dy burrave të drejtë. Në këtë porosi nuk pranohet dëshmia e grave, as kur dëshmojnë veç e veç, as kur dëshmojnë së bashku, ashtu siç nuk pranohet as dëshmia vetëm e një burri, krahas betimit.

\* \* \*

## KUJDESTARIA

### ***Kuptimi i fjalës “kujdestari”***

Kujdestari do të thotë, kur njeriu ngarkon një tjetër që, pas vdekjes së tij, ky i ngarkuar të plotësojë e të zbatojë punët që i janë lënë në ngarkim, si për shembull, të shlyejë borxhet e tij, ose të mbledhë borxhet që i vdekuri ka për të marrë, të shikojë fëmijët e tij dhe të shpenzojë për ta, si dhe të ruajë pasurinë e fëmijëve të tij. Personit që i lihen këto porosi, quhet “kujdestari i përzgjedhur”.

Autori i librit “El Xheuahir” e ka përkufizuar kujdestarinë me këto fjalë: “Ajo është për të nxjerrë të drejtën, domethënë mbajtjen e besës dhe nxjerrjen e asaj pasurie prej pasurisë që ka lënë i vdekuri, ose që ai të marrë ato që i takojnë, ose kujdestaria për një fëmijë, ose për një të çmendur, për të cilët kujdestari ka tagër të plotë si të ishte baba, ose gjyshi, ose ai vepron me anë të ndërmjetësimit, si kujdestari i lejuar për porosinë.”

Meqenëse kujdestaria është një lloj autoriteti, kujdestarit nuk i lejohet të heqë dorë, apo të tërhiqet prej detyrimit të kujdestarit, sepse kujdestaria është dispozitë që nuk rrezohet me rrëzim. Vetëkuptohet që kujdestarit i lejohet të prokurojë cilin të

dëshirojë ai që të kryejë një punë që hyn nën kujdestarinë e tij, plotësisht sikur të ishte vetë personi që dha kujdestarinë.

### ***Kthimi prej kujdestarisë e mospranimi i saj***

Porosilënësi ka të drejtë të kthejë prej kujdestarisë, derisa është gjallë. Gjithashtu, kur kujdestari ka dijeni se është emëruar kujdestar dhe personi që e ka emëruar atë kujdestar, vazhdon të jetë gjallë, kujdestari ka të drejtë të mos e pranojë kujdestarinë, me kusht që porosilënësi ka dijeni për mospranimin e kujdestarit. Kur është e pamundur që porosilënësi të njoftohet për mospranimin e kujdestarit, në këtë gjendje, kujdestaria bëhet e detyrueshme dhe kujdestarit, në asnjë gjendje, nuk i lejohet të mos e pranojë kujdestarinë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur burri i lë porosi vëllait të vet, që nuk është i pranishëm, vëllai s’ka të drejtë ta kundërshtojë kujdestarinë, sepse, sikur vëllai të ishte i pranishëm dhe do të kundërshtonte kujdestarinë, ai do të kërkonte një tjetër.”

Me këtë shpjegim bëhet e qartë se kujdestaria për kujdestarin bëhet e detyrueshme në dy gjendje.

*Gjendja e parë:* Ka dijeni për kujdestarinë dhe nuk e kundërshton, domethënë, kur është e mundur të njoftohet porosilënësi për mospranimin.

*Gjendja e dytë:* Është e pamundur njoftimi i porosilënësit për mospranimin e kujdestarisë për shkak se porosilënësi vdes, ose nuk ndodhet aty. Bazuar mbi këtë dispozitë, kujdestaria e dhënë më përpara, është prej ndodhive dhe nuk është prej kontratave,

pasi dihet që kontrata është e përbërë prej dy pjesësh: ofertës dhe pranimit, prandaj nuk mjafton vetëm mospranimi.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kujdestaria mund të jetë edhe në formën e një kontrate, si për shembull, kur porosilënësi emëron kujdestarin dhe kujdestari thotë: “Pranova.” Kjo fjalë e tij nuk mjafton, pasi për të vërtetuar kontratën, patjetër kujdestari duhet të përmendet me emër dhe pranimi prej këtij njeriu të thënë me emër, është pranim qoftë edhe pjesërisht.”

### ***Kushtet e kujdestarit***

Për kujdestarin është kusht

1- Të jetë i mençur e në moshë madhore, sepse i çmenduri e fëmija nuk mund të jenë kujdestarë as për veten e tyre dhe jo më të jenë kujdestarë për të tjerët. Patjetër që kujdestaria e fëmijës është e vlefshme, kur ai i bashkohet një të rrituri, i cili vepron i vetëm, derisa fëmija të arrijë moshën madhore, atëherë janë ortakë në veprim.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që i ka lënë kujdestarinë një gruaje së bashku me një fëmijë mashkull. A lejohet ky veprim?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kjo lejohet dhe gruaja e kryen kujdestarinë, pa pritur që fëmija të arrijë moshën madhore. Kur fëmija arrin moshën madhore, ai s’ka të drejtë të mos miratojë veprimet e gruas, me përjashtim të ndërrimeve e të ndryshimeve, pasi këto veprime ai ka të drejtë të mos i pranojë dhe gëzon të drejtën të rikthehet në porosinë që ka lënë i vdekuri.”



Kur personi të cilit i është lënë kujdestaria çmendet, kujdestaria rrëzohet. Nëse atij i rikthehet mendja, kujdestaria nuk i rikthehet më atij, sepse detyra e rrëzuar rikthehet vetëm me ndërrim.

Autori i librit “Esh Sheràiu uel Xheuahir” ka thënë: “Kur i vogli vdes, ose arrin moshën madhore i çmendur, i madhi i mençur mbetet i pavarur në kujdestari dhe gjykatësi nuk ka të drejtë të vërë një kujdestar të dytë në vendin e të voglit, për arsye të pranisë së pavarësisë së të madhit në kujdestari.”

2- Emërtimi i kujdestarit personalisht dhe, nëse lënësi i kujdestarisë thotë të jetë kujdestar njëri prej këtyre të dyve dhe nuk e përcakton me emër personin që do të jetë kujdestar, kujdestaria është e pavlefshme, për shkak se është e pamundur zbatimi i detyrës së kujdestarisë, pa ditur konkretisht cili është kujdestari.

3- Caktimi i sendit për të cilin lihet kujdestaria. Nëse lënësi i kujdestarisë thotë: “Filani është kujdestar”, pa shpjeguar se për cilin send është kujdestar, për më tepër nuk kuptohet asgjë as prej gjendjeve të ngjashme e as prej fjalëve, kujdestaria prishet. Patjetër që kujdestaria është e vlefshme, që puna të lihet në dorën e kujdestarit.

Një burrë i tha Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Babait tim po i afrohej vdekja, prandaj i thanë: ‘Lër ndonjë porosi.’

Ai tha: ‘Ky është im bir, çdo punë që të bëjë ai, ajo punë është e vlefshme.’ A është e vlefshme kjo fjalë e babit tim?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur atij burrit: “*Babai yt la porosi dhe e ka konsideruar të vlefshme.*”

4- Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se kujdestari detyrimisht duhet të jetë mysliman, kur lënësi i kujdestarisë është mysliman, por fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me kushtin e drejtësisë për kujdestarin. Për këtë çështje ata kanë tri thënie. Më e sakta e tyre është mjaftimi me besnikërinë e me qëndrueshmërinë në kryerjen e detyrës, në atë mënyrë që kujdestari e kryen porosinë ashtu siç është lënë, sepse kështu mjaftojnë argumentet e pakushtëzuara, në lidhje me kujdestarinë gjithëpërfshirëse, në lidhje me drejtësinë e me çështje të tjera. Prej jetëshkrimit të fukahave dihet se ata kanë gjykuar për vlefshmërinë e çdo kujdestarie, derisa të vërtetohet tradhtia e kujdestarit.

### ***Kujdestaria në dy vetë***

Fukahatë kanë rënë dakord mes tyre se i vdekuri ka të drejtë t’u lërë kujdestarinë dy vetëve, ose edhe më shumë. Nëse i vdekuri e ka lënë me të shkruar që secili prej tyre ka pavarësi në veprim, veprohet sipas shkresës që ai ka lënë. Nëse i vdekuri ka vënë kusht që njëri prej atyre të dyve të mos ketë pavarësi mendimi pa tjetrin, patjetër që ata të dy duhet të jenë së bashku në të gjitha veprimet. Nëse i vdekuri as nuk ka vënë kusht, as nuk e ka përcaktuar pavarësinë në veprim dhe as nuk ka vënë kusht që ata të veprojnë të dy së bashku, asnjëri prej atyre të dyve nuk ka të drejtë të veprojë i pambaruar pa shokun e tij.

Në të vërtetë, ne e dimë fare mirë detyrimin që kanë ata të dy, si zbatues, për të vepruar me një mendim të përbashkët, por dyshojmë në detyrimin që ai të veprojë i vetëm pa shokun e tij. Gjithsesi, baza është mosqenia detyrim.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo është thënia më e evidente në mesin e fukahave dhe ka një përhapje shumë të madhe, për shkak të besueshmërisë, domethënë dyshimi i lënësit të kujdestarisë, i cili e ka lënë kujdestarinë në dy vetë, domethënë që kryerja e asaj kujdestarie është e përbashkët, prandaj ajo duhet të kryhet prej atyre të dyve dhe jo vetëm prej njërit.”

Kur të dy kujdestarët kanë një mendim të përbashkët për një send, pikërisht kjo është ajo që kërkohet dhe, nëse ata të dy nuk merren vesh me njëri-tjetrin, gjykatësi ligjor i detyron ata të dy të merren vesh për çështjen që kanë për të kryer. Kur përputhja e të dyve në një vendim të vetëm është e pamundur, gjykatësi ligjor urdhëron shkarkimin e atyre të dyve dhe i zëvendëson ata me dy besnikë të tjerë, ose edhe me vetëm një kujdestar besnik, ashtu si të mendojë e të vendosë gjykatësi ligjor, sepse, në këtë gjendje, ekzistenca, ose mosekzistenca e atyre të dyve është e barabartë.

Të dy kujdestarët nuk kanë të drejtë ta ndajnë mes tyre pasurinë që kanë në kujdestari dhe asnjëri prej tyre nuk mund të ketë mendim ndryshe prej kujdestarit tjetër në lidhje me ndonjë send.

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë problem, sepse mendimi ndryshe me kujdestarin tjetër është kundërshtim në kërkesën e kujdestarisë në

lidhje me detyrimin për veprim të përbashkët, por secili prej tyre ka të drejtë të veprojë në mënyrë të pavarur, kur ka leje prej shokut të tij.”

Shumica e fukahave kanë thënë, ashtu siç është shkruar në librin “El Xheuahir”, sikur njëri prej dy kujdestarëve të vdesë dhe kushti është që të veprojnë së bashku, ose njeri prej atyre të dyve çmendet, ose tradhton, ose atyre u ndodh ndonjë gjë tjetër prej atyre punëve që e bëjnë detyrim heqjen e kujdestarisë, kujdestari tjetër vepron në pavarësi dhe nuk ka nevojë që atij t’i bashkëngjitet një person i ri, sepse veprimi bashkërisht ishte i kushtëzuar, kur edhe ata të dy ishin së bashku, pasi dihet që mungesa e kushtit nënkupton mungesën e të kushtëzuarit.

Kur të dy kujdestarët vdesin, çështja i referohet vendimit të gjykatësit dhe çështja mbetet plotësisht sikur të mos kishte kujdestar që në fillim.

### ***Tradhtia e kujdestarit***

Kur kujdestari tradhton, vetvetiu është i shkarkuar dhe të gjitha veprimet e tij bëhen të pavlefshme, pa qenë nevoja për shkarkimin e tij prej gjykatësit, sepse detyrimi për besnikëri është kusht. Por në rastin e tradhtisë, i kushtëzuari nuk mund të ekzistojë më, pasi vetë kushti nuk ekziston. Patjetër që gjykatësi e ndalon kujdestarin tradhtar të veprojë dhe, kur ai vepron, veprimi i tij gjykohet i pavlefshëm. Gjithashtu, bëhet detyrim për gjykatësin që në vendin e këtij kujdestari tradhtar, të vërë një njeri besnik, i cili përkujdeset për të drejtën e fëmijëve dhe për ruajtjen e pasurive që ka nën kujdestari.

## **Garantimi prej kujdestarit**

Kujdestari është njeri besnik dhe garanton, vetëm në rast vënie dorë, ose në rast shkujdesje, ashtu siç është për të gjithë besnikët.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka emëruar kujdestar një burrë tjetër dhe e ka urdhëruar atë t'i japë lirinë një robi me gjashtëqind dirhemë të marra prej një të tretës së pasurisë së lënësit të kujdestarisë, ndërkaq kujdestari shkon dhe i jep gjashtëqind dirhemët një burri që të bëjë Haxh për të. Ç' duhet të bëhet në këtë rast? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *"Mendoj që kujdestari të gjobitet me gjashtëqind dirhemë prej pasurisë së tij dhe kjo shumë të përdoret për qëllimin që kishte urdhëruar i vdekuri, për të liruar një rob."*

## **Kujdestaria mbi fëmijët**

Babai dhe gjyshi, nga ana e babait, kanë të drejtë të caktojnë kujdestar për fëmijët, nisur nga nevoja që kujdestaria për ata është e detyrueshme.

Autori i librit "Bulgatul Fakijh" ka thënë: "Kujdestaria e kujdestarit mbi fëmijët e lënësit të kujdestarisë vërtetohet me tekst dhe me fjalën e përbashkët të fukahave. Kjo kujdestari zbatohet ashtu siç është lënë, domethënë në kujdestari në përgjithësi, ose kujdestari e kushtëzuar. Nëse lënësi i kujdestarisë e ka lënë kujdestarinë në përgjithësi, për kujdestarin s'ka asnjë problem në kryerjen e punës që ai është ngarkuar në përputhje me ruajtjen interesave të fëmijëve, për ruajtjen e jetës së fëmijëve dhe të

pasurisë së tyre, apo për të marrë të drejtat që u takojnë fëmijëve dhe për t'i kthyer ato te fëmijët, përfshirë edhe veprime të tjera, si: blerje, shitje, marrëveshje për tokën, qiradhënie, si dhe çdo punë tjetër që ka lidhje me përmirësimin e pasurive të fëmijëve.”

Nëse lënësi i kujdestarisë ka caktuar ndonjë send të veçantë, nuk është detyrim që kjo detyrë t'i kalohet një tjetri. As nëna s'ka të drejtë të vërë ndonjë vlerë mbi fëmijët e saj, sepse nëna nuk është kujdestare e fëmijëve.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim që mund të atakohet origjina.”

Kujdestaria mbi fëmijët nuk vërtetohet ndryshe veçse me një tekst të qartë të lënë prej lënësit të kujdestarisë.

### ***S'ka kujdestari mbi fëmijët, kur është gjyshi***

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët, me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir”, se, kur babai vë një kujdestar për fëmijët e tij, kur është gjyshi nga ana e babait, kjo kujdestari është e pavlefshme, sepse babai i babait është si babai dhe askush s'mund të ketë kujdestari mbi fëmijët, kur është gjyshi nga ana e babait, qoftë edhe vetë gjykatësi ligjor.

### ***Kujdestaria për martesë***

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El-Mesalik” dhe me dëshminë e autorit të librit “El

Bulgah” se as babai e as gjyshi s’kanë të drejtë të lënë kujdestar për martesën e të voglit, mashkull ose femër. Nëse ata lënë kujdestar për martesën e të voglit, kujdestaria që ata lanë, është pa vlerë, për shkak se i vogli nuk ka nevojë për martesë. Për këtë çështje, kemi fjalën e Imam Bakirit, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur babai i djalit dhe babai i vajzës i kanë martuar ata të dy, atëherë po, martesë është e vlefshme.”, sepse është e kuptueshme se kujdestarët e lënë prej dy prindërve nuk janë vetë dy prindërit, prandaj, pa dyshimin më të vogël dhe krahas origjinës, kemi moslejimin e kujdestarisë për martesën e fëmijëve.

### ***A ka të drejtë kujdestari të vërë kujdestar?***

Fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” se kujdestari ka të drejtë të vërë kujdestar në punët për të cilat ai është venë vetë kujdestar prej lënësit të kujdestarisë, vetëm nëse, ky i fundit, e ka lejuar vënien e kujdestarisë prej kujdestarit. Gjithashtu, fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se kjo nuk lejohet për kujdestarin, kur lënësi i kujdestarisë e ka ndaluar kujdestarin të vërë kujdestar. Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, kur lënësi i kujdestarisë ka heshtur, domethënë, kur ai as nuk ka lejuar e as nuk i ka ndaluar kujdestarit të vërë kujdestar. Në këtë gjendje, fukahatë më të dëgjuar janë shprehur për moslejimin, sepse lejimi është i panjohur, prandaj si origjinë mbetet moslejimi.

## ***Detyra e kujdestarit***

Kur lënësi i kujdestarisë ka caktuar që një send të shikohet, kujdestarit nuk i lejohet që këtë detyrë t'ia kalojë një tjetri, por, nëse ai e ka lënë kujdestarinë në përgjithësi, pa caktuar konkretisht ndonjë send, kujdestarit i lejohet ta marrë në dorë ruajtjen e pasurisë së tij, ashtu siç do të lejohej për vetë lënësin e kujdestarisë, plotësisht ashtu siç qëndron puna edhe në prokurimin.

Kujdestaria mbi pasurinë nuk nënkupton edhe kujdestarinë mbi fëmijët, pasi për kujdestarinë mbi fëmijët patjetër kërkohet një shkresë e qartë, që të tregojë se kujdestaria mbi fëmijët është lënë prej vetë personit që ka emëruar kujdestarin. Kjo çështje u trajtua më sipër në paragrafin “Kujdestaria mbi fëmijët”.

## ***Paga e kujdestarit***

Kujdestari ka të drejtë të marrë një pagë prej pasurisë që ai është ngarkuar të kujdeset, aq sa merret zakonisht për atë sasi pasurie. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një person që merr në kujdestari pasurinë e jetimit, nëse ky kujdestar ka të drejtë të hajë prej pasurisë së jetimit. Ai është përgjigjur: “Ai shikon se sa pagë merr një tjetër që kryen të njëjtën detyrë dhe le të hajë në atë masë.”



## ***Ai që s'ka kujdestar***

Kur burri vdes pa emëruar kujdestar, ose vdes kujdestari dhe i vdekuri ka lënë fëmijë të cilët kanë nevojë për përkujdesje, për këta fëmijë s'mund të ketë kujdestar të imponuar, prandaj puna e këtyre fëmijëve shikohet prej gjykatësit ligjor, i cili është kujdestar për atë që s'ka kujdestar. Nëse është e pamundur të arrihet te gjykatësi ligjor, kujdestarinë për këta fëmijë e marrin njerëz të besueshëm prej besimtarëve të mirë.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Thënia më e përhapur në mesin e fukahave, në lidhje me vërtetimin e kujdestarisë për ata fëmijë, është e bazuar në tekstet e shumta e të sigurta që tregojnë për mënyrën e llogaritjes."

## ***Pohimi i kujdestarit***

Kur kujdestari pohon një borxh ose një send që kishte detyrim të shlyente i vdekuri, pohimi i tij nuk zbatohet as në të drejtën e të voglit e as në të drejtën e ndonjërit prej trashëgimtarëve të të vdekurit, për faktin se është pohim mbi të drejtën e tjetrit, sepse, në raste konflikti, kujdestari konsiderohet dëshmitar me të gjitha kushtet që kërkohen prej dëshmitarit, kur kujdestari nuk është vetë palë në padinë.

Kur kujdestari dëshmon në favor të fëmijëve, ose në favor të të vdekurit, dëshmia e tij nuk pranohet, sepse, në këtë rast, ai vërteton për veten e tij kujdestarinë për të vepruar mbi atë çka ai dëshmon.

## **Vërtetimi i kujdestarisë**

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se kujdestaria nuk mund të vërtetohet pa dëshminë e dy burrave të drejtë dhe nuk pranohet dëshmia e grave, as kur gratë dëshmojnë tek e tek e as kur dëshmojnë të gjitha së bashku. Gjithashtu, për vërtetimin e kujdestarisë nuk ka dëshmi të burrit krahas betimit. Kjo çështje është trajtuar më sipër, në kapitullin “Ndërmjet origjinës dhe një të tretës”, në paragrafin “Vërtetimi i testamentit”.

\* \* \*

## VEPRIMET E TË SËMURIT

### *I sëmuri*

Me fjalën “i sëmuri” këtu ka për qëllim të tregojë të sëmurin, sëmundja e të cilit është e puqur me vdekjen e tij, me kusht që sëmundja të jetë frikësuese, në atë mënyrë që njerëzit të mendojnë se jeta e tij është në rrezik prej asaj sëmundjeje.

Ndërsa dhimbja e dhëmballës, dhimbja e syrit, dhimbja e lehtë e kokës, ose dhimbje të tjera të ngjashme, nuk konsiderohen sëmundje frikësuese për të sëmurin dhe ky i sëmurë, prej këtyre dhimbjeve, ose edhe i sëmuri nga një sëmundje frikësuese, por që shërohet e që më pas vdes, janë në dispozitën e dhënieve të njeriut të shëndetshëm.

### *Veprimet e të shëndetshmit*

Pa asnjë dyshim e pa asnjë kundërshtim, mes shkollave juridike islame (medh’hebeve), i shëndetshmi, kur vepron në

pasuritë e tij, plotësisht në mënyrë të pakufizuar, domethënë që zbatimi i veprimit të tij nuk është i varur me vdekjen e vepruesit, veprimi i tij zbatohet që në origjinë. Kjo është e barabartë, qoftë veprim farz, si mbajtja e besës për shlyerjen e borxhit, ose favorizim, ose dhuratë apo lënie vakëfi.

Kur i shëndetshmi i var veprimet e veta me vdekjen, atëherë veprimi i tij është testament. Nëse ky testament nuk është veprim detyrimi që kryhet me pasuri, shuma për zbatimin e tij nxirret prej një të tretës së pasurisë që ai ka lënë. Në qoftë se është shlyerje borxhi, te imamatë, te shafi'itë e te hanbelitë, shuma nxirret prej origjinës së pasurisë, domethënë prej totalit të pasurisë që ai ka lënë, kurse te hanefitë e te malikitë, shuma nxirret prej një të tretës, ashtu siç është shpjeguar edhe në kapitullin përkatës.

### ***Veprimet e të sëmurit***

Nëse veprimet e të sëmurit janë të varura me vdekjen, ato janë testament dhe dispozita për këto veprime është ajo që thamë më sipër në lidhje me testamentin e të shëndetshmit, pasi s'ka dallim për testamentin, nëse është lënë në gjendje shëndetësore të mirë, apo në gjendje sëmundjeje, derisa i sëmuri e ka mendjen në vend dhe kupton e ndjen plotësisht.

Kur i sëmuri vepron pa asnjë kufizim dhe pa e varur veprimin me vdekjen e tij, atëherë shikohet: Në qoftë se veprimi kthehet te ai, si për shembull, ai ble një rrobë të kushtueshme, apo shijon ushqime e pije, ose bën shpenzime për ilaçet dhe për përmirësimin e shëndetit të tij, ose udhëton për pushime e për banjo, përfshirë edhe punë të tjera të ngjashme, të gjitha veprimet

e tij janë të vlefshme dhe askush s'ka të drejtë ta ndalojë, trashëgimtar ose jo trashëgimtar.

Kur i sëmuri bën një veprim pa pasur ndonjë përfitim, si për shembull, kur shet ose jep me qira, ose ndërron ndonjë send prej pronave të tij, duke e kompensuar me pasurinë e tij reale, puna e tij zbatohet prej origjinës së pasurisë dhe trashëgimtari s'ka të drejtë ta kundërshtojë atë, sepse trashëgimtari nuk është ngarkuar me ndonjë humbje prej vepruesit.

Kur i sëmuri vepron pa kufizim dhe pa e varur veprimin që bën me vdekjen e tij, për më tepër, në veprimin e tij ka favorizim, si për shembull, kur ai dhuron ose jep sadaka, ose shlyen borxhin e dikujt, ose fal ndonjë penaltet që shlyhet me pasuri, ose shet me çmim më të ulët se vlera e zakonshme, ose ble me çmim më të lartë, ose bën veprime të tjera që sjellin dëmtim pasuror për trashëgimtarin, shpenzimi për atë veprim nxirret prej një të tretës, plotësisht ashtu siç vepron për testamentin.

Nxjerrja e shpenzimit për veprimin prej një të tretës do të thotë që ne të ndalojmë zbatimin e atij veprimi pas vdekjes së vepruesit. Në qoftë se ai vdes me sëmundjen që e ka zënë dhe del në shesh se një e treta e pasurisë i përballon dhurimet e favorizimet, dhurimet e favorizimet zbatohen një më një, por, nëse se një e treta nuk i mbulon ato shpenzime, në këtë gjendje, bëhet e qartë prishja e veprimit shtesë mbi një të tretën, krahas mosshpërblimit të trashëgimtarit.

Në lidhje me këtë çështje, ka transmetime të shumta të shkallës "Sahijh", me të cilat kanë punuar fukahatë e mëvonshëm, ndër të cilët edhe autori i librit "El Xheuahir".

Gjithashtu, mbi ato transmetime janë mbështetur shumica e fukahave, sikurse ka thënë autori i librit “El Mesalik”. Prej atyre transmetimeve sjellim transmetimin që na njofton se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur në lidhje me një burrë, i cili, në çastet e vdekjes i jep lirinë robit të vetëm që kishte, mirëpo trashëgimtarët u ngritën dhe e kundërshtuan. Si duhet të veprohet? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Ai liron prej atij rob vetëm një të tretën.*”

Disa fukaha të tjerë kanë thënë se shuma nxirret prej origjinës së pasurisë.

### ***Ndërmjet testamentit dhe punëve që kryen i sëmuri***

Dallimi mes testamentit dhe punëve që kryen i sëmuri qëndron në faktin se lënia e testamentit ka lidhje me vdekjen, kurse punët që ai kryen, nuk kanë asnjë lidhje me vdekjen. Kjo është e barabartë, qoftë kur punët e tij s’kanë lidhje me vdekjen asnjëherë, qoftë kur puna e tij ka lidhje me një punë të caktuar dhe lidhja e asaj pune me veprimin është e lejueshme, si për shembull, ai taks të bëjë kurban dashin që ata e dinë cili është, nëse Allahu i jep djalë dhe në fakt djali lind pas vdekjes së tij. Kjo e taksur hyn në veprimet e të sëmurit.

Në librin e fik’hut hanbelij “El Mugnij” dhe në librin e fik’hut të imamive “Et’ tedhkireh” thuhet se veprimet e të sëmurit shoqërohen me testament në pesë sende dhe ndahen prej testamentit në gjashtë sende. Përputhja në fjalët e të dyja fjalive duket qartë, pasi El Alameh El Hil’lij ka vdekur në vitin 726H, çka do të thotë se ai ka marrë prej Ibn Kudamah, autorit të librit “El

Mugnij", vdekur në vitin 620H. Është me përfitim, që në vijim të sjellim fjalët e atyre të dyve në mënyrë të përmbledhur:

Pesë veprimet që shoqërohen me testament, janë:

1- Për zbatimin e testamentit dhe për zbatimin e veprimit shpenzimi nxirret prej një të tretës së pasurisë, ose prej shpërblimit të trashëgimtarëve.

2- Te imamitë, veprimet e kryera janë të vlefshme për trashëgimtarin, plotësisht si në testamentin, kurse te katër mëdh'hebet nuk është e vlefshme për trashëgimtarin, po kështu është edhe për testamentin.

3- Kur testamenti dhe veprimet e kryera janë bërë në gjendje të mirë shëndetësore, te Allahu i Lartësuar ato kanë më pak shpërblim se sadakaja.

4- Veprimet e kryera si dhe testamentet zbatohen në një të tretën.

5- Nxjerrja e shumës për veprimet e kryera dhe testamentet prej një të tretës, nuk merren në konsideratë as në gjendjen e vdekjes dhe as para vdekjes e as pas vdekjes.

Kurse gjashtë sendet, në të cilat ndahen veprimet e kryera prej testamentit, janë:

1- Testamentlënësi ka të drejtë të kthejë prej testamentit të tij, kurse dhënësit, në gjendje sëmundje, nuk i lejohet të kthejë prej dhënies së tij, kur është realizuar pranimi e marrja në dorë prej personit të cilit i është bërë dhënia. Sekretin këtu qëndron në faktin se testamenti si bamirësi është i kushtëzuar me vdekjen dhe,

derisa vazhdon kushti, testamenti nuk zbatohet dhe testamentlënësi ka të drejtë të heqë dorë prej lënies testament, kurse dhënia në gjendje sëmundje është e pakushtëzuar me ndonjë gjë.

2- Pranimi ose mospranimi i veprimeve të kryera ndodhin menjëherë dhe gjatë kohës që është gjallë dhënësi, kurse për pranimin e testamentit s'ka dispozitë, ashtu siç nuk ka dispozitë as për mospranimin e testamentit pas vdekjes.

3- Veprimet e kryera nuk janë të kushtëzuara, si për shembull, pasja dijeni për të vërtetën e dhënies e për mosdëmtimin. Edhe testamenti nuk ka kushte për dy rastet që u thanë për veprimet e kryera.

4- Veprimet e kryera kanë përparësi ndaj testamentit, edhe kur një e treta nuk mjafton për t'i plotësuar të dyja së bashku, me përjashtim të testamentit për lirimin e robit, pasi testamenti për lirimin e robit prej robërisë ka përparësi mbi të gjitha veprimet e kryera. Ky është mendimi i imamive, hanefive dhe i shafive (libri "Et Tedhkireh", kapitulli "Testamenti").

5- Kur një e treta nuk mjafton për zbatimin e veprimeve të kryera, te shafitë dhe te hanbelitë fillohet me plotësimin e të parës e kështu sipas radhës. Kur një e treta nuk mjafton për zbatimin e testamentit, pjesa që nuk mjafton, hyn te të gjithë, ashtu siç theksuam në rastin e disa testamenteve, kurse te imamitë fillohet me të parin e kështu sipas radhës, ashtu siç u tha për veprimet e kryera, do të thotë që e njëjta gjë është edhe me zbatimin e testamenteve.



## ***Pohimi i të sëmurit***

Kur i sëmuri me sëmundjen nga e cila vdes, i pohon një trashëgimtari, ose një të huaji një borxh ose një send, shikohet: Nëse këtu ka shembuj të ngjashëm, nga të cilët mund të mendohet se ai nuk është i vërtetë në pohimin e tij, madje ai akuzohet për atë pohim, në atë mënyrë që zakonisht përjashtohet që sendi për të cilin bëhet pohimi të jetë vërtet për personin në favor të të cilit bëhet pohimi; ose i sëmuri, për ndonjë shkak prej shkaqeve, ka qëllim që me pohimin e tij të preferojë ndonjë tjetër, nëse puna qëndron kështu siç u shtrua, ky pohim i të sëmurit hyn në dispozitën e testamentit dhe zbatohet prej një të tretës së pasurisë. Në qoftë se i sëmuri është besnik në pohimin e tij, në atë mënyrë që këtu nuk kemi asnjë shembull ose shenjë që të tregojë se ai është gënjeshtar në pohimin e tij dhe mes tij e mes personit në favor të të cilit ai pohon nuk ka ndonjë bashkëpunim prej të cilit zakonisht e nënkupton veprimin e tij, pohimi zbatohet prej origjinës së pasurisë, sado që të jetë shuma.

Çështja qëndron kështu siç u tha, kur dihet gjendja e pohuesit, por, kur gjendja e tij nuk dihet, domethënë, nëse ai është i akuzuar, apo është i sigurt dhe trashëgimtari thotë se trashëgimlënësi i tij nuk është besnik me pohimin që ka bërë dhe personi në favor të të cilit ai ka bërë pohimin për pasuri, ka detyrim të vërtetojë se ai e ka në pronësi sendin për të cilin i sëmuri ka bërë pohimin në favorin e tij. Nëse ai e vërteton këtë me argument, pohimi zbatohet prej origjinës së pasurisë, ndryshe trashëgimtari betohet se ai s'ka dijeni që sendi për të cilin ka pohuar trashëgimlënësi i tij është për filanin. Në këtë gjendje, pohimi zbatohet prej një të tretës së pasurisë.

Transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) flasin qartë për besnikërinë e pohuesit. Gjithashtu, ato flasin qartë se mospasja favorizim në pohimin e tij është kusht për zbatimin e pohimit prej origjinës së pasurisë që ai ka lënë, prandaj personi në favorin e të cilit është bërë pohimi, ka detyrim të vërtetojë këtë kusht me njërën prej rrugëve të vërtetimit, ndryshe nxjerrja e shumës për zbatimin e atij pohimi bëhet prej një të tretës. Rezultati i kësaj është: zbatimi i pohimit prej një të tretës, derisa të vërtetohet e kundërta, domethënë të vërtetohet besnikëria e besueshmëria e pohuesit. Patjetër, sikur të kemi akuzim për pohuesin dhe mosbesnikëri nga ana e tij, këto dy elemente janë ndaluese që zbatimi i pohimit të nxirret prej origjinës së pasurisë që ai ka lënë, derisa të vërtetohet e kundërta, domethënë të vërtetohet akuzimi.

Prej këtyre transmetimeve që tregojnë se besnikëria është kusht që pohimi të zbatohet prej origjinës e pasurisë që ai ka lënë, pasi akuzimi nuk është ndalues, kemi transmetimin që na njofton se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që u ka lënë porosi disave prej trashëgimtarëve të tij se ka borxhe për të shlyer. Si duhet të veprohet?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse i vdekuri ishte i sëmurë, jepi atij sipas porosisë që ka lënë.”

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: “...nëse ishte vërtet” dhe në një transmetim të tretë, shtoi: “... nëse ishte në gjendje të mirë.”.

Padyshim që fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) “nëse” tregon fare e qartë kushtin, atëherë zbatimi do të bëhet prej

originës, domethënë prej totalit të pasurisë që ai ka lënë, gjithnjë e kushtëzuar me besnikërinë e me fjalën e vërtetë.

Sej'jid El Jezdij, në punimin e tij shkencor (risàleh) "El Munxhezàtul matbùah", në fundin e tekstit të shkruar në marginaturën e këtij punimi shkencor, thotë: "Është e qartë që besnikëria është kusht në zbatimin prej originës dhe jo se akuzimi është ndalues. Pikërisht kjo është ajo çka mësohet prej teksteve në lidhje me varësinë e zbatimit, bazuar mbi besnikërinë, si dhe qenia e pohuesit i sëmurë, ose në gjendje të mirë, ose në gjendje të tjera. Rezultati del se nuk duhet të shpresohet që besnikëria të jetë kusht."

\* \* \*

DIVORCI.....	5
Divorcuesi.....	6
Divorci i kujdestarit.....	9
Prokurimi për të divorcuar.....	10
E divorcuara.....	12
Gruaja e dyshimtë.....	14
Vlefshmëria e divorcit në kohën e menstruacioneve.....	14
Formula .....	16
Dëshmia për divorcin.....	18
Burri suni dhe gruaja shí'a.....	20
Divorci është sunet dhe sajese.....	22
Divorci i kthyeshëm dhe divorci i pakthyesëm.....	23
E divorcua tri herë dhe bërësi hallall.....	26
Dyshimi dhe kthimi herë pas here.....	29
Vërtetimi i të divorcuarës me bërjen e saj hallall.....	29
Burri kryen marrëdhënie intime me gruan dhe pretendon divorcin.....	31
DALJA E GRUAS PREJ MARTESËS DHE NDARJA ME PAJTIM.....	32
Dalja e gruas prej martesës.....	32
Formula.....	33
Pagesa.....	37
Kushtet.....	39
Urrejtja.....	41
Dispozitat për daljen e gruas prej martesës.....	42
Ndarja me pajtim.....	46
KOHA E PRITJES LIGJORE.....	49
S'kalon kohën e pritjes ligjore.....	50
1- Koha e pritjes ligjore për të divorcuarën shtatzënë.....	54

2- Pas divorcit, gruaja pretendon shtatzëninë.....	55
3- Koha e pritjes ligjore për gruan me menstruacione të rregullta.....	56
4- Koha e pritjes ligjore e vajzës që s'ka menstruacione.....	57
5- Koha më e shkurtër e pritjes ligjore.....	58
6- Koha më e gjatë e pritjes ligjore.....	60
7- Koha e pritjes ligjore për gruan me martesë të ndërprerë.....	62
8- Koha e pritjes ligjore për gruan, burri i së cilës braktis Islamin.....	64
9- Koha e pritjes ligjore për gruan që i vdes burri.....	65
10- Pritja ligjore për shkak të kryerjes së marrëdhënieve initime të dyshimta.....	70
11- Mbledhja e dy pritjeve ligjore.....	72
12- Koha e pritjes ligjore për laviren.....	74
13- Koha e pritjes ligjore për ithtaren e librave të mëparshëm (çifute e kristiane).....	75
14- Gruaja e burrit të humbur.....	76
15- Koha e pritjes ligjore për shkak të martesës së prishur.....	79
16- Shpenzimi për gruan gjatë kohës që ajo plotëson pritjen ligjore.....	80
17- Trashëgimia e ndërsjellë mes divorcuesit e të divorcuarës.....	81
18- Ku e plotëson e divorcuara pritjen ligjore?.....	82
19- Martesa me motrën e gruas në kohën që motra e saj plotëson pritjen ligjore.....	83
KTHIMI.....	84
Kuptimi dhe legjitimiteti i fjalës “kthim” .....	84
Objekti i kthimit.....	85
Forma e kthimit.....	86
Dëshmia për kthimin.....	87
Braktisja e Islamit prej gruas gjatë kohës së pritjes ligjore.....	88

Konflikti.....	89
DIVORCI I GJYKATËSIT LIGJOR PËR SHKAK TË	
MOSSHPEZIMIT.....	93
Rëndësia e çështjes.....	93
Transmetimet.....	95
Fjalët e fukahave.....	95
Përmbledhje e fjalëve të fukahave.....	99
BURRI I THOTË GRUAS: “TË KAM SI NËNËN TIME!” (edh	
dhihàr), Burri betohet se do të qëndrojë larg gruas (el ijlàë) dhe	
MALLKIMI I NDËRSJELLË (el liàn).....	102
El ijlàë (Burri betohet se do të qëndrojë larg gruas).....	107
El liàn (Mallkimi i ndërsjellë).....	109
GJYKIMI (el kadàu).....	113
Kuptimi i fjalës “gjakim” (el kadàu).....	113
Kadiu, myftiu, muxhtehidi dhe fekiuhu.....	114
Posti i kadiut.....	115
Farzi kifàjeh.....	116
1- Kushtet.....	116
2- Pastërtia e lindjes.....	117
3- Liria.....	118
4- Të jetë mashkull.....	119
5- Drejtësia.....	119
6- Hulumtimi (ixhtihàd) .....	122
7- Vetëkontrollimi.....	124
8- Gjykatësi i arbitrazhit.....	125
Gjykimi i hulumtuesit.....	126
Gjykimi i ithtarëve të librave të mëparshëm te një gjykatës	
mysliman.....	128
ANKESA (ed da'uà) .....	131
Kuptimi i fjalës “ankesë” .....	131

Ankuesi.....	132
Dy pretenduesit.....	132
Kushtet e ankuesit .....	134
Detyra e pretenduesit.....	138
Personi kundër të cilit ngrihet ankesa.....	139
E drejta për të cilën bëhet ankesa.....	140
POHIMI (el ikràr) .....	143
Heshtja.....	143
S'kam dijeni.....	144
Pohimi me të drejtën e tjetrit.....	146
Ndërmjet pohimit dhe vërtetimit.....	147
S'ka mohim pas pohimit.....	148
Pohimi për kurvërim e vjedhje.....	152
SHKRESA DHE TRGUESIT .....	156
Kurani dhe shkrimi i borxhit.....	157
Fukahatë dhe shkresa.....	159
Treguesi dhe shkresa e thjeshtë.....	161
Treguesit.....	162
Fjalët që i vishen Imamit.....	164
DËSHMIA .....	166
Pretenduesi ka detyrim të sjellë argument.....	166
Kushtet e dëshmitarit .....	167
Rruga për njohjen e cilësive të dëshmitarit.....	167
Rruga e njohjes me burimin e dëshmisë .....	168
Rruga për njohjen e drejtësisë.....	172
Ankesa e ndërsjellë dhe mbizotërimi i argumentit.....	178
Kontrdikta mes dy argumenteve.....	181
Argumenti dhe dora.....	183
Çështje: .....	185
1- Gjykimi me dëshmi fals.....	185

2- Tërheqja prej dëshmisë.....	187
3- Në kontrata.....	189
4- Kontradikta në dëshmi.....	191
5- Dëshmia jo në procedurë gjyqësore.....	194
6- Nuk dihet se cilit besim i përket.....	196
DORA .....	200
Imamitë dhe dora.....	200
Kuptimi i togfjalëshit “vënie dorë” .....	201
Argumenti i vënies dorë mbi pronën.....	201
Pasuritë, ndodhitë, përkatësia familjare.....	202
Gjendja e dorës .....	204
TRADITA DHE PËRHAPJA MË E GJERË.....	207
Tradita.....	207
Tradita dhe legjislacioni.....	208
Tradita dhe objektet ligjore.....	209
Tradita dhe gjykimi.....	209
Përhapja më e gjerë.....	213
1- Përhapja më e gjerë dhe puna.....	214
2- Përhapja më e gjerë dhe dëshmia.....	214
3- Përhapja më e gjerë dhe gjykimi.....	216
DITURIA E GJYKATËSIT.....	218
Ndikimi i diturisë së gjykatësit në gjykim.....	218
Shkaqet e diturisë.....	218
Baza në gjykim.....	219
Ligjet moderne dhe imamët e medh’hebeve.....	221
Gjykimi, në kundërshtim me diturinë.....	222
Shikimi me sy.....	225
Gjykatat e ligjit të fesë.....	227
Shembujt e ngjashëm .....	227
Parimet e përgjithshme.....	228



Mjekësia ligjore.....	228
Përmbledhje .....	233
BETIMI.....	234
Detyra e mohuesit.....	234
Kushtet e betuesit .....	235
Objekti i betimit.....	237
Formula e betimit.....	238
Ndarjet e betimit.....	239
Betimi i mohimit.....	242
Betimi i refuzuar.....	245
Betimi plotësues.....	248
Betimi memorizues (ruajtës) .....	248
Gënjeshtër e betuesit.....	251
POROSITË.....	253
Kuptimi i fjalës “porosi” .....	253
Ligjërimi i testamentit.....	254
Formula.....	255
Tërheqja prej testamentit.....	259
Pranimi dhe mospranimi prej personit për të cilin lihet testamenti.....	261
Testamentlënësi.....	263
Personi për të cilin lihet testamenti.....	265
Personi për të cilin lihet testamenti vdes para testamentlënësit.....	270
Caktimi i personit për të cilin lihet testamenti.....	270
Sendi i lënë testament.....	273
MIDIS PASURISË BAZË DHE NJË TË TRETËS.....	275
1- Vetëm farz pasuror.....	275
2- Farzi është pasuror dhe njëherësh trupor.....	276
3- Farzi është vetëm trupor.....	278

4- Jo farz.....	280
Krahas borxhit, s'ka as trashëgimi e as testament.....	283
Një e treta në kohën e marrjes në dorë.....	284
Disa porosi në një testament.....	284
Porosia e lënë me sende për trashëgimtarët.....	288
Pjesa që merret zakonisht dhe sendi i veçantë.....	288
Testamenti për dobinë e përhershme.....	289
Vërtetimi i testamentit.....	291
KUJDESTARIA.....	294
Kuptimi i fjalës “kujdestari” .....	294
Kthimi prej kujdestarisë e mospranimi i saj.....	295
Kushtet e kujdestarit.....	296
Kujdestaria në dy vetë.....	298
Tradhtia e kujdestarit.....	300
Garamtimi prej kujdestarit.....	301
Kujdestaria mbi fëmijët.....	301
S'ka kujdestari mbi fëmijët, kur është gjyshi.....	302
Kujdestaria për martesë.....	302
A ka të drejtë kujdestari të vërë kujdestar?.....	303
Detyra e kujdestarit.....	304
Paga e kujdestarit.....	304
Ai që s'ka kujdestar.....	305
Pohimi i kujdestarit.....	305
Vërtetimi i kujdestarisë.....	306
VEPRIMET E TË SËMURIT.....	307
I sëmuri.....	307
Veprimet e të shëndetshmit.....	307
Veprimet e të sëmurit.....	308
Ndërmjet testamentit dhe punëve që kryen i sëmuri.....	310
Pohimi i të sëmurit.....	313

فقه الإمام جعفر الصادق عليه السلام

مؤلف: محمد جواد مغنية

الجزء الحادي عشر

الترجمة الى اللغة الألبانية: الشيخ الحاج سليم اصطفى

تيرانا: 2018

نام كتاب: فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام - الجزء الحادي عشر

مؤلف: محمد جواد مغنية

الترجمة الى اللغة الألبانية: الشيخ الحاج سليم اصطفى

زير نظر: وُلْتَتْ مَرِيَا

ويرايش: يريدا كولا

صفحه بندي و جلد: صبريه فزا

ناشر: جمعيت "نسيم"

چاپ: انتشارات "ليلو"

تيرانا: 2018